



SELAMI XHEPA

RRITJE PA ZHVILLIM

Shkaqet e dështimeve në
ekonominë shqiptare

Tiranë, 2022

SELAMI XHEPA

RRITJE PA ZHVILLIM

Shkaqet e dështimeve në ekonominë shqiptare

Botimi i parë, Tiranë 2022

Redaktore: Elona Çali

Desig&Layout: Grafika Elzana

Shtypur në shtypshkronjën “West Print”

© Të gjitha të drejta janë të rezervuara, Autori

Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e organizatës mbështetëse, Fondacionit Konrad Adenauer Shqipëri.

PËRMBAJTJA

Hyrje	5
Kapitulli 1 Progresi i njerëzimit: nga Kurthi Malthusjan tek shkëputja e madhe	13
Kapitulli 2 Merkantilistët e Rilindjes: proteksionizmi dhe rregullimi i ekonomisë	24
Kapitulli 3 Pronësia mbi tokën, bujqësia dhe jeta në periudhën paraindustriale	40
Kapitulli 4 Protokapitalizmi shqiptar: një historik i shkurtër i ekonomisë gjatë shekullit XX	54
Kapitulli 5 Socializmi: një ide e dështuar që nuk vdes	83
Kapitulli 6 Socializmi dhe kapitalizmi: dy sisteme në përballje	97
Kapitulli 7 Kurthet e tranzicionit	115
Kapitulli 8 Një lexim i vëmendshëm i Adamit	128
Kapitulli 9 Një model social tregu në kontekstin e ekonomisë shqiptar	140
Kapitulli 10 Varfëria, pabarazia dhe dhuna: një lidhje që duhet thyer	155
Kapitulli 11 Pagat e ulëta dhe paqëndrueshmëria e sistemit ekonomik	168

RRITJE PA ZHVILLIM
SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

Kapitulli 12	Ekonomiksi i manipulimit dhe mashtrimit	186
Kapitulli 13	“Shkatërrimi krijues” si protestë ndaj stabilitetit asfiksues	196
Kapitulli 14	Veprimi politik përballë ideologjisë	205
Kapitulli 15	Rritja e sigurisë si burim i katastrofave financiare	216
Kapitulli 16	Taksimi, shpenzimi dhe përfaqësimi publik	227
Epilog	Identiteti i ekonomisë shqiptare në rrjedhën e historisë	244
Literatura		254

HJRJE

Në thelbin e vet, historia e ekonomisë nuk është një tjetër veçse një përpjekje për të shpjeguar shumëllojshmërinë e modeleve të rritjes, stancionit dhe rënies së shoqërisë përgjatë kohës, si dhe të eksplorojë mënyrën se si përplasjet që janë pasojë e ndërveprimit njerëzor, prodhojnë rezultate që divergojnë shumë nga njëra-tjetra. (North, 1990¹)

Në kërkim të një shpjegimi të tillë, në një konferencë mbi shkaqet e prapambetjes së Europës Juglindore, të zhvilluar në vitin 1983 në Liqenin e Komos (Itali), u shtrua pikërisht një pyetje e tillë nga Eric Hobson²: “Pse Shqipëria nuk është aq e pasur sa Zvicra? Të dyja janë pak të populluara, vende malore, me burime të pakta, shtete të dobëta por të pavarura, ofruese mercenarësh dhe ushtarësh dhe kanë jetuar në paqe pjesën më të madhe të historisë së tyre.” Një pyetje intriguese për çdo studiues, por që kërkon një hulumtim të detajuar në historinë, ekonominë, politikën, kulturën dhe aspektet sociale të vendit, pas në historinë e vet dhe deri në ditët tona.

1 Douglass North, 1990, *Institutions, Institutional Change and Economic Performance*, Cambridge University Press.

2 Daniel Chirot, 1989, “The origins of backwardness in Eastern Europe: Economics and Politics from the middle ages until the early twentieth century”, Oxford University Press.


RRITJE PA ZHVILLIM
SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

Në një kontekst më të gjerë, pyetja e mësipërme duhet parë edhe në diferencat e zhvillimit midis Perëndimit dhe Perandorisë Otomane dhe te krijimi i një ndarjeje të qartë dhe të dukshme Lindje-Perëndim. Siç dihet, tezat mbi ndarjen Lindje-Perëndim dhe Veri-Jug kanë qenë një çështje dominuese në debatin intelektual e akademik, veçanërisht në vitet e Luftës së Ftohtë.

Në fakt, historianë të shquar të ekonomisë nënvizojnë se unike është shkëputja e Perëndimit, ndërsa Lindja duhet lexuar në kontekstin e një evolucioni dhe progresi të ngadaltë - një evolucion pa zhvillim – siç ishte edhe gjithë pjesa tjetër e botës. Vetë Ballkani duhet parë si diçka që ishte tipike për pjesën më të madhe të botës. Ai ka kaluar përmes periudhave të alternuara të prosperitetit dhe rritjes së popullsisë, me periudha rënieje ekonomike dhe demografike, të kaosit politik, migrimeve, etj. Kjo paradigmë madje, sipas disa historianëve të ekonomisë (Clark, 2008)³ është një tipar dallues i gjithë ekonomisë botërore deri në fillimin e Revolucionit Industrial para vitit 1800, siç bëhet evident nga grafiku 1, një interpretim të të cilit do e vijoj në kapitullin pasardhës.

³ Gregory Clark, 2008, *A Farewell to Alms: A Brief Economic History of the World*; Princeton University Press

Grafiku 1: Historia e ekonomisë botërore në një grafik. Rritja e të ardhurave që nga viti 1000 para Krishtit



Burimi: Gregory Clark, 2008

Në një moment reflektimi mbi gjendjen e njeriut shqiptar përgjatë gjithë historisë deri në krijimin e shtetit shqiptar, do t'i ngjasonte atij të një njeriu të humbur nëpër perandoritë e kohës. Tokat, njerëzit dhe pasuritë i jepeshin tregjeve të perandorive, një herë të Bizantit e më vonë asaj Otomane, por duke mbetur vazhdimisht në periferi të zhvillimit ekonomik. Standardi i jetesës së banorëve, në modelin e vet, mund të krahasohet në thelb me të njëjtin model që mund të përshkruajmë edhe në ditët e sotme – një shoqërie të ndarë në grupe, ku disa prej tyre kanë bërë një jetesë normale e të krahasueshme me ato të grupit përfaqësues edhe në vendet e tjera, e ku grupe të tjera kanë ndarë të njëjtin nivel mjerimi me grupet e tyre analoge në vendet e tjera. Ndeshim në

shënimet e udhëtimit të kronikanit të famshëm turk Celebia përshkrime që na sjellin në përfytyrimin tonë jetën që kishin qytetet shqiptare, cilësinë e ushqimit apo zakonet e tjera të popullsisë, dhe nga mendja të fashitet përfytyrimi që kemi të ruajtur në kujtesën tonë për vendin tonë si një vend krejtësisht i prapambetur. Udhëtimi i historisë kalon nëpër periudha lulëzimesh e progresi, por dhe prapësimesh e regresi, pasojë e faktorëve aksidentalë, ndikimeve të jashtme, apo rrethanave të caktuara historike që kanë kushtëzuar vetë gjendjen e shoqërisë njerëzore në rajon apo dhe në mbarë botën.

Historiografisë së ekonomisë shqiptare i mungojnë studimet kuantifikuese të rritjes dhe zhvillimit ekonomik pasi nuk disponojmë të dhënat statistikore për t'i kryer ato. Por, edhe në rastet kur të dhëna të caktuara mund të gjenden, saktësia e tyre është larg gabimit normal të pranimit të tyre si të dhëna vendimtare në gjykim. Mungesa e të dhënave kabërë që në punimet kërkimore të studiuesve të huaj Shqipëria të mos zërë ndonjë vend të posaçëm apo dhe të mos përmendet fare, kur i referohen ekonomive të Ballkanit apo Europës Juglindore. Këtë situatë e ndeshim deri në vitet e fundit të shekullit XX. Për pasojë, kur shkruan për historinë e ekonomisë sonë, ne ndeshemi kryesisht me histori episodesh të ndryshme të sjella përmes shënimeve të udhëtimit të personaliteteve të shquara të kohës apo me interpretime mbi baza ideologjike të zhvillimeve ekonomike e shoqërore të periudhës së monarkisë apo të komunizmit. Kjo vë në dyshim besueshmërinë e këtyre punimeve dhe

për pasojë një vakuum në historinë e ekonomisë së vendit është i dukshëm. Siç e thotë Thomas Carlyle, “... çmimi i të punuarit me statistikat historike është vigjilenca e përjetshme.”⁴ Për këto arsye, motivi për të hulumtuar në të shkuarën e jetës ekonomike e shoqërore të vendit, mbetet një detyrë e rëndësishme e historianëve të ekonomisë, që mund të jetë një degë e rëndësishme e kërkimeve në këtë fushë.

Ky libër përpiqet të eksplorojë mbi arsyet e moszhvillimit të ekonomisë shqiptare, në rolin e politikave dhe doktrinave ekonomike të kohës, bazuar në studimet e kryera nga autorë të shquar dhe njohës të realiteteve politike ekonomike e sociale, në të dhëna e statistika të arkivave dhe botimeve zyrtare të kohës dhe në përjasjen e këtyre zhvillimeve me doktrinën ekonomike dominuese, duke deduktuar ndikimet e politikave, reformave apo faktorëve të tjerë influencues në gjendjen e dhënë të ekonomisë së vendit.

Rrugëtimi i këtij libri nis nga Perandoria Otomane si pjesë përbërëse e së cilës Shqipëria ka qenë që prej shekullit XIV e deri në fillimin e shekullit XIX. Politikën ekonomike të kohës dhe doktrina merkantiliste që i kishin shërbyer aq shumë Perëndimit për të realizuar kapërcimin nga shoqëria feudale drejt sistemit kapitalist i shpjeguar përmes tranzicionit nga kapitali tregtar drejt kapitalit industrial, nuk ishin replikuar në Lindje. Kjo ishte dhe shkëputja e parë e madhe në modelin e zhvillimit të dy botëve. Më tej, krijimi i shtetit

⁴ Cituar nga, Todd G Buchholz, 2007, Ide të Gjalla të Ekonomistëve të Vdekur”, ISP&Dita 2000.

RRITJE PA ZHVILLIM
SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

shqiptar në vitin 1912, pas një periudhe destabiliteti të brendshëm, krijon mundësi për hedhjen e bazave institucionale të kapitalizmit dhe fillojnë të shfaqen tiparet e para të një shoqërie protoindustriale. Por konfliktet ballkanike dhe dy luftërat botërore do të ndikonin në progresin ekonomik e shoqëror. Ndërsa vendosja e komunizmit pas luftës, ishte një prapësim serioz në modelin e zhvillimit, dhe me gjithë progresin e shënuar në disa aspekte të jetës ekonomike e sociale, shembja e tij tregoi qartë koston me të cilën ishte blerë ky progres. Ishte shembja e Murit të Berlinit që e riktheu vendin në shinat e modelit normal të zhvillimit shoqëror e ekonomik, bazuar në pronën private dhe lirinë e shkëmbimeve dhe të veprimtarisë ekonomike. Këto tre dekada të tranzicionit sigurisht që kanë dëshmuar fuqinë e sistemit dhe kanë provuar se liria funksionon. Por një sërë dështimesh serioze që kanë karakterizuar këtë udhëtim historik, veçanërisht e shfaqur kjo në nivelet akoma të larta të varfërisë në vend dhe thellimit të pabarazive sociale në nivele shqetësuese, janë një thirrje për korrigjime të forta të sistemit. Në thelb, e gjitha rruga e zhvillimit ekonomik e shoqëror të Shqipërisë përgjatë historisë, siç përpiqem të provoj përmes këtij libri, është një histori e dështimit të institucioneve dhe përzgjedhjes së modelit të zhvillimit. Ndërsa në epokën përpara Revolucionit Industrial dhe në dekadat e sistemit komunist, problemi ishte sistemi dhe doktrina, në pjesën tjetër të historisë problemi ka qenë dështimi institucional, paaftësia e klasës politike dhe qeverisjes

për të garantuar themelet mbi të cilat ngrihet godina ekonomike e shoqërore e vendit.

Ky libër është një përmbledhje e punës kërkimore të zhvilluar gjatë disa viteve, dhe bashkë me të përmbledh dhe një sërë shkrimesh e punimesh të periudhës së tranzicionit që janë publikuar gjatë pesë viteve të fundit nga bashkëpunimi me revistën Medius.

Dëshiroj të falënderoj Fondacionin Konrad Adenauer Tiranë për mbështetjen bujare në botimin e këtij libri.

Uroj që lexuesit do ta gjejnë zbavitëse leximin e librit dhe se ai do të ndihmojë sadopak në një kuptim më të plotë të evolucionit social ekonomik të shoqërisë përgjatë historisë sonë.

Kapitulli 1

PROGRESI I NJERËZIMIT: NGA KURTHI MALTHUSJAN TEK SHKËPUTJA E MADHE

Kur përpiqemi të ndërtojmë gjurmët e evolucionit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë së një vendi përgjatë historisë, fakti i parë dhe ndoshta më i qenësishëm që duhet të sjellim në konsideratë është se zhvillimi dhe mirëqenia materiale janë një fenomen relativisht modern, i fillimeve të shekullit XIX. Ato lidhen me Revolucionin Industrial të filluar në Angli dhe vetëm që prej asaj kohe, bota ka hyrë në një përparim ekonomik e shoqëror të paprecedentë në histori.

Bota e para vitit 1800 ishte mbërthyer në të ashtuquajturin Kurthi Malthusjan⁵, kurritja e popullsisë e tejkalonte çdo përmirësim teknologjik (përmirësimi teknologjik shënonte një ritëm mesatar vjetor 0.05%,

5 Thomas Robert Malthus (1766 - 1834), klerik, ekonomist i ekonomisë politike dhe demografisë, mik i David Hume dhe Zhan Zhak Ruso, autor i veprës tronditëse *“Ese mbi Parimet e Popullsisë”* (1798). Malthus vlerësonte se popullsia rritej në progresion aritmetik ndërsa të mirat materiale në progresion gjeometrik, gjë që do ta mbante njerëzimin në një gjendje stanjacioni ku periudhat e prosperitetit lidheshin vetëm me episode e rënies së popullsisë ndërsa sa herë që popullsia rritej, të mirat materiale për frymë të popullsisë pakësoheshin.

ose sa 1/3 e ritmit të sotëm; Clark, 2007)⁶, duke bërë që ritmi i zhvillimit ekonomik të mbetet konstant që prej epokës së shoqërisë së gjuetisë. Sipas statisticienit të shquar Agnus Madison, rritja e ekonomisë botërore para Revolucionit Industrial ishte me 0.006%, ose 7% gjatë një shekulli. Grafiku që na shfaq prodhimin, të ardhurat dhe mirëqenien e shoqërisë që prej fillësive historike të njerëzimit shënjohe me një vijë të drejtë dhe të pandryshueshme përgjatë mijëvjeçarëve, ndërsa pas vitit 1800, trajektorja merr një formë eksponenciale, siç u prezantua në grafikun 1 në Hyrje. Rritja e ekonomisë europiane që nga gjysma e dytë e shekullit XIX ishte aq e madhe, sa dhe vetë Karl Marksi, ky “orakull i irrituar” dhe kritik revolucionar i sistemit ekonomik kapitalist, nuk i kishte rezistuar tundimit që të bëhej pjesë e spekulimit të Bursës së Londrës, duke investuar dhe fituar një shumë prej 400 paundësh⁷. Me gjithë divergjencat në nivelin e zhvillimit ekonomik të të dyja pjesëve të Europës, deri në fillimin e Revolucionit Industrial, diferencat ishin shumë të ngushta. Në vitin 1700 diferencat në treguesit e zhvillimit ekonomik midis vendeve vlerësoheshin në raportin 1:1.5 (1.6) (Bairoch, 1981)⁸.

6 Gregory Clark, 2007, “A Farewell to Alms: A Brief Economic History of the World”, Princeton University Press. Në librin e profesorit Robert Gordon “The rise and fall of American growth: the US standart of living since the civil war” (Princeton University Press, 2016), shifra e rritjes së ekonomisë botërore sipas Agnus Madison raportohet 0.006%, ose 7% për një shekull.

7 Niall Ferguson, “The Cash nexus: Money and Power in the Modern World 1700-2000”, Penguin Books, 2001, fq.5

8 Paul Bairoch and Maurice Lévy-Leboyer, 1981, Disparities in Economic Development Since the Industrial Revolution, Palgrave: Macmillan, 1981.

Duket si paradoks që ndërsa Revolucioni Industrial e bëri botën më të vogël, e solli atë më pranë në sajë të revolucionarizimit të transporteve dhe komunikimit, ai shënoi njëherësh edhe ndarjen më të madhe të saj, të Lindjes nga Perëndimi, midis të pasurve dhe të varfërve. Në vitin 1750 diferenca e të ardhurave për frymë ndërmjet Europës Perëndimore (përfshirë Britaninë) dhe asaj Lindore ishte 15%; u rrit në 20% në vitet 1800; 64% në 1860 dhe gati 80% në vitet 1900⁹. Vlerësuar në tërësi, sipas Bairoch (1981) ekonomia europiane (+ Rusia) për periudhën 1800-1913 u rrit me 1.7% në vit, dhe madhësia e ekonomisë së saj brenda kësaj periudhe u pesëfishua. Prodhimi industrial ishte rritur me një ritëm mesatar vjetor prej 2.6%, krahasuar me prodhimin bujqësor me një rritje prej 1%.


Në këtë paraqitje grafike të të ardhurave të marra nga *Our World in Data* (ourworlddata.org), të dhënat mbi prodhimin për frymë të shprehura në dollarë amerikanë të vitit 2011, rezultuan se të ardhurat për frymë të ish-Perandorisë Otomane në vitin 1700 ishin 923\$ ndërsa në vitin 1820 kishin arritur në 974\$, duke u rritur me vetëm 51\$ në harkun kohor të 120 viteve. Të ardhurat për frymë në Shqipëri në vitin 1870 ishin sa 61% e të ardhurave për frymë në Turqi. Të ardhurat për frymë në Turqi në vitin 1820 ishin sa 42% e të ardhurave për frymë në Europën Perëndimore, do të binin në 35% në vitin 1870, deri sa të shënonin kolapsin e plotë në vitet e Luftës së Parë Botërore. Ky

⁹ David Landes, 1995, "The wealth and poverty of nations Why Some are So Rich and Some So Poor", Little, Brown

RRITJE PA ZHVILLIM
SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

grafik ilustron dy ide themelore: (a) se të ardhurat dhe mirëqenia në përgjithësi në epokën para Revolucionit Industrial kanë qenë në stanjacion, dhe se (b) pas Revolucionit Industrial diferencat midis vendeve janë thelluar gjithnjë e më shumë. Këto divergjenca në nivelet e zhvillimit ekonomik vazhdojnë akoma dhe në vitet e tanishme. Për më tepër, rreziqet që imponohen nga progresi i fortë teknologjik që karakterizon epokën e sotme të Revolucionit të Katërt Teknologjik, mund të bëjnë që hendeku në treguesit e zhvillimit të thellohet edhe më shumë. Pasi kemi humbur shanset e revolucioneve më të hershme industriale, vendet në zhvillim ku bën pjesë dhe vendi ynë, rrezikojnë të humbasin edhe Revolucionin e Katërt.

Grafiku 2: Prodhimi i Brendshëm Bruto për frymë, në USD me çmimet fikse të vitit 2011, për periudhën 1750-2018



Ky proces i shkëputjes dhe divergjencës së madhe, ka ngritur shumë pikëpyetje mes studiuesve, të tilla si: Pse Revolucioni Industrial lindi pikërisht në atë kohë? Pse lindi në Angli dhe jo në ndonjë vend tjetër

të kontinentit? Si u përhap në pjesën tjetër të Europës dhe pse për më tepër mbeti i kufizuar vetëm në Veri dhe Perëndim të Europës ndërsa nuk u shtri edhe në Europën Juglindore dhe në Ballkan?

Një literaturë e pasur e historisë ekonomike është tashmë e disponueshme dhe një mori faktorësh, shkaqesh e arsyesh janë renditur dhe analizuar. Në perspektivën e vet historike, revolucioni industrial nuk ishte një akt i vetëm; ai ishte një proces i nisur prej shekujsh, ku një sërë shpikjesh dhe inovacionesh teknologjike kishin nxitur tregtinë ndëreuropiane por edhe ndëroqeanike; kishin nxitur zhvillimin e financave dhe të bankave në kuptimin e mirëfilltë modern, dhe krijuan premisa të fuqishme për rritjen e prodhimit të manufakturës, në industrinë tekstile, të çelikut dhe në industrinë kimike.

Një tipar i ekonomisë europiane të kësaj periudhe është se zhvillimi i saj ishte kryesisht rajonal, më tepër se një zhvillim harmonik i të gjithë kontinentit. Klastera industrish të caktuara ishin të përqendruara në rajone të caktuara të kontinentit, të cilat u shndërruan në gjenerator të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik të qyteteve ku ato ishin vendosur.

Industrializimi i Europës nuk ishte një proces i thjeshtë imitimi dhe adoptimi të teknologjisë angleze. Ai pati veçoritë e veta për secilin nga vendet e kontinentit, dhe që i pati fillesat dhe nxitjet e saj në hallka të ndryshme të zinxhirit të industrisë. Në Angli, zanafilla e këtij revolucioni ishin përsosjet në industrinë e fillit të pambukut, ndërsa në Gjermani dhe disa vende të tjera, në industri të prodhimit të mallrave finale të konsumit.

RRITJE PA ZHVILLIM
SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

Një tjetër dallim midis Anglisë dhe kontinentit në rrugën e industrializimit, lidhet me diferencat në sistemin bankar. Praktika angleze kishte krijuar një sistem bankar të ndarë nga biznesi korporativ ose nga bankat e investimit. Pra, bankat e kufizonin aktivitetin e tyre vetëm në kredidhënie dhe plotësimin e nevojave për burime financiare afatshkurtra, ndërsa financimi afatgjatë sigurohej nga tregjet e letrave me vlerë (bursat e kapitaleve), duke e shndërruar kështu Londrën në tregun financiar më të zhvilluar dhe më të sofistikuar të botës. Ndërsa sistemi bankar gjerman dhe i vendeve të tjera të kontinentit ishte ai i bankave investuese, ku bankat ishin edhe zotëruese të ndërmarrjeve, si dhe diktonin menaxhimin nëpërmjet emërimit të anëtarëve të tyre në bordet drejtuese.

Duke vështruar hartën e kontinentit për të parë përhapjen e industrializimit, rezulton se ajo u zhvillua përgjatë akseve: që nga fushat e Skocisë deri në Lombardi, dhe nga Franca-Polonia-Gjermania, deri në Ukrainë. Këto akse krijuan sinergjinë e fuqishme duke kombinuar burimet ekonomike, zhvillimin e një infrastrukture të fuqishme transporti dhe një integrim real të një ekonomie europiane. Nga ana tjetër, u krijua një shkëputje e madhe me pjesën tjetër të Europës Juglindore, që shtrihet deri në Italinë e Jugut dhe Gadishullin Iberik. Prapambetja e kësaj pjese të Europës në raport me zhvillimin impresionues të veriut, mbetet akoma një nga temat më interesante për kërkuesit dhe historianët e ekonomisë.

Revolucioni industrial i shekullit XIX ishte vepër e klasave të mesme dhe borgjezisë. Kjo mund

të shpjegojë superioritetin e Europës perëndimore e cila kishte krijuar, që në mesjetë, një klasë të mesme të pasur dhe të fuqishme, ndërsa në periferi të Europës ndeshim një borgjezi të dobët. Klasat e mesme të pasura dhe të fuqishme u bënë faktorë të rëndësishëm të reformave që hodhën poshtë institucionet e vjetra që ishin bërë pengesë për industrializimin.

Por një rol thelbësor në këto zhvillime kanë luajtur politikat dhe institucionet. Gjysma e variancës në performancën ekonomike të kontinentit mund të shpjegohet me politikat ekonomike dhe ndryshimet institucionale¹⁰. Përndimi kishte regjime parlamentare liberale, tregje liberale të faktorëve të prodhimit dhe një sistem ligjor që mbështeste funksionimin efektiv të tyre. Kjo kontrastonte me pjesën tjetër të Europës që kishte regjime autoritariste, qeverisje inefficente dhe që akoma ruante mbeturinat e feudalizmit. Në traditën e sotme kërkimore e akademike, institucionet dhe ndryshimet institucionale konsiderohen si variablat kyçe që shpjegojnë ndryshimet në zhvillimin ekonomik midis vendeve dhe rajoneve gjatë pesë shekujve të fundit. Nga ana tjetër, siç do të trajtohet më hollësisht dhe më poshtë në këtë kapitull, institucionet janë endogjene, të përcaktuara nga tradita, kultura, zakonet dhe besimet e popujve; ato përcaktohen nga shoqëria apo grupe të caktuara shoqërore. Duke qenë se grupet e ndryshme shoqërore kanë përfitime të ndryshme nga sistemi i institucioneve ekonomike, atëherë ka një

10 Douglass C. North, 1992, TRANSACTION COSTS, INSTITUTIONS, AND ECONOMIC PERFORMANCE, International Center for Economic Growth,

RRITJE PA ZHVILLIM
SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

konflikt në zgjedhjen e tyre dhe në analizë të fundit, ato zgjidhen në favor të grupeve më të pushtetshme. Një sistem institucional që mbështet klasën e kapitalistëve industrialë kundrejt pronarëve të tokave, për shembull, nxit zhvillimin e industrisë në raport me bujqësinë. Ndërkohë, siç e nënvizon Pamuk ¹¹, politikat centralizuese të ndjekura nga Perandoria Otomane që nga shekulli XV e në vazhdimësi, i vunë institucionet në shërbim të burokracisë e cila ishte klasa më e rëndësishme shoqërore. Edhe ndryshimet institucionale të kohës favorizuan në mënyrë përzgjedhëse inovacione në sektorë të caktuar, si industria e luftës dhe inovacionet në fushën fiskale që ishin kritike për ekspansionet territoriale të perandorisë, si dhe i mundësuan asaj mbijetesën për një kohë të gjatë.

Një kontribut i mirënjohur në fushën e teorive të zhvillimit është ajo e etapave të rritjes ekonomike e Rostow (1956).¹² Ideja e tij ishte ajo e një progresi linear të zhvillimit nëpër faza që kalon: nga shoqëria tradicionale – përgatitja e kushteve për të bërë kërcimin e madh – kërcimi – vënia në rrugën e zhvillimit të qëndrueshëm. Që të bëhej kërcimi, duhej që të dyfishoheshin ritmet e investimeve prodhuese, të zhvillohej një ose më shumë sektorë udhëheqës, me lidhje *backward* dhe *forward*, dhe një strukturë e përshtatshme institucionale që mund të nxiste

11 Sevket Pamuk, The Evolution of Factor Markets in the Ottoman Empire, 1500-1800; <https://www.lse.ac.uk/Economic-History/Assets/Documents/Research/GEHN/GEHNConferences/conf6/Conf6-SPamuk.pdf>

12 Rostow W.W, 1956, "The Take-Off into Self-Sustained Growth", Economic Journal 66.

zhvillimin ekonomik në dy apo tri dekada. Etapa e përgatitjes së kushteve për zhvillim nënkuptonte: investime në kapitalin njerëzor, zhvillimin e një infrastrukture ligjore dhe institucionale që lehtëson investimet dhe inovacionin dhe një sektor bujqësor dinamik që çliron faktorët e prodhimit, në mënyrë të veçantë fuqinë punëtore jobujqësore.

Kjo teori është mjaft interesante për të përshkuar evolucionin në tërësi të shoqërisë njerëzore, por shpesh ajo ishte e paaftë të shpjegonte modelet e zhvillimit të ekonomive të veçanta, si për shembull të Francës dhe të Britanisë. Kjo i dha rrugë zhvillimit të një teorie alternative mjaft të fuqishme të zhvilluar nga një tjetër ekonomist i madh i historisë së zhvillimit ekonomik, Aleksandër Gerschenkron (1962)¹³. Në librin e tij të rëndësishëm, *Economic Backwardness in the Historical Perspective*, ai parashtroi teorinë e zëvendësuesve të parakushteve të zhvillimit: inovacioni institucional mund të shmangë krijimin e marrëdhënieve mbi bazën e tregut, shteti mund të jetë një zëvendësues i tregjeve private të kapitalit, fitimet monopol mund të gjenerojnë kursimet për të financuar investimet, sistemi bankar mund të financojë sipërmarrjen dhe tregtia e jashtme mund të zëvendësojë sektorin e brendshëm bujqësor për të mbështetur zhvillimin e industrisë së brendshme. Kërkimet e bëra nga autorë të ndryshëm (Crafts, Trebilcock, etj.)¹⁴ nuk

13 Aleksandër Gerschenkron (1962), *Economic Backwardness in the Historical Perspective*

14 Nicholas Craft, 2013, Twentieth Century Growth; working paper; Warwick University;

gjejnë evidenca të qëndrueshme për konkluzionet e Gerschenkron. Teza që ka një pranueshmëri më të gjerë por që akoma është një fushë e kërkimeve të mëtejshme është ajo midis zhvillimit ekonomik dhe nivelit të zhvillimit të tregjeve financiare.

Megjithëse tezat e Rostow dhe Gerschenkron nuk kanë gjetur konfirmim të pranueshëm nga kërkimet e mëvonshme, fuqia e tyre intelektuale vazhdon akoma të ushqejë kërkimet ekonomike edhe në ditët e sotme. Për shembull, idetë e ndërhyrjes shtetërore për të shmangur rënien e ekonomisë në një ekuilibër të keq, janë formalizuar në modele që aplikojnë të ardhurat rritëse të shkallës dhe mostregtueshmërinë e disa inputeve të prodhimit (Rodrik, 1996)¹⁵. Po kështu, mbeten akoma një objekt kërkimi dhe debati intelektual roli i shtetit në zhvillimin ekonomik dhe çështjet e tjera që janë parashtruar nga këta autorë në lidhje me prerekuizitat për zhvillim.

Me gjithë sofistikimin e modeleve ekonometrike në studimin e rritjes dhe faktorëve të zhvillimit, dobësia themelore e tyre vazhdon të jetë e pranishme dhe që është paaftësia e tyre për të shpjeguar ndryshimet endogjene teknologjike dhe institucionale. Në këndvështrimin historik të zhvillimit, janë

Michael Trebilcock, "Let the Market Decide: The Case Against Mandatory Pick-and-Pay," (with Lawson Hunter and Edward Iacobucci) (September 25, 2014). C.D. Howe Institute e-Brief No. 184.

15 Dani Rodrik, 1996, Coordination failures and government policy: A model with applications to East Asia and Eastern Europe; Journal of International Economics, 1996, vol. 40, issue 1-2, 1-22

divergjencat e këtyre dy faktorëve që qëndrojnë në thelb të divergjencave të zhvillimit ekonomik midis vendeve.

Siç edhe e theksuam, shfaqja e Revolucionit Industrial nuk ishte një akt i vetëm, por një proces. Kishte qenë përhapja e ideve merkantiliste në Europë dhe rritja e klasës së tregtarëve, ajo që kishte hedhur bazat e procesit të investimeve në asetet fikse. Nga kapitali për qëllime spekulative, procesi i akumulimit të kapitalit i realizuar gjatë asaj periudhe shënon epokën e kalimit drejt investimeve kapitale afatgjata në proceset e prodhimit. Nga tregtia dhe kapitali spekulativ, tek prodhimi dhe kapitali i investuar në asetet fikse.

Duke qenë se merkantilizimi shikohet si doktrina mbizotëruese e kohës me një rol të rëndësishëm në zhvillimet ekonomike politike dhe sociale në kontinentin tonë, do të ndalemi paksa tek tiparet më të rëndësishme të saj dhe në arsyet se përse merkantilizimi nuk arriti të gjente përhapje dhe në ish-Perandorinë Otomane, pjesë e së cilës ishte dhe Shqipëria.

Kapitulli 2

MERKANTILISTËT E RILINDJES: PROTEKSIONIZMI DHE RREGULLIMI I EKONOMISË

Merkantilizmi përmbledh të gjithë mendimin ekonomik që prej shekullit XV e deri në mesin e shekullit XVIII, kur fillon teoria ekonomike moderne me botimin në vitin 1776 të *Pasurisë së Kombeve* të Adam Smith-it (dhe shpallet pavarësia e ShBA). Kjo doktrinë ekonomike sidoqoftë, nuk përfaqësohet me ndonjë mendimtar të spikatur, siç do të jenë më vonë shkolla klasike e Adam Smith-it, apo shkolla marksiste. Një nga profesorët më të shquar të historisë së mendimit ekonomik botëror, Alexander Gray¹⁶ thekson se, “merkantilizmi ishte gjithçka veç jo një ‘sistem’”. Edhe qëllimi i këtij kapitulli është të trajtojë rolin e ideve merkantiliste në zhvillimin ekonomik të Perëndimit, rolin e këtyre ideve në ish-Perandorinë Otomane.

Përgjatë shekullit XVI ndodhën ndryshime të rëndësishme strukturore ekonomike e sociale në kontinentin tonë. Zbulimet e mëdha gjeografike kishin provokuar një zgjerim të ndjeshëm të kufijve të shkëmbimeve tregtare të mallrave ekzotike, si dhe

16 Alexander Gray, “The Development of Economic Doctrine: An Introduction Survey”, Longmans, Green and Co Ltd., London, 1931.

një zhvendosje në qendrën e gravitetit të tregtisë botërore. Nga një botë në thelb rurale dhe artizanale, kemi lindjen e një bote industriale dhe tregtare. Ndërsa fuqia tregtare kaloi nga portet e Mesdheut drejt oqeanit atlantik, nga Levanti, drejt Perëndimit. Sasi të mëdha metalesh të çmuara që nxirreshin nga Meksika dhe Peruja, drejtoheshin drejt Spanjës e cila përjetoi një zhvillim të ndjeshëm gjatë kësaj periudhe historike.

Në planin socio-politik, u realizuan njëkohësisht transformime të rëndësishme politike. Shtetet moderne, të centralizuara dhe të unifikuara u ngritën mbi rrënojat e feudalizmit. Rilindja dhe Reformacioni provokuan një shkëputje nga mesjeta dhe lindjen e një mendimi të ri që do të kishte ndikime të mëdha në përshpejtimin e rritjes ekonomike. Për herë të parë, mendimi ekonomik abstragoi nga konsideratat etike që kishin kufizuar shumë praktikatat e biznesit dhe rolin e parasë dhe financës në ekonomi.

Të gjitha këto zhvillime, shënuan lindjen e doktrinës merkantiliste në Europë në mesin e shekullit XV dhe XVI. Parimi themelor i merkantilizmit ishte se fuqia dhe pasuria e shteteve, qëndron në zotërimin e një stoku të rëndësishëm metalesh të çmuara. Me gjithë diferencat e vogla nga njëri vend në tjetrin, në tërësi të gjithë merkantilistët janë njësoj nacionalist dhe intervencionist.

Merkantilizmi spanjoll shënon dhe formën rudimentare të lindjes së merkantilizmit. Gjatë lulëzimit të Spanjës për shkak të një fluksi të madh metalesh të çmuara, ari dhe argjendi vlerësoheshin si

të mjaftueshëm për veprat publike dhe kërkohet që të ruhej dhe të grumbullohet sa më shumë nga tregtia me vendet e tjera. Për këtë qëllim, u ndalua eksporti i metaleve të çmuara dhe favorizohej importimi i tij në sajë të një sistemi të balancimit të shkëmbimeve me jashtë. Importuesit lejohej të paguanin vetëm në mallra spanjolle, duke kufizuar daljen e metaleve të çmuara jashtë vendit.

Merkantilizimi francez shënon një perfeksionim të sistemit, duke vepruar në mënyrë jo të drejtpërdrejt mbi stokun e metaleve të çmuara nëpërmjet industrisë. Shteti duhet të inkurajonte sistematikisht prodhimin, me qëllim rritjen e shitjeve tek të huajt dhe grumbullimin e metaleve të çmuara prej tyre nëpërmjet pagesave që mbyllnin pozicionet e hapura tregtare. Pra, deficitit tregtar që krijonte një vend kur importet ishin më të mëdha se eksportet, duhet të paguhej me metale të çmuara, kryesisht ar. Kjo bënte që vendet me industri dhe tregti më të zhvilluar, të shtonin rezervat e tyre në ar ndërsa vendet me deficite tregtare të zvogëlonin rezervat valutore. Për pasojë, vendet duhet të ndërmerrenin politika sa më aktive në drejtim të mbështetjes së industrive me qëllim që të krijonin tepriçë të eksporteve mbi importet. Por, rritja e stokut të rezervave të metaleve të çmuara, që është sinonim i parasë së kohës, nënkuptonte dhe fuqizimin e monedhave të këtyre vendeve dhe për pasojë ndikonte negativisht mbi eksportet për shkak të mbiçmimit të monedhave kombëtare që krijon një monedhë e fortë. Ky arsyetim u zhvillua në atë periudhë nga Jean Bodin, një filozof humanist dhe mendimtar i shquar francez i

shkullit XVI. I ngarkuar për të hetuar mbi shkaqet e rritjes së çmimeve, ai kishte arritur në përfundimin se kjo kishte në themel të vet rritjen e stokut të metaleve të çmuara nga importet e saj nga Amerika. Kjo analizë e tij përfaqëson dhe fillesat e teorisë sasiore të parasë, sipas së cilës niveli i çmimeve varet në thelb nga sasia e parasë në qarkullim.¹⁷

Ishte Jean Baptiste Colbert që i dha formën e vet më të zhvilluar merkantilizmit francez, në veprën e vet *Lettres et Memoir (Letrat dhe Kujtime)*. Colbert¹⁸ kishte shërbyer si ministër shteti gjatë mbretërimit të Luigjit XIV dhe reformat e ndërmarra prej tij në planin politik dhe të tregjeve njihen në historinë e ekonomisë me nofkën e *Colbertizmit*. Në planin e brendshëm ai bënte thirrje për një sistem të privilegjuar fiskal dhe subvencion të krijimit të njësisive prodhuese që i dedikohen kryesisht prodhimit të mallrave për eksport (si artikuj luks, çelik, etj). Një sistem i përgjithshëm taksimi, të çmimeve dhe pagave, një rregullim të plotë të cilësisë së produkteve, zhvillim të transporteve – janë të gjitha fusha të ndërhyrjes shtetërore.

Në planin e jashtëm, që në vitin 1667 u vendos tarifa doganore për një proteksion rigoroz. Ndalohej importi i mallrave që prodhoheshin brenda vendit dhe që

¹⁷ Joseph A Schumpeter, 1954, *History of Economic Analysis*, Oxford University Press.

¹⁸ Schumpeter e vlerëson Colbert, duke e konsideruar si një shtetar dhe mendimtar që ishte i aftë të përpunonte politika të suksesshme në ekonominë franceze, por jo si një kampion të parimeve të mëdha, siç e quajnë shpesh admiruesit e tij (shif footnote të librit *History of Economic Analysis* (fq 148) për një vlerësim të rolit të Colbert në “doktrinën” merkanitiliste.

konkurreronin drejtpërdrejt me to; përkundrazi, lëndët e para nga vendet e huaja lejoheshin të importoheshin pa tarifa doganore për të ushqyer industrinë franceze. Eksporti nxitej nëpërmjet inkurajimit të shoqërive tregtare; ndërsa ndalohej eksporti i drithërave me qëllim shmangien e urisë dhe për të mbajtur paga të ulëta në mënyrë që t'i bëhej ballë konkurrencës ndërkombëtare.

Merkantilizmi britanik ose komercializmi i Thomas Mun dhe William Petty orientohej kryesisht në zhvillimin e tregtisë dhe transportit detar. Sipas këtyre dymendimtarëve të shquar britanikë të shekullit të XVI dhe XVII, duhej forcuar mbajtja e një bilanci pozitiv me jashtë vendit duke u rregulluar me sasinë e arit apo argjendit, duke mbajtur në konsideratë jo vetëm tregtinë e mallrave, por dhe të gjitha transaksionet e tjera me vendet e huaja. Në veçanti, duhej zhvilluar transporti detar për të kryer shërbimet e transportit të mallrave të cilat do të paguheshin me metale të çmuara. Ky parim u vu në veprim në saj të Aktit të Navigacionit të Cromwell (1651), që i rezervonte marinës britanike monopolin e transportit të mallrave me kontinentin jashtë-europian dhe ndalonte anijet e huaja të importonin mallra nga Anglia, mallra që nuk ishin me origjinë nga vendet e tyre.

Një tjetër përfaqësues i spikatur i merkantilizmit ishte John Law, autor i eksperiencës së parë (fatkeqe) franceze në emetimin e biletave bankare. Law ishte një ekonomist skocez që besonte se paraja ishte vetëm një mjet pagese dhe se ajo nuk përbënte pasuri në vetvete, ndërsa pasuria e kombeve varej nga tregtia. Thuhet se

ai është babai i financave dhe atij i atribuohet emetimi i parasë letër në botën e sotme moderne. Në fakt, eksperimenti i tij me krijimin e bankave që përdorin si kolateral vlerën e tokës (që i pagëzoi me emrin *lands banks*), që u materializua i modifikuar duke përdorur si kolateral letrat me vlerë të emetuara nga qeveria dhe taksat e grumbulluara në buxhetin mbretëror, ishte në fillesat e veta një sukses i padiskutueshëm. Por euforia që pushtoi tregun financiar francez, të nxitur pikërisht nga sukcesi që krijon tregu dhe pritshmëritë për fitime gjithnjë në rritje, shënuan fundin tragjik të të gjithë sistemit monetar të Francës së kësaj periudhe. Vetë ai ishte një kumarxhi i shkëlqyer, i pajisur me një tru shumë të fuqishëm në llogaritjet matematike. Ai ishte një ekspert i statistikave dhe konsiderohet autor i dy ideve madhore: “Teorisë së Rrallësisë së Vlerës” dhe “Doktrinës së letrave me vlerë reale”.¹⁹

Doktrina merkanitiliste kishte mbështetur zhvillimin e brendshëm ekonomik përmes politikave të ndërhyrjeve të forta shtetërore dhe rregullimeve qeveritare të industrive, dhe kishte stimuluar rritjen e shkëmbimeve tregtare me vendet e tjera, në kërkim të grumbullimit të arit, që ishte instrumenti kryesor i pagesave në tregtinë e jashtme. Grumbullimi i kapitaleve tregtare në vetvete kishte krijuar kushte të përshtatshme ekonomike në zhvendosjen e interesave nga tregtia drejt modernizimit të prodhimit. Progresi teknologjik mbështeste një rritje të fortë të produktivitetit të punës dhe kapitalit, duke favorizuar

19 Antoine Murphy, 1997, John Law: Economic Theorist and Policy-maker; Clarendon Press

investimet e destinuar në zgjerimin e veprimtarive prodhuese.

Edhe historia e zhvillimit ekonomik të ShBA-ve shkon në të njëjtat linja. Në librin e tij, Levy(2021)²⁰ konsideron se dinamikat e kapitalizmit paraindustrial, të asaj që autori e cilëson si *Epoka e Tregtisë* dhe që shtrihet përgjatë shekullit XVII e deri në nisjen e Luftës Civile, në kërkim të fitimeve tregtare, në ndjekje të interesit vetjak dhe me zgjerimin e tregjeve, kishin krijuar kushtet e nevojshme të asaj që njihet si “rritja smithjane”. “Merkantilizimi e transformoi {Amerikën} dhe kështu lindi kapitalizmi amerikan”.

Mendimi ekonomik i Perandorisë Otomane. Pse merkantilizmi në Lindje nuk dha rezultatet që kishte shënuar Perëndimi?

Në këndvështrimin e mendimit ekonomik të kohës, pikëpamjet merkantiliste janë një trashëgimi e përbashkët si në Perëndim edhe në Lindje. Shteti Otoman kishte njohje të përhapjes së doktrinës merkantiliste në Europë. Historiani Naima, në fillimet e shekullit XVIII argumentonte nevojën e Perandorisë për të përqaftuar idetë dhe praktikat merkantiliste europiane, duke argumentuar se nëse popullsia e perandorisë blinte mallra të prodhuara në vend dhe jo mallra të importuara, akçe²¹ dhe monedhat e tjera

20 Jonathan Levy, 2021, “*Ages of American Capitalism: A history of the United States*”, Random House

21 Akçe është monedha e përdorur në Perandorinë Otomane. Ajo kishte përmbajtje argjendi, prej nga rrjedh dhe nga turqishtja, “al”, domethënë “e bardhë”. Tre akçe ishin një *para* dhe njëqind

që qarkullonin do të mbeteshin në perandori dhe nuk do të iknin jashtë. Ky argument të sjell ndër mend një episod të një debati të zhvilluar midis Presidentit të ShBA-ve, Abraham Linkoln me një gazetar. Kur gazetari e pyeti nëse ai do dëshironte që të vishte një pallto angleze apo amerikane, Linkoln i ishte përgjigjur: “Nëse vesh një pallto angleze, unë kam pallton dhe anglezi ka dollarët e mi; nëse unë vesh një pallto amerikane, atëherë unë kam pallton dhe një tjetër amerikan ka dollarët e mi”. Mentaliteti merkantilist që e kufizon analizën vetëm deri në fundin e një transaksioni dhe shihet i shkëputur nga zinxhiri vijues i transaksioneve që vihen në lëvizje, është prezent akoma dhe kësaj dite.

Por, ndërsa merkantilizmi perëndimor ushqueu zhvillimin e shpejtë ekonomik dhe revolucionin industrial (që do të shënonte dhe shkëputjen përfundimtare midis Lindjes dhe Perëndimit), e njëjta ideologji ekonomike nuk dha të njëjtat rezultate dhe në Lindje.

Një shpjegim i këtij fakti lidhet me arsyet se përse zbatoheshin këto politika. Në Perëndim, për shembull, ndalimi i eksportit të metaleve të çmuara, i drithërave, i lëndëve të para, ato pra që i quajmë politika proteksioniste, u ndërmorën me qëllim

e njëzet *akça* ishin një *kuruş*. Nga fundi i shekullit të 17-të *kuruş* do të bëhej njësia kryesore monetare, ndërsa në mesin e shekullit XIX, ajo së bashku me monedhën *lira* e emetuar në ar, do të ishin pjesë e sistemit monetar bimetalik. Një libër shumë interesant mbi historinë monetare të Perandorisë Otomane është shkruar nga Sevket Pamuk, *A Monetary History of the Ottoman Empire*, Cambridge University Press, 2000.

rritjen e eksporteve dhe krijimin e një ekonomie krahasuese dhe me bilanc tregtar pozitiv. Ndërsa Perandoria²² i zbatonte këto politika proteksioniste vetëm në këndvështrimin e tregut të brendshëm, për të shmangur mungesën në treg të prodhimeve të nevojshme, në filozofinë e ekonomisë së bollëkut që predikonte besimi islam, apo për qëllime fiskale që ishin në interes të Perandorisë. Pra, proteksionizmi në Perëndim çoi në akumulimin e një pasurie në duart e grupeve shoqërore që financuan revolucionin industrial. Ndërsa këto politika të zbatuara në Lindje çuan në izolimin e këtij tregu të madh nga konkurrenca e huaj, dhe për rrjedhojë ushqyen prapambetjen e saj e cila vazhdon të jetë akoma e dukshme dhe sot.

Kjo diferencë në arsyt e ndryshme për të cilat zbatoheshin politikat proteksioniste, shihet për shembull tek qëndrimi i Perandorisë ndaj industrisë shumë të zhvilluar të mëndafshit (në Bursa), të pambukut dhe leshit dhe mallrave të tjera të konsumit. Qëllim kryesor ishin çmimet e ulëta me qëllim të furnizohej tregu me mallra dhe jo ruajtja nga konkurrenca e mallrave perëndimore. Pikërisht, kjo çoi në rrënimin e këtyre industrive nga vërshimi i mallrave të lira nga perëndimi. Ky proces rirforcohej edhe më shumë, sa më shumë që dobësohej fuqia e Perandorisë.

Politikat ekonomike shtetërore në Perandorinë Otomane nuk ndiqnin interesin publik në një sens abstrakt të fjalës. Qëllimet e politikave dhe

22 Fatih Ermiş, 2014, *A History of Ottoman Economic Thought: Developments before the nineteenth century*, Routledge

institucioneve që lidheshin me zbatimin e tyre formësoheshin nga struktura sociale, marrëdhëniet midis shtetit dhe shoqërisë, ose thënë në një formë më të përgjithshme, nga influencat politike dhe sociale që vepronin në Perandori. Në disa raste shteti bëhej zëdhënës i interesave të një grupi të caktuar social, e në raste të tjera shteti binte në dorën e burokracisë administrative e cila vepronte në mënyrë të pavarur dhe e pandikuar nga këto presione.

Për rrjedhojë, të kuptuarit e praktikave dhe politikave ekonomike Otomane kërkon njohjen e natyrës së shtetit otoman dhe marrëdhënieve të saj me grupet e ndryshme sociale. Deri në fundin e shekullit XV, ekzistonte një tension i dukshëm midis aristokracisë së tokave të provincave turke me administratën qendrore, duke e kaluar fuqinë herë tek njëri grup e herë tek tjetri. Ishin reformat centralizuese të Mehmetit II në gjysmën e dytë të shekullit XV që e anuan në mënyrë vendimtare balancën në favor të administratës qendrore. U vendos pronësia shtetërore mbi tokën dhe pushteti u përqendrua në duart e burokracisë qendrore. Gjatë kësaj periudhe, që vazhdoi deri në shekullin XVII dhe XVIII ku forcat decentralizuese morën përparësi, aktiviteti ekonomik e tregtar mbështetej dhe stimulohej nga shteti, dhe vetë tregtarët vepronin të pavarur dhe të paorganizuar në *gilde*, siç ishte praktika europiane. Pikërisht mungesa e këtij organizimi, dobësia e tyre ishte një tjetër arsye tjetër se përse nuk ndeshim një zbatim të merkantilizmit edhe në Perandori në trajtat që po zhvillohej në Perëndim.

Filozofia predominuese e Perandorive të kohës ishte ajo e një shteti të fuqishëm me të ardhura fiskale të grumbulluara jo për qëllime ekonomike, se sa për të rritur pushtetin e sundimtarëve nëpërmjet pushtimeve të territoreve të tjera. Nga ana tjetër, fuqia ushtarake shihej si mjeti themelor i sigurimit të pasurisë. Këto dy koncepte themelore ishin në themel të organizimit ekonomik e politik të Perandorisë Otomane. {Edhe merkantilizmi evropian kishte si qëllim shtimin e pasurisë në formën e grumbullimit të arit, si burim kryesor i pushtetit të monarkive që mund ta përdornin për financimin e fushatave të pushtimit dhe zgjerimit të territoreve.}

Historiani Otoman²³, Kinalizade (1561) shkruante:

Disa autoritete e kufizojnë grumbullimin e pasurisë nga tre sektorë: tregtia, artizanati dhe bujqësia. Megjithatë, disa shtojnë edhe një sektor të katërt, fuqinë ushtarako-politike. Kishte një mosmarrëveshje se, nga ana etike dhe e besimit, cili ishte më i miri. Sipas Imamit Shafi'i, tregtia ishte sektori më i mirë sepse ishte dhe profesioni fisnik i Profetit Muhamet. Por Mawardi e vendoste bujqësinë mbi të tjerët. Autoritete të mëvonshme argumentonin se transaksionet tregtare ishin pushtuar nga aq shumë praktika të paligjshme, sa ishte krijuar një mosbesim në origjinën e pasurisë; prandaj, bujqësia duhet të kishte më shumë prioritet se tregtia. Në akumulimin e pasurisë duhet të hiqet dorë së pari nga shtypja

23 Cituar nga Halil Inalcik, 1994, *An Economic and Social History of the Ottoman Empire, 1300–1914*, volume 1, Oxford University Press

dhe padrejtësia, së dyti, nga aktivitete të turpshme dhe së treti, nga puna e zezë.

Artizanati konsiston në tri kategori: fisnike, neutrale dhe inferiore. Profesionet e ulemave, burokratëve dhe ushtarëve bazohen në cilësi shpirtërore të tilla si arsyeja, retorika dhe vlera, dhe prandaj janë profesione fisnike. Fajdeja dhe punësimet e orientuara nga qejfet janë profesione inferiore. Për rregullin e mirë të botës, të gjithë këto profesione janë të nevojshme dhe është imperative që secili grup të qëndrojë brenda sferës së vet të aktivitetit. Profesionet neutrale apo të ndërmjetme përfshijnë bujqësinë që është e nevojshme për mbijetesë apo e argjendarit që nuk është kaq e domosdoshme.

Pra, siç shihet, në ekuacionin pasuri-pushtet, në dallim nga Perëndimi që vendoste theksin tek prodhimi dhe industria dhe ku klasat e tregtarëve kishin një rol parësor në shoqëri, në shoqërinë islamike këtë vend e zinte bujqësia dhe bujku. Në këtë çështje, mund të bëhet një analogji me fiziokratët francezë të shekullit XVIII që gjithashtu besonin se vetëm bujqësia ishte një sektor prodhues që meritonte mbështetje. Natyrshëm që kjo filozofi ka dhe pasojat e saj praktike, pasi ndërsa perëndimi lëvizte drejt zgjerimit dhe konsolidimit të një sistemi kapitalist të bazuar tek industria dhe tregtia, Perandoria Otomane mbështetej tek ekspansioni territorial, ruajtja e monopoleve në prodhim dhe tregti dhe sistemi konservator i pronësisë mbi tokën bujqësore.

Në këndvështrimin veberian, shkollarët modernë islamikë nënvizojnë se aktivitetet ekonomike të botës myslimane përcaktohen nga sistemi i vlerave të Islamit, shqetësimi themelor i të cilit është mirëqenia e komunitetit si i tërë. Ata e kritikojnë konceptin perëndimor të *homo economicus* pasi në këndvështrimin islamik jeta e njeriut drejtohet nga një objektiv i vetëm, “të arrijë të pranohet nga Allahu”. Prandaj dhe “objektivat” e vërteta të ekonomisë janë bamirësia për të varfrit dhe ata në nevojë, angazhimi i burimeve për mirëqenien e brezave të ardhshëm dhe përmirësimi i jetës së komunitetit. “Prodhimi dhe fitimi nuk janë qëllime, por mjete” – shkruan M. Al-Mubarak. Pra, në dallim nga bota perëndimore²⁴ ku fitimi ishte forca lëvizëse e shoqërisë dhe ekonomisë, në botën islame kjo forcë ishte mirëqenia e komunitetit. Pikërisht mbi këto parime ishte ndërtuar shteti dhe burokracia gjatë periudhës së Perandorisë.

24 Sigurisht që kjo lidhet me evoluimin e doktrinës kristiane, pasi edhe ajo e dënonte rendjen pas pasurisë. Apeli i mësimave të Krishtit ishte se të pasurit do të përjashtoheshin nga Mbretëria e Zotit: ishte më e lehtë që “një gamile të futet në vrimën e gjilpërës se për një të pasur të futet në Mbretërinë e Zotit” (Mateu 19:24). Gjithashtu, motivi i fitimeve konsiderohet si një faktor i rëndësishëm shtytës i kapitalizmit industrial, por historia e ekonomisë dëshmon se ai nuk është i vetmi. “... pjesëmarrësit në ekonominë kapitaliste duhet të motivohen nga ndjekja e qëllimit të tyre – fitimit – nga diçka më shumë se vetë ky qëllim, - shkruan Levy tek “*Ages of American Capitalism*”. Rendja e kapitalistit pas fitimit gjithnjë është komplikuar nga një shumëllojësi motivesh njerëzore racionale dhe joracionale.” Andrew Carnegie u shndërrua nga një biznesmen i suksesshëm spekulator në tregjet financiare, në një nga prodhuesit më të mëdhenj të çelikut sepse, siç e kishte shprehur ai, “doja të bëja diçka të prekshme”.

Kështu, institucioni i bamirësisë, *vakëfi*, ishte një ndër institucionet e rëndësishme, që luante funksione shoqërore dhe ekonomike të rëndësishme në procesin e rishpërndarjes së të ardhurave. Për të siguruar furnizimin e popullsisë më mallrat e nevojshme, administrata ndërhynte në kontrollin e tregut dhe të çmimeve. Inspektori i pazarit që emërohej nga shteti, kontrollonte peshat dhe masat, çmimet e tregut, dhe ishte një ndër funksionarët e rëndësishëm të burokracisë.

Një nga funksionet më të rëndësishme ekonomike të shtetit Otoman ishte furnizimi i kryeqytetit, i Pallatit dhe aparatit shtetëror (Genç, 1989)²⁵. Rolin kryesor në këtë funksion e ushtronin tregtarët dhe prodhuesit, dhe shteti ishte i ndërgjegjshëm për këtë rol të rëndësishëm të tyre, prandaj i mbështeste e madje edhe i stimulonte. Tregtarët e huaj ishin gjithashtu shumë të mirëpritur në Perandori, pasi ata sillnin produkte të panjohura në treg, por nga ana tjetër, shpeshherë, krijonin probleme në furnizimet e brendshme me mallra, për shkak të eksporteve drejt tregjeve europiane. Për rrjedhojë, herë pas herë shteti ndërhynte duke vendosur kufizime të eksporteve. Eksportet lejoheshin vetëm pasi të plotësoheshin nevojat e tregut të brendshëm. Veçanërisht këto kufizime ishin të forta për mallrat ushqimore dhe lëndët e para. Tregtia e jashtme stimulohej në veçanti për të furnizuar tregun e brendshëm, dhe kjo evidentohet në një sërë marrëveshesh tregtare

25 Mehmet Genç, 1989, "State and Economy in the Ottoman Empire"

koncensionare (ose kapitullimet, siç njihen) me republikat tregtare europiane, siç ishte Venediku. Një politikë e tillë kontraston dukshëm me merkantilizmin european, praktika që inkurajonin eksportet dhe ndalonin importet, pasi vetëm nga eksporti i mallrave sigurohej ari, që konsiderohej si forma kryesore (dhe e vetme) e pasurisë. Kjo nuk do të thotë se në Europë nuk praktikoheshin ndalimi i eksporteve sa herë që gjithashtu krijoheshin probleme në furnizimin e tregut të brendshëm me mallra bazike ushqimore dhe kishte kriza ushqimore, por këto ishin praktika të përkohshme dhe për raste të veçanta.

Ndalimi nga ligji islamik i dhënies së kredisë me interes pengoi zhvillimin e tregjeve bankare e financiare (letër kredinë dhe format e tjera të instrumenteve financiare) që po merrnin një zhvillim të madh në Perëndim. Në Perandori ekzistonte vetëm një embrion i pazhvilluar i bankave, kryesisht i zhvilluar nga tregtarët italianë që zhvillonin biznes në Stamboll²⁶. Në këtë mënyrë, Perandoria vazhdoi të mbështetej tek kontrolli i prodhimit bujqësor dhe pronësia shtetërore mbi tokën, si burimet kryesore të sigurimit të pasurisë.

Ndërhyrja e Perandorisë në zhvillimin ekonomik ishte minimaliste. Vetëm në raste emergjente shteti ndërhynte në projekte rrugësh apo veprash infrastrukture, duke ja lënë në tërësi këto investime sektorit privat. Po kështu, zgjerimi i vazhdueshëm i kufijve të Perëndorisë nuk inkurajonte zhvillimin

26 Sevket Pamuk, 2000, *A Monetary History of the Ottoman Empire*, Cambridge University Press.

intensiv të bujqësisë dhe rritjen e produktivitetit të industrisë. Ndërsa kufijtë e ngushtë të shteteve të vogla Perëndimore i detyronin ata të angazhoheshin në investime infrastrukturore dhe inovacione që çonin në një bujqësi intensive dhe industri kompetitive.

Ndërhyrja e qeverisë në menaxhimin e problemeve ekonomike ka patur gjithashtu evolucionin e saj. Sa më shumë që Perandoria zgjerohej dhe shtrihej në territore të reja, aq më e vështirë bëhej ndërhyrja, qoftë për shkak të pamjaftueshmërisë së burimeve të disponueshme, ashtu dhe të vetë eficiencës së ndërhyrjeve të tilla.

E thënë në mënyrë të përmblodhur, merkantilizmi evropian që i kishte shërbyer akumulimit të kapitalit dhe nxitjes së procesit të investimeve në industri, duke krijuar një dinamikë unike që ushqeu shkëputjen e madhe të Perëndimit, kishte dështuar në Lindje dhe në gjithë pjesën tjetër të botës. Ose ndryshe, ajo që duhej shpjeguar, nënvizon Robert Brenner²⁷, nuk është prapambetja e Lindjes pasi ajo ndiqte të njëjtin model të ndryshimit dhe progresit të ngadaltë si gjithë pjesa tjetër e botës, por dinamizmi ekonomik i Perëndimit.

27 Robert Brenner, 1989, "Economic Backwardness in Eastern Europe in light of development in the West", in "The Origins of Backwardness in Eastern Europe: Economics and Politics from the Middle Ages until the early twentieth century", edited by Daniel Chirot, University of California Press, 1989

Kapitulli 3

PRONËSIA MBI TOKËN, BUJQËSIA DHE JETA NË PERIUDHËN PARAINDUSTRIALE

Një ndër fushat e debatit lidhur me ndryshimet në performancat e zhvillimit të Perëndimit dhe Lindjes i referohet lidhjes midis industrializimit dhe politikave agrare. Historia dëshmon se modernizimi dhe produktiviteti i bujqësisë ishin shumë të rëndësishme në fillimet e industrializimit. Një bujqësi që përsoste teknikat e fermës, sillte rritje të produktivitetit por edhe rritje të ardhurave dhe kursimeve që mund të shkonin për financimin e industrisë. Bashkë më të, ajo çlironte fuqi punëtore që mund të punësohej në manufakturë.

Duke qenë se kjo është epoka e dominimit të bujqësisë, edhe historia e ekonomisë së kohës fokusohet në evolucionin që kanë pësuar strukturat institucionale të marrëdhënieve agrare. Rritja e popullsisë në Europën Perëndimore dhe bollëku i fuqisë punëtore, si dhe fakti që fuqia punëtore e marrë me pagesë ishte më produktive se format e vjetra të bujkrobërisë, krijuan premisa për një lloji të reformës agrare që e bënte zotërimin feudal më pak shtypës. Inovacionet në fushën e bujqësisë - përmirësimi i teknikës dhe teknologjisë së kultivimit të tokës dhe

zgjerrimi i sipërfaqeve të tokës së punueshme, shënojnë kalimin përgjatë shekujve IX-XIII të tranzicionit nga një bujqësi ekstensive, drejt një bujqësie intensive, me një rritje të ndjeshme të produktivitetit të tokës bujqësore. Por këto zhvillime mbeten të izoluara vetëm në Perëndim. Një ndër arsytet se pse inovacionet në bujqësi nuk u përhapën në pjesën tjetër të Europës, lidhen me kufizimet mjedisore. Inovacionet bujqësore i përshtateshin kushteve klimatike në veri përkundrejt një klime mesdhetare të pjesës tjetër të kontinentit. (O'Brien, Leandro Prados de la Escosura, 1992²⁸).

Ndërkohë zhvillime të kundërta ndodhnin në Europën Lindore dhe territoret e Perandorisë në Ballkan. Që prej shekullit XIII, pronësia mbi tokën që më parë ishte e komunitetit/fshatit, u bënë provinca të princëve dhe familjeve fisnike dhe fshatarët që dikur kishin qenë të lirë, ranë në statusin e *quasi*-bujkrobërisë.

Pronësia mbi tokën mbetet një faktor kyç që shpjegon diferencat në performancën e sektorit bujqësor dhe rolit pengues që luajti mungesa e zhvillimit të bujqësisë në tranzicionin drejt një shoqërie industriale në Lindje. Anglia kishte një sistem "kapitalist" bujqësor, me ferma të mëdha dhe të menaxhuara, në duar të fermerëve "kapitalist" që punësonin fermerët pa tokë. Fermat private kishin një interes të drejtpërdrejtë në krijimin e tepricave në prodhimin bujqësor që shkonte për treg dhe ofronte

28 O'Brien, Leandro Prados de la Escosura, 2008, Agricultural Productivity and European Industrialization, 1890-1980, The Economic History Review 45(3):514 - 536

nxitje për rritje të produktivitetit në bujqësi. Për pasojë, tepricat e prodhimit çlironin fuqinë e tepërt punëtore të punësuar në bujqësi e cila zhvendosej drejt zonave urbane duke u punësuar në aktivitetet jobujqësore. Edhe vendet e tjera ndoqën modelin britanik të reformës së tokës. Reforma agrare që u iniciua në Prusi në fillim të shekullit XIX, ishte sipas modelit britanik. Në shkëmbim të heqjes së shërbimit të punës dhe të taksave mbi pronën, 1/3 deri në gjysmën e tokës që mbahej nga fshatarët iu dha pronarëve të mëdhenj. Kështu u konsoliduan pronat dhe u krijuan marrëdhëniet kapitaliste në bujqësi. Gjermania gjithashtu kishte një praktikë ligjore të trashëgimisë tek vetëm një pasardhës, fëmija i madh ose i vogël i familjes. Kjo praktikë kishte nxitur emigracionin e përhershëm nga fshati dhe eksportimin e praktikës gjermane në bujqësi në vendet e tjera të kontinentit. Kolonët gjermanë ndeshen pothuajse në të gjithë vendet e Europës Qendrore, duke eksportuar jo thjesht praktikat e zhvillimit të bujqësisë, por edhe elemente të sistemit ekonomik e shoqëror Perëndimor. Gunst (1989)²⁹, për shembull, i atribuon një rol të rëndësishëm kolonëve gjermanë në zhvillimin e Hungarisë.

Në dallim nga pjesa tjetër e Europës, Franca ruajti sistemin tradicional agrar me ferma të vogla. Studimet kliometrike³⁰ nuk kanë konfirmuar pikëpamjen

29 Péter Gunst, 1989, *Agrarian Systems of Central and Eastern Europe*, tek *The origins of backwardness of Eastern Europe*, University of California Press.

30 Metodë kërkimore që zbaton metodat formale ekonomike dhe analizës ekonometrike në analizën e ngjarjeve dhe pririjeve historike.

tradicionale se industrializimi i saj në shekullin XIX u pengua ndjeshëm për shkak të strukturës së saj agrare. Studimet kanë arritur në përfundimin se produktiviteti i punës në bujqësi, gjatë shekullit XIX, është rritur me të njëjtat ritme si në Angli edhe në Francë. Sidoqoftë, duhet thënë se një ndër ndikimet pozitive të Revolucionit francez është se ai i zhduku mbeturinat e rendit të vjetër feudal dhe hapi një perspektivë të re për zhvillimin ekonomik të Francës.

Marrëdhëniet e pronësisë mbi tokën kanë luajtur një rol thelbësor në krijimin e nxitjeve të nevojshme për stimulimin e progresit teknologjik në bujqësi. Prandaj, në vijim po ndalemi shkurtimisht në mënyrën se si ishte ndërtuar ky sistem në kohën e Perandorisë Otomane dhe disa nga reformat që ajo kishte ndërmarrë në këtë fushë, për të vazhduar më tej me disa momente të rëndësishme të revolucionit bujqësor dhe faktorëve ndikues të tij.

Perandoria dallonte katër forma të pronësisë:

1. *“Miri”* ose toka shtetërore arë dhe kullota, që zinte rreth 90% të të gjithë tokës arë. (Inalcik³¹). Sipas të drejtës islamike, toka i përkiste Zotit, dhe sulltanit si i dërguar i Zotit. Shteti ishte gjithashtu pronar i pyjeve, maleve dhe hapësirave publike, si rrugët, tregjet publike. Edhe toka që nuk kishte trashëgimtar i kalonte në pronësi sulltanit si *“miri”*. Kjo ishte në fakt një trashëgimi romako-bizantine, të cilën e aplikoi dhe ligji islamik.

31 Halil İnalcık, 1994, *An Economic and Social History of the Ottoman Empire, 1300–1914*; Cambridge University Press

2. “*Timar*” ose tokë gjysmë publike, ishin tokat në pronësi të sulltanit që i jepeshin në përdorim zyrtarëve civil ose ushtarak. Kjo ishte baza e feudalizmit. Toka timar nuk ishte tokë në pronësi private dhe nuk mund të trashëgohej, por në kushte të caktuara ligjore apo joligjore, tokat timar shpesh trajtoheshin si zotërime private, të marra me kontrata afatgjata ose nëpërmjet korrupsionit të zyrtarëve të Perandorisë. Fermat timar që konvertoheshin në pronë private quheshin “çiflig”.

3. “*Vakëf*” ishin prona të përjashtuara nga taksat, që zotëroheshin nga institucionet e mirëqenies publike, si spitale, qendra bamirësie, etj. Duke gëzuar privilegje fiskale, pronarët e tokave shpesh krijonin fondacione bamirësie dhe e kalonin pronën në pronësi të vakëfit. Kjo ishte edhe një mënyrë për të kaluar tokat në pronësi private.

4. “*Mulk*” ishte prona në pronësi të vërtetë private. Ligjërish ajo konsistonte në tokën mbi të cilën ishin ndërtuar shtëpitë, kopshtet, vreshtat, pemëtoret – prona që përmirësoheshin nga pronarët. Në thelb, kur një tokë timar shndërrohej në pronësi private, ligjërish klasifikoheshin si tokë *mulk*. Tokat *mulk* përjashtoheshin nga kontrolli shtetëror: shteti nuk mund të kërkonte shërbim ushtarak nga familjet që kishin në zotërim tokë *mulk*. Megjithatë, shteti kishte *dominium eminens* dhe në kushte të caktuara të drejtat e pronësisë mund të abrogoheshin dhe pronësia i kalonte shtetit.

Kontrolli shtetëror mbi tokën dhe paaftësia e perandorisë për të reformuar marrëdhëniet pronësore në bujqësi, shihen si faktorë kryesorë të prapambetjes ekonomike të perandorisë. Në një ese të Fikret

Adanir³² janë analizuar në mënyrë të thelluar një sërë shkaqesh që lidhen me prapambetjen e bujqësisë në Ballkan, faktorë që lidhen me çështjet e taksimit, të demografisë së rajonit tonë dhe kushteve klimatike dhe të pjellorisë së tokës, politikat që zbatonte Porta e Lartë për furnizimin e Stambollit, Pallatit dhe ushtrisë, që ishte shqetësimi i saj kryesor, ishin jofavorizuese për rritjen e prodhimit të produkteve bujqësore, ndikimit të kërkesës së tregjeve europiane (Anglisë dhe Francës) për produktet blegtorale në strukturën e prodhimit duke favorizuar atë blegtoral kundrejt prodhimit bujqësor, etj. Edhe reformat e Tanzimatit të mesit të shekullit XIX të cilat reformuan ndjeshëm edhe bujqësinë përmes rritjes së centralizimit dhe lindjes së një forme pronësie më të zgjeruar, siç ishin çifligjet, që mund të nisnin bazat e kapitalizmit në fshat, në fakt edhe ato luajtën një rol shumë minor. Ato mbeten të kufizuara në më pak se 10% të tokës bujqësore në vendet e Ballkanit dhe për pasojë roli i tyre në zhvillimin e kapitalizmit në fshat ishte i papërfillshëm.

Roli i bujqësisë si sektor ekonomik dhe mënyrë jetese ishte shumë i rëndësishëm veçanërisht në Shqipëri (por dhe në gjithë Ballkanin). Deri në vitin 1922, mbi 90% e popullsisë merrej me bujqësi, ndërsa rreth 40% e fshatarëve ishin pa tokë dhe jetonin me sistemin e çifligut, ku toka jepej me qira, një trashëgimi kjo e sistemit të pronësisë së perandorisë otomane.

32 Fikret Adanir, 1989, "Tradition and rural change in South Eastern Europe during Ottoman Rule", in *The Origins of Backwardness in Eastern Europe*, University of California Press

RRITJE PA ZHVILLIM
SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

Mungesa e sigurisë në tokat pjellore dhe shfrytëzimi ekstrem nga çifligarët i punës së bujkrobërve, bëri që këto të fundit të tërhiqeshin në male, ku jeta ishte më e sigurtë dhe kishte mundësi për një mbijetesë të familjeve. Ndërkohë, pronat në zonat më pjellore mbeteshin të pakultivuara. Ja çfarë shkruan Best³³ në kujtimet e tij:

Gjithkush që mund të ruajë dhe të mbrojë prodhimet, mund të mbjellë ku të dëshirojë dhe kur vjen koha e vjeljeve, mund të marrë gjithë prodhimin për vete, nëse nuk ja kanë vjedhur.

Kjo kronikë i përket kohës së rënies së mbretërimit të Veli Pashës (i biri i Ali Pashës) në Thesali në vitet 1840.

Një tipar i tillë nuk i përket vetëm Shqipërisë. Për shembull në Vidir, një krahinë midis Rumanisë dhe Bullgarisë, shfrytëzohej vetëm 1/5 e tokës bujqësore. Edhe në tokat bujqësore ku autoriteti i Portës ishte më efektiv, prodhimi mbetej modest për shkak të mbajtjes së çmimeve të ulëta të drithërave, ndalimit të eksportit të tij, me qëllim sigurimin e ushqimit për ushtrinë dhe furnizimin me çmime të ulëta të qendrës së Perandorisë - Kostandinopojës. Çmimi me të cilin ushtria kishte të drejtë të grumbullonte drithin ishte sa çereku i çmimit të tregut.

Duke e përgjithësuar, është e qartë se edhe marrëdhëniet pronësore në bujqësi dhe prapambetja

33 J.J Best, 1842, *Excursions in Albania: comprising a description of the wild boar, deer, and woodcock shooting in that country: and a journey from thence to Thessalonica & Constantinople and up the Danube to Pest*; London: Wm. H. Allen & Co.

agrare, ishin ndër shkaqet që nuk mundësuan atë shkëputjen e madhe rostoviane të territoreve të ish-Perandorisë Otomane drejt epokës së industrializimit.

Jeta në Shqipëri gjatë shekujve XVI-XVII

Në epokën para revolucionit industrial, diferencat midis vendeve në standardet e mirëqenies kanë qenë relativisht të vogla dhe të pandjeshme. Siç e nënvizuum që në hyrje të këtij libri, kurthi mathusjan ishte një ligjësi e përgjithshme e shoqërisë, dhe përmirësime në standardin e jetesës së banorëve shënoheshin kryesisht gjatë episodeve të pakësimit të popullsisë. Të dhënat tregojnë se periudha pas Vdekjes së Zezë (mesi shekullit XIV) që vlerësohet se zhduku midis 30% dhe 60% të popullsisë në Europë, u shoqërua me rritje të fortë të pagave të punëtorëve dhe për pasojë dhe me rritjen e mirëqenies dhe të ardhurave për frymë. Kështu që alternimet midis periudhave të mirëqenies dhe mizeries, kanë qenë të pranishme në varësi të faktorëve demografikë, apo faktorëve të tjerë rastësorë, si klima, luftërat, etj. Këto momente ngritjesh dhe uljesh gjenden dhe shoqërinë shqiptare. Periudhat e lulëzimit të tregtisë kanë patur një ndikim të fortë në mirëqenien e popullsisë ndërsa epidemitë apo luftërat janë shoqëruar me përhapje të gjerë të varfërisë. Por diferencat midis vendeve ishin shumë të ngushta.

Roli i porteve të Durrësit dhe Vlorës në zgjerimin e tregtisë midis ish-Perandorisë Otomane dhe tregjeve europiane, përkrah atij të Raguzës, janë mjaft

të njohura në historinë e ekonomisë. Dokumente arkivore italiane të përgatitura nga Injaz Zamputi³⁴, dëshmojnë për nivelin e marrëdhënieve ekonomike e tregtare midis krahinave të Perandorisë dhe shteteve italiane. Në janar 1514, qyteti i Ankonës e miraton një kërkesë të tregtarëve të Janinës, Artës dhe Vlorës për të akorduar një nivel preferencial tarifash doganore për shitjen e mallrave në Ankona, Ravena dhe Torino, për produktet si pëlhura, lëkurë bagëtish, mbulesa leshi, batanije, velenxa, qilima, etj. (Vol. I, fq. 49)

Më 19 janar 1518 një dërgatë tregtarësh vlonjatë të kryesuar nga tregtari hebre Abram Trinci, arriti të sigurojë nga paria e Ankonës lehtësi të tjera në pagimin e detyrimeve doganore. Ky traktat konfirmonte të njëjtat taksa transiti të mallrave nëpër territoret e Venedikut, ato të vitit 1514. Në përgjithësi, taksa e doganës në rast shitjesh mallrash transit në qytetet italiane ishte 1% e vlerës së mallrave të shitur. Traktati gjithashtu jep një periudhë prej 2 muajsh që tregtarët e Sulltanit të shesin mallra duke paguar vetëm taksën e transitit, një masë që synonte të nxiste tregtinë midis dy vendeve. Ky regjim tregtar i akordohej të gjithë mallrave të sjella nga Kostandinopoja, Pera, Rumelia, Siria dhe Berberia - nga të gjitha territoret e Perandorisë (V.I). Për të nxitur rritjen e shkëmbimeve me qytetin e Ankonës janë regjistruar gjithashtu edhe proklamata të Sulltanit drejtuar shtetasve të Perandorisë për të blerë mallra në këtë qytet.

34 Injaz Zamputi, Akademia e Shkencave, v. 1989, Dokumente të Shekujve XVI-XVII për Historinë e Shqipërisë, në 3 vëllime

Ndërkohë, që nga viti 1520 u ndalua eksporti i materialeve luftarake për në Vlorë. Produktet e ndaluara ishin armët, çeliku, hekuri, druri dhe nitrati (që përdorej për prodhimin e barutit).

Marrëdhëniet midis Turqisë dhe Venedikut u acaruan duke filluar nga viti 1537 dhe Senati i Venedikut iu ndaloi anijeve të Raguzës të lundronin në portet turke, si një sanksion për pengimin që Turqia i kishte bërë daljes së Venedikut drejt Lindjes.

Duke përkruar gjendjen ekonomike dhe sociale të trevave shqiptare gjatë kësaj periudhe, në një raport të Gjon Xhustinianos, duke përkruar Tivarin dhe Ulqinin, shkruan:... *Shqipëria është e begatshme në çdo lloji drithi... çdo vit nxirren më shumë se 150,000 stere grurë, si dhe drithëra të tjerë.* (viti 1551, fq. 157)

Por katër vite më vonë, në vitin 1555, shkruhet se shqiptarët punonin si argat në korrje në arat e Maqedonisë, Thrakës, dhe Anadollit si punëtorë provizor dhe gjithë dimrin jetonin me paratë e fituara gjatë korrjeve të verës ... Në një kronikë të kohës shkruhej.... *ata (shqiptarët) janë pothuaj që të gjithë të zbathur dhe jashtëzakonisht të varfër...*" (fq. 190). Duhet mbajtur në konsideratë se vitet 1555-6, ishin vite të një zie buke dhe luftërash në të gjithë botën.

Në udhëtimet e tij nëpër viset shqiptare në shekullin XVI, kronikani turk Evliya Çelebi (1611 – 1682) na bën një përshkrim shumë interesant të kushteve të jetesës në krahinat shqiptare, duke nxjerrë në pah jo vetëm bukurinë e krahinave, por edhe jetën me cilësi që bënin banorët e tyre, madhësinë e qyteteve, zhvillimin e aktiviteteve tregtare, etj. Në

RRITJE PA ZHVILLIM
SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

një përmbledhje të këtyre shënimeve, duke marrë si tregues numrin e dyqaneve dhe prezencën e tregjeve të zhvilluara si tregues të shkallës së madhësisë së krahinave dhe kushteve të jetës në to, po rendis më poshtë të dhënat e nxjerra nga ky botim³⁵:

Delvina kishte 80 dyqane, por nuk kishte treg të mbuluar dhe të organizuar. Aktiviteti kryesor ishte tregtia e vajit të ullirit.

Gjirokastra kishte 20 dyqane dhe një treg të organizuar brenda të cilit zhvillonin aktivitetin 80 dyqane.

Berati kishte mbi 700 dyqane; kishte zejtarë dhe mutafxhinj që merren me industrinë e përpunimit të leshit. Qyteti kishte mbi 5,000 shtëpi të mbuluara me tjegulla (një shenjë përparimi ekonomik); më shumë se 100 pallate të mëdha të pajisur me hauze dhe shatërvanë; kishte 170 banja private. Tregu kishte 4 qendra dhe punonin 100 dyqane moderne.

Vlora: kishte 117 dyqane.

Durrësi duhet të siguronte mbi 30 barrë akçe prandaj kishte një administratë tatimore prej 200 vetash.

Kavaja dhe Peqini kishin 200 dyqane secili.

Elbasani duhet të siguronte të ardhura për Perandorinë prej 201,963 akçe. Kishte 1150 saraje dhe shtëpi të mëdha. Tregu kishte 900 dyqane të organizuara dhe organizonte edhe tregje publike të hapura. Ai është kryeqendra e sanxhakbeut.

Tirana kishte 300 shtëpi.

35 Evliya Çelebi, "Shqipëria 350 vjet më parë", Horizonte 2000; botimi 1, Shkodra 1930.

Shkodra siguronte të ardhura mbretërore prej 459,200 akça.

Shkupi kishte 2,000 dyqane ndërsa Manastiri 900 dyqane dhe 40 kafene.

Në librin e tij³⁶, Albania (*Monografia antropo-geografica*), studiuesi italian Eugenio Barbarich na sjell një përshkrim të detajuar të jetës ekonomike në Shqipërinë e fillimit të viteve 1900. Shqipëria është një vend bujqësor, por që teknikat e kultivimit të tokës, prapambetja teknike, mungesa e një sistemi irrigimi, mosnjohja e teknikave artificiale të përdorimit të fertilizatorëve, mungesa e një sistemi krediti, sistemi primitiv i transportit që realizohej me qerre dhe transport lumor me lundra shumë të vogla, nuk njihej akoma plugu prej hekuri dhe toka punohej me plug druri, etj. bënin që potenciali bujqësor të mos shfrytëzohej sa duhej. Edhe sistemi i qiramarrjes, thekson autori ishte demotivues pasi pronarët e tokave ua jepnin tokën kolonëve duke kërkuar në këmbim dy të tretat e prodhimit. Një politikë e tillë dekurajonte punimin e tokës dhe çonte në braktisjen e tokave pjellore. Potenciale të mëdha ekzistonin edhe në ekonominë pyjore, e cila shfrytëzohej shumë pak për shkak të mungesës së infrastrukturës së përshtatshme të transportit. Ndërkohë, kulturat kryesore që prodhoheshin për konsum të brendshëm (kryesisht) por dhe për eksport ishin drithërat, vaji i ullirit, rrushi, fasulja, lëkura e bagëtive. Sa i takon zhvillimit të manifakturës, ajo ishte kryesisht artizanale dhe

36 Eugenio Barbarich, 1905, Albania (*Monografia antropo-geografica*), Roma, Enrico Voghera Editore

RRITJE PA ZHVILLIM
SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

zhvillohej në shtëpi. Industritë ekstraktuese ishin relativisht të zhvilluara në nxjerrjen e bitumit në Vlorë, kripa që përfitohej nga uji i detit. Industria e tekstileve që ishte në formë artizanale ishte e përqendruar në Shkodër, Elbasan dhe Berat. Stofra prej pambuku dhe lini dhe veshje prodhoheshin dhe eksportoheshin nga Tirana, Kruja, Shkodra, Durrësi dhe Kavaja. Industria ushqimore ishte e zhvilluar, kryesisht në prodhimin e gjalpit, djathit, mishit të konservuar, përpunimit të drithërave. Eksportet e tyre llogariteshin rreth 1 milion lira në vit. Fabrika të vogla të prodhimit të sapunit gjendeshin në Shkodër, të prodhimit të tullave, tjegullave dhe vazove prej balte në Durrës, Kavajë, Shijak, Krujë dhe Tiranë.

Qyteti i Durrësit në vitin 1902 raportonte eksporte me vlerë prej 1,433,408 franga ari dhe importe me vlerë 2,529,425 franga ari. Importet totale të Shqipërisë vlerësoheshin në rreth 12 milionë lira italiane.

Shënime të tilla udhëtimi dhe përshkrime të jetës sociale e ekonomike na vijnë nga një numër udhëtarësh të cilët në përgjithësi konfirmojnë se para shekullit XIX dhe deri në fillimet e shekullit XX, jeta sociale dhe ekonomike në Shqipëri kishte zigzaget e saj. Ajo alternonte periudha të rritjes dhe përmirësimit të cilësisë së jetës, me periudha të rënies dhe depresionit ekonomik të cilat i atribuoheshin sa faktorëve të jashtëm ashtu dhe kushteve të brendshme, të lidhura me ndryshimet klimatike, luftërat, mungesën e stabilitetit, rendit dhe sigurisë etj.

Në përfundim, mund të theksojmë se vendet që arritën të përshtatnin më shpejt teknologjitë e tyre dhe

të ruanin tempin e këtij progresi, njohën një shkëputje të madhe në zhvillimin e tyre ekonomik e shoqëror. Ky fenomen vazhdon të dominojë që prej fillimit të shekullit XIX, duke qenë një tipar dallues edhe në botën e sotme. Në periudhën moderne, disa vende të Azisë arritën të shkëputen nga kurthi i nënzhvillimit gjatë mesit të shekullit XX. Ndërkohë, shumë vende akoma vazhdojnë të klasifikohen si ekonomitë në zhvillim, ose *emerging markets*, por pa mundur të bëjnë atë shkëputjen e madhe dhe të renditen si ekonomi të zhvilluara. Në epokën e sotme të Revolucionit të Katërt, gara teknologjike midis vendeve është bërë edhe më e fortë dhe nga këto premisa, diferencat midis vendeve mund të thellohen edhe më shumë në dekadat e ardhshme.

Kapitulli 4

PROTOKAPITALIZMI SHQIPTAR: NJË HISTORIK I SHKURTËR I EKONOMISË GJATË SHEKULLIT XX

Në analizën e zhvillimit ekonomik në një perspektivë historike, pyetja themelore është nëse ishte “akumulimi fillestar i kapitalit” burimi kryesor i progresit drejt një shoqërie kapitaliste të zhvilluar? Ky është thelbi i teorisë marksiste të kapitalit. Apo është pyetja e një komediani të famshëm rus të shekullit XVIII “Nga kush e mësoi profesionin e biznesmenit rrobaqepësi i parë”? Në këtë rast, zhvillimi i kapitalizmit mund të fillojë dhe pa ndonjë akumulim të mëparshëm kapitali, një pikëpamje smithiane kjo sipas së cilës progresi është në natyrën e vetë shoqërisë njerëzore. Analiza e mëparshme demonstroi se teoria smithiane e rritjes mbështet zhvillimin e shoqërisë në epokën e botës merkantiliste, ndërsa industrializimi dhe rritja ekonomike e epokës moderne, kërkon më shumë se sa thjesht prerekuizitat smithiane. Motivi i kërkimit të fitimit nuk është se shpjegon gjithçka në historinë e kapitalizmit sipërmarrës. Siç e thotë Brenner³⁷, “Ajo që e dallon rritjen ekonomike moderne,

37 Daniel Chirot, 1989, vepër e cituar

është diçka më e përgjithshme dhe më abstrakte: është prezenca në ekonomi e një shtyese sistematike, të vazhdueshme dhe gjeneraliste, ose një tendencë nga ana e prodhuesve në drejtim të një efience më të lartë, me çfarëdo mënyre". Por, kjo forcë motivuese nuk është thjesht motivi i fitimit. Faktorë të tjerë më kompleks duhen përfshirë në këtë analizë. Shpjegimi i performancës ekonomike përgjatë historisë kërkon një teori të ndryshimit demografik, një teori të rritjes së stokut të dijes dhe një teori të institucioneve, në mënyrë që të plotësohen boshllëqet që ekzistojnë në teorinë neoklasike³⁸. Në këto linja do të vijojmë analizën për të ndriçuar tezën që kemi marrë në shqyrtim.

"Shumë njerëz dhe pak kapital?" Zhvillimet demografike, marrëdhëniet pronësore në bujqësi dhe zhvillimi ekonomik.

Lidhur me tezën mbi natyrën dhe shkaqet e zhvillimit ekonomik apo të prapambetjes së saj, janë formuluar një sërë teorish të cilat shkojnë që nga gjurmët gjenetike të trashëguara të një populli, determinizmi

38 Teoria neoklasike nuk presupozon ekzistencën e kostove të transaksionit dhe bazohet në supozimin se gjithçka zhvillohet në kushtet e një konkurrence perfekte. Në këndvështrimin e teorisë klasike madje, nuk del qartë se përse historia ka rëndësi në zhvillimin ekonomik afatgjatë, përderisa çdo *shok* i jashtëm në një nga faktorët e prodhimit, ka një ndikim vetëm të përkohshëm pasi në afat të gjatë ekonomia shkon drejt ekuilibrit të qëndrueshëm unik të saj. Lidhja më tej bëhet e qartë kur shqyrtohen modelet e ekuilibrit të shumëfishtë, kur ekonomia kalon nga një gjendje ekuilibri në një tjetër.

gjeografik (burimet natyrore, klima), determinizmi kulturor i tij (idetë, parimet morale dhe besimit fetar), dhe deri tek teoritë e sotme moderne të rritjes ekzogjene dhe endogjene. Shumë prej këtyre teorive të mësipërme janë diskredituar (për shembull, askush nuk do të besonte se gjenet janë një faktor që shpjegon diferencat në performancën ekonomike të popujve të ndryshëm), e megjithatë elemente të veçanta të secilës prej tyre janë pika të rëndësishme të analizës shumë komplekse e shumëfaktoriale të zhvillimit.

Historia e zhvillimit ekonomik botëror dëshmon se bazat e zhvillimit të industrializimit u shënuan nga progresi dhe revolucioni agrar. Romeo, për shembull, arrin në përfundimin se ishte dështimi për të realizuar një revolucion agrar që për shkak se nuk kishte mundur përdorimin e bujqësisë si një burim për akumulimin fillestar të kapitalit, arsyeja që vonoi përhapjen e industrializimit. Po kështu edhe historiani i shquar i ekonomisë Gershenkron i kushton një vend qendror rolit të bujqësisë si faktori kryesor akumulues për financimin e revolucionit industrial dhe prapambetjen e saj, si shkakun kryesor për mospërhapjen e tij në të gjithë kontinentin evropian.³⁹ Po kështu, modeli i zhvillimit agrar në Europën Perëndimore e veçanërisht në Angli i zhvilluar nga Robert Brenner, shpjegon një pjesë të rëndësishme të progresit të Perëndimit.⁴⁰

39 Alexander Gershenkron, "Economic Backwardness in Historical Perspective", 1952 Rosario Romeo, "Risorgimento e capitalismo", 1959, Laterza

40 Brenner, vepër e cituar

Në të njëjtën linjë, edhe literatura e historisë ekonomike që studion shkaqet e prapambetjes së Ballkanit, pjesë e të cilës është edhe Shqipëria, me gjithë variacionet që ekzistojnë nga një vend tek tjetri, arrin në një konsensus që përmblihet në paradigmen se rajoni kishte një popullsi të madhe dhe rrallësi kapitali për investime në industri, që e fuste atë në një “rreth vicioz” të varfërisë në bujqësi. Argumenti shkon i tillë që, rritja e popullsisë e tejkalonte nivelin e produktivitetit në bujqësi, duke rritur kështu presionin për tokën e punueshme; kjo nga ana e saj çonte në ndarjen e mëtejshme të ngastrave të tokës gjë që në vetvete e ulte edhe më shumë produktivitetin e bujqësisë. Niveli i ulët i produktivitetit bënte që popullsia rurale, që ishte dominuese, të mbetej në nivelin e mbijetesës; niveli i kursimeve të ishte i ulët dhe për rrjedhojë, pak kapital ishte i disponueshëm për modernizimin e teknikave bujqësore të cilat do të çonin në rritjen e produktivitetit të këtij sektori, rritjen e kursimeve shtesë që mund të përdreshin për investime në industri, për të hedhur bazat e proto-industrializimit dhe më tej të një shoqërie industriale. Supozimi themelor i ekonomistëve është ai i një niveli marxhinal produktiviteti në bujqësi të barabartë me zero, që do të thotë se “anëtarët e shtuar të familjes bëhen pjesëtar në shpërndarjen e të ardhurave të saj pa kontribuar asnjë shtesë prodhimi apo të ardhure”, një stanjacion mathusian. (Mandelbaum, 1945⁴¹). Ky ligj rikardian i të ardhurave rënëse në të cilën ishte

41 K. Mandelbaum, 1945, The industrialisation of backward areas; Oxford: Blackwell, 1945

ngërthyer sektori bazë i ekonomisë së vendit, bujqësia, mund të cilësohet si faktori themelor që pamundësoi futjen e vendit në rrugën e industrializimit të saj.

Mbipopullimi ishte një tipar dallues i disa zonave të vendit, kryesisht atyre bregdetare. Nga pikëpamja e strukturës së tokës, vetëm 10% e tokës ishte e punueshme dhe që përdorej për veprimtarinë bujqësore. Kështu që presioni për lëvizje migratore të popullsisë ishte i madh.

Por në nivel vendi në tërësi, Shqipëria (dhe Ballkani) kishte dendësinë më të ulët të popullsisë në kontinent. Në mesin e shekullit XIX vetëm në zonat bregdetare që ishin më të populluara, dendësia arrinte në 20 banorë për km². Serbia, që kishte dendësinë më të madhe se mesatarja e rajonit, arrinte në 18.6 banorë për km², që ishte sa 36% e dendësisë së popullsisë së Francës. Ky densitet i ulët i popullsisë, së bashku me gjendjen e keqe të komunikimit midis qendrave të banuara, paraqesin së paku dy implikime:

- Për shkak dhe të gjendjes së mjerueshme të infrastrukturës, bëhej e pamundur dalja në treg e fermerëve; dhe
- Nuk lejonte specializimin (ndarjen e punës) në shfrytëzimin e pasurive natyrore.

Kjo gjendje e mbipopullimit në zonat me potencial bujqësor dhe e nënpopullimit në pjesën tjetër të vendit, nuk favorizonte prodhimin e tepricave që mund të shkëmbeheshin në treg. Blegtoria ishte kështu sektori dominues i jetës ekonomike dhe që siguronte edhe mjetet monetare të popullsisë, ndërsa bujqësia ishte

kufizuar vetëm për qëllimet e mbijetesës së familjes. Siç e kemi thënë dhe më herët, edhe kërkesat e tregut të huaj për produkte blegtorale, lëkurë dhe lesh, kishin patur ndikimin e tyre në këtë strukturë prodhimi midis bujqësisë dhe blegtorisë.

Një tjetër tipar i spikatur i profilit demografik të popullsisë së Ballkanit ishte predominimi i popullsisë rurale, duke dëshmuar për mungesën e rolit që kanë luajtur qytetet si qendrat e zhvillimit të kapitalizmit dhe progresit ekonomik të Europës.⁴² Duke përjashtuar Rumelinë Lindore ku popullsia urbane zinte rreth 21-23% të popullsisë, në të gjitha krahinat e tjera të Perandorisë Otomane, popullsia qytetare nuk e kalonte 19%. Provincat e Shqipërisë dhe Malit të Zi ishin me nivelin më të lartë të popullsisë rurale, dhe ku popullsia që banonte në qytete nuk e arrinte shifrën 10%.⁴³ Ky predominim i popullsisë rurale në Shqipëri ka vazhduar të jetë një trashëgimi permanente edhe pas Luftës së Dytë Botërore, me gjithë industrializimin e sforcuar dhe krijimin e qendrave urbane të përqendruara në shfrytëzimin e pasurive minerale dhe krijimin e industrisë së rëndë.

Në kontekstin e këtyre zhvillimeve demografike, edhe reformat agrare në Shqipëri nuk kishin mundësuar krijimin e fermave të mëdha e moderne dhe struktura e pronësisë mbi tokën dominohej nga

⁴² Mbi rolin e qyteteve në zhvillimin e kapitalizimit dhe përhapjen e tij mund të gjenden tek, Max Weber, *Economy and Society*, 1968; Marc Bloch, *Feudal Society*, 1961; Daniel Chirot, *The Rise of the West*, 1985.

⁴³ Michael Palaret, 1997, *The Balkan economies c. 1800-1914: Evolution without development*, Cambridge University Press

fermat e vogla e të mesme që prodhonin kryesisht për mbijetesë. Në një parantezë, duhet të nënvizojmë se marrëdhëniet e pronësisë mbi mjetet e prodhimit, në rastin konkret të tokës, përcaktojnë kursin e veprimit ekonomik që janë racionale të ndiqen si për prodhuesit e drejtpërdrejtë ashtu dhe për klasat e pronarëve. Për këtë arsye, marrëdhëniet pronësore përcaktojnë në një shkallë të madhe edhe evolucionin e ekonomisë në një shoqëri. Marrëdhënia shkakësore ndjek një linjë të tillë: forma e pronësisë formëson rregullat e riprodhimit për aktorët ekonomikë individualë dhe kjo nga ana e saj përcakton prirjen afatgjatë të zhvillimit/nënzhvillimit ekonomik.

Në fillimet e shekullit XX, marrëdhëniet feudale në bujqësi vazhdonin të ndikonin negativisht në zhvillimin e sektorit bujqësor, sektori kryesor i jetës ekonomike të vendit. Forma e pronësisë ishte heterogjene, ku ndeshen si çifligjet, prona kapitaliste dhe prona e vogël. Në fund të vitit 1928, çifligjet zinin një sipërfaqe prej rreth 200 mijë hektarë e po kaq edhe pronat shtetërore dhe ato të vakëfit.⁴⁴ Pati përpjekje për krijimin e fermave të mëdha kapitaliste në bujqësi, duke hyrë në kontrata koncensionare me kompani të huaja, me qëllim krijimin e kushteve për modernizimin e bujqësisë dhe rritjen e rendimenteve të prodhimit, por klima jo mikpritëse për investimet në vend bënë që ato të dështonin.

Përkeqësimi i gjendjes ekonomike në fshat dhe prapambetja e theksuar e bujqësisë, ushtruan një

44 Iliaz Fishta, Veniamin Toci, Gjendja ekonomike e Shqipërisë në vitet 1912-1944...”, fq.67

presion të madh dhe diktuan nevojën e kryerjes së reformave për të përmirësuar marrëdhëniet e pronës në bujqësi. Madje Mbreti Zog kërkoi asistencë teknike të ekspertëve italianë për të studiuar çështjen dhe për të ofruar këshilla për një reformë integrale në bujqësi. Rezultati i kësaj pune ishin një sërë ligjesh të shpallura në maj të vitit 1930, siç ishin ligji i reformës agrare, ligji mbi Bankën Bujqësore dhe kontrata tip që përcaktonte marrëdhëniet ndërmjet pronarëve të tokave dhe bujqve qiramarrës.

Ligji i reformës agrare i linte në pronësi pronarëve të mëdhenj 40 ha për kryefamiljarin dhe nga 5 ha për çdo pjesëtar të familjes, kur familja kishte mbi 5 frymë. Pas kësaj llogaritjeje të parë, fondi i disponueshëm i tokës do të ndahej: 1/3 do t'i shpërndahej me pagesë bujqve që i punonin tokat, me një çmim 20 franga ari për hektarë ndërsa 2/3 do të përdroreshin për t'ua dhënë me qira sipërmarrësve.

Duhet nënvizuar se kjo ishte një masë me rëndësi shumë të madhe dhe nëse do të ishte zbatuar, efektet e saj do të kishin qenë të ndjeshme. Por, presionet e pronarëve të mëdhenj të tokave, të cilët kishin një ndikim të madh në jetën politike të vendit, bënë që kjo reformë të zvarritej dhe në thelb të mos kryhej. Nga kjo reformë përfituan vetëm 1,905 familje një sipërfaqe të shpërndarë prej 6,375 ha tokë.

Gjendja e pronësisë mbi tokën në momentin e regjistrimit pas ardhjes në fuqi të komunistëve, tregon se pronarët e pasur dhe latifondistët, që përbënin rreth 3% të familjeve, zotëronin 26.8% të tokës (105.6 mijë ha); pronarët e mesëm dhe të vegjël, që përbënin 83%

RRITJE PA ZHVILLIM
SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

të familjeve zotëronin 60.4% të tokës (237,7 mijë ha), me një mesatare prej 1.8 ha për frymë, si dhe 13,8% e familjeve fshatare ishin pa tokë.

Sipas të dhënave të vjetorit statistikor të vitit 1958, shprehur me çmimet e vitit 1956, prodhimi industrial i vitit 1938 kishte shënuar 1,4 milionë lekë ndërsa prodhimi bujqësor 12,8 milionë lekë (të reja), ose 95.5% të prodhimit industrial e bujqësor të marrë së bashku. Të ardhurat që krijoheshin nga industria zinin vetëm 4.5% të të ardhurave kombëtare. Qartazi vendi ishte një vend pothuajse tërësisht bujqësor, sektor ky i karakterizuar nga një prapambetje e theksuar e përdorimit të teknikave moderne të prodhimit, pra dhe e rendimenteve të ulëta.

Ndërsa marrëdhëniet kapitaliste në bujqësi ishin vetëm në fillesat e veta dhe një zhvillim i ngadaltë, evolutiv, kishte filluar gjatë gjysmës së parë të shekullit XX, fundi i Luftës së Dytë Botërore dhe vendosja e komunizmit në Shqipëri shënoi ndryshimin më rrënjësor në marrëdhëniet pronësore mbi tokën, fillimisht të nisura me reformën agrare duke shtetëzuar tokën pa shpërblim dhe duke e shpërndarë falas për popullsinë rurale, për t'u pasuar më pas me format e kooperimit të detyrueshëm bujqësor, në formën e kooperativave dhe fermave shtetërore.

Reformat strukturore të ndërmarra gjatë kësaj periudhe, së bashku me një progres të shënuar drejt modernizimit të teknikës bujqësore, dhanë rezultate pozitive në rritjen e rendimenteve. Prodhimi bujqësor u rrit me mesatarisht 9% në vit në të gjithë periudhën e komunizmit, duke e dyfishuar prodhimin e vet në

çdo dekadë. Kombinimi i formave të pronësisë, duke lejuar ekzistencën e një ekonomie familjare për nevoja të brendshme dhe të fermave të mëdha shtetërore, dhanë rezultate pozitive deri në vitet '80, kur pronësia private u eliminua tërësisht, gjë që reflektohet edhe në rënien e shpejtë të ritmeve të rritjes së bujqësisë, mangësi të theksuara në furnizimin e tregut me mallra ushqimore deri në riprezantimin e sistemit të racionimit ushqimor në vitet e fundit të regjimit.

Investimet në bujqësi gjatë gjithë periudhës së regjimit komunist nuk e kaluan shifrën e 20% të totalit të investimeve, duke bërë që prodhimi bujqësor asnjëherë të mos plotësonte nevojat e brendshme për konsum, përkundrajt kjo edhe një politike të shtrëngimit dhe racionimit të konsumit ushqimor për popullatën.

Fundi i shekullit XX e rigjen Shqipërinë në pikën e vet nisëse në fillimet e saj: një shoqëri kryesisht rurale, me një bujqësi të prapambetur dhe të paaftë për të ushqyer popullsinë e saj, me çështje të pazgjidhura të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe probleme të rëndësishme strukturore të fragmentarizimit të saj, të mungesës së investimeve dhe për rrjedhojë prodhimtaria e sektorit është dukshëm nën nivelet e vendeve të rajonit e padyshim të vendeve të përparuara të Europës.

Nga proto-industrializimi në hiperindustrializim të sforcuar

Shembja e sistemit feudal dhe vendosja e marrëdhënieve kapitaliste në bujqësi në Shqipëri dhe në Ballkan në përgjithësi, zgjatën edhe një shekull më shumë krahasuar me pjesën tjetër të kontinentit. Kjo i atribuohet kryesisht ndikimit negativ të trashëgimisë së Perandorisë Otomane. Siç edhe mund të kuptohet, në kushtet e marrëdhënieve parakapitaliste të pronësisë, tregtia në vetvete ishte shumë modeste dhe jo e mjaftueshme të iniciohte dhe mbështeste një proces të zhvillimit industrial dhe ekonomik.

Teoria e proto-industrializimit mund të shpjegohet shkurtimisht si: Një komunitet i përqendruar fermerësh në një zonë me ofertë toke të pamjaftueshme. Në këtë mënyrë krijohet një mbiofertë e fuqisë punëtore që mund të përdoret në mënyrë sezonale për përpunimin e tepricave të prodhimeve bujqësore. Kjo shënoi dhe krijimin e protoindustrive, si faza e parë e zhvillimit të ekonomisë së sipërmarrjes moderne. Në rajonin e Ballkanit, vetëm Bullgaria arriti të krijonte, që nga viti 1870, kushtet e lindjes së proto-industrive, në dallim nga pjesa tjetër e Ballkanit Perëndimor. Historianët bullgarë e quajnë këtë “rilindja e hershme”.⁴⁵

Shqipëria filloi të ndërtojë një bazë industriale kryesisht duke filluar pas vitit 1925, ku ndeshet një gjallërim i aktivitetit të krijimit të sipërmarrjeve private

45 Michael Palaret, University of Edinburgh, “The Balkan Economies c. 1800-1914. Evolution without development”, Cambridge University Press, 1997.

anonime shqiptare por dhe të huaja dhe ndërmarrjeve të përbashkëta.

Tabela 1: Treguesit e zhvillimit të industrisë dhe punësimit

	1922	1928	1938
Numri i ndërmarrjeve	71	127	244
Numri i punëtorëve	500	2,000	7,435

(Iliaz Fishta, fq. 145)

Siç shihet nga të dhënat e tabelës 1, me gjithë dinamikat pozitive që vërehen në krijimin e ndërmarrjeve të reja dhe shtimin e punësimit në to, industria mbeti një sektor pa ndonjë rol të rëndësishëm ekonomik. Në vitin 1938, vlerësohej se prodhimi industrial e zëjtar zinte 9.8% të të gjithë prodhimit të përgjithshëm, ndërsa të ardhurat e krijuara në industri arrinin në 4.5% të të ardhurave të përgjithshme të vendit⁴⁶. Popullsia e punësuar në industri dhe artizanat u rrit nga 0.06% të popullsisë në vitin 1922 në rreth 0.9% në vitin 1938. Një panoramë të tillë nënzhvillimi na shfaqet në të gjithë gadishullin tonë. Në fillimet e shekullit XX, popullsia e punësuar në industri dhe artizanat ishte 0.2% e totalit të popullsisë për Maqedoninë, 0.5% për Serbinë dhe 0.35% për Bullgarinë. Kjo strukturë ekonomike e Shqipërisë dhe rajonit të Ballkanit kontraston dukshëm me ekonomitë e përparuara europiane që kishin hyrë në fazën e industrializimit. Për shembull, pesha e sektorit

⁴⁶ Iliaz Fishta, Sistemi monetar dhe i kreditit në Shqipëri, fq. 32

bujqësor në Britaninë e Madhe që në vitin 1870 zinte 22.7% të prodhimit të brendshëm, në vitin 1913 kishte rënë në vetëm 11.8%⁴⁷. Duke parë strukturën ekonomike të Bullgarisë, për shembull, bujqësia zinte 63.4% të totalit të prodhimit të brendshëm në vitin 1921, ndërsa industria dhe artizanati zinin 11.1% dhe degët e tjera kontribuonin pjesën që mbetet. Ndërsa në ekonominë shqiptare, bujqësia ishte sektori dominant, që kontribuonte mbi 76% të të ardhurave të buxhetit dhe ku punësohej më shumë se 90% e popullsisë.

Megjithëse nga viti 1925 filluan përpjekjet e para për nxitjen e krijimit të industrive në vend, fatkeqësisht ato u ndërpre në madje u goditën negativisht nga Depresioni i Madh i viteve 1929-33. Nga 10 fabrika që ishin krijuar dhe vepronin në vend, gjysma e tyre falimentuan dhe u mbyllën. Nga ana tjetër, politika fiskale e tatimore ishte gjithashtu shtrënguese. Veçanërisht barra e lartë tatimore për industrinë e përpunimit të duhanit, një industri relativisht e zhvilluar dhe me peshë si në tregtinë me jashtë dhe atë të brendshme, patën gjithashtu një ndikim negativ. Eksportet e duhanit dhe cigareve në fund të viteve 1933 kishin rënë me gati 10 herë në raport me vitin e parakrizës, 1928. Të njëjtin fat patën edhe industritë e reja të sapokrijuara edhe në sektorët e tjerë. Sistemi tatimor fiks që aplikohet mbi prodhimin blegtoral (taksa e xhelepit që aplikohet 1 frangë ari për kokë bagëtie), në kushtet kur kriza globale shkaktoi një rënie të çmimit të bagëtive, rëndonte automatikisht

47 Craft, 2001, *Historical perspectives on development*, "Frontiers of Economic Development, the future in perspective, fq. 314.

barrën fiskale të blegtorisë, e cila zinte mbi 70% të prodhimit bujqësor. Për pasojë, numri i krerëve të bagëtitve shënoi rënie gjatë kësaj periudhe, duke ndikuar në rënien e përgjithshme ekonomike në vend. Po kështu edhe politikat proteksioniste që u aplikuan gjerësisht gjatë periudhës së Depresionit të Madh, penguan ndjeshëm eksportet. Megjithëse ato ishin në nivele shumë modeste, kriza globale e vitit 1919 kishte dekurajuar industrinë e reja të sapokrijuara dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të reja.

Teza e studiuar nga literatura e periudhës komuniste mbi ndikimin e kolonializmit në zhvillimin ekonomik dhe shfrytëzimin e pasurive tona kombëtare, nuk gjen një mbështetje nga të dhënat statistikore. Zhvillimi nëpërmjet investimeve të huaja gjatë kësaj epoke nuk kishte qenë shumë i suksesshëm. Nga njëra anë nuk ndeshen investime të huaja në sektorët prodhues industrialë, por ato ishin të fokusuara vetëm në ekstraktimin e burimeve natyrore dhe “vjeljen e kremit” duke transferuar fitimet jashtë vendit dhe jo për t’i riinvestuar në vend. Kjo në fakt ka qenë një paradigmë që ndeshet në të gjithë botën ku roli i investimeve të huaja ishte i kufizuar vetëm në këta sektorë. Siç edhe shihet nga të dhënat e tabelës së mëposhtme, nivelet e prodhimit të naftës ishin shumë modeste ndërsa mineralet e tjera duket se nuk kaluan asnjëherë në një fazë prodhimi dhe tregtimi. Ndërsa ambienti për të pritur investimet e huaja nuk ishte aspak i favorshëm.⁴⁸ Pas një lufte konkurruese për

48 Për shembull, në kujtimet e Eqerem bej Vlorës tregohet shembulli i krijimit të një ferme moderne dhe me teknologjinë e

RRITJE PA ZHVILLIM
SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

naftën në vitet 1923-25, interesat amerikane u shuan kur panë se investitorët anglezë dhe italianë kishin gjetur shumë pak rezerva. Po për këtë arsye u braktisën dhe minierat e bakrit në Pukë që zotëroheshin nga jugosllavët.

Tabela 2: Nxjerrja e naftës nga puset që kishin filluar shpimet që prej vitit 1926, filloi vetëm në vitin 1929 dhe ishte në sasi të si më poshtë: (në ton)

1929	750
1930	900
1931	400
1932	1,300
1933	1,550
1934	9,240
1935	13,570
1936	44,700
1937	81,019
1938	108,116

Burimi: I Fisha, V. Toci, Gjendja ekonomike në Shqipëri, fq. 163

Pavarësisht se në pamje të parë ishte krijuar ideja se kapitalet e huaja kishin gllabëruar pasuritë natyrore të vendit, në fakt të gjitha investimet e firmave të huaja koncesionare nuk e kishin kaluar fazën e eksplorimit dhe zbulimit të mineraleve, dhe shumë pak aktivitet

kohës, në Shqipërinë e Mesme nga një sipërmarrës hungarez, por që për shkak të xhelozive tipike ballkanike, investitori u largua pa e përfunduar investimin e vet. (E. Vlora, Kujtime.)

ekstraktues u realizua. Ideja e kolonializimit të vendit nga interesat e kapitalit të huaj ishte kryesisht një mit i krijuar nga këndvështrimi i ideologjisë komuniste më shumë se një realitet veprues. Një mori ligjesh që u miratuan nga Parlamenti i kohës thjesht po hidhnin bazat e një legjislacioni për sipërmarrjen private të ngjashëm me praktikën e vendeve perëndimore, por që koha e pamjaftueshme dhe konteksti gjeopolitik në kontinentin tonë në atë periudhë, nuk i dhanë vendit tonë mundësinë që të bëhej pjesë e ekonomisë globale.

Roli i kapitalit privat lokal ishte shumë modest. Edhe një sasi e vogël kapitalesh që kishte mundur të grumbullohej nga një grup familjesh të pasura, e kishte gjetur më me leverdi të investonte në tregti se sa në investime afatgjata. Disa pak shoqëri aksionere që ishin krijuar gjatë këtyre viteve nuk patën sukses dhe shumë pak përpjekje u bënë për mbështetjen e tyre me politika më aktive publike. Qeveritë e kohës ishin të pamundura financiarisht për të bërë ndonjë përpjekje serioze për të nxitur investimet private në industri. Privilegjet për investimet në industri kufizoheshin në çlirimin e investitorëve nga barra e pagimit të tarifave doganore për makineritë e pajisjet, një masë e njëjtë që do të replikohej edhe në fillimet e tranzicionit gjatë dekadës së viteve '90.

Përpjekjet e bëra gjatë kësaj periudhe për fillimin e industrializimit, ndërtimin e infrastrukturës së transportit dhe sistemit bankar e të kreditit, megjithëse shumë modeste, siç e nënvizuar dhe më lart, fatkeqësisht u ndërpreu dhe u goditën negativisht nga Depresioni i Madh i viteve 1929-33. Në veçanti

RRITJE PA ZHVILLIM
SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

ndikimet negative të krizës pasqyrohen në dinamikat e tregtisë së jashtme. Pas një rritjeje impresionuese që shënuan eksportet duke filluar nga viti 1923 e në vazhdim, këto dinamika rritëse u ndërpre në dukshëm pas vitit 1930, dhe pothuaj u përgjysmuan.

Tabela 3: Vëllimi i tregtisë së jashtme
(në mijë franga ari)

	Eksporti	Importi
1920	1,500	17,500
1921	2,190	18,236
1922	2,962	12,099
1923	8,138	23,418
1924	12,379	20,499
1925	17,123	21,799
1926	11,964	24,865
1927	11,107	24,682
1928	14,859	32,312
1929	14,683	38,644
1930	12,352	33,289
1931	7,509	29,513
1932	4,500	22,814
1933	5,746	15,938
1934	4,284	12,333
1935	6,037	13,730
1936	7,435	16,778
1937	10,175	20,316
1938	9,750	22,980

(Iliaz Fishta, Gjendja ekonomike e Shqipërisë, faqe. 33)

Nivelet e eksporteve duhen nënvizuar që janë tepër të ulëta krahasuar edhe me vendet fqinje të pazhvilluara të Ballkanit. Kështu, eksportet shqiptare të llogaritura për një banor luhaten në midis 2 franga ari deri në 18 franga ari (maksimumi i vitit 1928-29), krahasuar me 31 franga për Maqedoninë, 40 franga për Serbinë dhe 42 franga për Bullgarinë.⁴⁹ Eksportet financonin 8.5% deri në 38% të totalit të importeve, duke krijuar një deficit të konsiderueshëm të bilancit të tregtisë së jashtme që duhej mbuluar me të ardhurat nga emigracioni, kreditë dhe ndihmat nga jashtë apo burime të tjera nga investimet e huaja të pakta të kohës dhe përdorimi i rezervës valutore të shtetit.

Kriza gjithashtu ndikoi në ecurinë e kredisë dhjetëvjeçare prej 100 milionë franga ari që Italia kishte premtuar t'i akordonte Shqipërisë, sipas marrëveshjes së nënshkruar në vitin 1931. Ajo ndikoi në ngadalësimin dhe pezullimin e punimeve civile në një sërë projektsh infrastrukturore që kishin qenë në proces zbatimi, siç ishte rruga Tiranë-Elbasan, Durrës-Kavajë, Vorë-Milot; ndërtimin e disa urave apo ndërtesave administrative, etj. Kushtet e huas ishin shumë miqësore: nuk do të aplikohesh asnjë interes mbi huan dhe kthimi i saj do të bëhej vetëm me përmirësimin e gjendjes së financave publike, kur të ardhurat e buxhetit të tejkalonin shifrën e 50 milionë frangave ar. Ndërkohë, interesi që vendet fqinje si Greqia, Bullgaria e Jugosllavia paguanin për

49 Statistikat për vendet e rajonit janë marrë nga John R. Lampe, vepër e cit.; fq. 197

kreditë që kishin marrë kryesisht nga bankat franceze ishte rreth 9% në vit. Sidoqoftë, rivalitetet politike për dominim dhe ekspansion të natyrës imperialiste në kontekstin e kohës dhe ndjenjat nacionaliste për pavarësi dhe identitet kombëtar që ishin shumë të fuqishme, çuan në fërkime midis qeverisë së Mbretit Zog dhe qeverisë italiane, me pasojë mosrealizimin e kredisë e cila mund të kishte dhënë një ndihmesë e veçantë në shëndoshjen e financave të vendit dhe në përfundimin e një sërë projektesh infrastrukturore dhe të urbanizimit të nisura më parë. Kredia u pezullua në prill të vitit 1933, si dhe u kërkua nga pala italiane edhe fillimi i pagimit të detyrimeve të krijuara nga kredia e parë prej 50 milionë frangave ar.

Me pak fjalë, ndërsa në fillesat e krijimit të shtetit të pavarur shqiptar industria ishte pothuaj inekzistente dhe e kufizuar në disa punishte të vogla të artizanatit, pas mesit të viteve '20, kur një lloji stabiliteti i brendshëm politik i moderuar po krijohej dhe gjendja e rendit dhe e sigurisë ishin fuqizuar, disa reforma ekonomike dhe financiare filluan të zhvillohen dhe të japin efekte. Edhe me mbështetjen e kapitalit të huaj dhe investimeve të huaja private, vendi filloi të hedhë bazat e një shoqërie proto-industriale, por pa mundur të bëjë një kapërcim të madh cilësor.

“Shtytja e madhe” do të vinte gjatë viteve të socializmit. Brenda gati dy dekadave, vendi pësoi ndryshimin më të rëndësishëm në strukturën ekonomike, ku industria filloi të bëhej sektori dominues në jetën e vendit. Me mbështetjen e fortë ruse dhe më pas

kineze, vendi u fut në rrugën e një industrializimi të shpejtë e të sforcuar, por të pastudiuar dhe që rezultoi të ishte rrënuese nga pikëpamja e eficiencës ekonomike të përdorimit të burimeve të rralla të zhvillimit. Fokusimi në industrinë e prodhimit të mjeteve të prodhimit më tepër se në prodhimin e sendeve të konsumit, dhe për më tepër krijimi i bazave për një industri të rëndë të gjithanshme, deri në prodhimin e mjeteve të rënda dhe të luftës, sipas parimit të mosvarësisë nga jashtë në çdo produkt, ishte keqpërdorimi më i madh që i është bërë burimeve materiale, financiare e njerëzore të vendit.

Investimet në industri që prej vitit 1950 e deri në fund të sistemit komunist, zinin më shumë se gjysmën e totalit të investimeve shtetërore dhe ku industria e rëndë mbante pjesën më të madhe, mbi 55% të tyre dhe kontribuonte me 52-65% të total të prodhimit industrial në vend. Për një vend si Shqipëria me një ekonomi të vogël dhe të mbyllur, ky ishte një raport shumë disproporcional, duke bërë që edhe këto përpjekje modernizuese të industrializimit, të rezultonin të pafrytshme. Në vijim do të ndalemi më hollësisht në arsyet e dështimit të sistemit komunist në vend.

Zhvillimet në financat publike, në sistemin bankar dhe të kredisë

Teoria e zhvillimit ekonomik i kushton një vend qendror rolit të tregut financiar, shkallës së zhvillimit të tij dhe korrelacionit pozitiv midis tregjeve financiare dhe rritjes ekonomike. Gjendja e financave publike dhe politikat buxhetore, të cilat minimizojnë eksternalitetet negative dhe rrisin normën sociale të kthimit të investimit, nga njëra anë, së bashku me ekzistencën e një tregu financiar të zhvilluar, që rrisin eficiencën e alokimit të fondeve drejt projekteve të investimeve më fitimprurëse, janë faktorë me rëndësi në analizën e zhvillimit ekonomik. Për më tepër, roli i shtetit në mbështetjen e zhvillimit ekonomik nëpërmjet rritjes së investimeve publike, ishte edhe doktrina ekonomike e kohës. Triumfi i kejsianizmit që prej viteve '30 e deri në mesin e viteve '70, e bëri këtë rrymë të mendimit intelektual më influencuesen e shekullit XX, pas marksizmit.

Nga analiza e të dhënave statistikore mbi të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit të pasqyruara në tabelën 4, konkluzioni i parë është ai i disiplinës fiskale dhe i politikës së ndjekur të një buxheti të balancuar.⁵⁰ Duhet nënvizuar se doktrina e

50 Statistikat e financave publike kanë pasaktësi që mund të jenë shqetësuese lidhur me saktësinë e gjykimit. Për shembull, ndërsa borxhi publik në vitin 1923 nga specialistët shqiptarë raportohej në vetëm 3 milionë franga ari, këshilltari financiar i dërguar nga Lidhja e Kombeve, Hunger, e llogariste atë në 15 milionë franga ari (Beqir Meta, Politika tatimore e shtetit shqiptar, 1925-1939; fq. 14).

buxheteve të balancuara ka qenë filozofia dominuese e qeverisjeve në të gjithë botën, duke përjashtuar episodet e luftërave që financoheshin përmes borxheve. Ndërkohë që episodet e krizave ekonomike e financiare adresoheshin përmes përshtatjeve natyrore, pa politika të ndërhyrjeve aktive përmes borxheve apo mbështetjes prej bankave qendrore. Pra, ekonomia rikthehej në ekuilibër në mënyrë automatike, duke u pastruar nga investimet e tepërta apo alokimet joeficiente të burimeve në ekonomi.

Kjo politikë ishte ndjekur dhe nga shteti shqiptar. Deficiti fiskal primar në nivelin e vet më të lartë arrinte në vetëm rreth 8% të totalit të të ardhurave. Të ardhurat ishin rritur me një ritëm mesatar vjetor prej rreth 3.5% për të gjithë periudhën 13-vjeçare, 1926-1939. Pas një rritje të fortë të të ardhurave deri në vitin 1933, në vazhdim shihet një rënie e ndjeshme e tyre dhe rritje e deficitit publik. Krijta e të ardhurave të buxhetit është impresionuese në kontekstin e situatës deflacioniste që kishte imponuar kriza botërore. Ndërsa rënia kumulative për dy vite financiare të njëpasnjëshme (1934-36) ishte me gati 50% të të ardhurave. Arsyet e kësaj rënieje shpjegohen me zhvillimet politike në përkeqësimin e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Italisë dhe mosfinancimin nga pala italiane të kredisë së dytë të akorduar për zhvillim. Siç shihet, varësia e Shqipërisë nga fuqitë e mëdha për të mbijetuar ekonomikisht, ka qenë një tipar kryesor edhe gjatë kësaj kohe, siç do të mbetet i tillë edhe gjatë sistemit komunist dhe në dekadat e para të tranzicionit postkomunist.

RRITJE PA ZHVILLIM
SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

Tabela 4: Gjendja e financave publike,
në mijë franga ari

	Të ardhurat	Shpenzimet	Deficiti
1926-1927	23,375	23,418	-43
1927-1928	27,362	25,373	1,989
1928-1929	30,272	28,167	2,105
1929-1930	30,801	33,125	-2,324
1930-1931	29,818	31,655	-1,837
1931-1932	32,720	35,511	-2,791
1932-1933	37,334	37,699	-365
1933-1934	24,118	23,673	445
1934-1935	18,507	18,888	-381
1935-1936	17,237	18,035	-798
1936-1937	18,584	18,879	-295
1937-1938	26,225	26,228	-3
1938-1939	28,235	28,565	-330

Duhet nënvizuar gjithashtu se kreditë nga jashtë ishin burim i rëndësishëm i financimit të ekonomive të prapambetura të Ballkanit, e diktuar kjo qoftë nga mungesa e një tregu të brendshëm financiar, ashtu dhe niveli i ulët i kursimeve të brendshme, si një reflektim ky i prapambetjes dhe nënzhvillimit në tërësi. Kriza e madhe e vitit 1929-33 i përkeqësoi edhe më shumë termet e financimit, duke rritur koston e shlyerjes së borxheve të huaja që luhatej nga 16% deri në 30% të të ardhurave të buxhetit për të gjithë ekonominë e vendeve të Ballkanit.

Gjendjes së financave publike që mund të konsiderohet si e mjerueshme, i shtohet edhe një mungesë totale e një tregu bankar e të kredisë. Krijimi

i bankës së parë të shtetit shqiptar daton më 4 tetor 1913, me nënshkrimin e marrëveshjes midis qeverisë së parë shqiptare të kryesuar nga Ismail Qemali dhe përfaqësuesve të bankës Wiener Bank Verein (austro-hungareze) dhe Banca Commerciale Italiana, dhe vjen në mungesën e plotë të një trashëgimie nga periudha e Perandorisë (vetë Perandoria Otomane krijoi bankën e emisionit për herë të parë në vitin 1863). Banka Kombëtare e Shqipërisë e krijuar me këtë marrëveshje koncesionare 60-vjeçare (me të drejtë shtyrjeje edhe për 30 vite të tjera, në rast se qeveria nuk kërkonte mbylljen e kontratës) kishte një kapital prej 10.5 milionë lireta në monedhë ari, dhe vepronte si bankë universale dhe bankë emisioni. Kartëmonedhat (biletat e emisionit) emetoheshin në shqip dhe frëngjisht. Banka kishte filialet e veta në Elbasan, Berat dhe Vlorë. Kjo bankë e pushoi aktivitetin e vet shumë shpejt, me fillimin e luftës ballkanike. Gjatë kësaj periudhe, në vend qarkullonin një sërë monedhash të huaja, turke, austriake, italiane, greke, serbe, etj. Me një vendim qeverie të datës 25 qershor të vitit 1921 u vendos që të gjitha monedhat të unifikoheshin dhe konvertoheshin në franga ar, që u shpall monedha kombëtare, dhe u përcaktua dhe kursi i konvertimit të monedhave që qarkullonin në vend me frangën ar. Shqipëria kishte përdorur gjerësisht monedhën e bashkimit monetar latin, franga-lira ari dhe pirja e shqiptarëve kishte qenë që të ruanin kursimet e tyre gjithnjë në metale të çmuara pa e pranuar monedhën letër⁵¹. Kurset e

51 Gino Borgatta, *Moneta e Credito in Albania*, shkrime të vitit 1910-1920

këmbimit të vendosura ishin lira sterlinë = 25 franga ari; lira turke = 22 franga ari; dollari amerikan = 5 franga ari; napoloni = 20 franga ari. Këtij kursi i bëhej një zbritje prej 10% për kartëmonedhat (me përjashtim të dollarit) dhe 5% për monedhat prej argjendi.⁵² Ndërsa më 16 shkurt 1922 u adoptua monedha kombëtare me emrin "lekë" e cila do të qarkullonte me kursin ligjor 100 lekë = 20 franga ari e po kështu, lejohej qarkullimi i lirshëm edhe i monedhave të huaja sipas kursit ligjor të shpallur. Sipas llogarive të përafërta të Profesor Kalmes, vlerësohej se në Shqipëri qarkullonin 50-100 milionë franga ari dhe të thesarisuara, duke anuar më shumë nga shifra e dytë⁵³.

Profesor Kalmes nga Luksemburgu ishte dërguar nga Lidhja e Kombeve për të hartuar një raport mbi gjendjen ekonomike e sociale të Shqipërisë. Raporti që u paraqit në sesionin e muajit shtator të Lidhjes, parashtronte nevojën e krijimit të bankës së emisionit dhe të rrjetit të institucioneve bankare e të kreditit, me një kapital 10-15 milionë franga ari. Një sërë projektesh të tjera u hartuan nga një sërë ekspertësh financiarë të dërguar nga Lidhja edhe në vitet në vazhdim, por duket se konfliktet e interesave midis fuqive të mëdha në atë periudhë për dominim në territoret ballkanike, e penguan finalizimin e këtij projekti edhe për disa vite. Siç dëshmon në kujtimet e tij Mehdi Frashëri, edhe propozimet që u bënë për krijimin e një banke me kapital tërësisht shqiptar asnjëherë nuk u arrit të finalizohesh nga qeveritë e kohës, të cilat ishin

52 Haxhi Shkoza, *Financat e Shqipërisë (1839-1934)*, fq.789

53 Cituar nga Borgatta, vepër e cituar

shumë jetëshkurtra si pasojë e paqëndrueshmërisë së brendshme politike.

Pas disa rivaliteteve politike me kapitalin anglez, qeveria angleze u tërhoq në favor të interesave italiane. Në këtë mënyrë, në mars të vitit 1925 u arrit marrëveshja e koncesionit me qeverinë italiane për krijimin e bankës kombëtare shqiptare (me kapital 51% italian dhe 49% shqiptar) dhe marrëveshjen e huas SVEA⁵⁴. Banka u krijua si institut shqiptar, me një kapital prej 12.5 milionë franga ari. Aksionerë të bankës ishin disa banka italiane (Credito Italiana, Banca Nazionale di Credito, Banca di Roma, Banca Commerciale Italiana, disa banka të vogla italiane, katër banka jugosllave, një bankë belge dhe tre aksionerë shqiptarë: Ajet bej Libohova, me 40,000 aksione; Eqerem bej Vlora, me 58,000 aksione dhe Nexhet pashë Vlora, me 52,000 aksione. Kontrata koncensionare kishte një afat 50-vjeçar dhe me të drejtë ripërtëritje. Qëllimi i krijimit të bankës ishte dhënia e një huaje nëpërmjet SVEA për një shumë 50 milionë franga ari, që të përdorej për zhvillimin e infrastrukturës së vendit.

Duke vepruar si bankë emisioni, politika monetare që do të ndiqte ajo ishte e sistemit të standardit të arit, domethënë që kartëmonedhat e emetuara ktheheshin lirisht në ar dhe në monedha të konvertueshme, si dollarë, lira, sterlina, etj. Në këtë mënyrë, u krye një reformë e plotë monetare, duke zëvendësuar të gjitha monedhat e huaja që qarkullonin në vend,

54 *Societa per lo Sviluppo Economico d'Albania*, dhe ndryshoi emrin në vitin 1936 duke u quajtur *Societa per i Finanziamenti Esteri*.

RRITJE PA ZHVILLIM
SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

me kartëmonedhën franga ari. Deri në fund të vitit 1928 ishin hedhur në qarkullim 10,095.000 franga ari kartëmonedha dhe 422,000 franga ari monedha.

Roli i kësaj banke në kreditimin e ekonomisë dhe në zhvillimin e vendit mbeti shumë i kufizuar. Madje, pjesa më e madhe e depozitave të vendit investoheshin në letrat me vlerë të qeverisë italiane. Nga ana tjetër, banka ndoqi një politikë diskriminuese kreditimi për qeverinë shqiptare dhe sektorin privat, duke favorizuar vetëm firmat italiane që vepronin në Shqipëri ose tregtarët vendas që kishin lidhje biznesi me këtë vend. Në disa kërkesa që kishte bërë qeveria shqiptare për emetim borxhi publik dhe blerjen e tij nga banka, ishin refuzuar nga drejtuesit italianë.

Përprojekjet e herëpashershme për krijimin e bankave të tjera me kapital privat shqiptar u minuan në mënyra të ndryshme⁵⁵, e po kështu u zvarrit edhe ideja e hedhur që në maj të vitit 1930 për krijimin e një banke bujqësore, e cila do të krijohet vetëm në vitin 1937. Po në këtë vit, u krijua edhe filiali i Banca di Napoli, me seli në Tiranë, me një kapital 1 milionë franga ari. Në vitin 1938 u përrurua ndërtesa e re e Bankës Kombëtare në Tiranë, duke zhvendosur selinë e saj qendrore nga Durrësi.

Deri në fund të vitit 1939, sistemi bankar shqiptar përbëhej nga vetëm 4 banka, me 17 degë dhe agjenci në të gjithë vendin. Aktiviteti kreditues ishte shumë

55 Një përprojekte serioze ishte ajo e shoqërisë SITA (Shoqëria Industriale Tregtare Shqipëri), një ndër shoqëritë më të mëdha në vend dhe që shtrinte veprimtarinë e vet në prodhimin e energjisë elektrike, tulla, tjegulla, kripë etj., por që nuk u realizua.

modest dhe për rrjedhojë, roli i saj në nxitjen e zhvillimit ekonomik të vendit ishte i neglizhueshëm. Për ilustrim, ndërsa bujqësia zinte më shumë se 90% të ekonomisë së vendit, kredia për këtë sektor ishte vetëm 2% e totalit të kredisë.

Depozitat në sistemin bankar ndërkohë njohën një rritje të fortë. Brenda një periudhe prej një dekade, rritja e tyre ishte 8-9 herë, duke reflektuar kryesisht hyrjet financiare nga kredia e qeverisë italiane. Por nga ana tjetër mesatarisht vetëm rreth 25% e depozitave ndërmjetëshoheshin si kredi për sektorin privat të ekonomisë.

Tabela 5: Gjendja e depozitave dhe kredisë në fund të çdo viti, në franga ari

	Depozitat	Kredia
1926	1,734,000	na
1927	3,589,000	na
1928	5,526,000	na
1929	8,598,000	na
1930	12,432,000	na
1931	16,095,000	na
1932	20,775,000	5,834,000
1933	16,488,000	3,365,000
1934	13,372,000	3,063,000
1935	9,557,000	3,814,000
1936	17,352,000	4,374,000
1937	14,810,000	4,869,000
1938	12,155,000	8,199,000

Burimi: Iliaz Fishta, Sistemi monetar dhe i kreditit në Shqipëri, 1925-1944; fq. 166

RRITJE PA ZHVILLIM
SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

Fillimi i Luftës së Dytë Botërore e gjeti Shqipërinë një vend me karakteristika të një prapambetjeje të madhe ekonomike dhe me një infrastrukturë të pazhvilluar. Në gati dy dekada të monarkisë zogiste ishin hedhur hapa të rëndësishëm institucionale në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm që do të garantonin një rritje ekonomike të shpejtë dhe modernizim të strukturave ekonomike e sociale të vendit. Por dy ngjarje të rëndësishme i kishin minuar këto përpjekje. Fillimisht ishte Depresioni i Madh i viteve 1929-33 që do të godiste rëndë aktivitetin e brendshëm ekonomik dhe tregtinë e jashtme. Por njëkohësisht edhe deflacioni do të godiste fort të ardhurat e pjesës më të madhe të popullsisë që merrej me aktivitet bujqësor. Ndërsa ngjarja e dytë do të ishte fillimi i Luftës së Dytë Botërore, fundi i së cilës shënoi një ndryshim dramatik të sistemit ekonomik, politik dhe shoqëror, instalimin e diktaturës komuniste.

Kapitulli 5

SOCIALIZMI: NJË IDE E DËSHTUAR QË NUK VDES

Nëçdoballafaqimqëshoqëriandeshmekrizateforta ekonomike e sociale, debatet mbi vetë natyrën e sistemit ekonomik dhe qëndrueshmërinë e tij, zënë vendin qendror në debatet akademike. Debatet e para të forta i ndeshim në vitet 20 të shekullit të kaluar, nën lidërshpinin e eksponentëve të rëndësishëm të shkollës austriake, ku vendin e nderit e mbajnë Ludwig von Mises, shkrimet e të cilit do të përmblihdeshin⁵⁶ më pas në librin, *“Socialism: An economic and sociological analysis”* (1952) dhe Friedrich von Hayek me veprën e tij kryesore në këtë fushë⁵⁷, *“The Road to Serfdom”* (1944). Në atë periudhë socializmi ishte ideologjia e modës dhe siç do të shprehej Stalini, sipas kujtimeve të Milovan Gjilasit, “tani socializmi mund të zbatohet edhe në një vend si monarkia britanike”⁵⁸. Sigurisht që Stalini i referohej në këtë rast simpatisë që kishin ngjallur idetë socialiste midis një grupi prominent intelektualësh britanikë dhe lëvizjes fabiane që ishte mjaft e fuqishme në atë kohë.

56 Ludwig von Mises, 1952, *“Socialism: An economic and sociological analysis”*

57 Friedrich von Hayek, 1944, *“The Road to Serfdom”*

58 Milovan Djilas, 1961, *Conversations with Stalin”*, Harcourt Brace Company

Pas Depresionit të Madh të viteve 1929-33 dhe fundit të Luftës së Dytë Botërore, sërish diskutimi mbi mbijetesën e sistemit kapitalist dhe nëse socializmi ishte forma më e përshtatshme e organizimit të jetës ekonomike në botën e pasluftës, mori një vend qendror. Ky debat u ushqye në veçanti nga botimi i tre veprave⁵⁹ shumë të rëndësishme nga tre ekonomistë shumë të shquar të kohës, “*Capitalism, Socialism and Democracy*” (1942) nga Joseph Schumpeter, “*Man and Society in the Age of Reconstruction*” (1940) nga Karl Mannheim⁶⁰ dhe “*The Great Transformation*” (1942) nga Karl Polanyi⁶¹. Të tre këta ekonomistë ndanin të njëjtin mendim se: Depresioni i Madh dhe Lufta e Dytë Botërore i kishin dhënë një përgjigje negative mbijetesës së sistemit kapitalist *laissez faire*. Rindërtimi botës së pasluftës sipas tyre, duhet të bazohej në një sistem inovativ, ku idetë socialiste ishin qendrore.

Pyetja e shtruar nga Schumpeter në atë kohë, “A mund të funksionojë socializmi?” (së cilës ai i kishte dhënë një përgjigje pozitive), në fundin e viteve 1980 u riformulua “Pse dështoi socializmi?” një pyetje që tërhoqi vëmendjen e shumë studiuesve të shkencave sociale. Triumfi i tregut të lirë dhe kapitalizmit konkurrues në shkallë botërore duket se po justifikonte predikimin e Fukuyamas se kishim prekur fundin e historisë. Por, kriza e fortë ekonomike e Recesionit

59 Joseph Schumpeter, *Capitalism, Socialism and Democracy* (1942)

60 Karl Mannheim, *Man and Society in the Age of Reconstruction* (1940)

61 Karl Polanyi, “*The Great Transformation*” (1942)

të Madh të vitit 2008, përsëri do të inkurajonte kritikët e sistemit kapitalist të riqarkullonin idetë e paqëndrueshmërisë së këtij sistemi. Vepra e Piketty, *“Capital in 21st century”* (2014)⁶² ka si ide qendrore thellimin e kontradiktave që krijon sistemi kapitalist për shkak të thellimit të pabarazive social-konomike, të cilat do e bëjnë sistemin kapitalist të paqëndrueshëm që të mbijetojë në histori.

Është shumë interesante se edhe pse socializmi ishte eksperimentuar për gati 7 dekada në pothuajse gjysmën e vendeve të botës dhe se përpjekjet dhe sakrificat e shumta të shoqërisë kishin përfunduar në një sistem që kishte mbjellë mjerim, sërish ideja e socializmit vazhdon të mbetet një ide tërheqëse dhe joshëse. Fundi i socializmit vazhdon të mos pranohet si një fakt historik dhe deterministik. Disa studiues nënvizojnë se socializmi ka funksionuar në pjesën më të madhe të kohës kur u eksperimentua, por ishin vitet '80 gjatë të cilave ai dështoi. Në një libër të tij⁶³, *“The new Russia in a changing world”* (2015), ish-udhëheqësi i fundit sovjetik Gorbaçov, mbron idenë se sistemi që ishte eksperimentuar në ish-Bashkimin Sovjetik dhe vendet e kampit socialist ishte më shumë një sistem tiranik, prandaj dhe nuk ishte sistemi socialist ai që dështoi, por tirania. Një ekonomist institucionalist, Janos Kornai e kishte pranuar mundësinë e funksionimit të sistemit socialist në një mënyrë të përkohshme; por ishte e pamundur që ai të funksiononte në afat të gjatë, siç kishte provuar

62 Thomas Piketty, 2014, *“Capital in 21st century”*

63 Mihail Gorbaçov, 2015, *“The new Russia in a changing world”*

të ishte sistemi kapitalist që është eksperimentuar nga njerëzimi prej më shumë se dy shekujsh. Këtë rrugëtim të socializmit dhe shkaqet ekonomike dhe të ekonomisë politike të dështimit, do përpiqemi ta trajtojmë shkurtimisht në vijim.

Socializmi në fillimet e veta dukej se po punonte. Artefaktet statistikore e mbështesin idenë se socializmi ka prodhuar rezultate të lavdërueshme në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore, duke ngushtuar ndjeshëm një hendek të fortë që ishte krijuar midis vendeve të zhvilluara Perëndimore dhe atyre të Lindjes. Është një fakt i njohur historik se që nga Revolucioni Industrial, ndarja midis Lindjes dhe Perëndimit do të thellohej ndjeshëm. Shqipëria dhe Ballkani (midis të tjerëve) padyshim që kishin mbetur në periferi të këtij transformimi ekonomik të pashoq në histori dhe prapambetja në raport me Perëndimin ishte thelluar. Pas një periudhe të shkurtër historike të monarkisë ku vendi u fut në etapën e protoindustrializimit dhe filloi të hidhte hapat e parë drejt krijimit të një sistemi ekonomik modern sipas modelit perëndimor, progresi do të ndërpritej nga nisja e Luftës së Dytë Botërore dhe instalimi i sistemit komunist pas lufte. Arritjet e sistemit të ri në planin ekonomik duket se ishin mbresëlënëse. Do e ilustrojmë këtë tezë me disa të dhëna interesante dhe të rëndësishme. Në vitin 1950⁶⁴, jetëgjatësia mesatare në Shqipëri ishte 53.5 vite, ndërsa në Gjermani ishte 66.69 vite. Pra një

64 Të gjitha të dhënat historike për Shqipërinë janë marrë nga Vjetori Statistikor i Shqipërisë, 1991, botim i Drejtorisë së Statistikës pranë Ministrisë së Ekonomisë.

qytetar shqiptar kishte një jetëgjatësi më të shkurtër me 13.2 vite krahasuar me një gjerman. Në vitin 1980, jetëgjatësia në Shqipëri ishte rritur në 70.2 vite ndërsa në Gjermani në 72.84 vite, pra diferenca në jetëgjatësi midis dy vendeve ishte shkurtuar në vetëm 2.64 vite. Vdekshmëria foshnjore në Shqipëri në vitin 1950 ishte 156.806 për 1,000 lindje të gjalla, ndërsa në Gjermani ky tregues ishte vetëm 51.059, me një diferencë shumë të lartë prej 105.747 vdekje foshnjore më shumë. Në vitin 1960 diferenca u ngushtua në 73.99 vdekje më shumë, në vitin 1970 në 41.427, dhe në vitin 1980 në 31.647 vdekje më shumë për 1,000 lindje të gjalla. Vdekshmëria foshnjore në Shqipëri kishte zbritur në 45.386, krahasuar me Gjermaninë me 13.739.

Statistikat “makroekonomike” gjithashtu dëshmojnë për një rritje të fortë në dekadat e para të instalimit të sistemit socialist. Të ardhurat kombëtare, të cilat niseshin nga një bazë shumë e ulët e vitit 1950, brenda një dekade u rritën me 81% dhe deri në vitin 1970, ato u rritën me 2.8 herë, pra pothuajse u trefishuan. Ky proces vazhdoi deri në vitin 1980 kur e ardhura kombëtare ishte rritur me 3.5 herë krahasuar me vitin 1950, por në fund të vitit 1990, ajo kishte rënë në 3.1 herë. Ivan Szelenyi dhe Balasz Szelenyi (1994)⁶⁵, sjellin evidenca të këtij procesi konvergjence në të gjitha ekonomitë e ish-vendeve të lindjes me vendet perëndimore. Sipas këtyre autorëve, progresi ishte më i madh në vendet

65 Ivan Szelenyi dhe Balasz Szelenyi (1994), “Why socialism failed: Toward a theory of system breakdown. Causes of disintegration of East European State Socialism”, *Theory and Society*, April, 1994.

që ishin edhe më të varfra, duke marrë si shembull rastin e Bullgarisë. Por, kjo evidentohet dhe në rastin e Shqipërisë, ku një sërë të dhënash ekonomike e sociale, dëshmojnë për një ndryshim të rëndësishëm që kishte ndodhur në veçanti gjatë tri dekadave të para të instalimit të sistemit socialist. Treguesit e arsimit, të shëndetit publik, të prodhimit industrial dhe bujqësor, të tregtisë së jashtme, transportit, etj., dëshmojnë për një rritje të shpejtë që ishte shënuar në periudhën 1950-1980.

Këtu do të bëjmë një parantezë sa i takon vërtetësisë së statistikave, të cilat janë dëshmuar qartazi që më së shumti ishin fabrikime statistikore. Ata që kanë jetuar dhe kanë punuar në vitet e atij sistemi mund të dëshmojnë episode të shumta të raportimeve të rreme statistikore të cilat motivoheshin nga penaltitetet e ashpra që zbatoheshin në rast të dështimit të realizimit të planeve të shtetit. Në mënyrë të veçantë këtu po i referohemi treguesve kryesorë “makroekonomikë” si prodhimi përgjithshëm, investimet, konsumi, të ardhurat për frymë, etj. Në një artikull të Vonyó, Tamás dhe Klein, Alexander (2017)⁶⁶, dëshmohet se diferenca midis raportimeve statistikore zyrtare dhe vlerësimeve rigoroze të pavarura që janë kryer nga autorët dhe nga studiues të tjerë, është mjaft e lartë në tri nga vendet që ata analizojnë: Hungaria, Republika Çeke dhe Polonia. Kështu diferenca midis treguesit të prodhimit shoqëror dhe GDP së estimuar luhatet të jetë

66 Vonyó, Tamás; Klein, Alexander (2017): Why did socialist economies fail?, School of Economics Discussion Papers, No. 1708, University of Kent, School of Economics, Canterbury

i mbivlerësuar me 2-2.6 pikë përqind, investimet fikse, veçanërisht pas viteve '70 mbivlerësohen me 2-3 pikë përqind. Kjo do të thotë se të gjithë indikatorët kyç të produktivitetit të ekonomisë ishin të mbivlerësuar, si prodhimi për punëtor, intensiteti i kapitalit, thellimi i kapitalit, produktiviteti total i faktorëve, etj.

Por, përtej ekzagjerimeve që paraqesin statistikat zyrtare, ka një pranim konsensual se deri në mesin e viteve 1970, sistemi socialist ka performuar mirë në aspektin e rezultateve ekonomike. Por, duke filluar nga viti 1975, do të dëshmohej një përkeqësim i fortë i të gjithë indikatorëve ekonomikë e socialë. Në fakt, siç dëshmohet në studimin e Vonyó (cit. lart) diferenca në rritjen e GDP për frymë midis vendeve ish-socialiste dhe ekonomive të Europës Jugore (Spanjë, Itali, Portugali, Greqi, etj), kishte filluar të thellohej ndjeshëm që nga mesi i viteve 1970. Pas një momenti konvergjence që ishte arritur në vitin 1975, vendet e Europës Jugore po shënonin një rritje mesatare pesëvjeçare të GDP/frymë që shkonte nga 4-5.5%, ndërsa në vendet ish-komuniste ajo kishte rënë nga rreth 4.5% në vitin 1976, me një rënie permanente derisa do të arrinte në rreth 1.8% në vitin 1990. Edhe nivelet e investimeve në formimin e kapitalit fiks në vendet ish komuniste kishin mbetur shumë modeste, duke u luhatur në intervalin 20-25% të GDP, një shifër më e ulët se vendet që po shënonin ritme të larta të rritjes në vendet e Europës Perëndimore dhe disa prej vendeve të rritjes së shpejtë të Azisë.

E thënë në mënyrë të përmbledhur, edhe pse vendet e sistemit socialist kishin performuar

relativisht mirë në tri dekadat e para të pasluftës, dhe në disa fusha kishin ngushtuar hendekun e thellë që kishin trashëguar në raport me vendet e zhvilluara perëndimore, vendet e tjera kapitaliste që kishin ndjekur politikat e tregut të lirë dhe konkurrencës, ishin rritur shumë më shpejt, dhe këto ritme rritjeje do të vazhdonin edhe gjatë viteve '80 e në vazhdimësi.

Kriza e viteve '80 shënon dhe fillimin e shembjes së sistemit socialist. Në fakt pika e kthesës kishte nisur që nga viti 1975. Po cilët ishin faktorët pas kësaj krize? Ishin kryesisht faktorët e jashtëm apo dhe të brendshëm? Në Shqipëri përgjithësisht rënia e viteve '80 lidhet me shkëputjen e plotë nga kampi i ish-vendeve socialiste dhe izolimi total politik dhe ekonomik i vendit. Ekonomia shqiptare ka manifestuar një varësi tepër të fortë nga kapitali i huaj përgjatë gjithë historisë. Ajo që ka ndryshuar ka qenë thjesht emërtimi i varësisë: në periudhën e monarkisë ajo është cilësuar nga historiografia e kohës komuniste si epoka e shfrytëzimit kolonialist nga kapitali i huaj dhe si nënshtrim i monarkisë ndaj vendeve të huaja (Italia), ndërsa në epokën komuniste ajo cilësohej si ndihmë solidariteti midis vendeve të kampit komunist. Siç e ka dëshmuar ndryshimi i herëpashershëm i aleancave politike, nga ish-Jugosllavia, tek ish-Bashkimi Sovjetik dhe më vonë tek Kina, edhe kjo gjeopolitikë e aleancave ishte në fakt përsëri një dëshmi e vasalitetit politik. Në thelb problemi është një i vetëm: ndryshimet në strukturën ekonomike të vendit i dedikohen në një masë të madhe rolit kritik që ka luajtur mbështetja e huaj. Siç dihet, që në fundin e viteve 1970, Shqipëria

i ndërpreu marrëdhëniet politike dhe ekonomike me Kinën, e cila kishte siguruar një mbështetje esenciale për ekonominë e vendit gjatë gjithë viteve '70, duke siguruar mbështetje teknologjike, ushtarake dhe në mallra konsumi për popullatën. Që nga kjo periudhë, vendit i duhej të siguronte importe kritike për funksionimin e ekonomisë në terma tregtare. Edhe pse forma e tregtisë barter ishte gjerësisht e përdorur, sërish termat e tregtisë do të reflektonin gjendjen e ndryshuar në tregjet ndërkombëtare. Edhe tregtia midis vendeve të KNER, organizatës së bashkëpunimit ekonomik midis ish-vendeve socialiste, bazohej në indeksimin e çmimeve të tregtisë bazuar në ecurinë e çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Për pasojë, vitet '80 dëshmojnë për një konjunkturë ekonomike ndërkombëtare të përkeqësuar edhe për ish-vendet socialiste. Në veçanti, kriza e naftës që kishte nisur që në mesin e viteve '70, do të shtrihej në ish-vendet socialiste me disa vite vonesë, ngjashmërisht dhe me krizat e fundit siç ishte ajo e vitit 2008 e cila do të vinte drejt rajonit tonë me dy-tri vite vonesë. Shqipëria kishte një industri që bazohej në konsumin e lartë të energjisë dhe importet e lëndëve djegëse pas vitit 1980 u rritën ndjeshëm, duke u luhatur në 25-30% të totalit të importeve të vendit. Në fakt, të gjithë ish-vendet socialiste kishin investuar në teknologji që kishin një shkallë të lartë të konsumit të energjisë, edhe për shkaqe që lidhen me politikën e ruajtjes së çmimeve të ulëta të produkteve energjetike krahasuar me vendet e perëndimit.

Në rastin e Shqipërisë, problemi i inefficiencave ekonomike ishte shumë më i dukshëm krahasuar

RRITJE PA ZHVILLIM
SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

me vendet e tjera ish-socialiste. Nga një vend i prapambetur agrar, burimet ekonomike u zhvendosën drejt industrisë së rëndë, duke arritur në kufijtë e absurditetit. Kështu, pesha e industrisë do të ishte deri tri herë më e lartë se vendet shumë më të përparuara të Lindjes, si Polonia, Hungaria dhe Çekosllovakia.

Tabela 1: Struktura ekonomike në fund të sistemit komunist, %, viti 1989

	Shqipëria	Çekoslo- vaki	Hungaria	Polonia
Industria	58.2	40	32.4	29.1
Bujqësia	24.7	17	24.3	28.9
Ndërtimi	8.2	7.6	5.3	5
Transporti	2.7	8.3	8.2	8.3
Tregtia dhe ushqim social	2.5	8.7	7	6.5
Tregtia e jashtme	2.8			
Të tjera	0.9	18.4*	22.8	22.3

Burimi: Të dhënat e Shqipërisë janë marrë nga vjetari statistikor, 1990; ndërsa për vendet e tjera është marrë nga studimi i Vonyó, Tamás; Klein, Alexander (2017) (cit. më lart).

Përkeqësimi i termave të tregtisë në tregjet ndërkombëtare, së bashku me mungesën e aksesit ndaj kapitalit perëndimor, bënë që investimet në formimin e kapitalit fiks të shënonin një rënie të fortë, duke sjellë si pasojë një rënie të ndjeshme në treguesit e produktivitetit të ekonomisë. Rritja e çmimit të lëndës djegëse kishte ndikuar në rritjen e kostove dhe

humbjen e konkurrencës së produkteve të industrive të vendeve ish-socialiste. Nga ana tjetër, shumë nga vendet ish-socialiste kishin përfituar nga normat e ulëta të interesave që u krijua nga petrodollarët, dhe kishin marrë kredi të shumta me norma të ulëta interesi në tregjet ndërkombëtare. Kur normat e interesave filluan të rriten ndjeshëm edhe për shkak të inflacionit të lartë, atëherë kostoja e kredive u shndërrua në një barrë të rëndë ekonomike. Vende si Rumania, për shembull, bënë sakrifica të pashembullta për të shlyer borxhin e huaj, duke e çuar popullsinë vendase në një krizë të mallrave bazike. Mungesa e kapitalit po pengonte ndjeshëm mundësinë e këtyre vendeve për t'u bërë pjesë e revolucionit të tretë industrial dhe modernizuar industrinë. Natyra paternaliste e shtetit në socializëm nuk lejon falimtimin e ndërmarrjeve; firmat operojnë në kushtet e "*soft budget constrain*". Kjo sjellje është krejt e ndryshme nga ajo e firmave që përballen me "*hard budget constrain*"; ato zgjerohen përtej mundësive përmes procesit të rialokimit të burimeve shtetërore, jo duke ndjekur logjikën ekonomike që dikton mekanizimi i çmimit të tregut.

Një argument interesant mbi arsyet e rënies së ndjeshme të produktivitetit në ekonominë socialiste, është dhënë nga Popov (2010)⁶⁷. Ai sugjeron ekzistencën e një cikli jete të investimeve në sistemin socialist. Duke iu referuar ekonomisë sovjetike ai argumenton se rritja

67 Popov Vladimir V. (2010), "Life Cycle of the Centrally Planned Economy: Why Soviet Growth Rates Peaked in the 1950s", CEFIR and NES Working Paper n. 152, November <http://pages.nes.ru/vpopov/documents/Soviet%20Growth-Boston.pdf>

e fortë e investimeve në fillimet e sistemit, brenda një periudhe njëzetvjeçare krijon nevojën e rizëvendësimit të teknologjive apo shpenzime të larta të riparimeve kapitale të tyre. Por, përballë mungesës së burimeve dhe e shtyrë nga nevoja e zgjerimit të investimeve në krijimin e kapaciteteve të reja, ndërmarrjet vazhdojnë të mbajnë në shfrytëzim teknologji të vjetruara. Për pasojë, produktiviteti ekonomisë fillon të bjerë.

Si pasojë e dështimit të vendeve ish-socialiste për ristrukturimin e ekonomisë në kushtet që u krijuan duke nisur që nga vitet '80, ritmet e rritjes së ekonomisë ranë ndjeshëm, e bashkë me të edhe treguesit e mirëqenies u përkeqësuan gjithashtu.

Kështu, duket se pas shembjes së socializmit qëndrojnë radhët e gjata të qumështit (bashkë me xhinset, *rock and roll*-in dhe raketat amerikane të luftës së yjeve). Por, përtej kësaj historie të shkurtër të ciklit të ekonomisë dhe rënies së fortë që do t'i paraprinte shembjes së sistemit socialist, pyetja themelore është:

A ishin problemet e ekonomisë në thelbin e dështimit të sistemit socialist, apo janë çështjet e legjitimitetit të sistemit? Cila është origjina politike e problemeve ekonomike të socializmit? Në fakt, ineficiencat ekonomike dhe aspektet e legjitimitetit politik janë në një marrëdhënie dialektike mes tyre. Kriza ekonomike e socializmit është gjithashtu dhe një krizë e legjitimitetit të sistemit, pasi inspirimi kryesor i ideve socialiste ishte nevoja për të promovuar lirinë dhe demokracinë dhe për të krijuar një shoqëri egalitare dhe me mirëqenie të lartë. Slogani çek i "socializmit me fytyrë njerëzore" kishte një mbështetje

të gjerë si nga komunistët dhe nga jo-komunistët. Por, realiteti provoi të ishte ndërtimi i një prej diktaturave më të egra. Problemi me socializmin ishte jo vetëm dështimi në aspektin ekonomik, por dhe se në planin politik nuk ishte në gjendje të themelohej si një sistem demokratik; pra kishte minuar legjitimitetin e tij. Në aspektin sociologjik, vetë kuadrot komunist filluan të besojnë se ishte më mirë të ishin të pasur se të ishin komunist. Fryma komuniste që kishte mbizotëruar tek gjenerata e parë e themeluesve të sistemit, nuk arriti të përcillej tek gjenerata pasuese. Prandaj pas viteve '80 përkrahja ndaj tregut po gjente më shumë përkrahje midis neokomunistëve. Profesori amerikan i sociologjisë ekonomike, Viktor Nee e ka trajtuar këtë aspekt të socializmit në një artikull me një titull ironik, por që e përmbledh në mënyrë të shkëlqyer këtë transformim të socializmit, "Të flesh me armikun – pse komunistët e duan tregun"⁶⁸. Ndoshta ky transformim sociologjik i shoqërisë shpjegon dhe suksesin e socializmit kinez, (A mund të quhet socializëm rasti i Kinës?) që në fakt është një kapitalizëm i mirëfilltë në aspektin ekonomik.

Po, a kemi arritur me kapitalizmin dhe demokracinë fundin e historisë sipas kuptimit të Fukuyama? Qartësisht gjendja e sotme e teknologjisë është jo e përshtatshme me kapitalizmin. Thelbi i teorisë ekonomike të sistemit kapitalist është marginalizimi, domethënë ofrimi i një njësie produkti shtesë vetëm

68 Victor Nee & Peng Lian (1994), "Sleeping with the enemy: A dynamic model of declining political commitment in state socialism", Theory and Society volume 23, pages 253–296 (1994)

kur kostoja e ofrimit të tij gjen një konsumator që është i gatshëm të paguajë çmimin e ofrimit të tij. Në fakt, teknologjitë e kanë zhbërë këtë koncept. *E-books* janë shembulli më perfekt që ilustron këtë ide. Sot mund të shkarkohen libra falas nga interneti, dhe kostoja e një shkarkimi të një libri më shumë është zero. Pra, në kuptimin ekonomik, jemi në një shoqëri të “*zero marginal cost*” e cila bie ndesh me konceptin e ekonomisë kapitaliste. Shembulli i *e-books* sot zbatohet në shumë të mira ose shërbime digjitale (muzikë, televizion, fotografi, film, etj.). Ekonomiksi është shkenca e rrallësisë; asgjë nuk prodhohet pa kufizime, thoshte Walras, themeluesi i shkollës margjinaliste. Ky lloj ekonomiksi ku individët mund të shumëfishojnë produktet në shkallë globale dhe me zero kosto (pasi janë paguar kostot fikse), mund t’i përngjasojë një lloji të ri socializmi, një socializëm global ku kooperimi nuk ndodh sipas metodës së vjetër të planit burokratik, por si një “*network*” social që ndodh në mënyrë spontane. Por, sërish ky fakt ndoshta është shpejt të merret si një provë se kapitalizmi po shuhet. Ajo që është e sigurtë është se socializmi, të paktën në formën e vet origjinale si pronësi shtetërore mbi mjetet e prodhimit, çmime të përcaktuara administrativisht dhe jo nga tregu dhe zhvillimi ekonomik mbi bazën e planit qendror shtetëror, është një ide e vdekur që nuk mund të jetojë kurrë. Viktor Hugo thoshte se “asgjë nuk mund të jetë më e fuqishme se një ide së cilës i ka ardhur koha”. Socializmi mbeti një ide e fuqishme, por koha e tij ndoshta nuk kishte ardhur, dhe në formën e imagjinuar nga baballarët themelues marksist, me shumë gjasa nuk do t’i vijë koha kurrë.

Kapitulli 6

SOCIALIZMI DHE KAPITALIZMI: DY SISTEME NË PËRBALLJE

Kapitalizmi është padyshim një nga konstruksionet më të mëdha sociale të njerëzimit, që kombinon pronën private, sipërmarrjen e lirë, dhe koordinimin e prodhimit dhe shkëmbimeve përmes tregut. Roli i shtetit është ai i garantimit të ligjit dhe rregullit, infrastrukturës publike dhe mbajtjen hapur të tregtisë dhe investimeve midis shteteve. Përmes urbanizimit, zhvillimit teknologjik dhe industrializimit, i kombinuar kjo dhe me sistemin politik shumëpartiak dhe zgjedhjet demokratike, kapitalizmi ka prodhuar sukseset më të mëdha në historinë e njerëzimit. Madje, vetë Marksi tek *Manifesti Komunist* (1848)⁶⁹, ka dhënë vlerësimet më të larta për arritjet e kapitalizmit. “Borgjezia, shkruan ai, përmes përmirësimit të shpejtë të të gjithë instrumenteve të prodhimit dhe duke lehtësuar ndjeshëm mjetet e komunikimit, sjell civilizim midis të gjitha kombeve, edhe tek ato më barbarët”. Por, sipas Marksit, ishte vetë suksesi i këtij sistemi, me pabarazinë në pasuri si tiparin e saj dallues, që do të sillte dhe shembjen e tij, për shkak

⁶⁹ Karl Marksi, 1848, *Manifesti Komunist*

të ashpërsimit të kontradiktave klasore. Dhe mbi këtë dështim, ai projektoi lindjen e një sistemi të ri, atij socialist, që sipas Marksit, duhej të realizohej përmes dhunës revolucionare.

Këtej e ka zanafillën beteja teorike e sistemeve krejt të kundërt midis tyre, socializmit dhe kapitalizmit, beteje që në fakt kishte nisur që në mesin e shekullit XIX, kur socialistët utopistë kishin filluar të eksperimentonin në shkallë lokale dhe të kufizuar shoqërizimin e kapitalit dhe të mjeteve të prodhimit. Por, socialistët utopikë nuk kishin qenë në gjendje të ndërtonin një konstrukt social e ekonomik që t'i qëndronte kritikës dhe logjikës. Idetë e tyre ngjanin mjaft naive dhe nuk i qëndruan dot përballjes logjiko-teorike. Prandaj dhe beteja e vërtetë teorike do të zhvillohet vetëm pas gjysmës së dytë të shekullit XIX, kur Marksi synoi t'i japë një veshje teorike ideve socialiste utopike. Pra, socializmin utopik ai pretendoi ta shndërronte në socializëm shkencor.

Sistemi socialist kishte ligjet e tij të veçanta, “ku ligji bazë i socializmit” që përshkruhet në tekstet e ekonomisë politike ishte “plotësimi gjithnjë e më i plotë dhe në rritje i nevojave materiale dhe shoqërore të popullsisë përmes zhvillimit të vazhdueshëm dhe perfeksionimit të prodhimit shoqëror”. Ndër të ashtuquajtura ligje të tjera të sistemit ishte ai i “zhvillimit të planifikuar e proporcional”, “i rritjes më të shpejtë të prodhimit të mjeteve të prodhimit mbi rritjen e mjeteve të konsumit”, një praktikë që ligjëronte në fakt politikat e investimeve që rezultuan të ishin me pasojë shumë negative dhe pa asnjë bazë

teorike. Sa i takon ligjit të vlerës, ai qëndronte vetëm në sferën e mallrave të konsumit. Vetë Stalini në librin⁷⁰ e tij “Probleme Ekonomike të Socializmit në Bashkimin Sovjetik” (1952), duke e pranuar veprimin e ligjit të vlerës edhe në socializëm, do të shkruante se “planifikimi qendror nuk mund t’i kapërcejë disa ligje “objektive” të zhvillimit ekonomik.

Në fakt, këto ligjësi të socializmit nuk bëjnë pjesë në korpusin e ligjeve marksiste të lëvizjes nga një sistem ekonomik e shoqëror tek një rend më i lartë. Një përpjekje serioze në formulimin e ligjeve të socializmit, nënvizon Nuti⁷¹, është bërë nga Wlodzimierz Brus në Poloni dhe Rudolf Bahro në Gjermani.

Wlodzimierz Brus ishte ekonomist dhe funksionar politik, që do të emigronte në Britaninë e Madhe ku do punonte në Oxford si profesor i studimeve të Europës Lindore dhe Ruisë Moderne. Në veprën e tij më influencuese të botuar në vitin 1961, “*Probleme të Përgjithshme të Funksionimit të Ekonomisë Socialiste*”, ai argumentonte⁷² se “demokracia dhe tregu ishin të nevojshme për ndërtimin e socializmit”; faktorët politikë dhe ekonomikë në sistemin socialist janë të pandashëm. Ai do të zhvillonte idenë e kontradiktave dhe konflikteve që lindin në socializëm, si formimi i grupeve, dobësimi i incentivave, tendenca monopoliste e ndërmarrjeve për shkak të centralizimi të industrisë,

70 Josif Stalin, 1952, “Probleme Ekonomike të Socializmit në Bashkimin Sovjetik”

71 Domenico Mario Nuti, 2018, The rise and fall of socialism, DOC Research Institute

72 Wlodzimierz Brus, 1961, “Probleme të Përgjithshme të Funksionimit të Ekonomisë Socialiste”

shfaqjen e disbalancave në sferën e konsumit dhe përkeqësimin e disiplinës së punës, burokratizimi, - të gjitha këto fenomene që binin ndesh me socializimin e mjeteve të prodhimit dhe rolin progresist të planifikimit ekonomik.

Ndërsa filozofi gjermano-lindor Bahro⁷³ analizoi nevojën e reformave që buronin nga kontradiktat midis burokracisë qendrore të planifikimit dhe drejtuesve të ndërmarrjeve. Edhe Bahro mbronte idenë e “demokratizimit politik” të ekonomisë socialiste dhe se zhvillimi i socializmit do të çonte drejt demokratizimit të partive komuniste.

Një nga konfliktet themelore në ekonominë socialiste është ajo midis kërkesës dhe ofertës, e cila ka themel të saj ruajtjen fikse të çmimeve dhe pagave, më saktë mungesën e fleksibilitetit të tyre për t’iu përshtatur raporteve të kërkesës dhe ofertës për të mira. Ruajtja e çmimeve të ulëta çon në mangësi të tregut për të mira dhe kërkesa e tepërt nuk zgjidhet përmes mekanizmit të çmimit, por përmes thellimit të centralizimit ekonomik. Ky konflikt themelor në sistemin socialist nuk çoi drejt reformave që mund të pajtonin raportet e kërkesë-ofertës, por përkundrazi drejt centralizimit të ekonomisë dhe racionimit të furnizimit konsumator. Përfundimisht ai çoi drejt revoltave politike dhe vetë shembjes së sistemit.

Pritshmëritë për sistemin socialist ishte se ai, përmes planifikimit qendror, do të ishte në gjendje të arrinte drejt ekuilibrit, përpara se disbalancat të çime-

73 Rudolf Bahro, 1982, *Socialism and Survival*,

ntoheshin, do të krijonte rritje më të lartë ekonomike dhe eficiencë dhe drejtësi sociale në shpërndarjen e të ardhurave kombëtare. Ky proces, siç edhe e analizuam në kapitullin e mëparshëm, arriti njëfarë suksesi deri në mesin e viteve '70, por që më pas dështoi. Dështimi gjithashtu nuk ishte thjesht për shkak të rënies së ritmeve të rritjes ekonomike. Në të vërtetë, sistemi i planifikimit qendror asnjëherë nuk ishte në gjendje të arrinte ekuilibrin makroekonomik, dhe disbalancat e brendshme dhe të jashtme ishin një tipar permanent i sistemit. Dështimet ose inefficiencat mikroekonomike madje ishin gjerësisht të kritikuarra më shumë nga brenda vendeve socialiste se nga kritikët perëndimorë. Inflacioni i fshehtë dhe papunësia e fshehtë, ishin të dukshme në formën e mungesës së ndjeshme të mallrave të konsumit dhe punësimit fiktiv. Kjo e fundit do të krijonte një dëmtim serioz afatgjatë të kulturës së punës. Nën punësimi përmes vendeve të tepërta të punës nëpër ndërmarrje, krijonin pamjen e punësimit të plotë, por në fakt produktiviteti i punës ishte në një rënie të thellë. Sidoqoftë, e vënë në balancë në konkurrencë me sistemin kapitalist, socializmi krijon më shumë punësim dhe mbrojtje më të mirë të punëtorëve.

Raporti më i suksesshëm i socializmit me objektivat e tij dhe me sistemin kapitalist, ishte drejtësia sociale. Por edhe në këtë aspekt, duhet trajtuar me objektivitet edhe deficienca e sistemit në krijimin e nxitjeve për më shumë investime në kapitalin njerëzor, në inovacion dhe përmirësimin e proceseve teknologjike dhe të prodhimit. Mungesa e stimuljeve monetarë dhe nivelet

relativisht “flat” të shpërblimeve nga puna, nuk ofronin nxitjet e nevojshme për zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe inovacion. Gjithashtu, në kushtet e mungesave serioze për mallra konsumi për të gjithë qytetarët, shtresat e privileguara të “nomenklaturës” filluan të krijohen dhe diferencimi social ishte i dukshëm edhe në atë sistem.

Një nga kritikët e forta që i bëhen politikave të tranzicionit të vendeve lindore drejt sistemit kapitalist, është se ato rrënuan ndërmarrjet e trashëguara nga sistemi komunist. Kjo është një kritikë serioze dhe që meriton një projekt kërkimor të dedikuar. Por në tërësi mund të thuhet se ekonomia e trashëguar ishte thellësisht inefficente dhe e paaftë t’i bënte ballë presioneve të konkurrencës globale. Për shembull, Hare dhe Hughes (1991) kanë demonstruar se në startin e tranzicionit, në Republikën Çeke, Hungari dhe Poloni, gati një e katërta e eksporteve, bazuar në çmimet botërore, kishin një vlerë të shtuar negative. Japonia blinte makineri sovjetike për t’i përdorur si skrap, ndërsa alumini nga blloku sovjetik shitej me një çmim më të ulët se energjia që përdorej për shkrirjen e tij. (Nutti, 2018).

Në fundin e rrugëtimit të vet, socializmi që kishte nisur si një triumf mbi kapitalizmin, nuk arrinte të siguronte për qytetarët e vet as edhe furnizimet me prodhimet bazike në ushqime e veshmbathje, pa bërë fjalë për makina apo prodhime të teknologjisë së lartë që ndesheshin me shumicë në perëndim. Një sërë përpjekjesh për reformimin e socializmit që u zbatuan në ish-vendet socialiste duke nisur që nga vitet ‘50,

nuk arritën të përmirësonin rezultatet e sistemit. Në thelb, arsyeja kryesore lidhej me mungesën e avantazheve themelore që siguron tregu: sinjalet që transmetojnë çmimet në tregje në shpërndarjen e burimeve. Vendosja e tregut pas shembjes së sistemit komunist, krijonte premisat e kthimit të ekonomisë në ligjësitë e saj natyrore të veprimit.

Socializmi e ka nisjen e vet tek dështimet e sistemit kapitalist. Cilat ishin **dështimet e kapitalizmit** të cilat krijuan kushtet e përshtatshme të zhvillimit të një doktrine të re që do të mishërohej në sistemin socialist? Kjo na çon tek analiza e sistemit kapitalist dhe më specifikisht tek pyetja esenciale: A është kapitalizmi një rend i shfrytëzimit të punës? Për këtë do nisemi nga analiza e teorisë marksiste.

Teoria e vlerës nga puna dhe mbivlera, përbën thelbin e doktrinës marksiste. Sistemi kapitalist, megjithëse ndryshe nga sistemet e mëparshme në dukje ishte jo shfrytëzues, pasi marrëdhënia punëdhënës-punëmarrës rregullohej nga kontrata individuale në të cilën palët futen me vullnet të lirë, Marksi vlerësonte se kapitalizmi bazohej tërësisht në shfrytëzimin e punës. Vlera është thjesht mishërimi i punës dhe për pasojë, mbivlera, ose fitimi kapitalist nuk ishte tjetër veçse puna e papaguar e punëtorit. Rritja e fitimeve në kapitalizëm (mbivlera, sipas konceptit marksist), nuk është tjetër veçse rritje e shfrytëzimit të punëtorëve.

Në këtë logjikë të vlerës dhe mbivlerës, Marksi i jep vlerën zero sipërmarrjes, rrezikut, pasigurisë, që në fakt janë motori i progresit të sistemit kapitalist.

Zëvendësimi i kapitalit fiks në fakt ndodh në çdo sistem, edhe në sistemin socialist. Ndërmarrjet shtetërore dhe në sistemin socialist llogarisnin të ardhurën neto të ndërmarrjes, që së bashku me fondin e amortizimit, përdroreshin për zëvendësimin teknologjik dhe investime të reja në shtimin e kapitalit fiks në ekonomi. Ndërsa e ardhura neto e centralizuar e shtetit shërbente si instrument i rialokimit të burimeve midis sektorëve të ekonomisë. Këtë rol në ekonominë kapitaliste e luan fitimi kapitalist, dhe për analogji, nuk mund të quhet shfrytëzim kapitalist i gjithë fitimi. Pra, termi «shfrytëzues» mund të kufizohet vetëm në konsumin e kapitalistit dhe jo në të gjithë fitimin kapitalist. Por Marksi në analizën e tij nuk bënte asnjë dallim midis pjesës shfrytëzuese dhe joshfrytëzuese të fitimit kapitalist. «Akumulo, Akumulo! Ky është Moisiu dhe Profetët e sistemit kapitalist!» (Kapitali, Vëllimi 1, Kapitulli 24). Në fakt akumulimi me çdo çmim e me çdo kusht u shndërrua në një moto kryesore të pasuesve marksist, siç e thotë ekonomisti anglez, Hicks.

Marksi e shikon sistemin kapitalist si anarkik dhe jo i qëndrueshëm, që do të gjenerojë kriza ekonomike, deri sa do të çonte në shembjen e sistemit. Ajo që Marksi nuk mban sërish në konsideratë është axhustimi automatik që ndodh në sistemin kapitalist. Procesi i axhustimit ndodh në afatin e shkurtër, sipas modelit të Leon Walras⁷⁴: për një nivel të caktuar të prodhimit, çmimi rritet apo bie në varësi të luhatjes së kërkesës. Në afatin e mesëm, sipas modelit

74 Leon Walras, 1899, Elements of Pure Economics, përkthimi i vitit 1954.

Marshallian⁷⁵: ndryshimet në nivelet e prodhimit reflektojnë përshtatjen e nivelit të çmimeve me kostot marzhinale të prodhimit, dhe efektin zinxhir të ndikimit të kërkesës për inpute në të gjithë zinxhirin ekonomik. Në afatin e gjatë, ndryshimet në kapacitetet prodhuese axhustohen në raport me ndryshimet në stokun e kapitalit fiks, sipas pritshmërive që kanë ndërmarrjet mbi kërkesën e ardhshme për prodhim, pra duke shtuar kapitalin fiks ose duke mos e zëvendësuar kapitalin e amortizuar. Pikërisht përmes këtij mekanizimi të axhustimit automatik, rregullohen nivelet e çmimeve dhe sasive të prodhimit, transaksionet ndërsektoriale dhe kapacitetet prodhuese të ekonomisë në tërësi. Për analogji, ky proces axhustimi automatik ndodh njësoj si termostati i kontrollit të temperaturës së dhomës. Duhet bërë një parantezë këtu: kjo logjikë nuk funksionon në tregjet financiare, ku euforia dhe sjelljet e turmës mund të marrin përmasa të tilla që e bëjnë korrektimin dhe rikthimin në ekuilibër një proces shumë të kushtueshëm.

Ajo që në sistemin ekonomik kapitalist ndodh përmes këtij procesi automatik të axhustimit të luhatjeve të ndryshoreve, në sistemin socialist kryhet përmes planit qendror të shtetit. Pyetja këtu shtrohet nëse shteti e kryen këtë proces axhustimi në mënyrë më eficiente se vetrregullimi nga forcat e tregut.

Një përgjigje serioze të kësaj pyetjeje e gjejmë te dy veprat e rëndësishme të Friedrich von Hayek,

75 Alfred Marshall, 1890, Principles of Economics, Cambridge University

“Ekonomiksi dhe Dija” (1937) dhe “Përdorimi i Dijes në Shoqëri” (1943) dy vepra që do i jepnin atij Çmimin Nobel në ekonomi në vitin 1974. Hayek argumenton se dija mbi kërkesën për një produkt është gjerësisht e përhapur te çdo konsumator, prandaj dhe çmimi i tregut është bartësi kryesor i informacionit që orienton alokimin e burimeve të rralla në ekonomi.

“Karakterit specifik i problemit të rregullimit racional të ekonomisë, përcaktohet pikërisht nga fakti se dija mbi rrethanat prej të cilave ne duhet të nisemi, kurrë nuk ekziston në një formë të koncentruar apo integruar, por është një dije e shpërndarë në copëza të paplota dhe shpeshherë kontradiktore që zotërohet nga moria e individëve të veçantë. Prandaj dhe problemi ekonomik i shoqërisë nuk është thjeshtë se si të shpërndajë burimet «e dhëna» - nëse «e dhënë» nënkupton të dhëna të një mendjeje të vetme e cila e zgjidh në mënyrë të kujdesshme problemin që ofrojnë këto «të dhëna». Problemi është se si të sigurojmë përdorimin sa më të mirë të burimeve që njihen nga secili anëtar i shoqërisë, për qëllime, rëndësinë relative të së cilës e dinë vetëm këta individë. Thënë shkurt, është problemi i shfrytëzimit të dijes që askush nuk e zotëron në totalitetin e vet”⁷⁶.

Pra, problemi i ndërtimit të një modeli optimal të shfrytëzimit të burimeve ekonomike, nuk është në thelb një problem matematikor i optimizimit që mund të zgjidhet nga një “planovik”, por i dijes mbi

76 Friedrich August von Hayek, “The Use of Knowledge in Society,” *American Economic Review*, XXXV, No. 4; September, 1945, pp. 519–30.

kërkesën në raport me një nivel të dhënë të çmimit, një informacion që gjendet te moria e konsumatorëve të përhapur në të gjitha tregjet. Në këtë kuptim, ai që mund ta realizojë më mirë këtë planifikim, është thjesht tregu.

Megjithatë, në një qëndrim kritik ndaj kësaj qasjeje duhet nënvizuar se miti që kapitalizmi siguron eficiencën e plotë, në kuptimin paretian të fjalës (që është e pamundur të prodhohet një njësi më shumë e një produkti pa sakrifikuar një njësi të një produkti tjetër alternativ dhe se do jetë e pamundur të rrisim dobinë e një individi pa sakrifikuar dobinë e dikujt tjetër), nuk qëndron tërësisht. Tregjet janë të paplota ose disa nuk ekzistojnë, konkurrenca perfekte është kryesisht një konstrukt teorik më shumë se një realitet, asimetria e informacionit luan një rol në marrjen e vendimeve të investimit, eksternalitetet vazhdojnë të jenë të pranishme në shoqëri dhe në botën e sotme, sundojnë pritshmëritë dhe jo çmimet (Nuti, 2018).⁷⁷ Në veçanti, tregjet e punës janë shumë të ndryshme në krahasim me inputet e tjera të prodhimit.

Shqetësim serioz ekziston veçanërisht në raport me ndarjen e të ardhurës së krijuar, edhe në kushtet e eficiencës së plotë të tregjeve. Për më tepër kur pasuria është shpërndarë në fillimin e vet nga faktorë joekonomikë, atëherë konflikti midis eficiencës dhe drejtësisë, bëhet mjaft serioz dhe që mund të rrezikojë kohezionin social. Historia ka treguar se zhbërja e pabarazive të mëdha të krijuara ka kaluar përmes

⁷⁷ Domenico Mario Nuti, (2018), The rise and fall of socialism, Special Report, DOC Research Institute.

tronditjeve të mëdha sociale dhe revolucioneve. Fatmirësisht në epokën tonë moderne reduktimet e varfërisë janë arritur përmes përmirësimeve institucionale, por sërish nuk ka garanci se në afat të gjatë historia të mos përsëritet nëse kjo çështje nuk merret me po aq seriozitet me të cilën është marrë problemi i varfërisë.

Por, me gjithë dështimet dhe mangësitë e tij, çfarë ka arritur sistemi kapitalist gjatë shekujve, veçanërisht gjatë shekullit të fundit? A është bota më e mirë apo më e keqe?

Duke ju referuar statistikave të ndërtuara nga Agnus Madison, paraqitja grafike e disa prej treguesve kryesorë të ekonomisë, si të ardhurat për frymë, varfëria dhe pabarazia, dëshmojnë se bota kurrë nuk ka qenë më e begatë, me nivele kaq të ulëta të varfërisë dhe me pabarazi që janë zvogëluar, edhe pse gjatë tri-katër dekadave të fundit fenomeni ka filluar të marrë një prije të një rritjeje të fortë.

Vendet që ndoqën modelin kapitalist të zhvillimit përjetuan një rritje eksponenciale të prodhimit për frymë. Në vendet e kapitalizmit liberal amerikan, të ardhurat për frymë u rritën me rreth 21 herë në periudhën 1820-2017 (nga 2,513\$ në vitin 1820, në 52,517\$ në vitin 2017). Në vendet e Europës Perëndimore, ato u rritën me 17 herë (duke arritur në mesatarisht 39,257\$ nga 2,307\$) ndërsa në vendet e Europës Lindore u rritën me 25 herë, (duke arritur në 20,116\$ nga 818\$). Nga grafiku dalin në pah dhe diferencat midis sistemit ekonomik kapitalist dhe atij


KAPITULLI 6 / SOCIALIZMI DHE KAPITALIZMI: DY SISTEME NË PËRBALLJE

socialist gjatë viteve të pasluftës së Dytë Botërore, ku duken qartë ritmet shumë më të lartë të rritjes që kishte krijuar sistemi kapitalist.

PBB për frymë, 1820-2018

PBB për frymë e përshtatur me ndryshimin e çmimeve përgjatë kohës (inflacionin) dhe diferencat e çmimeve midis vendeve – e matur në dollarë ndërkombëtar me çmimet e vitit 2011

Our World in Data



Source: Maddison Project Database 2020 (Bell and van Zanden (2020))

OurWorldinData.org/economic-growth • CC BY


Edhe në rastin e Shqipërisë, grafiku që pasqyron prodhimin kombëtar për frymë (në USD, sipas Paritetit të Fuqisë Blerëse, me çmimet e vitit 2011) që prej mesit të shekullit XIX, vitet pas shembjes së sistemit socialist, flasin qartë për një rritje impresionuese të të ardhurave.



RRITJE PA ZHVILLIM SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

Kjo rritje e fortë ekonomike ka funksionuar për të gjithë shoqërinë globale, me përjashtim të Afrikës Subahariane ku zhvillimet ekonomike e sociale mbeten problematike, për shkak të keqqueverisjeve dhe luftërave civile.


Treguesit e varfërisë janë përmirësuar në mënyrë dramatike, veçanërisht pas viteve 2000. Së pari varfëria ekstreme ra ndjeshëm. Nga rreth 50% e popullsisë botërore që në fillimet e viteve 1980 jetonte në varfëri ekstreme (me nën 1.9\$ në ditë), në vitin 2015 ky tregues ka rënë në vetëm 10%. Në vitin 1990, 1,9 miliardë banorë jetonin në kushtet e varfërisë ekstreme ndërsa në fund të vitit 2018 kjo shifër ishte 680 milionë banorë.



Progres i madh është arritur dhe në reduktimin e varfërisë relative (me të ardhura më pak se 3.1\$ në ditë), veçanërisht në vendet me të ardhura të larta të mesme. Në këtë grup vendesh bën pjesë dhe Shqipëria por që fatkeqësisht në këtë tregues vendi ngjason më tepër me grupin e vendeve me të ardhura të mesme të

KAPITULLI 6 / SOCIALIZMI DHE KAPITALIZMI: DY SISTEME NË PËRBALLJE

ulëta, pasi varfëria relative në Shqipëri përfshin gati 40% të popullsisë.



Një studim i Milanovic, Lindert dhe Williamson (2007)⁷⁸, përpiket t'i japë përgjigje pyetjes nëse pabarazitë në epokën pas Revolucionit Industrial janë thelluar krahasuar me epokën paraindustriale. Duke u bazuar në tabelat sociale (të cilat William Petty i quante si *Aritmetika Politike*), autorët konkludojnë mbi pabarazitë në 14 shoqëri paraindustriale, që nga Perandoria Romake në shekullin 14 AD, në Bizantin e vitit 1000, Anglinë e vitit 1688, Spanjën e Re në vitin 1790, Kinën e vitit 1880 dhe Indinë britanike të vitit 1947. Autorët kanë ndërtuar vijën e kufirit të pabarazisë dhe kanë vendosur vendet respektive bazuar në treguesin e pabarazisë në të ardhura sipas koeficientit Gini dhe nivelit të të ardhurave për frymë. Kurba e pabarazisë

78 Branko Milanovic, Peter H. Lindert, Jeffrey G. Williamson, 2007, MEASURING ANCIENT INEQUALITY, Working Paper 13550 <http://www.nber.org/papers/w13550>

kufi tregon nivelin maksimal të pabarazisë që mund të përvetësonin të pasurit dhe përkundrejt kësaj vije vendosen indikatorët e pabarazisë të llogaritura si treguesit e vëzhguar.

Siç paraqitet në grafik, epoka parainduatriale është karakterizuar nga një nivel më i lartë i pabarazisë; duket se ka një klasterim të vendeve afër kurbës së pabarazisë kufi. Ndërsa Anglia e vitit 1668 dhe e fillimit të shekullit XIX dhe Mbretëria e Napolit (1881), duken shoqëri shumë egalitare. Franca dhe Holanda, për shembull duket se kanë patur një nivel shumë më të lartë të pabarazisë se në ditët e sotme.

Historia, përmbyllin autorët, ofron dy përfundime të qarta mbi këtë çështje. Së pari, pabarazia në të ardhura gjatë gjithë jetës midis individëve ka qenë gjithnjë më e lartë se pabarazia midis të ardhurave matur me të ardhurat vjetore. Së dyti, pabarazia e matur me të ardhurat e fituara gjatë jetës ka ardhur në një rënie të fortë në masën që pesë shekujt e përmirësimeve në jetëgjatësinë e individëve, ishin në një masë të madhe rrjedhojë e rënies së vdekshmërisë foshnjore.


KAPITULLI 6 / SOCIALIZMI DHE KAPITALIZMI: DY SISTEME NË PËRBALLJE

Pabarazitë në epokën paraindustriale: Koefficienti GINI dhe "Kufiri i Mundësisë së Pabarazisë"

Në shoqëritë e varfëra ka një kufi të epërimit në nivelin të pabarazisë që nuk mund të tejkalohet pasi në të kundërt, të varfërit do të binin poshtë nivelit të mbijetesës. Niveli maksimal i përballueshëm i pabarazisë është një funksion rritës i të ardhurave mesatare dhe kjo ide përcillet përmes kurbës së Kufirit të Mundësisë së Pabarazisë.

↙ Venësimi kufirit të epërimit të pabarazisë (pabarazia maksimale brenda klasave)

↘ Venësimi kufirit të poshtëm të pabarazisë (nuk ka pabarazi brenda klasave)



Data source: Milanovic, Lindert and Williamson (2008) – Ancient Inequality. In The Economic Journal. Volume 121, Issue 561, pages 255-272. The interactive data visualization is available at OurWorldInData.org. There you find the raw data and more visualizations on this topic. Licensed under CC-BY-SA by the author Max Roser.


Treguesit e pabarazisë sigurisht që kanë njohur një ulje të theksuar që nga epoka industriale dhe deri në fundin e viteve '80 të shekullit të kaluar. Por, siç vërehet nga grafiku më poshtë, në vendet anglishtfolëse rritja e pabarazive ka filluar t'i afrohet niveleve të larta të botës së fillimit të shekullit XX, ndërkohë që në Europën Kontinentale ky tregues mbahet nën kontroll. Duket një rritje e lehtë e pabarazisë në disa vende të BE-së, por Holanda dhe vendet nordike, për shembull, kanë arritur një shoqëri shumë më egalitare se pjesa tjetër e kontinentit. Kështu, top 1% i popullsisë së pasur merr një të pestën e të ardhurave në SHBA, por rreth 6-7% të të ardhurës vjetore në Holandë dhe vendet nordike, dhe rreth 10% në vendet e tjera europiane.

RRITJE PA ZHVILLIM SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE


OurWorld
in Data

Përqindja e të ardhurave që shkon te top 1%, që prej vitit 1900

Evucioni pabarazive në vendet anglisht-folëse ndjek një vijë në formë U



Evucioni pabarazive në Evropën kontinentale dhe Japoni ndjek një vijë në formë L.



Data source: World Wealth and Income Database (2016). This is income before taxes and transfers. This data visualisation is available at OurWorldinData.org. There you find the raw data and more visualisations on inequality and how the world is changing. Licensed under CC BY-SA by the author Max Roser.

Sipas Oxfam (2018), dy të tretat e pasurisë në 2,043 miliardë (matur me USD), janë rezultat i trashëgimisë, monopoleve dhe kronizmit. Edhe ardhja në pushtet e miliardëve në shumë vende të botës, shihet si një evidencë e korrupsionit të proceseve demokratike që është shkaktuar nga pabarazitë në rritje.

Fatkeqësisht pabarazitë kanë ardhur në rritje dhe në Shqipëri. Si indikatorët që masin shpërndarjen e të ardhurave edhe perceptimet e publikut flasin për një rritje serioze të pabarazive. Për më tepër, publiku percepton se vetë proceset e krijimit të pasurisë kanë qenë të pandershme. Diskutimin për këtë çështje po e zhvendosim në një kapitull tjetër të këtij libri.

KURTHET E TRANZICIONIT

Rrugëtimi tridhjetëvjeçar i Shqipërisë drejt një shoqërie demokratike, të shtetit ligjor dhe ekonomisë së tregut ka një ecuri me shumë prapësime dhe zhgënjime, duke realizuar një ndryshim të fortë shoqëror, shpeshherë për mirë, por dhe i shoqëruar me probleme e sfida serioze që mbeten përpara. Tani që bëhen tri dekada të këtij rrugëtimi, një shikim pas në kohë mund të na ndihmojë të shohim më kthjellët çfarë shkoi mirë apo keq dhe se si mund të rifillojmë një rrugëtim drejt një shoqërie me standarde më të larta demokratike dhe të mirëqenies sociale.

Humnera që zbuloi shembja e sistemit komunist

Përjetimi emocional dhe shpirtëror i shembjes së sistemit ishte një ndjesi e veçantë ku ndërthurej entuziazmi i pritshmërisë për liri me ndjenjën e pasigurisë mbi zhvillimin e mundshëm të ngjarjeve. Shembja e komunizmit në vendet e Lindjes i përshpejtoi proceset politike dhe në Shqipëri, pasi vendi ynë ishte i fundit që iu bashkua proceseve demokratizuese. Në fakt, sistemi ekonomik i vendit ishte shembur prej kohësh dhe ndryshimet në Lindje vetëm se e përshpejtuan këtë proces. Sistemi i tregtisë

në klering, mbi të cilin ishin ndërtuar marrëdhëniet mes vendeve lindore me të cilat Shqipëria kryente pothuaj në mënyrë ekskluzive shkëmbimet me jashtë, nuk funksiononte më. Në mungesë të plotë të valutës që nevojitej për të blerë lëndët e para të importit mbi të cilat funksiononte e gjithë industria e vendit, sistemi i prodhimit shumë shpejt do të shkonte drejt falimentimit total. Qeveria e kohës shpalli të famshmin "80-përqindësh", ku punëtorët paguheshin me 80% të pagës pa shkuar në punë. Sistemi i furnizimit të popullsisë me produktet bazike kishte ndeshur në vështirësi dhe sistemi i racionimit ushqimor ishte dëshmi e pamundësisë së regjimit komunist për të mbijetuar. Në fakt, në vitin 1991 që mund të merret si viti "zero" i shembjes së sistemit komunist dhe i fillimit të proceseve demokratike, prodhimi i përgjithshëm bruto i vendit kishte rënë me 30% krahasuar me vitin 1989. Rënia me 1/3 e prodhimit, papunësia masive dhe rritja shpërthyese e inflacionit me 236% në vitin 1992, rritja e menjëhershme e deficitit buxhetor (nga një vend me deficit 0% në sistemin komunist, menjëherë në 30% dhe me rritje të shpejtë për të kapur shifrat e 60% të prodhimit të brendshëm brenda një periudhe trevjeçare) treguan se humnera që kishin përpara kishte qenë e frikshme.

Unë besoj te një shprehje që artikulohej në atë kohë se, nëse nuk do të ishin radhët e gjata në dyqanet e bukës, ndoshta as komunizmi nuk do të kishte rënë. Ironike që komunizmi, i cili kishte pretenduar se do të triumfonte mbi kapitalizmin kryesisht në planin ekonomik, pikërisht aty do të dështonte. Siç

do të dëshmohej, edhe në vendet e tjera të Lindjes të ish-Bashkimit Sovjetik, rënia e prodhimit ishte në gati 40% krahasuar me vitin 1989. Sa për krahasim, rënia në përmasa të tilla e prodhimit kombëtar ishte e përmasave të viteve të Depresionit të Madh të vitit 1929.

Mbi këtë dëshpërim social dhe rrënim ekonomik, është e natyrshme që pritshmëritë e shoqërisë të ishin të larta. Kishte një eufori deri në naivitet në ato vite të hershme. Pritej që brenda një dekade vendi të shndërrohej në një vend me një ekonomi moderne, me institucione demokratike dhe funksionim të shtetit ligjor, një vend që do të anëtarësohej në BE dhe që procesi i konvergencës, kryesisht falë fluksit të menduar të investimeve të huaja, do të konvergohte shumë shpejt drejt niveleve të vendeve të zhvilluara. Libri i Fukuyama-s mbi fundin e historisë tingëllonte shumë bindës dhe rendi i ri botëror i një shoqërie të harmonisë globale po bëhej një realitet. Në fakt, gjërat do të ndryshonin shumë shpejt edhe në planin global, por ngjarjet që ndodhën në Shqipëri në vitin 1997 do të tregonin se sa jorealiste kishin qenë pritshmëritë tona.

Rrugëtimi i vështirë në rrugë të panjohura dhe zhgënjimet që u prodhuan

Shqipëria kaloi në një rrugëtim shumë të vështirë jo vetëm në planin ekonomik, por edhe politik e shoqëror. Shembja e komunizmit kishte ardhur në një vakuum edhe teorik lidhur me politikat më të mira të

transformimit të një vendi nga një sistem në një tjetër. Për këtë arsye, vendet ish-komuniste iu drejtuan një dokumenti që në vitin 1989 do të emërtohej nga ekonomisti John Williamson, si “*Washington Consensus*”. Në fakt, ky dokument që më vonë do të konsiderohej si shkaktari kryesor i dështimeve të tranzicionit, nuk lidhej me realitetet ekonomike të vendeve ish-komuniste. Ai ishte një dokument që ishte prodhuar nga diskutimet që zhvilloheshin në Washington DC për mënyrat më të mira të adresimit të krizës së borxheve të Amerikës Latine. Në një terren të panjohurash të mëdha edhe teorike dhe të veprimit praktik të politikëbërës, ky ishte një dokument i plotë reference dhe i vetmi. Si një “menu” zgjedhjeje për reformat, ai nuk vendoste ndonjë renditje prioritare, pavarësisht se më vonë dokumenti do të shpallej fajtor edhe për këtë. Por cilat ishin recetat që ofronte “Washington Consensus? Dokumenti ofronte dhjetë drejtime prioritare të politikave publike që renditeshin:

1. **Disiplinë fiskale**, duke shmangur krijimin e deficiteve të larta në raport me GDP;
2. **Riorientimin e shpenzimeve publike** nga subvencionet drejt politikave më të zgjeruara që synojnë rritjen ekonomike, mbështesin të varfrit, kryesisht përmes investimeve në arsim, shëndetësi dhe infrastrukturë;
3. **Reforma e sistemit të taksimit**, përmes zgjerimit të bazës së tatueshme dhe adoptimit të normave të moderuara marxhinale tatimore;
4. **Normat e interesit** të përcaktuara nga tregu dhe të jenë pozitive në terma realë;

5. **Kurse këmbimi** kompetitive;
6. **Liberalizim i tregtisë** duke eliminuar tarifaf, kufizimet sasiore dhe masat e tjera mbrojtëse;
7. **Liberalizimi i hyrjes së kapitalit të huaj**;
8. **Privatizimi** i ndërmarrjeve shtetërore;
9. **Derregullimi i ekonomisë** duke eliminuar rregullat që pengojnë hyrjen e firmave në treg, me përjashtim të atyre që justifikohen me mbrojtjen e mjedisit dhe konsumatorit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të tregjeve financiare;
10. Mbrojtja ligjore e të **drejtave të pronësisë**.

Edhe pse kjo listë reformash do të përmbliidhej në formën e një doktrine neoliberalë në trinomin “Stabilizim-Privatizim-Derregullim”, në fakt Williamson e ka mohuar një fakt të tillë. Madje, elementet tipike të axhendës neoliberalë që lidhen me liberalizimin e llogarisë kapitale, ekonomixsin e anës së ofertës dhe monetarizmin, si dhe të shtetit minimal, as nuk janë diskutuar ndonjëherë.

Po çfarë thonë studimet e kryera *ex post* mbi impaktin e reformave të agjendës “Washington Consensus” në rritjen ekonomike? Një studim i Grier et al (2020) gjen se këto reforma ndikuan në një rritje të ndjeshme të të ardhurave për frymë në një kuadër kohor 5-10 vjeçar ⁷⁹. Një studim tjetër që kufizohet

79 Grier, Kevin B.; Grier, Robin M. (2020). “The Washington Consensus Works: Causal Effects of Reform, 1970-2015”. *Journal of Comparative Economics*. 49: 59–72. doi:10.1016/j.jce.2020.09.001. ISSN 0147-5967.

vetëm në ekonomitë e Brazilit, Meksikës dhe Kilit gjen rezultate mikse. Stabilizimi makroekonomik është përmirësuar ndjeshëm, por rritja ka qenë heterogjene dhe madje zhgënjyese, thekson studimi⁸⁰. Një studim tjetër i kryer mbi ekonomitë e Afrikës Subsahariane gjen se impakti i reformave të Washington Consensus fillimisht ishte me ndikim negativ mbi të ardhurat për frymë (në vitet 1980-1990), por pas viteve 2000 krijuan një efekt shumë pozitiv mbi rritjen ekonomike⁸¹.

Edhe pse nuk ka ndonjë studim kuantifikues të këtyre reformave në kontekstin e ekonomisë sonë, duhet theksuar se kryesisht opinioni ka qenë kritik dhe zhgënjyës në raport me rezultatet e tranzicionit në tërësi. Analiza e dështimeve është shumëfaktoriale dhe duhet të zgjerohet përtej aspekteve ekonomike. Por, unë po ndalem në debatin e zjarhtë të zhvilluar në atë kohë dhe që akoma mbetet subjekt i kërkimeve të studiuesve të ekonomisë, atë midis **gradualitetit dhe “terapisë shock”**.

Shqipëria përqafoi “terapinë shok” në gjykimin tim një zgjedhje e drejtë e diktuar nga konteksti i brendshëm ekonomik, politik dhe kulturor. Të zgjedhësh gradualitetin, transformimin e ngadaltë të

80 Goldfajn, Ilan; Martínez, Lorenza; Valdés, Rodrigo O. (2021). “Washington Consensus in Latin America: From Raw Model to Straw Man”. *Journal of Economic Perspectives*. 35 (3): 109–132. doi:10.1257/jep.35.3.109. ISSN 0895-3309

81 Archibong, Belinda; Coulibaly, Brahim; Okonjo-Iweala, Ngozi (2021). “Washington Consensus Reforms and Lessons for Economic Performance in Sub-Saharan Africa”. *Journal of Economic Perspectives*. 35 (3): 133–156. doi:10.1257/jep.35.3.133. ISSN 0895-3309.

strukturës ekonomike, do të thoshte që ndërmarrjet të kishin burimet e duhura financiare, njerëzore e menaxheriale, teknologjike dhe të lidhjeve me tregjet, në mënyrë që privatizimi i tyre të ishte i ngadaltë dhe të mos i ngjante si një *'fire sale'*, ose një privatizimi nëpërmjet likuidimit ose falimentimit. Në fakt, siç edhe e theksova, ndërmarrjet pothuajse të gjitha qëndronin të mbyllura prej kohësh, lidhjet me tregjet ishin ndërprerë për shkak të mungesës së mjeteve të nevojshme financiare. Mbi të gjitha, vendi nuk kishte kapacitetet e duhura menaxheriale që të përshtaste ndërmarrjet me sistemin e tregut të lirë. Teknologjia në shumë raste ishte tepër e vjetruar dhe nuk garantonte një konkurrencë me mallrat e huaja. Shqipëria eksperimentoi me një program të ristrukturimit të ndërmarrjeve, sipas modelit të gradualitetit që fillimisht të ristrukturonte ndërmarrjet, nëpërmjet një procesi *spin off* (duke veçuar njësitë e pasuksesshme dhe duke lënë vetëm njësitë ekonomikisht eficiente), të mbështetjes me likuiditet dhe lëndë të para, të cilat pasi ato të viheshin në eficiencë të plotë, t'i nënshtroheshin më pas privatizimit si sipërmarrje të vërteta operuese. Rezultati ishte një dështim i plotë. Rreth 30 milionë dollarë që ishin huazuar nga Banka Botërore nuk arritën qëllimet e tyre në të gjithë portofolin e rreth 30 ndërmarrjeve që ishin përzgjedhur në këtë program. Vendi gjithashtu zgjodhi të kalonte në regjimin e kursit luhatës të kursit të këmbimit të monedhës, jo aq shumë si një zgjedhje e saj, sesa për shkak të pamundësisë financiare për të mbështetur një zgjedhje të kursit fiks, që është një politikë e arritjes më të shpejtë të

stabilizimit makroekonomik. Kur rezervat valutore ishin inekzistente, nuk mund të kishte vend për t'u menduar për zgjedhje strategjike.

Në thelb, zgjidhjet që bënte vendi ynë ishin më shumë të diktuar sesa një përzgjedhje e studiuar mes alternativave. Por rezultatet mbeten skeptike.

Tri dekada janë një periudhë relativisht e gjatë për të ndërtuar një histori të re moderne, për më tepër që dinamikat globale kanë qenë mjaft të favorshme. Triumfi i lirisë dhe demokracisë në shkallë globale, i sistemit të ekonomisë së tregut dhe lirisë së sipërmarrjes, bashkë me një zhvillim të panjohur më parë në historinë e ekonomisë së një revolucioni të ri industrial, e kishin të gjithë potencialin që me politikat e duhura dhe me një lidhshmëri të përgjegjshëm politik, si dhe vizion të qartë për të ardhmen, të kishim arritur në këto tri dekada një demokraci funksionale, një ekonomi më moderne dhe me baza solide të rritjes së saj dhe për pasojë dhe një shoqëri më kohezive dhe të shëndetshme. Emigracioni masiv në fillimet e tranzicionit, bashkë me një shoqëri me një ndjenjë të lartë kursimi, duke i shtuar dhe investimet e huaja si një faktor suplementar, do të kishin mundësuar një sipërmarrje më të zhvilluar dhe një integrim më të mirë të ekonomisë sonë në zinxhirin e prodhimit botëror. Fatkeqësisht, sot, pas tri dekadash, demokracia mbetet shumë e dobët dhe institucionet jofunksionale, ekonomia e brendshme akoma ka një strukturë disi arkaike ose që nuk ngjitet me tiparet e një ekonomie moderne dhe një popullsi me disparitete

shumë të larta në shpërndarjen e të ardhurave. Edhe vlerat shoqërore u kolapsuan, disa prej të cilave, nga më të mirat të trashëguara, në vetvete një kapital social shumë i fortë që mund të ishte një burim i fortë zhvillimi, i lanë vendin një rënieje të fortë të rolit të familjes dhe komunitetit, një paaftësie të sistemit të edukimit për të ndërtuar sistemin e vlerave të një shoqërie të transformuar. Zhgënjimet e qytetarëve mund të lexohen jo vetëm te rikthimi i nostalgjisë për sistemin e kaluar që kanë raportuar disa anketime, por te vazhdimi, së fundmi, me ritme edhe më të shtuara, të emigrimit të popullsisë drejt perëndimit.

“Milestones” në transformimin demokratik

Këtu është vendi që të ndalemi pak për një analizë disi më të hollësishme të disa prej aspekteve më konkrete të tranzicionit. Brenda secilës prej tyre mund të evidentohen elemente pozitive dhe negative që kanë bashkëjetuar, duke ndikuar në eficiencat e politikave përkatëse.

Shpërndarja e tokës bujqësore. Ishte një ndër reformat e para të tranzicionit, e cilësuar si ndër më të suksesshmet. Suksesi i saj matet me rritjen e shpejtë të sektorit bujqësor dhe kontributin e pazëvendësueshëm të tij në prodhimin e përgjithshëm ekonomik dhe në punësim. Ishte hapi i parë për ndërtimin e kapitalizmit në fshat. Por, nga ana tjetër, kjo reformë është edhe shumë e kundërshtuar pasi krijoi probleme serioze me pronarët e vërtetë të tokës, duke lënë pronarët e

vërtetë pa pronën e tyre. Po kështu, fragmentarizimi i thellë i pronës ka krijuar një mori fermerësh me sipërfaqe shumë të kufizuara ku rendimenti bujqësor është mjaft i ulët për shkak të gjendjes së prapambetur teknike dhe teknologjike në prodhimin bujqësor. Pra, sektori që ushqe u rritjen ekonomike për thujse gjatë gjithë dekadës së parë të tranzicionit, është shndërruar në një sektor që po frenon ritmet e rritjes. Masat e konsolidimit të tregut të tokës janë mjaft akute për të nxitur investimet private në modernizimin e sektorit dhe rritjen e rendimentit të prodhimit. Nga ana tjetër, politikat e taksimit nuk po nxisin përdorimin e tokës bujqësore. Sipërfaqe të mëdha tokash vazhdojnë të mbeten djerrë dhe jashtë aktivitetit ekonomik.

Privatizimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, me gjithë disa kritika që lidhen me procesin e zbatimit, ishte gjithashtu ndër reformat që vazhdon të cilësohet si ndër më të suksesshmet. Mendoj se ajo mbajti në konsideratë si shpirtin sipërmarrës të investitorëve vendas, ashtu dhe adresimin e kërkesave legjitime të ish-pronarëve si partnerë në këtë proces. Procesi i privatizimit të këtyre objekteve krijoi dhe shtratin e zhvillimit të sipërmarrjeve të reja dhe, në disa raste, riaktivizimin e industrive tradicionale që ishin zhvilluar dhe më parë në to. Në analizë të fundit, ky proces, së bashku me liberalizimin e hyrjes në treg të investitorëve të rinj, krijuan bazat e zhvillimit të sektorit privat në ekonominë e vendit dhe burimin kryesor të rritjes ekonomike. Natyrisht që në procesin e zbatimit mund të ketë patur edhe mangësi apo

praktika të konsideruara si jo të drejta, si për shembull, kërkesat e vazhimit të aktivitetit ekonomik për tre vjet pas privatizimit, praktika e privatizimit nëpërmjet bordeve, etj. Sidoqoftë, në analizë të fundit, rezultati final i këtij veprimi mund të konsiderohet si një reformë me impakte mjaft pozitive për ekonominë e vendit.

Privatizimi i bankave dhe ndërmarrjeve strategjike. Siç është vlerësuar edhe nga studiues të ekonomisë dhe financave dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare, progresi i reformave në këtë fushë ka patur mjaft mangësi, përveçse është zvarritur mjaft në kohë. Ngadalësia në privatizimin e bankave, për shembull, rezultoi në përsëritjen disa herë të ristrukturimit të tyre, duke e bërë ristrukturimin bankar si një ndër operacionet më të kushtueshme për buxhetin e shtetit dhe taksapaguesit shqiptarë (Fatkeqësisht nuk është bërë asnjë përpjekje për të dhënë një shifër të kostove të ristrukturimeve të sistemit bankar). Të njëjtat konsiderata ndajmë edhe për vonesat në privatizimin e ndërmarrjeve të mëdha. Vonesat në këtë drejtim nuk kanë veçse efekte negative për vetë këto ndërmarrje.

Liberalizimi i tregtisë dhe integrimi i saj në sistemin botëror të tregtisë mendoj se mund të konsiderohet gjithashtu si një sukses i reformave të tranzicionit. Anëtarësimi në OBT, rrjeti i marrëveshjeve të tregtisë së lirë me rajonin, marrëveshja e tregtisë së lirë me Bashkimin Europian, mendoj se janë

“milestones” në matjen e suksesit të politikave tregtare. Natyrisht që ka grupe të ndryshme interesi, që reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj përmbajtjes së tyre, ndaj produkteve të veçanta apo industrive të caktuara.

Por vendi nuk arriti të ndërtojë institucionin thelbësor të sistemit të kapitalizmit: atë të mbrojtjes së pronës private. Mbrojtja e të drejtave të aksionarëve të vegjël, zbatimi i kontratave, eficienca e dobët e ligjit dhe institucioneve që operojnë në këtë fushë, si hipotekat, marka dhe patentat, pronësia intelektuale, etj., vazhdojnë të jenë shqetësimi më madhor për ekonominë.

Siç po e fakton reforma në drejtësi, sistemi i drejtësisë në Shqipëri ishte thellësisht i korruptuar. Në vend të “*rule of law*” duket se ka sunduar “*rule of lawyer*”. Kjo shthurje e sistemit të drejtësisë, bashkë me standardet aspak demokratike të qeverisjeve, kanë bërë që autoriteti i shtetit në publik të bjerë dhe të humbasë respektin për ligjin nga qytetari i thjeshtë. Kjo është një sëmundje e rrezikshme dhe mund të ketë pasoja afatgjata në zhvillimin e vendit.

Historia ka treguar se disa vende kanë mundur të bëjnë një kërcim të madh dhe shkëputje nga stadi i një shoqërie në zhvillim duke hyrë në rrugën e modernitetit dhe të një shoqërie me standarde të larta ekonomike dhe demokratike. Disa të tjera kanë mbetur të ngërthyer në kurthin e nënzhvillimit, duke patur rritje ekonomike të përvitshme, por pa mundur të çlirohen nga kthetrat e nënzhvillimit, një fenomen që ekonomistët e emërtojnë si ‘*development trap*’.

Shqipëria deri tani mbetet e ngërthyer në këtë kurth. Është sfida më madhore e lidershipit politik në vitet e ardhshme që vendi të kalojë nga ky stad dhe të futet në rrugën e modernizimit ekonomik e shoqëror sipas standardeve të familjes europiane ku dhe aspirojmë të bëhemi pjesë në të ardhmen e afërt.

Kapitulli 8

NJË LEXIM I VËMENDSHËM I ADAMIT

Fjala është për Smithin, simbolin e *'laissez faire'*, themeluesin e teorisë ekonomike, vepra e të cilit, *"Pasuria e Kombeve"*⁸², konsiderohet si vepra më madhore e shkruar ndonjëherë në fushën e shkencave sociale. "Me veprat që ka shkruar, Adam Smith i bën hije edhe diellit", thotë Rothbard Murray⁸³. Qëllimi i këtij kapitulli nuk është analiza e veprës së tij, por trajtimi i disa miteve që vazhdojnë ende të rrethojnë emrin e tij, edhe pse shkrimet dhe veprat e Smithit janë shumë të njohura dhe të studiuara gjerësisht nëpër universitete dhe nga bota akademike. "Ky është fati i personaliteteve të mëdha, - shkruan Russell, - të vlerësohen shumë, por dhe të jenë të keqkuptuar".

Jo se në shkencën e ekonomisë - për aq sa mund të quhet ajo e tillë - nuk gjen një duzinë mitesh për të cilat mund të shkruash. Për shembull, mitin se çdo shqiptar lind duke trashëguar një borxh prej 3,000\$, thua se që në maternitet, në vend të certifikatës së lindjes, fëmijës i jepet një letër borxhi (me këtë nuk

82 Të gjitha citimet rreth Smith janë marrë nga vepra e tij, Adam Smith, *"Pasuria e Kombeve"* Dita 2000.

83 Rothbard Murray, 1995, *An Austrian perspective on the history of economic thought*, Ludwig von Mises Institute

dua të them se borxhet janë të mira!). Apo mitin se paranë e emeton qeveria (banka qendrore), kur në fakt paraja është krijim kredie që prodhohet nga bankat nëpërmjet procesit të kredisë; miti mbi lidhjen e inflacionit me papunësinë, misteri mbi paranë në shoqërinë njerëzore, etj. Për më tepër, kur lexon historinë e ekonomisë moderne, duket sikur mit është edhe shkëputja spektakolare e perëndimit, ndërsa prapambetja e pjesës tjetër të botës, ku bën pjesë dhe Shqipëria, është histori.

Njëri nga mitet më interesante dhe intriguese është historia e krijimit të bankës qendrore të SHBA-ve, Sistemi i Rezervës Federale (FED), në vitin 1912 (ndonjë studiues skrupuloz do të korrigojë vitin 1913, viti kur FED filloi të operojë), rreth së cilës janë shkruar aq shumë libra me natyrë konspirative, më interesante nga të cilët është libri i G. Edward Griffin⁸⁴, *“The Creature from Jekyll Island - a second look at the Federal Reserve”*, botuar në vitin 1994.

“Krijesa e ishullit Jekyll” zë fill me një udhëtim të organizuar në mënyrë tepër sekrete. Udhëtimi për në ishull daton një mbrëmje me shi të ftohtë nëntori të vitit 1910, nga stacioni hekurudhor i Nju-Xhersit. Në një seksion të ndarë të stacionit qëndronte vagoni i trenit privat me etiketën Aldrich, të senatorit të mirënjohur të Rhode Island, vjehëri i John D. Rockefeller, pronari i Standart Oil. Nelson Aldrich ishte, përveçse senator, një biznesmen i madh që, si investitor partner i bankës Morgan, zotëronte aksione

84 G. Edward Griffin, 1994, *“The Creature from Jekyll Island - a second look at the Federal Reserve”*

në sipërmarrje private në shumë degë të ekonomisë. Aldrich do të qëndronte në krye të grupit prej gjashtë vetash që ishin nisur me misionin e rëndësishëm të krijimit të arkitekturës së sistemit bankar modern amerikan. Personazhet e tjera të shquara të atij treni privat asaj nate ishin: Abraham Piatt Andrew, asistent i sekretarit të Thesarit; Frank A. Vanderlip, president i National City Bank të Nju-Xhersit; Henry Davison, partner kryesor në J.P.Morgan Company; Benjamin Strong, shefi i J.P.Morgan's Trust Company; Paul M. Warburg, partner i Kuhn, Loeb&Co, përfaqësues i dinastisë së Rotshildëve në Angli dhe Francë. Ky i fundit ka botuar dhe vetë një vepër madhore mbi historikun e krijimit të FED, dhe të sistemit monetar e bankar amerikan gjatë asaj periudhe. Udhëtimi prej më shumë se tetëqind miljesh do ta çonte grupin e udhëtarëve drejt një ishulli në bregun kalifornian, që ishte blerë nga Morgan dhe disa partnerë të tij të cilët e përdornin për t'u arratisur nga jeta e përditshme ose për gjueti rosash dhe shpendësh të egër. Asnjë nga pasagjerët që po udhëtonte në vagonin privat të Aldrich nuk ishte i identifikueshëm. Mënyra sekrete e sjelljes do të vazhdonte gjatë gjithë qëndrimit prej nëntë ditësh. Stafi shërbyes i ishullit ishte zëvendësuar me personel të ri dhe të zgjedhur, të gjithë pjesëmarrësit në konferencë do t'i drejtoheshin njëri-tjetrit vetëm në emër. Ishte pikërisht ky mister dhe mënyra sekrete e organizimit që do të shërbente, siç e cilëson biografi Ron Chernow, "si burimi i mijëra historive konspirative". Njëri prej pjesëmarrësve në konferencën sekrete të

Jekyll Island, Paul Warburg, do të shkruante⁸⁵ në vitin 1930 një libër të tijin voluminoz prej 1750 faqesh “*The Federal Reserve System, Its Origin and Growth*”, ku do të nënvizonte se “rezultatet e konferencës do të ishin krejtësisht konfidenciale. Madje dhe fakti se ishte mbajtur ky takim duhej mbajtur sekret për publikun.” Historia vazhdon të zhvillohet si një *thriller*, por nuk përbën interes për këtë shkrim. Në fakt, duket shumë paradoksale që edhe pse sot shkenca ndodhet në kufijtë e së pamundurës, mitet vazhdojnë të jetë po aq të fuqishme sa dhe në botën e lashtë. Duke marrë shkas nga realiteti, ato dalin shumë përtej tij, fitojnë jetën e vet dhe bëhen më të fuqishme se vetë realiteti.

Edhe Adam Smith që është simbol i kapitalizmit dhe tregut të lirë, jo pak është mitizuar nga besimtarët e tregut të lirë, apo (neo) liberalët. Jo vetëm që është një mitizim që shkon përtej të vërtetës së veprës së tij, por edhe realitetet ekonomike, politike dhe sociale të dy kohëve janë kaq të ndryshme sa vetë referenca ka nevojë për një përditësim. Realiteti i kapitalizmit të sotëm është kaq larg sistemit ekonomik për të cilën ka shkruar ai, aq sa, realisht, shoqëria duhet të tronditet dhe të reflektojë në mënyrë kritike për të korrigjuar funksionimin e vetvetes. Duke qenë se emri i tij është sinonim i tregut të lirë, i interesit personal dhe individualizmit, duket sikur njëherazi ai është dhe një mbrojtës pakufi i interesave të bizneseve të mëdha dhe se interesat e shoqërisë dhe grupeve të tjera shoqërore nuk duhet të mbahen në konsideratë;

85 Paul M Warburg, 1930, “*The Federal Reserve System, It’s Origin and Growth*” in two volumes (The Macmillan Company)

sikur publikja nuk duhet të ekzistojë dhe se gjithçka i duhet lënë forcave të pakontrollueshme të tregut. *“Pasuria e kombeve”* dhe *“Teoria e sentimenteve morale”* duhen lexuar të dyja në harmoni. Edhe pse *“Pasuria e kombeve”* u shkrua më vonë, disa nga temat e etikës së sistemit ekonomik ai i rimerr nga *“Teoria e sentimenteve morale”* dhe i zhvillon sërish duke i vendosur të dyja veprat e tij në koherencë të plotë.

Interesi vetjak. Kur Smith thotë se ne nuk e presim bukën nga mirësia e bukëpjekësit, por është interesi i tij vetjak ai që e shtyn atë të prodhojë një mall sa më cilësor, askush nuk mund të gjejë argumente ta hedhë poshtë këtë postulat thelbësor në ekonomi. Por te *“Teoria e sentimenteve morale”* ai shkruan: “Sado egoist që të jetë njeriu, është e qartë se ka disa parime në natyrën e tij që janë edhe në interesin e pasurimit të të tjerëve dhe se lumturia e tyre është edhe në interesin e tij, edhe pse ai nuk nxjerr asgjë prej tyre, përveç kënaqësisë që po e sheh diçka të tillë.” Pra, edhe po ta shohim në mënyrë egoiste veprimin e interesit vetjak, lumturia e të tjerëve është gjithashtu edhe në interesin e sipërmarrësve. Më tutje, Smith argumenton se skllavëria është më e kushtueshme për sipërmarrësit sesa puna e paguar. Dhe, në këtë linjë arsyetimi, një punë e keqpaguar është më e kushtueshme se një punë e mirëpaguar. Këtu duket sikur futem në një paradoks, pasi Smith dhe Rikardo ishin mbështetës të tezës së teorisë së vlerës nga puna, që shërbeu si bazë e teorisë së mëvonshme marksiste të mbivlerës si punë e papaguar e punëtorit.

Ajo që Smith argumenton në këtë çështje është se një punëtor i papaguar është krejtësisht i pamotivuar dhe se, për pasojë, puna e tij është shumë joproductive. Një punëtor i papaguar apo i keqpaguar nuk ka motivimin që të përmirësojë proceset e punës, teknologjinë, organizimin e punës dhe të jetë inovativ në kryerjen e operacioneve të prodhimit. Kenichi O'Hmae⁸⁶, një guru i shkencës së menaxhimit, shkruan se një nga burimet e jashtëzakonshme të inovacioneve për korporatat japoneze janë idetë që japin vetë punëtorët e kompanive. Në katin e parë të firmave qëndrojnë të vendosura kuti ku punëtorët mund të shkruajnë dhe të hedhin idetë e tyre mbi përmirësimet që ata sugjerojnë për gjithçka në korporatë. Kështu grumbullohen mijëra ide - falas, pa asnjë shpenzim shtesë - të cilat studiohen nga inxhinierët, të cilët i shndërrojnë ato në procese inovative duke i bërë firmat japoneze ndër më konkurrueset në botë.

Në fakt, pjesa mbyllëse e citimit të Smithit se *"...ai nuk nxjerr asgjë prej tyre përveç kënaqësisë që po e sheh diçka të tillë"*, nuk duket e saktë. Rritja e pagave stimulon kërkesën ekonomike dhe vetë shitjet për mallrat që prodhojnë vetë firmat. Pra, krijojnë kërkesë shtesë duke rritur vetë shitjet e tyre. Kështu veproi Henri Ford kur e bëri pagën javore 5\$ në vitet 1920, ndërkohë që pagat në SHBA ishin vetëm 1\$. Kjo ishte një strategji tepër e suksesshme si për kompaninë, ashtu edhe për punëtorët.

86 Kenichi O'Hmae, 1998, Bota pa Kufij, Dita 2000

U zgjata në këtë pikë për të argumentuar edhe njëherë se Adam Smithi thotë se interesat vetjake shërbejnë më mirë kur shërbejnë njëherësh po aq mirë edhe interesat e aktorëve të tjerë në kompani apo në shoqëri. Të rrisësh pagat, të mbrosh shëndetin e të punësuarve, të krijosh një ambient pune komod dhe stimulues, të mbrosh mjedisin në komunitetin ku vepron, janë po aq në interesin e vetë pronarëve të firmave, sa edhe të punëtorëve.

“Dora e padukshme”. Gjuha që përdor Smithi në veprën e vet është hyjnore, siç është simbolika e dorës së padukshme. Në librat e shenjtë lexojmë për frymën hyjnore që sjell rregullin në botën tokësore, ashtu sikurse dhe dora e padukshme sjell ekuilibrin nga kaosi i miliona e miliarda transaksioneve të pakoordinuara ekonomike. Në këtë pikë, Smithi, duhet thënë, se ishte deri diku radikal, pra se tregu prodhon rezultatin më të mirë të mundshëm. Por, sot jeta ekonomike e globit është shumë më tepër komplekse krahasuar me kohën kur jetoi Smithi. Nga epoka e Revolucionit të Parë Industrial, kur jetoi Smithi, në botën e sotme të Revolucionit të Katërt, realiteti nuk ka të krahasuar. Por, edhe për kushtet e asaj epoke disi primitive krahasuar me botën e sotme, Smithi na bën disa paralajmërime se, në mjaft raste, tregjet duhen mbajtur nën kontroll. Madje Smithi ishte mbështetës edhe i vendosjes së kufizimeve për normën e interesit mbi huan, një tezë që as ekonomistët e majtë sot nuk e mbështesin.

Ai thoshte se kapitalistët gjithnjë do të përpiqen

të shfrytëzojnë njerëzit e zakonshëm ose duke bërë që rregullat të hartohen sipas interesave të tyre, ose duke fiksuar çmimet e mallrave dhe të shërbimeve. “Normat e fitimit janë gjithnjë më të larta në vendet që shkojnë drejt rrënimit”. Sikur rregullatorët të lexonin Smithin, me siguri që ekonomia e vendit do të ishte më e shëndetshme; sikur kapitalistët shqiptarë ta kuptonin Smithin, me siguri do të operonin me rregulla të tjera tregu dhe norma fitimesh brenda logjikës normale të vlerësimit të së ardhmes së shoqërisë. Normat e fitimeve, njësoj si dhe normat e interesit, janë shprehje e çmimit që ne i japim të ardhmes sonë. Në shoqëritë me stabilitet dhe ku besimi për të ardhmen është i lartë, edhe fitimet dhe interesat janë më të ulëta; e kundërta ndodh në shoqëritë e trazuara dhe që vuajnë destabilitet social. Kjo është një tezë e studiuar edhe nga ekonomistët e shkollës institucionaliste, të cilët kanë parë lidhjen midis besimit tek e ardhmja, normave të interesit dhe krimit në shoqëri. Fakti se normat e fitimit në bizneset vendase janë shumë të larta, është njëherësh shprehje e mungesës së besimit që vetë investitorët shohin për të ardhmen, pikërisht siç e thotë dhe Smithi.

Konsumi dhe prodhimi. Përfituesit kryesorë të tregut të lirë duhet të jenë konsumatorët, sipas Smithit, ndërsa interesat e bizneseve i sheh si të varura nga konsumatori. “Konsumi është qëllimi i vetëm dhe final i prodhimit dhe interesat e prodhuesit duhen ndjekur vetëm për atë që ato i shërbejnë promovimit të interesit të konsumatorit. Maksima është kaq

vetevidente, sa është absurde të përpiqesh ta provosh. Por, interesi i konsumatorit, pothuajse gjithnjë dhe në mënyrë konstante, sakrifkohet në emër të interesave të prodhuesve; dhe duket se prodhimi, dhe jo konsumi, është qëllim i vetëm dhe final i industrisë dhe tregtisë...”

Por çfarë mendonte Smithi për biznesmenët e kohës së tij? Shfrytëzimi i punëtorëve, pagat e ulëta dhe fitimet e larta duket se kanë ngjallur neveri te Smithi. “Rritja e fitimeve vepron njësoj si interesi i përbërë. Tregtarët dhe manufakturuesit tanë ankohen mjaft për efektet negative që kanë pagat e larta në rritjen e çmimeve dhe rënien e shitjeve si brenda, dhe jashtë vendit. Por ata nuk thonë asgjë rreth normave të larta të fitimeve. Ata heshtin për efektet e dëmshme të fitimeve të tyre; ata ankohen vetëm për ato të personave të tjerë. Kjo logjikë e operimit të sistemit kapitalist ndikon negativisht edhe mbi edukimin.”, thotë Smithi. “Prirja e kapitalizmit për të paguar paga të ulëta krijon klasa të ulëta dhe për pasojë fëmijët e këtyre klasave, në vend që të studiojnë, janë të detyruar të punojnë më shumë në kurriz të edukimit.” Prandaj, në këtë pikë Smithi thekson se qeveritë duhet të luajnë një rol shumë aktiv në fushën e edukimit. Këtë argument Smith e merr edhe kur trajton rreziqet e një specializimi të thellë, pasi kjo e shndërron individin në një makinë pune duke e zvetënuar intelektualisht. “Prandaj kura është edukimi publik”, thotë Smith. “Qeveria duhet të jetë po aq e përkushtuar ndaj edukimit, - thotë, ai, - sa ç’është edhe ndaj luftës ndaj lebrozës apo sëmundjeve të ndryshme.”

Adam Smith ishte gjithashtu kundër korporatave, duke i paraparë rreziqet e ndarjes së pronësisë nga menaxhimi në një korporatë, një problem themelor në teorinë principal-agjent të ekonomiksit të ditëve tona. Krizat e sotme të sistemit financiar nuk mund të mos shihen si dëshmi tronditëse e të vërtetave që na ka thënë Adam Smith që prej shekullit XVIII dhe që janë dhe sot po aq të rrezikshme për botën tonë.

A besonte Smithi te tregu i lirë si një sistem më superior se çdo sistem tjetër? Padyshim që po. Por ai asnjëherë nuk ka thënë se ky është sistemi perfekt, ku gjithkush do të jetë përfitues dhe se biznesmenët nuk duan ta manipulojnë sistemin duke përfituar në kurriz të më të dobëtëve dhe të pambrojturve. **Dora e padukshme e Smithit kërkon të çlirohet jo vetëm nga ndërhyrjet e qeverisë, por edhe nga manipulimet e ‘oligarkëve’, të biznesmenëve të pushtetshëm që influencojnë ligjbërjen dhe rregullimin ekonomik në favor të interesave të tyre.** Dora e padukshme është e dobishme kur ajo vepron në përfitim të konsumatorëve dhe jo të interesave të prodhuesve të cilët nuk e quajnë të pamoralshme të abuzojnë me konsumatorin në emër të interesave të tyre. Është provuar se edhe kompani shumë prestigjioze ndërkombëtare kanë abuzuar me lirinë - lista është e gjatë dhe nuk ja vlen të përmenden edhe për faktin se vetëm ata janë “kapur” nga sistemi. Plot kompani të tjera që nuk janë kapur, apo vetë autoritetet nuk dëshirojnë “t’i kapin”, janë përreth. Mentaliteti “për t’ia hedhur konsumatorit” është një mendësi mbizotëruese te shumica e sipërmarrjeve, pikërisht duke keqinterpretuar konceptin smithian të interesit vetjak.

Doktrina smithiane e tregut të lirë dhe e konkurrencës perfekte vështirë se ndeshet në jetën reale. Si mund të konkurrojnë njësoj një kioskë e vogël e rrugës me supermerkatat e mëdha të Tiranës; një punëmarrës i pambrojtur (Zot mëshiroji sindikatat!) ndaj një punëdhënësi me pushtet dhe influencë ekonomike dhe politike; një riparues i vogël makinash ndaj një qendre të madhe distribicioni dhe mirëmbajtjeje të markave të makinave të mëdha. Si mund të ketë ekuilibër forcash kur ballafaqohen një depozitues i vogël në bankë apo huamarrës i vogël dhe banka; një investitor i vogël në një fond investimesh dhe menaxherët e këtyre bankave të investimit. Kjo asimetri është kaq e fuqishme sot sa, nëse nuk veprohet me shpejtësi dhe forcë, pasojat do të jenë edhe më shqetësuese për shoqërinë nesër. Falimentimet nga kriza e madhe e vitit 2008, ashtu si dhe e gjithë krizave të mëparshme, kanë rrënuar kursimet e miliona depozituesve të vegjël, por nuk kanë cenuar interesat ekonomikë të asnjë bankieri; përkundrazi, ata janë larguar me shuma të majme monetare edhe kur të gjithë janë rrënuar. Rendja drejt fitimeve të larta dhe pasurimit pa kufij ka apeluar dhe filozofë të mëdhenj të virtytit, jo më borgjezët mëkatarë, të cilët kanë qenë historikisht të përbuzur nga shoqëria. Bertrand Russell thotë, për shembull, se “stoiku Seneka, edhe pse ishte filozof stoik, të cilët urrenin pasurinë dhe lëvdonin jetën e thjeshtë, të vështirë dhe të mundimshme, kishte krijuar një pasuri prej rreth 300 milionë sestere (gati 5 milionë paund sterlina të viteve të sotme), kryesisht duke i dhënë hua Britanisë me norma shumë të larta.”

Thjesht moralizimi dhe besimi filozofik nuk mund t'i vërë fre etjes për fitime marramendëse. Kemi nevojë për rregulla të forta që balancojnë më mirë interesat midis grupeve të ndryshme shoqërore.

Triumfi i kapitalizmit sot është kryesisht prej dorës së padukshme që mbahet nën fre dhe kontroll nga dora e dukshme e rregullimit nga ana e institucioneve që mbrojnë interesat publikë. Dhe meqenëse kjo e fundit kërkon shtetar me cilësitë që kërkonte Platoni, filozof dhe mbrojtës të së drejtës, jam skeptik edhe për të ardhmen.

Kapitulli 9

NJË MODEL SOCIAL TREGU NË KONTEKSTIN E EKONOMISË SHQIPTAR

Të rralla janë momentet historike për një komb kur taq shumë gjëra kërkohet të kryhen brenda një kohe shumë të shkurtër. I tillë ishte fundi i Luftës së Dytë Botërore për Gjermaninë e Konrad Adenauerit, por ngjashmërisht ishte dhe situata e Shqipërisë pas rënies së komunizmit në vitin 1992. Historia kishte regjistruar efektet shkatërrimtare të politikave të sojit të 'agjentëve të pushtetshëm të shkatërrimit', siç i konsideronte Burckhardt tipa të tillë politikanësh, dhe ishte në pritje të një gjenerate politikanësh ndryshe, 'agjentëve të pushtetshëm të shërimit' të kombeve, siç ishte Adenauer.

Edhe fundi i komunizmit në Shqipëri, nga pikëpamja e dramave social-ekonomike ngjante deri diku me panoramën e Gjermanisë në fundin e luftës: papunësi masive, vështirësi në plotësimin e nevojave më bazike të shoqërisë, turma emigrantësh që në rastin tonë simbolizohet me anijet e vjetruara të tejmbushura drejt Europës.

Mrekullia ekonomike gjermane do të ndodhte menjëherë pas lufte: një rritje ekonomike dyshifrore

dhe një rikthim i qëndrueshëm dhe pakthim në skenën e ekonomisë botërore. Edhe pse nuk po nënvizoj një lidhje të drejtpërdrejtë shkakësore të politikave ekonomike të Adenauerit dhe ministrit të tij të ekonomisë, Ludwig Erhard pasi bumi ekonomik i asaj periudhe mund të lidhej edhe me ritmet e larta të rritjes në shkallë globale si pjesë e euforisë së pasluftës, politikat ekonomike neoliberales të Adenauerit luajtën një rol themelor, madje vendimtar, në këto zhvillime. Siç shkruhet edhe në librin biografik të Adenauerit⁸⁷...“për dekada, historia e ekonomisë së Republikës Federale u formësua nga dy vendime: heqja dorë në mënyrë radikale nga ekonomia e komanduar nga ana e Erhardit paralelisht me reformën e tij monetare të vitit 1948, që në një farë mënyrë formësuan kushtet nisëse të politikave të tij neoliberales, dhe vendimi i vitit 1949 për të krijuar qeverinë e Adenauerit si një (të ashtuquajtur) koalicion i vogël protreg me Demokratët liberalë të FDP, duke dobësuar pozitat e majtistëve nga radhët e CDU“. Ishte pikërisht në këtë periudhë kur Adenauer improvizoi termin “ekonomi sociale e tregut“ një term që ishte futur në leksikun e ekonomiksit gjerman pak vite më parë nga Müller-Armack, një ekonomist kryesor i Shkollës së Këlnit.

Trashëgimia gjermane me modelin e ekonomisë sociale të tregut, e formalizuar me botimin nga Erhard të veprës së tij *Prosperity through Competition*

87 Hans-Peter Schwarz, 2017, Shënime për Adenauerin - një portret i Adenauerit, Botim i Fondacionit Konrad Adenauer, Tiranë.

në vitin 1958 një teori dhe model që ishte pasuruar me kontribute nga një mori ekonomistësh gjermanë të famshëm si Roepke, Eucken, Boehm, Müller-Armack e të tjerë, dhe e zbatuar në praktikë nga vetë Erhard, janë një model që balancon parimet e tregut të lirë me objektivat e një zhvillimi të balancuar social.

Riunifikimi i Gjermanisë menjëherë pas shembjes së Murit të Berlinit është me interes nga pikëpamja e aspektit politik të reformave. Konvertimi i markës lindore në raportin një me një me *deutschmark*-ën, edhe pse tregu i zi kishte një normë konvertimi që shkonte në 8:1; partiteti i pagave në kushtet kur produktiviteti i punëtorit gjermanolindor ishte sa 1/3 e atij perëndimor, ishin vendime që bazoheshin në konsiderata politike, që shteti i ri gjerman nuk mund të përbëhej nga dy shoqëri të ndryshme. Sigurisht që ekonomiksi i politikave të tilla shkonte në të kundërt – një monedhë e zhvlerësuar dhe paga më të ulëta do të përthithin papunësinë në lindje dhe do të krijojnë më shumë eksporte dhe potencial për rritje ekonomike të fortë. Edhe sistemi i mbrojtjes sociale për të papunët që krijoheshin si pasojë e privatizimeve në Lindje, do të gëzonin të njëjtën mbrojtje, si dhe në Perëndim, duke krijuar disincentiva për punësim. Një sistem gjeneroz i përfitimeve të papunësisë, duke vepruar si një nivel page i vendosur prej sindikatave, ndikon në ofertën dhe jo në kërkesën e tregut të punës, duke e mbajtur papunësinë në nivele të larta. Këto shembuj janë një dëshmi e fortë e ndikimit të modelit gjerman mbi politikat ekonomike.

Në këtë kontekst është me interes të shikojmë se si edhe Shqipëria ka adoptuar politikat e saj gjatë

viteve të tranzicionit drejt modelit të ekonomisë së tregut. A ka qenë dimensionin social një shqetësim i politikave të brendshme? A kanë arritur të balancohen objektivat e rritjes ekonomike me ato të krijimit të një shoqërie kohezive dhe pa diferenca të rrezikshme në shpërndarjen e të ardhurave? A kemi një legjislacion pune që mbron vendin e punës dhe një treg pune që krijon një kompresim të niveleve të pagave në ekonomi përkundër një dispersioni të madh të tyre? A kemi një politikë të mirëqenies sociale që është e hapur për të gjithë dhe që financohet nga të punësuarit dhe jo nga taksat, apo një skemë të ngushtë dhe të kufizuar vetëm për ata që janë në nevoja emergjente? A kemi element të rolit të familjes në skemat e mbështetjes sociale, sipas modelit mesdhetar, apo thjesht mbështetje tek tregu në zgjidhjen e tyre? A kemi politika aktive të punësimit shoqëruar me fleksibilitet të tregut, apo politika rixhide? Duke i konsideruar këto si tiparet më thelbësore të modelit gjerman të ekonomisë sociale të tregut, në vijim do të analizojmë edhe tiparet më kryesore të sistemit të sotëm politiko-ekonomik shqiptar, duke u kufizuar në vetëm disa nga temat që cekët më sipër.

Rritja ekonomike post-tranzicion– a mund të flitet për një “mrekulli ekonomike”?

Modeli i tranzicionit ekonomik dhe politik shqiptar nga pikëpamja e mbështetjes ideologjike i përngjet një modeli të fortë liberal. Programet e reformave të para të tranzicionit, tërësisht ortodokse,

u hartuan nga ekspertët e FMN dhe Bankës Botërore sipas principeve të njohura si *“Washington Consensus”* me fokusim tek liberalizimi, derregullimi dhe stabilizimi makroekonomik, duke vendosur një kufizim të fortë buxhetor në financat publike dhe të kreditit për sektorin e ndërmarrjeve shtetërore, të cilat efektivisht do të ndalonin çdo mundësi ristrukturimi të ndërmarrjeve publike qoftë nëpërmjet mbështetjeve buxhetore apo lehtësive kredituese. Konteksti ekonomik, financiar dhe menaxherial mendoj se justifikon plotësisht zgjedhjen e një modeli të tillë. Në planin ekonomik, kërkesa e brendshme e dobët dhe varfëria gjerësisht e përhapur, nuk krijonin kushte për të udhëhequr një proces ristrukturues të industrive. Ekonomia kishte njohur një rënie të fortë që prej fillimit të viteve 1980. Me gjithë disa episode rritëse të përkohshme, mesatarisht për gjithë periudhën 1981-1992 ekonomia ishte rritur mesatarisht me -1.9% në vit (grafiku 1). Në kushtet e hapjes dhe disponueshmërisë së mallrave të huaja, konsumatorët thjesht refuzonin të blinin një mall vendas. Ndërsa dalja në tregjet e huaja ishte thjesht një utopi. Diferencat e mëdha teknologjike, mosnjohja dhe mungesa e lidhjeve me tregjet ndërkombëtare, etj., janë pak nga një listë e gjatë faktorësh pengues. Nga ana tjetër, gjendja financiare e ndërmarrjeve shtetërore ishte problematike. Borxhet që ndërmarrjet i kishin njëra-tjetrës dhe borxhet e huaja që ndërmarrjet e tregtisë së jashtme kishin ndaj firmave të huaja, ishin një nga shqetësimet e para të procesit të ristrukturimit. Këto borxhe u morën përsipër nga buxheti shtetit dhe bilancet financiare të

tyre u pastruan, por nevoja për financimin në blerjen e lëndëve të para dhe vazhdimin e veprimtarisë së tyre, kërkonte mjete financiare valutore shtesë të cilat thjesht nuk disponoheshin nga thesari. Në këto rrethana, vendosja e kufizimit buxhetor, vepronte si një presion i madh për privatizimin e ndërmarrjeve, një proces që në fakt u realizua thjesht si një akt likuidimi të tyre. Kapacitetet menaxheriale ishin gjithashtu shumë deficitare. Ndërmarrjet ishin menaxhuar sipas parimeve të ekonomisë së centralizuar dhe si një ekonomi plotësisht e mbyllur ku aftësitë menaxheriale nuk mund të zhvilloheshin.


Shkurt, në një kontekst të tillë dhe një situatë sociale shpërthyese, privatizimi me shpejtësi ishte një alternativë imponuese. Privatizimi në shkallë të gjerë i një sektori industrial pothuaj tërësisht i falimentuar, krijonte një papunësi masive. Deficiti fiskal gjatë vitit 1991, vitit të shembjes së diktaturës, arriti në 44% të prodhimit të brendshëm, një deficit i financuar tërësisht me kredi nga sistemi bankar, dhe që deri në vitin 1993 të fillimit të reformave, do të rritej me mbi 10% duke e çuar borxhin publik në 58.6% të PBB-së (IMF, 1994). Pra, i gjithë sistemi ekonomik: ndërmarrjet, bankat, individët ishin në një gjendje kritike.

Vendosja e disiplinës ekonomike e financiare mbi ndërmarrjet dhe kontrolli i masës monetare nëpërmjet vendosjes së objektivave sasiorë në rritjen e agregatëve monetarë në programin monetar të Bankës së Shqipërisë, kontribuuan në vendosjen nën kontroll të inflacionit i cili në vitin 1992 kishte arritur deri në 236%! Stabilizimi i inflacionit, bashkë me fillimin e hapjes së ekonomisë ndaj investimeve private dhe privatizimi

RRITJE PA ZHVILLIM SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

masiv në veçanti i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe privatizimi i tokës në bujqësi, krijuan kushte që ekonomia të futej në një trajektore rritëse gjatë gjithë dekadës së viteve '90, duke përfshiruar vitin 1997. Ritmi mesatar i rritjes gjatë kësaj periudhe ishte 7.3% në vit (grafiku 1) dhe në fund të vitit 2000, Shqipëria kishte arritur të rikuperonte plotësisht humbjen e prodhimit që u shënua gjatë rënies së sistemit⁸⁸. Me këtë tregues, Shqipëria ishte ndër vendet e para të ekonomive në tranzicion që arriti shërimin ekonomik nga trauma e rënies së sistemit komunist. Por, pas një rritje të shpejtë gjatë dekadës së parë, ritmet e rritjes ranë në mënyrë të dukshme.

Grafiku 1: Ritmi mesatar vjetor i rritjes
së PBB-së, 1981-2014



Burimi: Ndërtuar me të dhënat e marra nga World Development Indicators, updated, 2016

Një analizë e hollësishme dhe rigoroze nga pikëpamja metodologjike mbi burimet e rritjes në

⁸⁸ The World Bank, 2002, "Transition: The first ten years - Analysis and Lessons for Eastern Europe and the Former Soviet Union"

KAPITULLI 9 / NJË MODEL SOCIAL TREGU NË
KONTEKSTIN E EKONOMISË SHQIPTAR

Shqipëri është kryer nga një grup i ekspertëve të Bankës Botërore⁸⁹, Robert Solow (MIT) dhe Robert Barro (Universiteti Harvardit). Studimi aplikon metodën e kontabilitetit të rritjes (*growth accounting*) dhe faktorizon ndikimin individual të faktorëve të prodhimit (punës dhe kapitalit) dhe produktivitetit total të faktorëve (ose përfitimet nga përmirësimi i shpërndarjes së burimeve ekonomike). Rezultatet e këtij studimi janë paraqitur në këtë tabelë, (tabela 1) nga ku spikasim disa konkluzione të rëndësishme të tij.

Tabela 1: Llogaritjet e burimeve të rritjes ekonomike
(skenari 1: pa marrë në konsideratë heqjen e stokut të kapitalit të trashëguar nga sistemi mëparshëm).

	Mesatarja vjetore e		Kontributi nga		
	rritjes reale te PBB, %	Rritja e kapitalit	rritja e fuqisë punëtore	Rritja e TFP	Rritja faktoriale
1982-89	2.17	2.2	1.93	-1.97	4.13
1990-92	-15.26	0.47	0.78	-16.5	1.25
1993-03	6.27	-0.05	0.18	6.1	0.13
1993-96	9.25	-0.54	-0.51	10.3	-1.05
1998-01	7.35	0.05	0.56	6.75	0.61
2002-03	5.35	0.78	1.07	3.5	1.85

Burimi: The World Bank group, Country Economic Memorandum, 2004

89 Shqipëria: Ruajtja e Rritjes së Qëndrueshme edhe përtej Tranzicionit, Memorandum Ekonomik i Bankës Botërore për Shqipërinë, Raport Nr. 29257-AL, Dhjetor 2004

Është e dukshme që në epokën e paratranzicionit ishte niveli i kapitalit dhe punës që ndikonte pozitivisht në normën e rritjes, por që alokimi i burimeve dhe efienca e përdorimit të tyre ishin me impakt negativ. Një tezë e mendimit ekonomik thekson se për rritjen ekonomike nuk është aq i rëndësishëm niveli i kapitalit se sa efienca me të cilin përdoret ky kapital ose faktor prodhimi⁹⁰. Për rrjedhojë, është e kuptueshme që me liberalizimin e çmimeve dhe të shkëmbimeve në fillimet e tranzicionit, burimi kryesor që ushqe rritjen ekonomike ishin faktorët e efiençës së përdorimit të faktorëve (TFP). Nga ana tjetër, efekti i veprimt të tij që është e kuptueshme se do të ishte në rënie, nuk ka qenë e mundur të kundërbalancohet nga rritja e përdorimit të faktorëve të rinj të prodhimit, punës dhe kapitalit. Ky është një shpjegim logjik i rënies së normës së rritjes ekonomike përgjatë viteve.

Duke e shtrirë analizën në vitet e dekadës së dytë dhe të tretë të tranzicionit, shqetësimi i mësipërm gjen konfirmim.

90 Në studimet e historianëve të ekonomisë dhe ekonomistëve të zhvillimit, reziduali ishte dhe shpjeguesi kryesor i rritjes ekonomike të ekonomive të vendeve të botës. Ky rezidual identifikohet me një kompozitë të efekteve të forcave të ndryshme, si: (i) përmirësimi në cilësinë e punës nëpërmjet edukimit, eksperiencës dhe trajnimit në punë; (ii) rialokimit të burimeve nga aktivitetet me produktivitet të ulët në aktivitetet me produktivitet të lartë qoftë për shkak të forcave të tregut apo eliminimit të deformimeve të ekonomisë; (iii) shfrytëzimit të ekonomisë së shkallës; (iv) përmirësimit të mënyrave të kombinimit të burimeve për të prodhuara mallra dhe shërbime, jo vetëm në nivel ekonomie, por dhe në nivel fabrike apo ferme. Gerald Mayer, 2001, *The Old Generation of Development Economists and the New*, in *Frontiers of Development Economics: The future in perspective*.

KAPITULLI 9 / NJË MODEL SOCIAL TREGU NË
KONTEKSTIN E EKONOMISË SHQIPTAR

	Rritja e GDP, reale, %	Kontributi nga investimet	Kontributi nga puna	TFP
2000-2008	6.1	3.1	0.9	2.0
2009-2015	2.4	1.3	0.7	0.4
2015-2017	3.4	2.0	0.8	0.6

Burimi: E. Themeli, Albania's growth prospects, 2nd ABB conferences, 2017

Po kështu, duke parë këto prirje në faktorët e rritjes, rritja ekonomike në të ardhmen pritet të ngadalësohet më tej⁹¹, nëse nuk zbatohen politika të nxitjes së kursimeve dhe të investimeve në ekonomi. Ky konkluzion është me implikime mjaft

91 Autoret e studimit të CEM, parashikojnë ekuacionin e mëposhtëm neoklasik të rritjes:

$$y_{ritje_i} = \alpha_0 + \alpha_1 \ln\left(\frac{I}{Y}\right) + \alpha_2 \ln(sec_i) + \alpha_3 \ln(n_i + g + \delta) + \alpha_4 \ln(y_{0,i}) + \varepsilon_i$$


ku *yritje* është niveli i rritjes së GDP reale për frymë gjatë periudhës 1980-2000, *y*₀ është GDP reale fillestare për frymë në 1980, (*I/Y*) dhe *n* janë nivelet mesatare të rritjes së investimeve dhe popullsisë për periudhën 1980-2000, *sec* është niveli mesatar i regjistrimit në arsimin e mesëm për periudhën 1980-96, dhe *g*+ δ (niveli i përparimit teknologjik dhe amortizimit) është supozuar të jetë një nivel i njëjtë prej 0.05 për të gjitha vendet. Niveli mesatar i regjistrimit në arsimin e mesëm është konsideruar ai i periudhës 1980-'96 vetëm për arsye se siç është vënë në dukje edhe më parë, të dhënat e *Treguesve të Zhvillimit Ndërkombëtar* për nivelet e regjistrimit në arsimin e mesëm mbas vitit 1996 nuk janë të krahasueshme me ato të periudhës përpara vitit 1996. Duke aplikuar të dhënat e vendit tonë në këtë ekuacion regresioni, rritja afatgjatë e prodhimit për frymë në Shqipëri rezulton të zbrësë deri në 2.16%. Edhe rënia e ritmeve të rritjes që është vërejtur pas vitit 2010, më shumë se sa ndikimit të faktorëve të jashëm të krizës globale, mendoj se i duhen atribuar shterimit të burimeve të brendshme të rritjes.

RRITJE PA ZHVILLIM SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

të rëndësishme për politikëbërjen dhe përvijon në këtë mënyrë dhe prioritetet themelore të vendit në fokusimin e politikave qeveritare, në masat që nxisin investimet private, të brendshme dhe të huaja, dhe që nxisin inovacionin dhe sipërmarrjen në vend.

Në kontekstin e garës rajonale për zhvillim dhe progres ekonomik, Shqipëria vazhdon të mbetet vendi me të ardhurat më të ulëta, përkundër një rritje pozitive dhe relativisht më të lartë se vendet e rajonit. Siç dëshmohet nga grafiku 2, Shqipëria në vitin 1990 kishte të ardhura për frymë sa 28.5% e të ardhurave të vendit fqinj, Maqedonisë, dhe ka arritur deri në fund të vitit 2014 në 84% të të ardhurave të tij. Por, sërish jemi akoma në vetëm 58% të të ardhurave për frymë të Bullgarisë dhe 34% të të ardhurave të Kroacisë, dy vendet me të ardhura më të larta në rajon, ndërsa ato qëndrojnë në një të tretën në raport me të ardhurat mesatare të vendeve të BE-së.

Grafiku 2: PBB për frymë në vendet e rajonit,
në USD korentë



Burimi: Ndërtuar me të dhënat e marra nga World Development Indicators, updated, 2016

Në përfundim mund të thuhet se tranzicioni ekonomik ka prodhuar efekte pozitive për rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë, porse ruajtja e ritmeve të larta të rritjes, e domosdoshme për të realizuar konvergencën reale me vendet e zhvilluara, kërkon reforma të reja. Rritja ekonomike e qëndrueshme dhe me ritme të larta kërkon politika të reja që stimulojnë inovacionin dhe teknologjitë e përparuara dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, si faktorë të rritjes së produktivitetit dhe zhvillimit. Konkurrueshmëria e ekonomisë sonë është bazuar kryesisht tek faktorët “çmim”, si kostot e lira të punës, taksat e ulëta dhe monedha kompetitive, ndërkohë që vendet e suksesshme, siç na e thotë eksperiencia gjermane flasin për konkurrencë bazuar në teknologji të reja, në kërkim-zhvillim dhe inovacion produktesh dhe procesesh, pra, në konkurrencë që buron nga cilësia dhe jo nga lirësia. Ishte ky drejtim lëvizjeje dhe progresi që e bëri Gjermaninë ekonominë më konkurruese në skenën botërore, edhe pse është një vend “i kushtueshëm”: me paga të larta, monedhë të fortë dhe nivele të larta taksimi.

Ekuiteti i tranzicionit – fitimtar dhe humbës

Nga një shoqëri me pretendime egalitariste, tranzicioni prodhon fitimtarët dhe humbësit e vet, jo domosdoshmërisht të lidhur me kushtet fillestare të nisjes së reformave, proceseve të liberalizimit dhe privatizimit, por edhe për shkak të krijimit të strukturave të reja ekonomike të niveleve të ndryshme të pagave, normave të ndryshme të kthimit

të investimit në edukim, lindjes së një klase të re sipërmarrësish që ndërmarrin rreziqe në kërkim të përfitimeve të larta, etj. Edhe pse një çështje shumë komplekse, pabarazia ekonomike është në thelbin e vet një atribut i zhvillimit ekonomik dhe tipar i tij.

Metoda kryesore e privatizimit që u ndoq në Shqipëri ishte ajo e privatizimit në favor të punonjësve dhe menaxherëve të kompanive, që së bashku me privatizimin e apartamenteve të banimit, pronësonin qytetarët. Kjo do të thotë se prioritet kryesor mbetej barazia më shumë se efienca e ndërmarrjeve të privatizuara. Studimet kanë provuar se metodat e privatizimit që nuk vënë në prioritet shitjen e objekteve investitorëve jashtë ndërmarrjes janë më pak eficiente⁹². Kjo metodë privatizimi rezultoi në struktura të dobëta të qeverisjes së firmave duke krijuar kosto të panevojshme ekonomike pa sjellë ndonjë dobi edhe në aspektin e ekuitetit, siç do të dëshmohej nga rritja e ndjeshme e pabarazive sociale brenda dekadës së parë të tranzicionit.

Megjithatë, pronësimi i banorëve të zonave rurale duke iu shpërndarë tokën bujqësore, bashkë me privatizimin e banesave me një çmim shumë simbolik, ishin një shembull i natyrës sociale të reformave të tranzicionit.

Në kushtet e një papunësie të lartë dhe varfërie masive që karakterizoi shembjen e sistemit komunist, ndërtimi i një sistemi të mbrojtjes sociale ishte një

92 Djankov and Murrell's, 2000, *The Determinants of Enterprise Restructuring in Transition: An Assessment of the Evidence*. Washington, D.C.: World Bank.

prioritetet i dorës së parë. Reforma e mbrojtjes sociale që nisi në vitin 1992 me krijimin e Ministrisë së Punës përfshinte rimodelimin e sistemit ekzistues të sigurimeve shoqërore, themelimin e asistencës sociale, vendosjen me ligj të përfitimeve të papunësisë dhe të shërbimit të punësimit, krijimin e sistemit të sigurimit të shëndetit dhe krijimin e një rrjeti institucionesh për menaxhimin e këtyre programeve.

Sistemi mbrojtjes sociale sidoqoftë ofron një mbulim të kufizuar shërbimesh, që targeton disa nga kategoritë në nevojë si të moshuarit, individët në paaftësi dhe jetimët. Sistemi kontribuohet nga punëdhënësit dhe punëmarrësit dhe siç ka provuar eksperiencia europiane, funksionon mirë sa kohë që kemi një treg pune formal dhe ku individët paguajnë kontributet. Në kontekstin e ndryshimeve demografike si dhe gjendjes së informalitetit të lartë në tregun e punës, skema ka rezultuar thellësisht problematike nga pikëpamja e qëndrueshmërisë financiare.

Edhe pse programet e shpenzimeve sociale thithin një pjesë të rëndësishme të burimeve financiare të buxhetit (rreth 10% të PBB-së), gjendja sociale e grupeve përfituese është e rënduar, me pamundësi për të plotësuar nevojat bazike. Efekti i këtyre programeve në reduktimin e varfërisë mbetet shumë modest ndërsa strukturat e kapitalit social dhe burimet e kapitalit human po degradojnë. Masa e përfitimit ekonomik të grupeve që jetojnë me asistencë sociale bie nën kufirin e linjës zyrtare të varfërisë me 0.3-0.8\$, edhe duke përdorur linjën e 1\$ në ditë për përfitues⁹³.

93 Genc Ruli, Artan Hoxha, Social Business and Social Exclusion in Transition Countries: The case of Albania.

RRITJE PA ZHVILLIM
SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

Nga ana tjetër, skema është shumë e dobët për mbrojtjen e individit, pasi përfitimi ofrohet vetëm për ta që kanë paguar sigurimet sociale në vitin e fundit të tyre të punës. Informaliteti i lartë dhe lëvizjet demografike nga zonat rurale në zonat urbane, bën që të gjithë këto individë të jenë të përjashtuar nga skema.

Studimet nënvizojnë se skemat në tërësinë e vet operojnë me një efektivitet të ulët dhe se mundësitë financiare të qeverisë për të rritur masën e përfitimeve janë të kufizuara. Ndryshimet parametrike nuk do të arrijnë të shëndoshin sistemin dhe ta bëjnë atë të vetfinancueshëm. Ndoshta është e nevojshme që zgjidhjet alternative të vendosin mekanizma mbrojtës brenda familjes, duke i zhvendosur detyrimet për brezin e tretë në nivel individual dhe më të drejtpërdrejtë.

Në përfundim, skemat e mbrojtjes sociale janë financiarisht jo të qëndrueshme dhe në një afat jo shumë të largët, do të krijojnë presione të papërballueshme për buxhetin. Ndryshimet demografike dhe dinamikat e tregut të punës do të kërkojnë korrektive serioze të skemës së pensioneve, të cilat shkojnë përtej ndryshimeve thjesht parametrike. Rikonsiderimi i modeleve që prej fillimit është një ushtrim i nevojshëm dhe sa më shpejt të fillohet aq më pak pasoja do të prodhohen për të ardhmen. Ky është një shqetësim që ka përfshirë shumë nga vendet e kontinentit tonë, përfshirë Gjermaninë, dhe prej ku dhe ne mund të marrim leksione të vyerë për reformim.

Kapitulli 10

VARFËRIA, PABARAZIA DHE DHUNA: NJË LIDHJE QË DUHET THYER

Kur flasim për lirinë, nënkuptojmë lirinë për të bërë një jetë të mirë, një jetë që ia vlen ta jetosh. Mungesa e lirisë është varfëria, mohimi i këtyre mundësive. Por pyetjes se a është varfëria dhunë, filozofët dhe sociologët i japin përgjigje të ndryshme. Një grup autorësh (Audi, Miller etj.) konsiderojnë se injorimi i nevojave të më të varfërve (si karakterizim i varfërisë) nuk realizohet nëpërmjet ushtrimit të dhunës, prandaj dhe varfëria nuk është dhunë. Autorë të tjerë (Holmes, Harris etj.) konsiderojnë se varfëria ka të njëjtat efekte si dhe dhuna, pavarësisht nëse ushtrohet apo jo forcë në raport me nevojat e individit. Përkufizimi që i jepet në këtë rast varfërisë nuk është thjesht si një mungesë të ardhurash, si një pamundësi ekonomike, si një koncept monetar, por si një shfaqje dhe manifestim i padrejtësisë. Pra, në këtë konceptim, varfëri nuk do të thotë të jesh i varfër dhe me pak para, por që sistemi sillet në mënyrë të padrejtë ndaj individëve apo grupeve shoqërore me të ardhura më të ulëta. Po ndalemi pak më gjatë në konceptin e varfërisë dhe përkufizimin e saj, pasi është me rëndësi

dhe implikime jo vetëm politike, por edhe në raportin midis atyre që marrin dhe që japin, përfituesve dhe taksapaguesve.

Paraja luan një rol qendror në raportin e individit me varfërinë, por po aq të rëndësishme janë dhe aspektet jomonetare: shëndeti i mirë, lagje dhe komunitete të shëndetshme në aspektin social, thënë shkurt, një mjedis që minimizon rreziqet e rënies në varfëri për individin. Siç e thotë populli, njerëzit janë të lumtur të gjithë njësoj, ndërsa varfëria përjetohej e ndryshme tek individë të ndryshëm, është funksion i karakteristikave indiosinkratike individuale dhe të familjes. Pra, vetëm një i varfër mund ta përkufizojë varfërinë, të përcaktojë se kur ai quhet i varfër. Për këtë arsye, problemi i parë i rëndësishëm që ka shoqëria është si ta masë varfërinë, një problem global dhe shumë më i mpreshtë, sidomos për vendet e varfra.

Që prej vitit 2002, kur varfëria filloi të trajtohet si një problem ekonomik dhe social në Shqipëri, vija e varfërisë është vendosur sipas standardit që përdor Banka Botërore, me 1 dollarë në ditë për person për varfërinë ekstreme (i rritur në 1.9\$ (sipas paritetit të fuqisë blerëse) në ditë që prej vitit 2015) dhe 2 dollarë për varfërinë relative. Ky nivel i varfërisë është përkufizuar duke marrë për referencë të ardhurat e vendeve më të varfra të Afrikës dhe si i tillë nuk mund të shërbejë si një standard global krahasimor. Ai mund të përdoret për të matur varfërinë vetëm në vendet e varfra, me të ardhura të ulëta, por jo për ekonomitë e vendeve që nuk klasifikohen si të varfra. Çdo vend duhet të ndërtojë matje të përshtatshme për të

përcaktuar vijën kombëtare të varfërisë. Së dyti, edhe kur vendet ndërtojnë një vijë kombëtare të varfërisë, duke qenë se ekonomia është dinamike, duhet që kjo dinamikë të reflektohet edhe në përditësimin e vlerës së këtij kufiri. Nëse Shqipëria përdorte një kufi varfërie absolute prej 1\$ në ditë në vitin 2001, edhe pse sot përdor si vijë varfërie një kufi të përditësuar prej 1.25\$ në ditë, në fakt çmimet e brendshme janë rritur me mbi 45%, që do të thotë se vija e përditësuar e varfërisë nuk e mat saktë nivelin e varfërisë në vend. Trajtimi i problemit të matjes së varfërisë është në të vërtetë një aspekt shumë thelbësor i analizës së fenomenit, prandaj dhe meriton një trajtim të zgjeruar në një punim tjetër, duke qenë se kjo tematikë del jashtë kontekstit të këtij libri. Në këtë çështje vlen të shtohet se vetë përcaktimi i vijës së varfërisë duhet të jetë një proces demokratik, ku të përfshihen aktorët e shoqërisë, ata që marrin dhe ata që japin. Duhet pra, që të hapet një debat kombëtar për të përkufizuar se kush duhet të konsiderohet i varfër dhe ku duhet vënë pragu monetar i këtij klasifikimi⁹⁴. Importimi nga Banka Botërore i një treguesi të tillë me implikime të forta për politikën kombëtare nuk mund të jetë një zgjidhje.

94 Siç e theksuam, Banka Botërore ka konsideruar vijën e varfërisë absolute dhe relative me 1\$ dhe 2\$ në ditë për person, respektivisht. Ky kufi është rritur në vitin 2015 në 1.9\$ dhe 5.5\$ në ditë për person (për vendet me të ardhura të mesme të larta ku bën pjesë Shqipëria). Duke qenë se vlera e një dollari në Shqipëri vlerësohet gati sa 2 dollarë nominal, në terma nominalë kufijtë e varfërisë janë sërish me 1\$ për varfërinë absolute dhe rreth 3\$ për varfërinë relative.

Ndryshimet që shënoi shoqëria shqiptare gjatë këtyre viteve që nga shembja e sistemit komunist, kanë krijuar realitete sfiduese ekonomike dhe sociale. Rënia e sistemit që ishte në krizë me vetveten, shumë shpejt do të prodhonte krizat e reja karakteristike të botës sonë që manifestohen në raport me pasigurinë, varfërinë, dhunën, degradimin mjedisor dhe sigurinë ushqimore, një model tregjesh financiare që aq sa prodhon progres ekonomik, është njëherësh edhe burim pabarazish të thella dhe rrënimi ekonomik për grupe të tëra shoqërore. Shoqëria post tranzicion u karakterizua nga një rritje e shpejtë ekonomike, ku një pjesë e popullsisë u shkëput ndjeshëm nga varfëria, ndërsa një pjesë tjetër mbeti pas në këtë progres. Nëse qytetari mesatar ka shënuar progres të të ardhurave gjatë këtyre tri dekadave, një pjesë e popullsisë vazhdon të mos jetë pjesë e rritjes ekonomike. Në këtë interpretim, varfëria aq sa është një tipar i trashëgimisë nga sistemi komunist, është edhe një rrjedhojë e proceseve transformuese të tranzicionit, një indikator i progresit drejt një shoqërie të zhvilluar.

Arsyeja se përse shoqëria e sotme është më shumë se kurrë e shqetësuar për fenomenin e varfërisë, lidhet sa me ndikimin që ka varfëria dhe pabarazia në rritjen e qëndrueshme ekonomike, po aq edhe për problemet sociale me të cilat shoqërohen këto fenomene. Është gjerësisht e pranueshme se varfëria është shkak i dhunës, se njerëzit që jetojnë në varfëri kanë një probabilitet më të lartë të përfshihen në akte dhune. Në një qasje të tillë sociologjike, një mjedis varfërie do të përkthehej si jetesë në një banesë të

papërshtatshme, në një lagje të varfër, në një familje me probleme të bashkëjetesës. Një mjedis i tillë krijon kushte të përshtatshme për sjellje të dhunshme. Episodet që përcjell media e përditshme tregojnë se dhuna, konfliktet dhe krimet ndeshen kryesisht në familjet me mundësi ekonomike të kufizuara dhe që përgjithësisht janë dhe me një nivel arsimor të cekët. Veçanërisht krimi dhe dhuna tek moshat e reja ndeshen tek individët që vijnë nga familje me prindër të divorcuar, me të ardhura të pakta dhe nivel arsimor të ulët, me prindër emigrantë, etj. Kur analizohen lidhjet midis varfërisë, dhunës dhe krimit, treguesi referues në këto raste është varfëria ekstreme; individët në pamundësi të plota jetese janë kontingjent i fortë i dhunës dhe krimit në shoqëri. Edhe evidencat e ofruara nga institucionet ligjzbatuese në Shqipëri dhe studime të ndryshme tregojnë se divorcet, dhuna në familje, krimi i rrugës kanë si kontingjente individë që jetojnë në kushtet e varfërisë ekstreme, që përgjithësisht shoqërohen edhe me një nivel arsimor të ulët.

Duke u ndalur tek fenomeni i varfërisë në Shqipëri, duhet thënë se ne jemi në tërësi një shoqëri e varfër, ndërsa grupe sociale të caktuara janë në kushtet e një varfërie edhe më të theksuar. Në fund të dekadës së parë të tranzicionit, rreth 1/4 e popullsisë, edhe e matur me standardet më të dobëta të të ardhurave (2\$/ditë për frymë), vlerësohej se jetonte në varfëri ndërsa 1 në 20 persona jetonin në varfëri ekstreme, pa qenë në gjendje të plotësonin nevojat bazike të jetesës (referoju të dhënave të tabelës). Varfëria ishte dominuese

veçanërisht në zonat malore dhe ato rurale, ku mundësitë e jetesës ishin të kufizuara. Po ashtu, ishin të kufizuara aksesit në arsim, shërbime shëndetësore dhe shërbime publike jetësore. Pas një dekade që kur autoritetet shtetërore vendosën luftën ndaj varfërisë si një objektiv të rëndësishëm politik në zbatim të angazhimeve për arritjen e objektivave të mijëvjeçarit (MDG), sërish gati 1 në shtatë individë jeton në varfëri ndërsa varfëria ekstreme është kufizuar ndjeshëm. Sipas të gjitha matjeve vendi ynë rezulton të jetë vendi me përhapjen më të gjerë të varfërisë në rajon dhe me nivelin më të ulët të të ardhurave për frymë. Niveli i pagave është më i ulëti dhe duke qenë se paga është burimi kryesor i të ardhurave të familjeve, kjo shpjegon dhe këtë renditje të përqësuar në raport edhe me fqinjët tanë.

Një nga tiparet e reja të varfërisë që po manifestohet në dekadën e re është se nga një fenomen rural, varfëria është shndërruar në një fenomen i pranishëm në zonat urbane ose periurbane. Studimet gjithashtu tregojnë se një pjesë e madhe e popullsisë është vulnerabël ndaj varfërisë, që do të thotë se ndodhia e një ngjarjeje të caktuar (humbja e vendit të punës, një fatkeqësi natyrore, sëmundja e një pjesëtari të familjes, etj.) do të bënte që varfëria të shtohet. Edhe kriza e çmimeve të prodhimeve ushqimore e vitit 2007 dhe më tej kriza ekonomike e ndikuar nga ajo financiare globale e vitit 2008, bëri që fenomeni i varfërisë në Shqipëri të zgjerohet më shumë. Ka arsye për të besuar se që prej vitit 2012 kur është bërë dhe matja e fundit e varfërisë (*Living Standard Measurement Survey – LSMS*), varfëria

KAPITULLI 10 / VARFËRIA, PABARAZIA DHE DHUNA:
NJËLIDHJE QË DUHET THYER

të jetë zgjeruar shumë më fort, për shkak se një pjesë e rëndësishme e të ardhurave të familjeve që nuk klasifikoheshin si familje në varfëri ishin me burim nga të ardhurat nga emigracioni, një burim që ka shkruar drejt shterimit për shkak të krizës së fortë në Greqi dhe Itali prej ku e kishin origjinën remitancat. Po kështu, industrinë minerare pësuan goditje të forta si pasojë e rënies së fortë të çmimeve të produkteve energjetike dhe mineraleve, gjë që u manifestua dukshëm në rënien e eksporteve. Për pasojë edhe punësimi dhe të ardhurat e punonjësve të këtyre industrive pësuan rënie.

Treguesit e varfërisë sipas rajoneve, %

		2002	2005	2008	2012
Tirana	I varfër	17,8	8,1	8,8	12,1
	Tejet i varfër	2,3	1	0,2	1,6
Bregdet	I varfër	20,6	16,8	12,7	17,7
	Tejet i varfër	3,6	2,3	1,5	3
Qendrore	I varfër	25,6	20,8	10,7	12,6
	Tejet i varfër	4,6	4,9	0,9	2,3
Malore	I varfër	44,5	25,2	25,9	15,1
	Tejet i varfër	10,8	3,1	3,7	1,2
Gjithsej	I varfër	25,4	17,9	12,5	14,3
	Tejet i varfër	4,7	3,3	1,2	2,3

Burimi: INSTAT database

Nga ana tjetër, të varfrit shfaqin një frikë të përhershme ndaj të qenit të dhunuar. Në veçanti, sistemi gjyqësor është pothuaj i paarritshëm për shtresat më të varfra të shoqërisë, e për pasojë ata mund të dhunohen, të shfrytëzohen, të vidhen dhe të jenë krejtësisht të pambrojtur nga sistemi juridik. Studime të kryera nga organizata ndërkombëtare kanë konfirmuar se të varfrit jetojnë larg çdo mbrojtjeje ligjore. Një nga rastet tipike që ilustron këtë tezë është ai i të miturit Ardit Gjoklaj apo Myrvete Duka, të vrarë në landfillin e Tiranës. Siç e nënvizon dhe një raport studimor i kryer në vitin 2012 nga një organizatë ndërkombëtare që eksploron lidhjen midis varfërisë ekstreme dhe dhunës, “Kur e vendosim veten në pozitat për të kuptuar dhe për të mësuar nga viktimat që jetojnë në kushte të tilla, të shfaqet një tjetër realitet: aktet e dhunës që kryhen krahas mohimit të të drejtave themelore, bazike. Deprivimi material i katandis njerëzit në kushtet e mbijetesës; pasiguria i çon familjet drejt shpërbërjes; shfrytëzimi i vjedh individit potencialin e tij; poshtërimi, përjashtimi dhe përçmimi arrijnë një pikë ku njerëzit që jetojnë në varfëri ekstreme nuk konsiderohen si genie njerëzore”.

Por raporti midis dhunës dhe varfërisë qëndron dhe në anën e kundërt: dhuna shkakton varfëri, për shkak se ajo prodhon një mjedis të papërshtatshëm ku njerëzit të investojnë, të zgjerojnë mundësitë për rritje ekonomike më të fortë dhe përmirësim social. Sapo personat sigurojnë të ardhura më të larta, ata largohen nga këto zona të varfra (apo nga vendet e varfra) duke thëlluar edhe më shumë dikotominë midis

lagjeve të pasura dhe atyre të varfra, midis vendeve të pasura dhe atyre të varfra. Siç e thotë nobelisti Deaton, arratisja e disave nga varfëria, lë të tjerët pas, duke bërë që historia e progresit të jetë njëherësh dhe histori e pabarazive. Historia është e pasur me shembuj të vendeve ku mungesa e rendit apo rritja e dhunës, janë bërë shkak i rënies ekonomike, i rrënimit edhe të kombeve të përparuara, si dhe i perandorive të përbotshme. Dhuna bëhet kështu shkak që vendet të bien në 'kurthin e varfërisë' dhe të thellimit të pabarazive midis rajoneve, edhe brenda një vendi. Pasiguritë, dhuna dhe varfëria ekstreme bëhen kështu një zinxhir që duhet shpërthyer.

Në rastin e parë, varfëria është shkak i dhunës; në rastin e dytë, dhuna bëhet shkak i varfërisë. Të dyja këto teza janë të vërteta dhe duhen eksploruar në mënyrë që të ndërtohen politika më të përshtatshme të thyerjes së këtij rrethi vicioz.

Një konkluzion i parë që mund të nxirret është se tranzicioni drejt ekonomisë së tregut është shoqëruar me rritje të varfërisë, siç edhe ka ndodhur në historinë e kombeve të zhvilluara. Varfëria dhe pabarazia janë tregues të progresit të një shoqërie. Në etapat e para të zhvillimit ato thellohen dhe ndërsa fillojnë të bëhen kërcënuese për stabilitetin ekonomik dhe social dhe rrezikojnë të mbajnë një vend të mbërthyer në "kurthin e moszhvillimit", rëndësia e adresimit të këtij problemi me politika dhe institucione bëhet nevojë e dorës së parë.

Duke qenë se varfëria dhe pabarazia janë një binom i pandarë, është vendi të shtojmë disa fjalë edhe për këtë fenomen.

Një pabarazi në rritje është gjithashtu problematike nga pikëpamja e stabilitetit dhe kohezionit social. Nga njëra anë pabarazia është burim frymëzimi për ata që kanë mbetur pas dhe që mund të shohin tek më të pasurit një model se si mund të përfitojnë nga mundësitë që ofron shoqëria e sotme e mobilitetit; nga ana tjetër, një nivel pabarazie i thellë mund të krijojë kushte për destabilitet social, konflikte dhe dhunë. Prandaj trajtimi i pabarazisë është me po aq rëndësi sa dhe varfëria ekstreme në kushtet e një shoqërie demokratike.

Nëse pranojnë parimin e eficiencës Pareto, ku nëse dikush është më mirë dhe ndërkohë që askush nuk bëhet më keq, atëherë shoqëria është më mirë, pyetja është nëse a duhet që shoqëria të shqetësohet për pabarazinë edhe në këto rrethana? Profesori i Harvard-it Martin Feldstesin, për shembull, thekson se pabarazia nuk është një shqetësim i shtruar për zgjidhje. Por, nobelisti Agnus Deaton, me të drejtë thekson se parimi i eficiencës Pareto duhet shtrirë jo vetëm në përmasat e varfërisë ekonomike në terma monetarë, por të mirëqenies në tërësi. Nëse rritja e të ardhurave të një grupi social nuk ndikon negativisht në rritjen e të ardhurave monetare të grupeve të tjera shoqërore, por mund të ndikojë negativisht në aspektet e tjera të mirëqenies shoqërore, atëherë parimi i eficiencës Pareto nuk mund ta justifikojë pabarazinë. Paraja dhe mirëqenia janë dy gjëra të ndryshme. Një dallim duhet bërë gjithashtu edhe për barazinë që krijohet nga rritja e të ardhura të individëve inovatorë revolucionarë, si Bill Gates apo i

ndjeri Stiv Jobs dhe pasurimit që vihet nga bankierët dhe menaxherë korporatash të cilët duke rrezikuar kapitalet e aksionarëve (kursimtarëve), nga njëra anë sigurojnë fitime marramendëse për veten e tyre dhe në rast falimentimesh rrënojnë miliona kursimtarë të vegjël, fondet e pensioneve, etj., duke realizuar kështu një rishpërndarje të pasurisë së paprecedent në historinë njerëzore. Ky është lloji i pabarazive që krijohet nëpërmjet abuzimit të sistemit dhe si i tillë është burim konfliktesh të mëdha sociale.

Historianët dhe ekonomistët kanë argumentuar gjerësisht se një nga arsyet se përse vendet e Lindjes mbetën pas atyre të Perëndimit nuk lidhet me faktin se të parat nuk patën rritje ekonomike. Përkundrazi, rritja ishte shumë e pranishme dhe tek ato, porse pasuria ishte përqendruar në duart e pak sundimtarëve të fuqishëm dhe elitave aristokratike, gjë që nuk krijoi kushte për një rritje të qëndrueshme permanente të këtyre vendeve. Ata nuk lejonin që në këtë lojë të rritjes ekonomike të futeshin dhe inovatorë të tjerë të cilët mund të garantonin një rritje të qëndrueshme. Fatkeqësisht këto shoqëri ishin shoqëri të pabarazive të forta. Kjo është arsyeja që këto vende rriteshin ekonomikisht, por pa mundur të prodhonin qytetërimin që mundësoi zhvillimi ekonomik i botës perëndimore. Historianë të tjerë të ekonomisë shtojnë dhe rolin e edukimit të privilegjuar të kufizuar tek fëmijët pasardhës të këtyre elitave të kohës, duke bërë që pabarazia të vazhdonte të ishte e qëndrueshme

përgjatë kohës. Daron Acemoglu dhe Simon Johnson⁹⁵ evidentojnë një tjetër aspekt të pabarazive: atë të institucioneve, të cilat janë disenjuar të mbrojnë interesat e këtyre grupeve të elitave të pushtetshme, siç ilustron dhe kriza e fundit financiare dhe pabarazia që ajo thellon për të cilën folëm pak më lart.

Një fakt është i dukshëm: pabarazia midis vendeve të pasura dhe atyre të varfra po rritet në mënyrë shqetësuese. Raporti i të ardhurave midis Zvicrës, për shembull, dhe Zimbabves sot është 400:1, ndërkohë që një shekull më parë ajo ishte 5:1. Disa vende jo vetëm që kanë mbetur pas, por po e thellojnë dhe më shumë këtë pabarazi. Frika është se Revolucioni i Katërt Industrial i kohës së sotme të IA (inteligjencës artificiale), të robotikës dhe printerit katërdimensional, të industrive që do të pakësojnë ndjeshëm kërkesën për punë të pakualifikuar dhe nga ana tjetër do të rrisin të ardhurat për ata me kualifikime të larta, do të çojë në rritje edhe më të forta të pabarazive si brenda vendeve, por më shumë midis vendeve të pasura dhe atyre të varfra. Potenciali destabilizues dhe mundësitë për konflikt do të jenë edhe më të shtuara.

Në konkluzion, duhet nënvizuar se shoqëria jonë e sotme është shumë më e pasur se kurrë më parë në histori. Por varfëria vazhdon të jetë një fenomen edhe më shqetësues se kurrë më parë. Në veçanti varfëria ekstreme si një rrezik potencial për fenomenin e krimit dhe të dhunës duhen monitoruar me kujdes nga politikbërësit. Pabarazia si një burim destabiliteti

95 Daron Acemoglu and Simon Johnson, 2005, Unbundling Institutions, (Journal of Political Economy, 2005, vol. 113, no. 5)

KAPITULLI 10 / VARFËRIA, PABARAZIA DHE DHUNA:
NJË LIDHJE QË DUHET THYER

krijon premisa të forta për rënien në varfëri dhe për pasojë dhe për shtimin e krimit dhe dhunës. Shkurt, për të ndërtuar një shoqëri kohezive, një shoqëri me potenciale të një rritjeje të qëndrueshme, varfëria, pabarazia dhe dhuna janë një zinxhir lidhjesh të forta që duhen thyer. Njerëzimi që ka qenë i suksesshëm në menaxhimin e epokave të varfërisë, duhet të jetë po aq efikas dhe në menaxhimin e bollëkut që karakterizon botën e sotme.

Kapitulli 11

PAGAT E ULËTA DHE PAQËNDRUESHMËRIA E SISTEMIT EKONOMIK

Ky kapitull merr shkas nga natyra e modelit ekonomik të tranzicionit që kemi ndërtuar në këto vite, duke kërkuar burimin e konkurrencës së ekonomisë tek lirësia: pagat e ulëta, monedha të zhvlerësuara, burime ekonomike të bollshme dhe me kosto të ulëta, etj. Ky lloj ekonomiksi i lirisisë e ka mbajtur shoqërinë në këtë gjendje të strukturave ekonomike me një produktivitet të ulët, i cili në vetvete ushqen këtë lloj sjelljeje edhe në afat të gjatë, pa mundur të bëjmë kapërcimin e madh të shkëputjes përmes krijimit të strukturave të një ekonomie moderne. Argumenti se pagat përcaktohen nga produktiviteti dhe ekonomia nuk mund të shpërndajë më shumë nga sa krijojmë, prodhojmë, qëndron. Kjo logjikë është e saktë prandaj dhe duhet të rrëmojmë paksa më thellë për të parë nëse çështja është vërtet për shkak të produktivitetit, apo kemi një problem më serioz të natyrës së ekonomisë politike. Prodhimë pak dhe shpërndajmë pak, apo edhe nivelet aktuale të prodhimit mundësojnë që të shpërndajmë më shumë. Që në fillim dua të theksoj se ekonomia jonë më së

shumti vuan nga ky problem serioz, i shpërndarjes, dhe që do përpiqem me aq pak informacione sa kemi ta trajtoj më hollësisht. Nga ana tjetër, për të shmangur çdo keqkuptim të natyrës ideologjike e doktrinore, dua të pohoj se veten time e rreshtoj ndër atë grup njerëzish që e mbështesin dhe e përkrahin epërsinë e sistemit kapitalist dhe të tregut të lirë, që virtytin e tregut që funksionon në kushtet e konkurrencës së lirë e konsiderojnë si shumë më superior se çdo qeveri e virtytshme (nëse gjendet diku në planet një e tillë). Funksioni ekonomik dhe social që luan sipërmarrësi kanë qenë thelbësorë në historinë e progresit shoqëror, siç e dëshmojnë qartë statistikatat që e masin atë dhe mirënjohja e shoqërisë mbetet e pakushtëzuar pasi rreziqet që ata marrin përsipër e kanë çuar shoqërinë deri në kufijtë e sotëm të fanta-shkencës dhe bollëkut material. Por, duke e lexuar me kujdes këtë histori të shkurtër progresi, dhe duke besuar se progresi (ashtu sikurse asgjë tjetër në jetë) nuk duhet marrë si e dhënë, një numër pyetjesh mund të shtrohen. A do të kishte mbijetuar kapitalizmi sikur Britania e Madhe dhe shoqëritë e zhvilluara të perëndimit të mos kishin reformuar sistemin e nxitjeve ekonomike që në fillimet e Revolucionit Industrial? A do të kishte qenë kapitalizmi amerikan aq vibrues sa ta ngjiste këtë vend në krye të progresit njerëzor që prej fillimeve të shekullit XX, nëse që në nisjen e këtij shekulli ish-Presidenti amerikan Ted Rusvelt nuk do të kishte zhbërë monopolet, duke e bërë veprues të famshmin Aktin Antitrust Sherman të vitit 1890? A do kishte qenë bota po kaq paqësore dhe e stabilizuar në planin

social politik nëse kapitalistët do të kishin vazhduar të ndiqnin politika aq agresive të akumulimit fillestar të kapitalit sa ato që ndeshen në fillimet e Revolucionit Industrial, kohën kur Karl Marksi ishte angazhuar aq fuqishëm në kritikën ndaj sistemit kapitalist që në ngjizjen e tij?

Dikush mund të pyesë a ja vlen të shqetësohemi për këto pyetje kur shekujt për të cilët flasim sot ngjajnë si periudhë e antikitetit të lashtë, kur krahasohet me stadin e sotëm të zhvillimit. Shqetësimi im lidhet me qëndrueshmërinë e sistemit, në mënyrën se si funksionojnë sot gjërat në Shqipëri (dhe në fakt dhe në të gjithë botën, por këtë shqetësim le t'ia kursejmë vetes dhe të lëmë mendimtarët e botës që në fakt prej kohësh po shkruajnë për çështjet e kësaj natyre).

Për të ilustruar thelbin e problemit që më shqetëson, po i referohem një rasti individual që mendoj se është i mjaftueshëm për të kuptuar funksionimin e sistemit. Rastësisht lexova bilancin financiar të një kompanie shqiptare të para dy viteve (mendo: bilanci i dorëzuar në zyrat e shtetit të cilat besohet gjerësisht se karakterizohen nga një dozë e lartë e fshehjes së gjërave të vërteta!). Dy shifra më spikatën në mënyrë të dhimbshme: fitimi i firmës (domethënë i pronarit, pasi firmat shqiptare nuk janë aksionere dhe me pronësi të gjerë që shpërndajnë fitime për publikun, përfshirë punëtorët e kompanive) në atë vit kishte arritur në rreth 10 milionë euro, dhe fitimet ishin rritur krahasuar me një vit më parë. Ndërsa shpenzimet për personelin (paga dhe sigurime) ishin vetëm 600 mijë euro, dhe me një rënie shumë të lehtë ndaj një viti më

parë. Mesazhi është i qartë: fitimet rriten, shpenzimet për fuqinë punëtore bien! Për më tepër, shpenzimet për forcën e punës zënë gati 6% të fitimit të pronarit! Kam shfletuar disa bilance të tjera dhe gjetjet e mësipërme janë konsistente: pagat zënë një përqindje shumë të vogël në raport me fitimin e pronarit.

Në teorinë ekonomike këto dy raporte i quajmë norma e kthimit nga kapitali (*return on capital*) dhe norma e kthimit nga puna (*return on labor*). Siç rezulton nga këto të dhëna të bilanceve, norma e kthimit nga kapitali është disa herë më e lartë se norma e kthimit nga puna. Në fakt, edhe në një analizë të statistikave të raportuara nga INSTAT mbi vlerën e shtuar në ekonomi, punësimin dhe pagat, e mbështesin tezën time të mësipërme se pagat janë mbajtur artificialisht të ulëta edhe pse produktiviteti në ekonomi është rritur. Në një analizë me të dhënat e periudhës 2010-2018, rezulton se produktiviteti mesatar në ekonomi është rritur me një ritëm mesatar vjetor prej 7%, ndërsa pagat nominale janë rritur mesatarisht me 3%. Që do të thotë se hapësirat për një rritje pagash të motivuara me rritjen e produktivitetit kanë qenë dhe me të paktën 4% më shumë çdo vit. Hapësirat kanë qenë edhe më të mëdha në sektorë të veçantë, përfshirë dhe industrinë e fasonerisë, me një rritje të mundshme që mund të ishte mbi 7-8%.

RRITJE PA ZHVILLIM
SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

**Tabela 1: Rritja mesatare vjetore e produktivitetit dhe
pagave për periudhën 2010-2018**

Rritja mesatare për periudhën 2010-2018			
	Produktiviteti	Paga mesatare	Diferenca: Rritja e pagës / Produktivitet
1 Të gjithë prodhuesit për treg	7%	3%	-4%
2 Industria nxjerrëse	11%	2%	-8%
3 Ushqime, pije dhe duhan	8%	5%	-3%
4 Tekstile dhe veshje	12%	4%	-7%
5 Lëkurë dhe këpucë	12%	4%	-8%
6 Druri, artikuj me dru dhe mobilie	10%	5%	-5%
7 Letra dhe shtypshkrimet	2%	3%	1%
8 Rafineria, Industria kimike dhe plastike	36%	-2%	-38%
9 Produkte minerale jometalike	3%	1%	-2%
10 Metalet dhe produkte metalike	8%	2%	-6%
11 Industri të tjera përpunuese	4%	2%	-2%
12 Energji elektrike dhe gazi	15%	3%	-11%
13 Furnizimi me ujë	21%	5%	-17%
14 Ujërat e zeza dhe trajtimi i mbetjeve	11%	7%	-4%
15 Ndërtimi	3%	1%	-2%
16 Tregtia dhe riparimi i automjeteve	15%	3%	-12%

KAPITULLI 11 / PAGAT E ULËTA DHE
PAQËNDRUESHMËRIA E SISTEMIT EKONOMIK

17 Tregtia me shumicë	11%	3%	-8%
18 Tregtia me pakicë	11%	7%	-4%
19 Akomodimi	22%	5%	-17%
20 Shërbimi ushqimor	7%	5%	-2%
21 Transporti	4%	2%	-2%
22 Posta dhe magazinimi	3%	3%	0%
23 Aktiviteti i publikimeve dhe prodhimi i programeve	33%	3%	-30%
24 Telekomunikacioni dhe transmetimi i programeve	3%	3%	1%
25 Shërbime të informacionit	-70%	2%	72%
26 Aktivitete të pasurive të paluajtshme	10%	1%	-9%
27 Shërbime profesionale	16%	5%	-11%
28 Agjencitë e udhëtimeve	41%	-1%	-41%
29 Arsimi	10%	3%	-7%
30 Shëndetësia dhe aktiviteti i punës sociale	31%	19%	-12%
31 Shërbime të tjera	31%	8%	-23%

Burimi: Llogaritjet e autorit bazuar në të dhënat e INSTAT

Duke analizuar ecurinë e pagave, që përfaqëson normën e kthimit nga puna, për të njëjtën periudhë, rezulton se pagat në termat realë janë ulur. Nëse paga mesatare e raportuar për të gjithë ekonominë në vitin 2010 ishte 30,395 lekë, në vitin 2018 ajo ishte 38,160 lekë, që e skontuar për një normë inflacioni mesatare 3% në

vit, do të thotë se paga reale në vitin 2018 ishte vetëm 29,247 lekë të vitit 2010. Efektivisht, në terma realë paga për një periudhë pothuajse 10-vjeçare nuk ka ndryshuar fare në fuqinë e saj blerëse, dhe kjo është mënyra se si matet vlera e parasë; sa mallra dhe shërbime blejmë me paranë që kemi në xhep përgjatë kohës.

Pra, nëse për pothuajse 80% të popullsisë të ardhurat reale janë në stanjacion që prej gati një dekade, ndërsa fitimet e kapitalit rriten, atëherë pyetja e natyrshme është se a mund të jetë një sistem i tillë funksional? A është ky lloj kapitalizmi i qëndrueshëm? A do të mund të pranohet gjerësisht nga shoqëria shqiptare që sistemi ekonomik të funksionojë vetëm për një grup individësh dhe të mos arrijë që pjesa më e madhe e shoqërisë të ndryshojnë standardin e jetesës së tyre? Përgjigjja që vjen nga historia është: Jo. Herët apo vonë, tronditjet sociale do të destabilizojnë shoqërinë në një mënyrë të dhunshme, duke sjellë pasoja serioze për shoqërinë dhe të ardhmen e vetë sistemit.

Po pse kapitalisti shqiptar rend pas rritjes së fitimeve deri në ekstrem? Sepse me këto fitime mund të blejë biznese të reja, prona të patundshme, koncesione, - zgjerime horizontale dhe vertikale në industri dhe në ekonomi - duke krijuar një akaparim të jetës ekonomike në limitet e karteleve dhe grupeve "holding", që ngushtojnë gjithnjë e më shumë hapësirat për firma të reja, të vogla por me potenciale rritëse; që ngushtojnë hapësirat e konkurrencës duke krijuar një ekonomi të çmimeve të larta dhe duke përjashtuar kështu grupe të mëdha shoqërore nga konsumi i të

mirave dhe shërbimeve. *“Winer takes it all”*.

Po nëse bizneset do të ndiqnin një tjetër logjikë, atë të rritjes së normës së kthimit nga puna, domethënë, të rrisnin çdo vit pagat dhe shpërblimet për stafin, të investonin në përmirësimin e kapitalit të tyre njerëzor jo vetëm në përmirësimin e aftësive të tyre teknike, por dhe në zhvillimin e dimensionit njerëzor të stafit. Për shembull, çfarë do të dëmtonte në fitimet e kompanisë që solla si shembull, nëse shpenzimet e personelit do të dyfishoheshin? Rënia e fitimit do të ishte krejt e papërfshillshme; një rrumbullakim shifre pas presjes dhjetore. Por efekti pozitiv në ekonomi do të ishte i jashtëzakonshëm. E nëse ky eksperiment shtrihet në të gjithë ekonominë, ekonomia do të kishte një fuqi blerëse dy herë më të lartë. Firmat do të kishin mundësi të dyfishonin shitjet, duke shumëfishuar fitimet e tyre. Këtë bëri Fordi në fillimet e shekullit XX në ShBA, dhe suksesi është i njohur. Një sukses që u imitua dhe që vazhdoi të respektohej deri në fundin e shekullit të kaluar. Shqipëria nuk do të rezultonte me pagat më të ulëta në rajon por do të tentonte të konvergohte me pagat e vendeve në zhvillim.

Është ndarja e madhe sociale që po krijohet nga fillimi këtij shekulli, që bën thirrje për reformim. Të paktën disa gjëra duhet të ndryshojnë në një vend si Shqipëria, ku hendeku social është i thellë dhe varfëria është masive.

Reformimi i modelit – disa ide paraprake

Në një studim që bazohet në matjen e perceptimeve të publikut⁹⁶, si dhe në vlerësimet empirike dhe teorike, është provuar se mënyra e funksionimit të sistemit ekonomik është shumë e anësuar. Me gjithë rritjen ekonomike gjatë tri dekadave të tranzicionit e cila ka prodhuar një farë progresi për shoqërinë në tërësi, grupe të mëdha shoqërore kanë mbetur pas. Ndarja e të ardhurave që krijon rritja ekonomike vlerësohet se ka favorizuar më shumë kapitalin dhe më pak punën dhe rritja e produktivitetit në ekonomi mund të mbështesë nivele më të larta të pagave. Prej këtij buron se ndërhyrja e politikave publike për të garantuar një shpërndarje më të drejtë të ardhurave është mjaft e motivuar. Nga ana tjetër, vetë procesi i krijimit të pasurisë konsiderohet si i padrejtë. Kjo do të thotë se jo vetëm rezultati i ndarjes së të ardhurave, por dhe procesi që e krijojnë atë, konsiderohen si shoqërisht të padrejta. Kjo nënkupton se ka dhe një argument më shumë për politika rishpërndarjeje, të cilat gjejnë mbështetje të gjerë nga të gjitha forcat e spektrave ideologjikë të ndryshëm. Korrektimi i sistemit kërkon reforma serioze në ndryshimin e qeverisjes ekonomike në shumë nivele dhe një rol aktiv të institucioneve publike.

Mbështetja sociale duhet konceptuar jo përmes paternalizmit, por aftësimin të individit dhe

96 Selami Xhepa, Adrian Civici, 2020, OPINIONE DHE QËNDRIME TË PUBLIKUT MBI FUNKSIONIMIN E SISTEMIT EKONOMIK DHE ROLIN E SHTETIT NË SHOQËRI, financiar nga Fondacioni Friedrich Ebert, Tiranë

pavarësisht të tij. Investimet dhe ndërhyrjet publike duhet të synojnë krijimin e mundësive të barabarta në oportunitete, duke rritur veçanërisht investimet për edukimin dhe aftësimin për punë veçanërisht të familjeve në nevojë. Nga ana tjetër, transferimi pasurisë midis brezave nuk duhet të krijojë hendeqe të mëdha midis grupeve shoqërore që në nisje. Rritja e mobilitetit social duhet të jetë një objektiv me rëndësi për politikatat publike.

Proceset e globalizimit dhe progresit teknologjik përbëjnë oportunitete me rëndësi veçanërisht për ekonomitë e vogla si Shqipëria. Ato mundësojnë aksesimin e dijes dhe teknologjive të reja në tregjet ndërkombëtare, duke ndikuar pozitivisht në rritjen e produktivitetit të ekonomisë. Por ato pozojnë njëkohësisht dhe rreziqe për tregun e punës. Kjo nënvizon dhe njëherë rëndësinë e rishqyrtimit të rolit të shtetit dhe politikave më proaktive në krijimin dhe mbrojtjen e funksionimit të tregjeve.

Që ekonomia e nesërme të mos jetë një ekonomi e normave të ulëta të rritjes, produktivitetit të ulët, pabarazive të larta dhe një mjedisi të degraduar, duke lexuar me vëmendje mendimet e publikut dhe leksionet që janë fituar nga provat empirike, po paraqesim disa rekomandime që mund të ushqejnë politikbërjen në vitet që vijnë.

a. Politikatat për kontrollin e proceseve që prodhojnë pabarazi dhe rritje ekonomike jopërfshirëse:

- 1 Ndërmarrja e politikave financiare e fiskale të mirëstudiuara dhe afatgjata kërkojnë më

së pari inovacione institucionale. Themelimi i një **komiteti të politikave fiskale**, si një institucion i pavarur dhe profesional që të garantojë stabilitetin e financave publike. Ai do të vlerësojë programet buxhetore vjetore dhe 3-vjeçare të qeverisë, rreziqet fiskale për angazhimet e ndërmarra nga kontrata të Partneritetit Publik Privat apo forma të tjera koncesionesh apo garancitë e ofruara për projekte të ndërmarrjeve publike; dhe të shqyrtojë çdo ndryshim të politikave fiskale dhe sistemit tatimor në raport me pasojat që krijohen në ndarjen e të ardhurave kombëtare.

- 2. Rregullat e kontabilitetit dhe tatimit mbi veprimtarinë ekonomike** duhen rishqyrtuar me objektivin e ribalancimit më të mirë të shpërndarjes së të ardhurës kombëtare të krijuar. Në veçanti, favorizimet fiskale e tatimore që ofrohen herë pas herë nga legjislacioni, duhet të kushtëzohen me rritjen e investimeve të firmave në përmirësimin e kapitalit fizik dhe atij njerëzor. Specifikisht, përmirësimi i kushteve të punës dhe rritja e të ardhurave të punëtorëve, duhet të jenë një objektiv qendror i çdo përfitimi nga politikat publike apo lehtësie fiskale e financiare. Rishikimi duhet të përfshijë të gjithë legjislacionin për investimet e huaja strategjike dhe lehtësitë dhe privilegjet që ofrohen ndaj tyre, duke mos i kushtëzuar ato

me nivelin e investimit, por me punësimin e mirë, kushtet dhe standardet e punës dhe teknologjisë, sidomos kërkesat e ruajtjes së shëndetit në punë, efektet përhapëse të brendshme (nënkontraktimet dhe furnizimet e brendshme), etj.

3. **Rritja e transparencës së firmave dhe fuqizimi i rolit të audituesve**, bashkë me sistemin e ndëshkimeve në raste certifikimesh të bilanceve jo korrekte. Sistemi i përgjegjësisë për vërtetësinë e deklarimeve financiare duhet të shihet në të gjitha hallkat, që nga punonjësi i autorizuar financiar i firmës, firmat që ofrojnë shërbimet e mbajtjes së llogarive dhe hartimit të bilanceve, te procesi i certifikimit të audituesve dhe deri te roli i audituesit publik dhe Bordit të Mbikëqyrjes Publike. Nivelet shqetësuese të të ardhurave buxhetore përkundrejt një niveli tatimesh normative edhe më të larta se vendet e rajonit, janë dëshmi e shkallës së lartë të evazionit fiskal. Ky evazion ligjërohet përmes veprimtarisë së kontrollorëve dhe audituesve duke prodhuar pasoja serioze për ekonominë.
4. Pasuritë kombëtare të nëntokës dhe mbitokës dhe të gjitha marrëveshjet koncensionare të dhëna në ofrimin e shërbimeve publike, duhet të jenë subjekt i rregullave të veçanta kontabël dhe financiare. Megjithëse Shqipëria

është anëtare e **Iniciativës së Transparencës së Industrive Ekstraktuese (ITIE)**, e cila dikton plotësimin e **standardeve të caktuara të transparencës dhe raportimit financiar**, fatkeqësisht nuk disponohet asnjë dokument zyrtar nëse vendi i ka plotësuar detyrimet e kësaj marrëveshjeje. Duhet që institucionet shtetërore, ministritë përkatëse të detyrojnë firmat plotësimin e çdo detyrimi që burojnë nga këto rregulla, duke i transpozuar ato si rregulla të brendshme ligjore dhe jo si detyrime që vijnë thjesht nga ITIE dhe që duken sikur janë vullnetare. Propozojmë që rregulla të posaçme të transparencës dhe raportimit financiar të shtrihen jo vetëm për firmat që merren me shfrytëzimin e pasurive të nëntokës, por të gjitha marrëveshjet koncensionare që i japin një të drejtë subjekteve private të përdorin asetet publike.

5. Investimi për **edukimin e të rinjve dhe integrimin e tyre në tregun e punës** është një nga prioritetet më absolute për shoqërinë. Sot janë më shumë se 250 mijë të rinj që nuk ndodhen as në bankat e shkollave dhe as në marrëdhënie pune. Kualifikimi tyre me aftësitë për punë dhe integrimi në tregun e punës janë një sfidë serioze parë dhe në kontekstin e një ekonomie të bazuar në standarde më të larta teknike e teknologjike. Gjithashtu, mbyllja për shkak të pandemisë së COVID-19 ka ndikuar në cilësinë e edukimit dhe aftësinë e studentëve

që me gjasa do të lenë gjurmë afatgjata duke ndikuar në të ardhurat e tyre. Forcat politike duhet të ndërmarrin masa kurajoze për financimin e arsimit, ose përmes skemës së taksimit të përgjithshëm, që do të thotë të rikonsiderojnë sistemin tatimor për rritjen e ndjeshme të të ardhurave të buxhetit, ose përmes tarifave më të larta dhe subvencioneve reale për studentët nga shtresat në nevojë. Nga ana tjetër, indikatorët e cilësisë së sistemit arsimor dhe treguesit e performancës së çdo institucioni arsimor duhet të fillojnë të zbatohen në përfitimin e financimeve publike për institucionet publike të arsimit.

6. **Impaktet e ndryshimeve teknologjike** të stimuluar së tepërmi në kushtet e pandemisë së covid-19 dhe perspektivave akoma më të gjera në të ardhmen e afërt në këtë drejtim, duhet të mbahen në konsideratë nga politikat e qeverisë. Rrezikimet e vendeve të punës për shkak të progresit teknologjik kërkojnë një vëmendje të shtuar dhe politikat publike që mbështesin transferime teknologjike dhe inovacione, duhet të favorizojnë punësueshmërinë dhe dimensionin human të teknologjisë (për shembull, politikat e subvencioneve).
7. Roli i sindikatave të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë duhet të jetë shumë më aktiv,

RRITJE PA ZHVILLIM
SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

me synim përmirësimin e dialogut social, artikullimit publik dhe mbrojtjes së interesave të punonjësve.

8. Është e domosdoshme një strategji më aktive për identifikimin dhe hartimin e politikave të duhura nxitëse të punësimit dhe formimit profesional të forcës së punës, me qëllim që të hapen vende pune cilësore që garantojnë të ardhura sa më të larta për punonjësit, si dhe mundësi për aftësi gjatë gjithë ciklit të jetës, si dhe përmirësimin rrënjësor të sistemit të shërbimeve të punësimit dhe arsimit profesional.
9. Shndërrimi i programit të Ndhmës Ekonomike në skemë aktive riintegrimi nëpërmjet krijimit të paketave e masave specifike për krijimin dhe rritjen e mundësive për punësim, duke shtuar përfshirjen në politikat aktive të tregut të punës të përfituesve të Ndhmës Ekonomike.
10. Rritja e eficiencës së skemës së ndihmës ekonomike dhe transformimi i saj nga një skemë pasive në një skemë aktive nëpërmjet programeve të riintegritit dhe kombinimit të tyre me skemat e punësimit nëpërmjet krijimit të lidhjes së qëndrueshme midis skemës së ndihmës ekonomike dhe skemave të arsimit profesional dhe programeve të përgatitjes për punësim me synim fuqizimin dhe aktivizimin e familjes dhe individit në tregun e punës.

11. Në kuadrin e strategjisë dhe politikave të mbrojtjes sociale është e nevojshme që objektivat të jenë sa më të qarta, të mirë-adresuara dhe të matshme, me synim kryesor reduktimin e varfërisë dhe zvogëlimin e ekspozimit të familjeve të varfrave dhe grupeve sociale vulnerabël ndaj rreziqeve dhe goditjeve të natyrave të ndryshme që ndikojnë në nivelin e varfërisë, duke rritur kapacitetin e tyre për të mbrojtur veten nga rreziqet dhe mungesën e të ardhurave, si dhe mbajtjen e një standardi jetese të pranueshëm.
- b. Politika për **korrektimin e rezultateve** që krijohen nga shpërndarja ekonomike.
12. Me qëllim që të krijohen kushte më të barabarta në oportunitetet ekonomike që në nisje, në kushtet e nevojës për një harmonizim e balancim më të mirë në ngarkesën fiskale ndërmjet taksimit të punës, kapitalit dhe pronës, Shqipëria duhet të shqyrtojë me prioritet **vendosjen e tatimit mbi trashëgiminë**. Në të gjitha vendet, taksa e trashëgimisë është një politikë e rëndësishme publike jo vetëm thjesht për qëllime fiskale, por për qëllime më madhore të rishpërndarjes së të ardhurës së krijuar ndër breza dhe zbutjes së diferencave midis brezave në startimin e veprimtarisë profesionale të tyre. Praktikrat që zbatohen janë të njohura: (a) vendosja e një vlere të caktuar si prag përjashtimor për

trashëgiminë të fëmijët, dhe një norme tatimi mbi vlerën e pronës/pasurisë së trashëguar (relativisht të lartë - deri në 40% nga vende të tilla si Britania e Madhe, ShBA, etj.); ose (b) norma më të ulëta dhe me përjashtime shumë të kufizuara (në shumë dhe vetëm brenda familjes së ngushtë).

13. Kuadri ligjor i qeverisjes së firmës duhet të rishqyrtohet për të ribalancuar pushtetin midis aktorëve brenda saj: punëmarrës dhe punëdhënës. Një mori ligjesh që janë prodhuar në mbrojtje të interesave të punëmarrësve, nuk kanë gjetur aspak zbatim, duke konfirmuar se ato janë përshtatur thjesht si pjesë e respektimit të detyrimeve ndërkombëtare, siç janë ato që burojnë nga procesi i integritit European. Është e nevojshme që të nisë një diskutim i madh brenda vendit lidhur me raportet mes punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe se cilat mund të jenë **instrumentet më efikase detyruese që të ruajnë një balancë më të mirë të interesave të palëve**. Inspektoriatet shtetërore që përgjigjen për monitorimin e respektimit të këtyre standardeve të hartojnë raporte vjetore të punës së tyre dhe ato të bëhen transparente për publikun. Mund të konsiderohet edhe kalimi drejt një **certifikate cilësie për firmat që respektojnë standardet e punëtorëve dhe të mjedisit**, si një mënyrë për të nxitur dhe mbështetjen apo ndëshkimin e

publikut ndaj produkteve dhe shërbimeve të firmave.

14. **Legjislacioni mbi pagën minimale** në ekonomi duhet të forcohet. Duhet të kontrollohet rigorozisht nga institucionet ligjzbatuese zbatimi saj dhe masat ndëshkuese në raste të zbulimit të shkeljeve duhen ashpërsuar ndjeshëm. Mund të hartohet dhe një **kod i praktikave për pagesat mbi pagën minimale** bazuar në një dialog kombëtar në Këshillin Trepalësh: punëdhënës-punëmarrës-qeveri.
15. Është e domosdoshme të përcaktohet niveli real i varfërisë dhe minimumit jetik në vend, analizuar sipas nivelit të çmimeve, shportës së konsumit, nivelit të shpenzimeve dhe nivelit të inflacionit, ndikimin e situatës së pandemisë së Covid-19 në thellimin e varfërisë, etj., me qëllim për të vlerësuar drejt kontributin në reduktimin e varfërisë dhe ruajtjes së transparencës mbi shpenzimin e fondeve publike për reduktimin e saj.

Kapitulli 12

EKONOMIKSI I MANIPULIMIT DHE MASHTRIMIT

Më 6 prill 1987, në një konferencë të Organizatës Botërore të Ushqimit (FAO), në Meksiko Siti, Ministrit të Jashtëm të Shqipërisë së asaj kohe, do t'i jepej çmimi i parë për ushqimin. Asokohe, çdo i rritur e kuptonte se vendi po kalonte një nga periudhat më të vështira në plotësimin e nevojave ushqimore për qytetarët dhe kishte filluar të zbatohej një sistem racionimi ushqimor. Në Shkodër, qyteti që e kishte sfiduar gjithnjë sistemin komunist me humorin e vet shpotitës, qarkullonte dhe një barsoletë ironizuese me këtë rast. Kur drejtues të lartë të partisë ishin duke propaganduar përpara popullit për këtë “arritje” të madhe të partisë, dikush nga rreshtat e fundit shpërthen në lot. “Çfarë ke që qan? - pyesin shefat e partisë.” “Po qaj kur mendoj kush e di se ç’heqin ata që kanë marrë çmimin e dytë!” Ironike të mendosh se ç’përmasa irracionale merr propaganda atëherë kur politika/qeverisja gjendet në momentet e saj më të vështira.

Politikanët gënjejnë rëndom dhe detyrojnë edhe të tjerët të gënjejnë në emër të tyre: që nga rishkrimi i historisë, pengimi apo ndalimi i mediave që të raportojnë dështimet e politikave, maskimi i

dështimeve të performancës ekonomike dhe përpjekjet për krijimin e realiteteve virtuale të një mirëqenieje boshe. Shembulli i mësipërm është një rast *in extremis* i propagandës në rrethanat më të vështira dhe të pabesueshme.

Kjo lloj sjelljeje politike duket interesante në këndvështrimin e teorisë së lojës, pasi në kushtet kur mashtrimi apo manipulimi i informacionit nga aktorët politikë duket një sjellje e natyrshme, atëherë publiku që e merr këtë informacion nga politika, duke e ditur se po mashtrohet, duhet ta “skontojë” informacionin dhe t’i përshtatë besimet e tij sipas kësaj norme “skontimi” dhe jo sipas informacionit që i komunikon politika. Përse, pra, duhen bërë gjithë këto përpjekje të sforcuara për të sajuar informacione mashtruese? Në veçanti, kjo duket e pakuptimtë në raport me një lloj audience që është e sofistikuar dhe që, nga ana e saj, ka mundësi ndikimi më të fortë te publiku mbi arritjet apo dështimet e vërteta të politikës.

Në fakt, një mori studimesh empirike nga shkencat e ekonomisë, të psikologjisë dhe të shkencave sociale kanë provuar se, ndonëse jo të gjithë, shumica e njerëzve nuk i përshtatin besimet e tyre duke i skontuar me “normën e mashtrimit”, ashtu sikurse predikon teoria standarde. Zbatimi i metodave eksperimentale në kushte laboratorike ka provuar se njerëzit kanë prirjen të besojnë gjërat që i thonë politikanët. Ata që besojnë në gjithçka që qeveria thotë, kanë një ndikim të madh dhe në sjelljen e atyre që janë të ndërgjegjshëm se po gënjehen, por dhe të atyre që janë burim i vetë gënjeshtërisë.

Gënjeshtat, mashtrimet dhe thashethemet kanë rrënuar sisteme financiare të sofistikuar, kanë devijuar madje dhe rrjedhat e historisë. Libri i Charles Mackay⁹⁷, *“Memoirsof the Extraordinary Popular Delusionsand the Madnessof the Crowd”* është një libër reference i pakrahasueshëm për ngjarjet e mëdha historike që e kanë origjinën te çmenduritë e turmave për shkak të zhgënjimeve nga informacionet e rreme. *“Fakenews”* nuk është një fenomen i ri i epokës sonë; vetëm se sot teknologjia e ka amplifikuar ndikimin e tij në përmasa të rrezikshme për njerëzimin në shkallë globale. Në një vështrim më të fokusuar tek mënyra se si sistemi ekonomik krijon një mjedis të përshtatshëm, vërejmë se mashtrimi dhe manipulimi mund të shndërrohen në qeliza kancerogjene për trupin e shëndetshëm të ekonomisë. Fatkeqësisht, në ekonominë e tregut të lirë njerëzit janë të lirë jo vetëm të zgjedhin, por edhe “të peshkojnë dhe të peshkohen”, një tezë që do ta eksplorojmë në vazhdim.

Në vitin 2015, dy profesorë të mirënjohur të Universitetit të Princeton, Akerlof dhe Shiler⁹⁸ (autorë të librit *“Animal Spirit”*), botuan një libër shumë të veçantë, *“Phishing for Phools”* (Të peshkosh ‘budallenj’), duke na paralajmëruar mbi rreziqet që mund të sjellë për shoqërinë abuzimi me parimet e tregut të lirë dhe motivin e fitimit si motori lëvizës i shoqërisë. Po

97 Charles Mackay, 1841, *Memoirsof the Extraordinary Popular Delusionsand the Madnessof the Crowd*,

98 George Akerlof and Robert J. Shiller, 2015, *Phishing for Phools: The Economics of Manipulation and Deception*, Princeton University Press.

themi si fillim se ky nuk është një libër kundër tregut, përkundrazi, ai na ndihmon të kuptojmë virtytet e tij, por dhe se si duhet të shmangim praktikat abuzuese të tregut si një mënyrë për të shpëtuar vetë tregun dhe virtytet e tij.

"Phishing for Phools" na mëson se ka dy lloj "budallenjsh" që mund të peshkohen: ata që peshkohen përmes informacionit dhe emocionalët. Të peshkuarit nëpërmjet informacionit ka të bëjë me ata që veprojnë mbi bazën e një informacioni që iu është dhënë në mënyrë të qëllimshme për t'i mashtruar. Për shembull, rasti i *"Enron"*, kompanisë më të madhe të energjisë në botë, e cila falimento i vitin 2001, përbën një shembull tipik se si informacioni i rremë dhe praktikat mashtruese "inovative" të kontabilitetit ndikojnë në vendimmarrjen e aksionarëve. Ndërsa sjellja emocionale mund të veprojë ose për shkak të iluzioneve, njësoj si iluzioni optik në fizikë, ose për shkak se emocioni psikologjik vepron mbi arsyen dhe *common sense* të individit.

Ky lloji mashtrimi dhe manipulimi ka pasoja, së pari, mbi pasigurinë e financave të familjes. Duam apo nuk duam, prodhuesit kanë qenë shumë të suksesshëm që të bindin konsumatorët të shesin gjithçka që ata prodhojnë dhe konsumatorët të blejnë më tepër gjëra nga sa kanë nevojë. Ka prova se konsumatorët, për shembull, blejnë makina më tepër nga sa kanë nevojë; apo shtëpi banimi përtej mundësive të tyre. Rezultati: kredia ndaj sektorit familjar ka arritur në nivele shqetësuese. Në SHBA, borxhi i sektorit familjar arrin në më shumë se 130% të

të ardhurave të disponueshme. Domethënë, qytetarët shpenzojnë 1,3 herë më shumë nga sa janë mundësitë e tyre reale. Në vendin me ekonominë më të madhe të botës, falimentimi i familjeve në pagimin e detyrimeve të tyre është i lartë: në vitin 2007, p.sh., 2.7% e familjeve u larguan nga banesat e tyre për arsye të pamundësisë për të paguar këstet e kredive. Statistikat tregojnë se ky fenomen i pamundësisë për të përballuar nivelet e shpenzimeve po rritet ndjeshëm dhe se nivelet e kursimeve të familjeve janë tkurrur si kurrë më parë në histori. Për shembull, libri i Akerlof-it dhe Shiller-it tregon se familja mediane⁹⁹ amerikane nuk ka më shumë kursime mënjanë se të ardhurat mesatare mujore. Për analogji, është si të themi se kursimet e një familjeje mediane në Shqipëri të jenë më pak se 1000 euro.

Kjo na sjell te pasoja e dytë e dëmshme: kërcënimi ndaj stabilitetit makroekonomik dhe financiar. Borxhi konsumator i lartë, bashkë me përfshirjen në sistemin financiar të individëve “të peshkuar nga tregtarët e produkteve financiare toksike”, përbëjnë shkaktarët kryesorë të krizës së fundit financiare të vitit 2008. Në ekonomaksin e krizave përdoret një term i Reinhart-it dhe Rogoff-it, “*This Time is Different*”, shprehje që është e vërtetë, sepse çdo herë janë aktorë të tjerë, produkte të tjera, blerës të tjerë, realitete të ndryshme, etj. Rezultati final është i njëjtë: të gjithë janë të

99 “Mediana” është mesatarja që korrektohet nga ekstremet, për shembull përjashtohen nga llogaritja super të pasurit miliarderë pasi përfshirja e tyre do jepte një mesatare të shtrembëruar, të ndikuar shumë nga të ardhurat e miliarderëve.

mashtruar dhe krizat janë të paevitueshme. E gjitha kjo lojë e tregjeve financiare i ngjan lojës së magjistarit, që e vendos monedhën poshtë njëres nga tri gotat dhe pasi i tollovit ato mbi tavolinë, ju kërkon të gjeni se në cilën prej tyre ndodhet monedha. Në fakt, pasi hapen të tria gotat, monedha nuk është asgjëkund; ajo ka përfunduar në duart e magjistarit. Personat e peshkuar paguajnë një çmim të shtrenjtë për vendimet që kanë marrë mbi informacione të deformuara apo qoftë dhe për shkak të emocionit psikologjik të ndikuar nga fqinji i pasuruar përmes investimeve të tij në derivativë apo letrave të tjera me vlerë për qëllime spekulative. Këto dështime të tregjeve financiare shoqërohen jo vetëm me humbjen e pasurive personale, por dhe me pasoja afatgjata për shkak të depresionit ekonomik, rritjes papunësisë, humbjes së besimit në tregje, etj. Le të sjellim në kujtesë mashtrimin e madh të firmave piramidale në Shqipëri në vitet '90 që sollën ngjarjet dramatike të vitit '97.

Dëmi që shkakton fenomeni "*phishing for phools*" nuk është askund më i dukshëm sesa në shëndetin e njeriut. Sëmundjet e obezitetit, që vijnë për shkak të bollëkut, sot vrasin më shumë sesa pllakosjet e urisë dhe të varfërisë. Trajtimet teurapeutike me bazë hormonesh janë shkaktarët kryesorë të sëmundjeve kancerogjene; reklamat e barnave që tregtohen në mënyrë të pakontrolluar janë shqetësuese. Sot, ushqimi, ilaçet e pakontrolluara dhe të patestuara, alkooli dhe duhani janë kërcënime serioze për shëndetin e shoqërisë. Fatkeqësisht praktikrat e këqija të marketingut po ndihmojnë këtë biznes të

“peshkimit”. Profesor Taleb¹⁰⁰ tregon një histori, kur gjatë fluturimit në një avion të linjës *British Airways*, një xhentëlmën i ulur pranë tij, brenda dy minutash bisede (aq sa për të kërkuar sheqer dhe qumësht për kafënë) i tregoi stjuardesës se ai ishte fitues i Çmimit Nobel dhe president i një akademie të famshme. Stjuardesa, duke mos e ditur se çfarë ishte Çmimi Nobel, u largua duke përsëritur me vete “Çmim Nobel”. Kjo të sjell ndër mend shprehjen se është e vështirë të jesh njeri i madh përballë një pastrueseje hoteli. “Edhe marketingu”, thotë Taleb, “përtej përcjelljes së informacionit, është pasiguri.” Veçanërisht marketingu që përcjell informacion mashtrues për konsumatorin, është diçka tinëzare.

Por si është e mundur që ne konsumatorët marrim vendime që shkojnë kundër logjikës racionale, vendimeve të peshuara sipas logjikës që i referohet ekonomiksi klasik? Në fakt, shkencat e psikologjisë, që prej Frojdit dhe deri tek Kahneman dhe Tversky¹⁰¹, na tregojnë se vendimet tona janë më shumë emocionale sesa mbi baza racionale të analizave kosto-përfitime, të renditjes së preferencave dhe të zgjedhjes së tyre sipas një funksioni të maksimizimit të dobisë dhe minimizimit të kostove etj... Zgjedhjet që bëjmë në supermarket, se sa mollë apo portokalle blejmë, në kushtet e një buxheti të kufizuar (një shembull tipik që jepet në tekstet mësimore të ekonomiksit), gjen

100 Nassim Nicholas Taleb, 2015, *Antifragile: Things That Gain from Disorder*, Random House Publishing Group

101 Shih, për shembull, Daniel Kahneman, 2012, *Thinking, Fast and Slow*, Farrar, Straus and Giroux

zbatim në këtë rast apo në situatë të ngjashme si kjo. Por nuk është ky rasti tipik i sjelljes së konsumatorit në shumicën dërrmuese të vendimeve të tij të blerjes. Ekonomisti institucionalist Thorstein Veblen¹⁰² e kishte anashkaluar këtë hamendësim themelor të teorisë ekonomike të ndërtuar nga neoklasikët që në fundin e shekullit XIX. Studiuesit e psikologjisë rendisin një sërë arsyesh pse njerëzit janë të “peshkueshëm”: duan të shkëmbejnë dhurata dhe favore; duan të jenë të mirë dhe të sjellshëm me ata që kanë për zemër; nuk duan t’i kundërvihen autoritetit; duan të ndjekin të tjerët kur vendosin se si të sillen; duan që vendimet e tyre të jenë së brendshmi të qëndrueshme; dhe i shmangen mundësisë për të humbur.

Edhe kur vendimet merren në mënyrë racionale, tregu i lirë, siç e thamë, ofron jo vetëm lirinë për të zgjedhur, por dhe lirinë për të “peshkuar” individë, në kuptimin e shitjes së produkteve apo shërbimeve të panevojshme, atyre që shkojnë përtej mundësive reale të individit, apo shitjes së produkteve “fake” që rrezikojnë shëndetin e individit, etj. Mendoni pak mashtrimin vetë kur blini një shërbim, p.sh. nga një bankë apo kompani e shërbimit celular? Kur merrni një kartë krediti apo një shërbim financiar, apo një paketë shërbimesh interneti? Sa herë ndodh që banka të keqpërdorë fuqinë e vet asimetrike në dëm të interesit të klientit, për shembull, duke mos pranuar apo duke shtyrë në kohë me muaj anulimin e kartave të kreditit, ndërkohë që klienti detyrohet të paguajë edhe pasi ka

102 Thorstein Veblen, 2007, *The theory of the leisure class*, Oxford University Press.

shprehur vullnetin për të mbyllur një kontratë, duke sajuar komisione për shërbime apo duke ndryshuar termat e një kontrate kredie në mënyrë të njëanshme dhe pa alternativa të tjera zgjedhjeje nga klienti, etj. Sa individë e kanë gjetur veten të mashtruar nga email-e që joshin individë për miliona euro apo dollarë që janë gati të transferohen në llogarinë e tyre, mjafton të paguajnë një tarifë për kostot administrative të procesimit të pagesave. Sa telefonata shqetësuese bien çdo ditë në aparatit tuaj duke ju shpjeguar se jeni përzgjedhur si fitues i një shorti për të blerë një pajisje (çfarëdo) të klasit të parë, me një ulje çmimi të paimagjinueshme; apo reklamat që përdorin imazhin e disa të moshuarve për të reklamuar përfitimet e përmirësimit, të kuptojmë se përdorimi i disa ilaçeve, të cilat me një kërkim të thjeshtë në internet, shikohet se tregtohen vetëm në Shqipëri. Lista e mashtrimeve të qëllimshme që i bëhen individit shtohet gjithnjë sa më inovative dhe të sofistikuar bëhen tregjet. Ne akoma nuk kemi tregje financiare të zhvilluara, por mashtrimi që bëjnë platformat elektronike të tregtimit të parave kanë marrë një përhapje të gjerë. Me gjithë paralajmërimet e herëpashershme që ekspertët bëjnë nëpërmjet mediave, sërish plot individë bien pre e mashtrimeve të firmave të tilla. Sillni në kujtesë stilin që përdorte “Ujku i Wall Street” për të gjetur blerës letrash me vlerë për gjoja projekte marramendëse konglomeratesh gjigante, kur në fakt kompania ishte një kioskë e braktisur diku në një zonë të pabanuar!

Episodet që shtjelluam deri tani tregojnë qartë se shoqëria ka nevojë për më tepër mbrojtje nga

"peshkatarë" të tillë. Rregullat e marketingut mbi reklamën dhe shitjet promovionale, veçanërisht me teleshitjet, duhen rishkruar. Penalitetet për abuzuesit me sistemin duhen rritur, por më shumë duhet të synohet rritja e probabilitetit të kapjes së përdoruesve të praktikave të tilla mashtruese. Pra, institucionet rregullatore dhe mbikëqyrëse të tregut duhen forcuar dhe mbështetur me burime të mjaftueshme për të kryer më mirë këtë detyrë. Individit e ka të pamundur të mbrojë vetveten përballë këtij fenomeni. Ndoshta duhet të mendohet dhe për një lloj disipline të re "*economics for the disabled*", për ata që janë më vulnerabel, pre e praktikave të tilla, siç janë të moshuarit dhe individët apo familjet më pak të arsimuara. Këshillimi financiar duhet të përhapet më gjerësisht mes popullsisë. Veçanërisht në temat që lidhen me menaxhimin më të mirë të portofolit financiar të familjeve, duke alokuar më shumë kursime për moshën e pleqërisë, apo për të përballuar situata të caktuara që burojnë nga pasiguritë e tregjeve.

Tregjet e lira janë si një thikë me dy presa: ato veprojnë në mënyrë tepër efikase kur nuk abuzohen; por krijojnë hapësira të mëdha abuzimi për mashtruesit nëse lihen pa rregullimet e nevojshme institucionale. Biznesi dhe profesioni (mjekët, ekonomistët, financierët, bankierët, inxhinierët, etj.) kanë nevojë për rregulla etike. Ekonomiksiti i duhet shtuar më shumë etikë dhe më pak doza pozitivizmi.

Kapitulli 13

“SHKATËRRIMI KRIJUES” SI
PROTESTË NDAJ STABILITETIT
ASFIKSUES

Në veprën e tij *Kapitali*, Karl Marksi kishte shkruar se “shkatërrimi i dhunshëm i kapitalit nuk vinte nga marrëdhëniet që buronin nga jashtë sistemit, por si një kusht për ruajtjen e vetvetes”. Domethënë, shkatërrimi i kapitalit ishte një nevojë e brendshme për lulëzimin e sistemit kapitalist. Por ekonomisti që do të bëhej Profeti i Inovacionit ishte austriaku Joseph Schumpeter me librin e tij “*Kapitalizmi, socializmi dhe demokracia*” (1942). Në këtë vepër ai do të përkufizonte për herë të parë termin e shkatërrimit krijues si një proces ku teknologjia dhe inovacioni krijojnë mënyra të reja të të bërit të gjërave, duke zhdukur të vjetrën. “Që sistemi të përmirësohet, disa gjëra duhen shkatërruar”, është mesazhi i veprës së tij. Biznese, produkte, industri, mënyra prodhimi dhe sisteme organizimi zhduken dhe specie të reja lindin. Inovacioni teknologjik në epokën tonë vetëm se e ka përshpejtuar këtë proces, duke ia shkurtuar dhe më shumë jetën së vjetrës. Aq shumë e ndjeshme është kjo shpejtësi e përmbyesjeve të mëdha, sa edhe bota para viteve 2000 në shumë drejtime duket histori.

Në parantezë: Ka një diskutim interesant në librin

Antifragile: Things that gain from disorder të Nasim Taleb lidhur me faktin se kush e ka pagëzuar emrin "shkatërrim krijues". Sipas Taleb, ishte Niçe te *Lindja e Tragjedisë* që e ka përdorur në referencë të Dionisit, të cilin e quante "krijimtarisht shkatërrues" dhe "shkatërrimtar krijues". Dy forcat që vihen përballë në këtë vepër janë ato apoloniane dhe dionisiane: njëra simbol i të qenit i matur, i balancuar, racional, mishërim i arsyes dhe vetëpërmbajtjes; tjetri i errët, i thellë, i egër, xanxar, i vështirë për t'u kuptuar, i dalë nga rrathët periferikë të vetvetes. Niçe, sipas Talebit, kishte kuptuar se rritja e dijes – dhe e gjithçkaje tjetër – nuk mund të vijonte pa forcat dionisiane.

Shembulli që sjell Schumpeter është ai i hekurudhës në *Illinois Central Railroad*. Sa më shumë që hekurudha zgjerohej, aq më shumë rritej prodhimi i trenave, zgjerohej gama e mallrave që transportoheshin me hekurudhë, lindnin qytete dhe zona të reja të banuara. Por kjo u shoqërua me zhdukjen e disa formave të sistemeve bujqësore në Midwest. Një mënyrë e tërë jetese u shkatërrua; puna në fermë u shndërrua nga një traditë historike e të ushqyerit të familjes, në një industrializim të aktivitetit bujqësor. Në fakt në të gjithë botën e zhvilluar sot bujqësia nuk përbën më mënyrë jetese, por thjesht një degë të industrisë. Këto cikle të hopit teknologjik ndeshen çdo pesëdhjetë apo njëqind vjet. Nëse bumi ekonomik i shekullit XIX dedikohet industrisë tekstile, hekurit, qymyrit dhe motorit me avull, bumi i mesit të shekullit XIX i dedikohet çelikut dhe ndërtimit të hekurudhave; ai i fillimit të shekullit XX i dedikohet prodhimit të

makina dhe energjisë; ky i shekullit ku kemi hyrë i dedikohet ICT dhe industrive të lidhura me të.

Schumpeter ishte një ekonomist i shquar që arriti të ndërtojë një teori po aq madhore, sa dhe Marksi. Por, nëse Marksi shihte klasën punëtore në qendër të krijimit të vlerës në ekonomi dhe proletariatin si agjentin që do të ndryshonte historinë e shoqërisë nëpërmjet revolucionit proletar, Schumpeter shihte sipërmarrësin në qendër të sistemit ekonomik kapitalist dhe progresit shoqëror. Aq i drejtë ka qenë ky parashikim i Schumpeterit, sa në librat e sotëm të biznesit, historia (figurativisht) do të ndahet sipas një kalendari që ndan periudhën historike para dhe pas Bill Gates. Motivi që qëndron pas rendjes drejt inovacionit është vullneti për të krijuar një perandori të vetën, nënvizon Schumpeter. “Ata nuk janë persona delikatë apo finë; shpesh ata janë shumë të vrazhdë, por duan ta sulmojnë botën në një mënyrë të caktuar. Aventurierët e dikurshëm, kapitalizmi i shndërroi në shpirtra kalkulues”.

Në një shkrim të Lawrence Summers dhe DeLong¹⁰³ të para pak kohësh shkruhet se “ekonomia e së ardhmes me gjasa do të jetë ‘schumpeteriane’”, ku motori i krijimit të pasurisë do të jetë inovacioni. Pikërisht prej këtij udhëhiqet rritja ekonomike dhe pasurimi i kombeve. Normat e fitimeve në bizneset

103 J. Bradford DeLong and Lawrence H. Summers, 2001, The ‘New Economy’: Background, Historical Perspective, Questions, and Speculations, Federal Reserve Bank of Kansas City’s symposium, “Economic Policy for the Information Economy,” at Jackson Hole, Wyoming

inovatore janë të ngjashme me fitimet monopoliste dhe për pasojë ato krijojnë industri me fitime lukrative. Produktet sot janë më shumë ide sesa kosto materiale dhe për pasojë mundësia për krijim monopolesh natyrore është shumë e lartë - derisa një inovacion tjetër ta shkatërrojë atë produkt. Prandaj sot kemi probleme shumë më të vështira nga pikëpamja e rregullimit të industrive. Vetëm disa ditë më parë Google u ndëshkua nga Komisioni Europian për abuzim në tregun e reklamave. Pak operatorë sot dominojnë në industritë farmaceutike, të teknologjive të komunikimit, etj. Shumë debate zhvillohen sot, për shembull, lidhur me dëmet që i sjell një euro e fortë ekonomisë së sotme europiane. Për shkak se në raport me dollarin apo monedhat e tjera botërore euro kishte ruajtur një vlerë shumë të lartë përgjatë gjithë viteve 2000, disa ekonomistë kanë fajësuar pikërisht euron e fortë si shkak të dobësive të ekonomisë europiane. Por, në fakt, eksportet gjermane kanë shënuar ritme rritje shumë të larta në të gjithë sektorët; Gjermania ka vazhduar të jetë eksportuesi më i madh botëror pas Kinës. Arsyeja? Produktet gjermane janë produkte që bazohen në teknologji inovative dhe për pasojë çmimet e tyre nuk janë të ndjeshme në raport me çmimin e parasë.

Duke dëshmuar para Kongresit, ish-Guvernatori legjendar i FED-it, Greenspan, thoshte se "përshpejtimi i dukshëm i procesit të shkatërrimit krijues që ka shoqëruar industrinë inovative dhe që është reflektuar në zhvendosjen e kapitalit nga industrinë e dështuara në ato që kanë arritur në caqet e teknologjisë, ka qenë

i jashtëzakonshëm". Por, mikroprocesori, fibra, laseri, teknologjitë e satelitit dhe optike dhe teknologjitë e informacionit për të cilat bënte fjalë Greenspan gati një dekadë më parë, sot ngjajnë industri të saturuara dhe gjenerata të reja teknologjish të inteligjencës artificiale janë në aplikime gjithnjë e më masive.

Pikërisht prej këtej merr shkas edhe ajo që thonë Summers dhe DeLong: ata e ngrenë shqetësimin në kontekstin e rritjes sekulare në të cilin ndodhet sot ekonomia botërore, një rritje e ngadaltë problematike. Rritja schumpeteriane nuk është gjë tjetër veçse një rritje e udhëhequr nga industritë e reja inovative, të cilat duke gjeneruar norma të larta fitimi do të ushqejnë dhe më shumë inovacion. Industritë me norma të larta fitimi nxitin një proces të rritjes së çmimeve të letrave me vlerë duke nxitur një rritje të investimeve. Nga ky proces burimet ekonomike do të rialokohen dhe më me forcë nga industritë inefficente drejt industrive të reja. Me fjalë të tjera, procesi i inovacionit do të jetë dhe më tronditës nga pikëpamja e stabilitetit ekonomik në vitet që vijnë.

Procesi i inovacionit është njëherësh dhe burim i destabilitetit në ekonomi, prandaj dhe ekuilibri ekonomik për të cilin flitet në modelet e teorisë ekonomike, në fakt, është thjesht një fotografim momental i gjendjes së ekonomisë; gjendja e natyrshme e saj është destabiliteti. Tronditjet që krijojnë teknologjitë e reja në botën ekonomike dhe sociale, e prishin qetësinë dhe gjendjen statike. Në vitin 2009, një programues kompjuterësh, Garret Camp, themeloi kompaninë *UberCab*, që do të krijonte një model krejt

të ri në biznesin e shërbimit taksi. Sot më shumë se 100 milionë persona përdorin këtë formë shërbimi, i cili, duke aplikuar një politikë dinamike të formimit të çmimit, krijon kursime për përdoruesit, por edhe racionalizon burimet ekonomike, që nga karburantet, konsumi i makinave, etj. Sigurisht që kjo ka dëmtuar interesat e biznesit tradicional të shërbimit taksi që mund të vijë duke u tkurrur akoma dhe më shumë. IBM nuk do të kishte mbetur në treg nëse nuk do ta kishte kuptuar në momentin e duhur largimin nga biznesi i vjetër dhe krijimin e linjave të reja të biznesit. IBM do të ishte harruar siç janë harruar emra dikur të famshëm, si Compaq, MCI Worldcom, Pan Am, Kodak etj.

Schumpeter na përcjell dhe një mesazh tjetër të rëndësishëm me veprën e vet: mekanizimi i inovacionit nëpër laboratorët e korporatave rrezikon të zhdukë sipërmarrësin dhe, për pasojë, dhe suksesin mbi të cilin qëndron triumfi i kapitalizmit. Profesori i Harvardit Clayton Christensen pohon se ajo që ndodhi në Japoni ishte pikërisht ajo që Schumpeter kishte paralajmëruar. Megjithatë, evidencat e deritanishme janë kundër kësaj hipoteze. Kapitalizmi dhe sipërmarrja, shpirti sipërmarrës dhe aventurier i biznesit janë zgjeruar edhe më shumë. Numri i *start ups*-eve që veprojnë në industritë e reja inovative janë në rritje në të gjithë botën e zhvilluar dhe brezi i ri, që vjen i familjarizuar me këto teknologji, gjeneron ide edhe më 'të çmendura' se ato që janë zhvilluar. Sidoqoftë, rreziku i rutinizimit të inovacionit duhet kuptuar si një thirrje për të krijuar dhe mbështetur

një infrastrukturë të përshtatshme për sipërmarrje në mënyrë që procesi i shkatërrimit krijues të mos ndalojë.

Në fakt, këtu duket se merr shkas dhe shqetësimi që dëshiroj të ngre në këtë pikë: mungesa e sipërmarrjes inovatore, e manifestuar në strukturat ekonomike problematike për vendin tonë. E shtjelluar pak më hollësisht si më poshtë:

Brezi më i moshuar ishte mësuar ta shihte krijimin e një industrie të rëndë me oxhaqe të larta që tymosnin qytetet. Mbi to shkruhej me germa të mëdha: “Tymi është simboli i triumfit tonë”, duke përcjellë kështu idenë e krijimit të një industrie të rëndë si bazë për modernizimin e vendit. Sot oxhaqet dhe tymi janë thjesht simbole të katastrofës mjedisore, ndërsa ekonomia që nuk nxjerr më tym dhe që nuk ka uzina dhe fabrika masive prodhon 4 herë më shumë mallra dhe shërbime, ndërsa të ardhurat për frymë sot janë dyfishuar në çdo dekadë që prej rënies së sistemit komunist. Oxhaku, që ishte simbol i protestës së bujqësisë së zhdukur, sot është gjithashtu simbol i protestës ndaj degradimit mjedisor dhe ndotjes, fenomene që duke shkaktuar ndryshimet klimatike në përmasa shqetësuese, po shndërrohen në kërcënim për vetë të ardhmen e planetit tonë.

Përtej këtij ndryshimi të madh strukturor pozitiv për ekonominë tonë, risitë teknologjike dhe organizative dhe inovacioni në ekonomi nuk kanë arritur të krijojnë tronditjen e madhe të sistemit dhe ndryshimin e *status quo*-s. Statistikat tregojnë se eksportet e produkteve me bazë teknologjike

nga vendi ynë pothuajse nuk ekzistojnë; investimet e firmave shqiptare në teknologji dhe *know how* dhe përdorimi i teknologjisë për modernizimin e praktikave të organizimit dhe drejtimit të biznesit, janë shumë modeste. Treguesit e konkurrencës që matin shkallën e sofistikimit teknologjik të bizneseve dhe inovacionin që botohen në Raportin Global të Konkurrueshmërisë, e rendisin vendin tonë në fund të listës. Bizneset e mëdha të vendit vazhdojnë të mbeten të orientuara drejt aktiviteteve tregtare, të tregut të ndërtimeve dhe të shfrytëzimit të pasurive natyrore të vendit, por nuk kemi firma që veprojnë në fushat e zhvillimit të teknologjive apo edhe në aplikime të caktuara inovative të teknologjive ekzistuese. Duket se në Shqipëri ka ndodhur vetëm procesi shkatërrues i së vjetrës, por akoma nuk kemi krijuar një raport familjar me industrinë dhe ekonominë e dijes së epokës sonë.

Si vjen protesta e sotme në raport me ekonominë? Mendoj se ajo është një mospranim i një ekuilibri të dobët institucional të krijuar përgjatë viteve dhe shprehje e nevojës për të krijuar një mjedis të ri, me institucione funksionale, veprim të shtetit ligjor dhe rregullave të një konkurrence të ndershme në treg. Do të ishte një kosto më e madhe për shoqërinë nëse në emër të një stabiliteti asfiksues ekonomik, protesta qytetare do të fashitej. Revolta e studentëve, për shembull, solli një debat të ri për një riformatim të arsimit të lartë; revoltat e përsëritura të fermerëve do të detyrojnë qeverinë të gjejë një balancë më të drejtë në raportet e interesave të fermerëve, tregtarëve dhe konsumatorëve; protestat e mjedisorëve kanë detyruar

qeverinë të prapësohet nga një sërë projektesh me impakt mjedisor; protestat politike nuk ka dyshim se do të sjellin një përmirësim të sistemit politik në vend dhe krijimin e një kuadri të ri institucional ku sipërmarrja private të zhvillohet në një normalitet të ri. Një ekuilibër i ri më i lartë institucional do të shfaqet që të mund të krijojmë premisa të reja pozitive për të nxitur një shpirt të ri të shkatërrimit krijues.

Meqenëse agjenti kryesor i ndryshimit që kam përdorur në këtë shkrim është sipërmarrësi shkatërrues, po e mbyll me nevojën emergjente që ka shoqëria jonë për të nxitur krijimin e shpirtit sipërmarrës. Bota sot është e mbushur me likuiditet. Ajo që mungon për ta shndërruar atë në projekte janë idetë inovatore dhe individët që kanë jo vetëm talent, por dhe që marrin përsipër rreziqet. Propozimi i Taleb-it që bota duhet të ketë një ditë në kalendarin e vet që të quhet Dita e Sipërmarrësit më duket shumë e gjetur, si dhe motivi që shoqëron këtë propozim:

“Shumë prej jush do të përfundojnë në dështim, të parespektueshëm dhe në varfëri, por ne ju jemi mirënjohës për rreziqet që keni marrë dhe sakrificat që keni bërë për hir të rritjes ekonomike të planetit dhe të nxjerrjes së njerëzve nga varfëria. Ju jeni burim i antifraxhilitetit. Kombi ynë ju është mirënjohës.”


Kapitulli 14

VEPRIMI POLITIK PËRBALLË IDEOLOGJISË

Thuhet se termi *e majtë* dhe *e djathtë* u atribuohet francezëve në periudhën e ngjarjeve revolucionare të shekullit XVIII, kur sapo ishte rrëzuar monarkia. Teksa lexoheshin projektligjet dhe hidheshin për miratim, deputetët ftoheshin të uleshin sipas këtij rendi: në të majtë deputetët që përkrahnin ligjet dhe kishin qëndrime radikale kundër monarkisë, ndërsa në të djathtë ata që ishin më tradicionalistë, më konservatorë dhe jo përkrahës të ndryshimeve revolucionare. Ndoshta prej kësaj historie të së majtës dhe së djathtës, Churchill-i, Clemenceau-ja dhe Lloyd George, u atribuohet (sipas rrethanave të referuesit) të kenë thënë se *“gjithkush që nuk është socialist deri në moshën 20-vjeçare, nuk ka zemër; ndërsa gjithkush që është ende socialist pas moshës 40-vjeçare, nuk ka kokë”*. Që prej kësaj kohe, të djathtët identifikohen si konservatorë dhe mbështetës të traditës, të familjes, pronës dhe lirisë individuale, ndërsa të majtët si revolucionarë ose më progresistë, siç identifikohet në fjalorin politik amerikan.

Përtej kësaj ndarjeje të madhe historike, në jetën politike të partive të kohës së sotme që garojnë në fushata elektorale, vështirë se gjenden ndarje të qarta

ideologjike të së majtës dhe të së djathtës. Teoria politike e demokracisë përfaqësuese, *Teoria e Votuesit Median*, e shpreh qartë se interesi i maksimizimit të votës (sjellje racionale sipas interesit vetjak), i shtyn polet politike të dy krahëve të shkojnë drejt votuesit median, siç tregohet dhe në grafikun më poshtë. Ky grafik tregon qartë faktin se në botën e sotme identitetet ideologjike të partive politike janë përzierë, duke krijuar zhargone të reja politike, si “e majta e qendrës”, “e djathta e qendrës”, ku përgjithësisht renditen dy forcat kryesore politike, të majta dhe të djathta, ndërsa aleancat e tyre elektorale përfshijnë deri edhe format më ekstreme ideologjike të majta apo të djathta. Nevoja për të arritur votuesin median bën që liberalët të jenë të detyruar të shkojnë drejt pikës M në grafik, po ashtu dhe konservatorët. Nëse konservatorët kapin vetëm votuesin deri në segmentin S, atëherë pushteti do të kalonte te liberalët.



Kjo teoremë e votuesit median shpjegon në një masë të madhe përse njerëzit janë mërëzitur me politikën.

Ata shpesh nuk arrijnë të gjejnë dallime të pastra mes forcave politike garuese. Sot nuk gjen politikan që t'i ketë mbetur besnik ideologjisë; politikanë të tillë i kanë mbetur historisë (ish-kandidati për president i SHBA-së në vitin 1850, Henry Clay, është shprehur: "Zotëri, do të preferoja të isha në anën e së drejtës më tepër sesa të isha president").

Le të ndalemi në veprimin politik shqiptar për të kuptuar identitetet politike të së majtës dhe të së djathtës. Kryeministri i Shqipërisë, Rama, në një takim me shoqatat e biznesit italian në Romë, u është drejtuar investitorëve të zgjedhin Shqipërinë për të investuar, sepse (midis të tjerave) nuk ka sindikata. As Margaret Theçer, e cila ka zhvilluar një nga "betejat" më të famshme ndaj sindikalistëve britanikë të minierave të qymyrit, nuk ka guxuar ndonjëherë të artikulojë një shprehje të tillë. Artikulimi i kryeministrit shpreh një tezë që mund t'i shkonte për shtat një të djathtë ekstreme, por kurrë një force politike të majtë, siç është Partia Socialiste. Nga ana tjetër, kryetari i opozitës së djathtë, z.Basha, në një fjalë përpara sindikalistëve bëri një premtim që programi qeverisës i së djathtës do të vendosë me ligj pagën minimale në Shqipëri, në mënyrë që interesat e punëtorëve të mbrohen më mirë përpara kapitalit. Edhe pse duhet thënë se kjo masë ekziston në më shumë se gjysmën e vendeve anëtare të BE-së dhe në shumë shtete në SHBA-ve, propozimi i kësaj mase nga e djathta është kundërdoktrinare. Teoria e votuesit median e shpjegon më së miri këtë lëvizje politike – nevoja për të kapur votat e punëtorëve që janë pjesa më e madhe e votuesit në vend.

Agjenda e qeverisë sonë socialiste shkon dhe më tej në të njëjtat linja me thaçerizmin dhe reganoekonomiksin, e evidentuar në fushën e privatizimeve dhe *partneritetit publik-privat*. Privatizimet e gjithanshme të utiliteteve dhe shërbimeve në të gjithë sektorët ekonomikë (transport, energji, furnizim me ujë etj.), bashkë me lindjen e formave moderne të koncesioneve të hershme, siç është *partneriteti publik-privat*, janë politika thaçeriste të ndjekura më vonë nga presidenti Regan. Zgjerimi i skemës së *partneritetit publik-privat* nga qeverisja e sotme e majtë, duke e shtrirë atë deri në ofrimin e shërbimeve të shëndetit dhe të arsimit (kjo e fundit thjesht mbeti në letër për shkak të organizimeve studentore, por fatkeqësisht të sëmurët nuk e kanë këtë shans të organizimit dhe kundërshtimit) është e paprecedentë. Edhe më keq, reformimi që i është bërë kësaj forme të partneritetit, duke e kaluar të gjithë barrën e rrezikut të dështimit të investimit të shteti dhe buxheti publik nuk gjejnë asnjë justifikim, as ideologjik dhe as ekonomik. Privatizimi i shërbimeve publike ka shkuar aq thellë në qeverisjen e sotme të majtë, saqë edhe Ministria e Brendshme që duhet të ofrojë rend dhe siguri publike, ka krijuar një firmë për ofrimin e shërbimeve të sigurisë. Po kaq në mbrojtje të interesave të kapitalit ishte dhe masa tjetër e qeverisë së majtë: përgjysmimi i tatimit mbi dividendin, nga 15% në 8%, një e ardhur që vilet nga një grup shumë i vogël individësh të pasur, pronar korporatash, minierash apo pasurish të ndryshme të vendit. Kjo, nga ana tjetër, kontraston me rritjen e tatimit mbi të ardhurat personale, duke kaluar nga tatimi proporcional tek

tatimi progresiv. Qëllimi i saj është të tatojë më shumë individët me të ardhura të larta, por që në fakt kjo rëndon kryesisht mbi shtresat e mesme të shoqërisë. Rezultati i kësaj politike duket se janë favorizimi i atyre që janë në majë të piramidës së të ardhurave (super të pasurve) dhe atyre që janë në fund të kësaj piramide (të varfrit). E gjithë kostoja bie mbi mesin e piramidës, shtresën e mesme të shoqërisë. Kjo është shtresa që përbën shtyllën e një shoqërie demokratike: është amortizatore e tronditjeve sociale, udhëheqëse e rritjes ekonomike, fytyra e standardit të vërtetë ekonomik e shoqëror të një shoqërie. Rrënimi i saj ka filluar të japë shenjat e pasojave negative në mënyrë të veçantë në ekonomi, por edhe në jetën shoqërore të vendit. Kështu, jeta në qytetet përtej Tiranës është tmerrësisht e varfër intelektualisht, përveç fundjavave kur dyndjet nga Tirana i japin atyre pak gjallëri. Ritmet tejet të ngadalta të rritjes ekonomike do të jenë një shqetësim serioz për shoqërinë tonë, sepse fuqia blerëse e kësaj klase është tkurrur ndjeshëm, ndërsa as të varfrit dhe as të pasurit nuk e ndryshojnë dot më dinamikën e kërkesës agregate ekonomike.

Ndoshta aspekti ku duket se ruhet koherenca ideologjike e së majtës është raporti i saj me rregullimin e jetës ekonomike dhe sociale në vend. Kjo ndeshet në të gjithë sektorët: pa një autorizim qeveritar nuk mund të kryhet asnjë veprim individual. Për shembull, është ministri ai që vendos se kur hapet e mbyllet shkolla; që të ndryshosh përzgjedhjen e një universiteti apo një programi mësimor apo të regjistrohesh në një program për herë të parë, kjo e drejtë kufizohet vetëm

një herë në vit dhe në datë shumë të përcaktuar; që të kryesh studimet për një diplomë të dytë, duhet të shpenzosh të njëjtin numër vitesh në sistem njësoj si për diplomën e parë, megjithëse ka shumë kredite të njohura që janë të transferueshme; që të bësh rolin e guidës turistike për një operator turistik, duhet të pajisesh me një licencë nga ministria; që të riparosh çatinë e rrënuar të shtëpisë duhet të marrësh një leje ndërtimi, duke pritur afatet maksimale ligjore edhe pse çatia mund të zërë poshtë rrënojave familjen; që të hapësh dyqanin në mëngjes duhet të llogarisësh që disa orë në ditë t'ua kushtosh vizitave të inspektorëve tatimorë apo trupave të tjera inspektuese; që të ndërtosh një banesë të thjeshtë në fshat, për strehim individual, duhet të kryesh të njëjtën procedurë ligjore e dokumentare njësoj si ndërtimi i një qiellgërvishtësi në Tiranë... Lista mund të pasurohet pa fund. Në rastin më të mirë, kjo mund të konsiderohet si një shfaqje e mentalitetit antikapitalist, në rastin më të keq (por më tepër të mundshëm) si krijim i një sistemi të prirur të ushqejë korrupsionin në institucionet dhe politikat publike. Këto aktivitete *rent-seeking* të njohura gjerësisht nga teoria ekonomike dhe politike, janë tepër të dëmshme për shoqërinë. Ato transferojnë të ardhurat nga konsumatorët, të cilët paguajnë një çmim shumë më të lartë për mallrat dhe shërbimet, tek politikanët, duke përdorur si instrument biznesin. Transfertat që biznesi bën në favor të këtyre grupeve me qëllim kapërcimin e këtyre mureve bllokuese të jetës normale ekonomike, konvertohen në çmimet e larta që paguan shoqëria. Teoria, madje, thekson se

këto humbje janë edhe më të mëdha se kaq, për shkak të çmimeve më të larta nga sa justifikojnë kushtet e një tregu konkurrues, dhe kjo në vetvete deformon zgjedhjen konsumatore duke kufizuar kërkesën për mallra apo shërbime të ndryshme që në kushte të çmimeve më të ulëta do të kishin patur akses.

Në fushën e taksimit, e djathta ka qenë më konsistente: taksa të ulëta dhe thjeshtëzim pengesash burokratike përmes derregullimit me qëllim zgjerimin e lirisë ekonomike. Por e djathta, gjithashtu, ka qenë jo gjithnjë e qëndrueshme në politikat e saj. Veçanërisht në raport me pronën private. Duke mos u ndalur tek historia e mëkatit fillestar që shënohet me ligjin nr. 7501, i gjithë legjisllacioni për legalizimin e banesave që vazhdon pambarim në agjendat e të gjitha qeverive prej vitesh, nuk është gjë tjetër veçse përvetësimi më masiv në histori që i është bërë pronës private në mënyrë të paligjshme. Në këtë çështje ka kontributin e saj edhe e djathta shqiptare që asnjëherë nuk ka vendosur shenjtërinë e pronës si gurin e themelit të saj doktrinar. Për hir të votave të Astirit, e djathta është investuar në një aksion politik pa kuptim; ajo mund të jetë një çështje e organizatave për mbrojtjen e të drejtave të individit apo grupeve qytetare, por jo kauzë e një force politike të djathtë.

Artikulime populiste të së djathtës ndeshen në shumë qëndrime politike mbi reforma të caktuara. Për shembull, duke kundërshtuar reformën në arsimin e lartë dhe duke dalë në krah të studentëve, opozita u shpreh për arsim falas për të gjithë dhe për të gjitha nivelet e edukimit. Teza e arsimit falas është e

debatueshme pasi arsimit nuk është një mall publik, por privat sipas teorisë së ekonomisë publik. Financimi publik i niveleve të arsimit, deri në ato universitare, tërësisht me fonde buxhetore gjen argumente që janë të pranueshme edhe për të djathtët, me nevojën që një shoqëri moderne të sigurojë një egalitarizëm në aksesin ndaj disa mallrave edhe për të pamundurët. Arsimit konsiderohet si njëri prej tyre. Financimi nga fondet publike edhe të arsimit të lartë universitar dhe pasuniversitar është i pajustificueshëm për forcat politike të djathta dhe për më tepër në mënyrën aktuale të ofrimit të shërbimit. Megjithatë kjo temë u rrah gjerësisht në numrin e kaluar të kësaj reviste dhe nuk po e shtjelloj më tej.

Ky skanim i shkurtër i veprimit politik të dy forcave kryesore, e majta dhe e djathta në Shqipëri, tregon se identiteti ideologjik ka qenë dytësor dhe kanë mbizotëruar interesat elektoralë ose aktivitetet *rent-seeking*, kryesisht këto të fundit kur forcat politike janë në qeverisje.

Por a është e mundshme në kushtet e sotme të shoqërisë që e majta dhe e djathta të kenë identitete ideologjike të dallueshme dhe të shprehura qartësisht? Mos ndoshta zhvillimet e një bote shumë komplekse si kjo e sotmja i bëjnë të pakuptimta ndarjet ideologjike? Apo se zhvillimi i kapitalizmit në fazën e tanishme kërkon një qasje të re dhe të ndryshme nga të dy krahët e politikës?

Qysh prej krizës së vitit 2008 nuk kanë munguar thirrjet për një reformim tërësor të sistemit të sotëm ekonomik dhe shoqëror, dhe tanimë pranohet

gjerësisht nga të gjitha palët se sistemi duhet reformuar. Reformimi i kapitalizmit sot për një kapitalizëm të shekullit XXI, është një sfidë e madhe si për të djathtën, dhe për të majtën. Të majtët duhet të mësojnë se si të rritet më mirë pasuria, ndërsa të djathtët se si mund të ndahet në mënyrë më të drejtë ajo. Të dyja këto dimensione janë kritike dhe nevoja për veprim është shumë urgjente nëse nuk duam të shohim ndonjë formë revolucioni të shfaqet në një të ardhme jo të largët, ku e gjithë shoqëria do të bëhet më keq. Mbështetës të rëndësishëm të nevojës për të reformuar sistemin vijnë nga radhët e shefave ekzekutivë të bankave më të mëdha në botë, përfaqësuesit e “oligarkisë financiare” sipas terminologjisë majtiste, si Jamie Dimon i JP Morgan Chase apo multimiliarderi Ray Dalio. Nuk mund të ketë një mbështetje pa kushte për biznesin kur shoqëria shkon drejt një ndarjeje të madhe nga pikëpamja e pasurisë. Pabarazia mbetet shkaku themelor ndarës në shoqëri. Sot, sipas studimeve të një kompanie konsulence që merret me pagat e drejtuesve të korporatave, Equilar, shefat e korporatave amerikane marrin një shpërblim median (*mesatarja e saktë që eliminon ekstremet nga dy krahët e piramidës së pagave*) 254 herë më të lartë se paga mediane e punëtorëve të këtyre korporatave, dhe 1 në 10 prej tyre, më shumë se 1 000 herë më shumë. Dyzet vjet më parë ky raport i diferencës së shpërblimeve ishte më pak se 30 herë. Kur përqendrimi i pasurisë dhe i aktivitetit ekonomik arrin në një pikë kritike, kjo shndërrohet në rrezik serioz për vetë sistemin, duke kërcënuar shembjen e tij. Teknologjia dhe

globalizmi kanë ndihmuar në këtë polarizim dhe sot populizmi po ushqen gjithnjë e më fort lëvizje të forta e radikale, të cilat mund të bëhen rrezik real për sistemin. Rezultatet e Gallup-it gjatë vitit 2018 treguan se 51% e amerikanëve të moshës 18-29 vjeç kanë një shikim pozitivist ndaj mënyrës socialiste të organizimit të ekonomisë, ndërsa përqindja e atyre që kanë pikëpamje pozitive për kapitalizmin ka rënë nga 68% në vitin 2010, në vetëm 45%.

Duke shfletuar pasqyrat financiare të kompanive shqiptare të depozituara në institucionet publike, në shumicën e rasteve vërehen diferenca absurde: fitimet neto (pas taksave) të pronarit të biznesit rezultojnë të jenë edhe më të larta se të gjitha shpenzimet për kostot e personelit (paga, sigurime dhe taksa) (!). Edhe më e papranueshme është një gjendje e tillë e shpërndarjes së të ardhurave të krijuara në ekonomi që burojnë nga shfrytëzimi i pasurive natyrore të vendit. Meqenëse kontabiliteti e amortizon koston e investimit (kredi apo burime të tjera të financimit) duke e zbritur nga të ardhurat e veprimtarisë, fitimi neto i koncesionarëve dhe sipërmarrësve është i pashpjegueshëm që të jetë në nivele më të larta se e gjithë kostoja totale e punës, pasi në thelb krijimi i pasurisë apo veprimtaria ekonomike e firmës është fryt i punës së punëtorisë, dhe jo vetëm i imagjinatës dhe shpirtit aventurier të kapitalistit. Kjo është një statistikë e frikshme që në fakt shpjegon se përse gjendja e pagave reale në ekonomi vazhdon të bjerë nga viti në vit dhe bashkë me të edhe fuqia blerëse e shoqërisë. Ligjësitë ekonomike e shpjegojnë pagën si një çështje të produktivitetit, domethënë

kostot e fuqisë punëtore për të prodhuar një njësi më shumë malli apo shërbimi. Fakti që raporti në ndarjen e të ardhurave që krijohet nga puna dhe kapitali rezulton me një disproporcion të këtyre përmasave, do të thotë se teoria në këtë rast dështon në shpjegimin e niveleve të ulëta të pagave. Më thjesht, produktiviteti i fuqisë punëtore është shumë më i lartë sesa tregon niveli i pagave të tyre. Pa dashur ta përgjithësoj këtë konstatim, mendoj se si një çështje shumë serioze e ekonomisë politike kërkon një investigim të plotë dhe me shumë përgjegjësi në mënyrë që të veprohet mbi këto fenomene.

Kapitalizmi ku mungojnë rregullat e lojës, apo ku ato, edhe kur ekzistojnë, zbatohen në mënyrë preferenciale duke krijuar favorizime të paligjshme dhe ku shpërndarja e pasurisë krijon polarizime sociale në nivele shoqërisht të papranueshme, është vënë në rrezik mbijetese përballë një agresiviteti në rritje të publikut. Kryeministri shqiptar e pranoi publikisht këtë frikë teksa i kërkoi një grupi biznesmenësh të fuqishëm shqiptarë që të bëjnë më shumë për solidaritetin social, pasi përndryshe rrezikojnë shumë për sigurinë e tyre të ardhshme. Është koha që këto rreziqe dhe paralajmërime të shndërrohen në rregulla të reja të funksionimit të sipërmarrjes, duke synuar një shoqëri kohezive dhe me mirëqenie për të gjitha grupet shoqërore.

Kapitulli 15

RRITJA E SIGURISË SI BURIM I KATASTROFAVE FINANCIARE

Pasiguria, rreziku, frika, misteri, ankthi, stresi, janë materia që ka ushqyer dhe ka shoqëruar njerëzimin që nga lindja. Shkenca dhe ideologjitë janë përpjekur t'i japin përgjigje ngushëlluese njerëzimit, duke synuar sigurinë në vend të pasigurisë, shmangien e rrezikut përkundrejt marrjes së tij, të dukshmen ndaj misterit, komfortin shpirtëror dhe jetën e qetë kundrejt ankthit dhe stresit. Feja, për shembull, është një ideologji ngushëlluese për individin dhe shoqërinë. Ndërkohë që industri të tëra kanë lulëzuar për të kontrolluar rreziqet dhe pasiguritë, industria gjigante e sigurimeve (dhe shërbimeve financiare), apo miliarda dollarë të ardhura të kompanive farmaceutike kanë nën kontroll nivelet e ankthit dhe të stresit, aq të kudogjendura në shoqërinë e sotme postmoderne. Për të rritur sigurinë në industrinë e fluturimeve, shkencëtarët pajisën aeroplanët me sisteme të pavarura të fluturimit pa pilot, por fatkeqësisht përfundimet nuk ishin *pa rrezik*. Kur ato janë parë si sisteme zëvendësuese, katastrofat janë shtuar, por kur janë konsideruar thjesht si plotësuese të tyre, siguria është rritur ndjeshëm.

E papritura është, sipas themeluesit të shkencës së pasigurisë, Nassim Taleb¹⁰⁴, një *Mjellmë e Zezë*: një ngjarje e rrallë, me ndikime ekstreme dhe e parashikueshme në retrospektivë (por jo në perspektivë). Ngjarje të tilla që kanë dominuar shoqërinë tonë, veçanërisht pas Revolucionit Industrial kanë patur ndikime serioze edhe për faktin se shoqëria është sjellë sikur ngjarje të tilla të mos ekzistonin. Vëzhgimet empirike që na konfirmojnë rregullsinë e ngjarjeve dhe na shtyjnë drejt përgjithësimeve mbi matjen e rrezikut dhe pasigurisë, e kanë shtyrë njerëzimin drejt krijimit të besimeve të gabuara. Talebi sjell shembullin e gjelit të detit, i cili është mësuar që sapo lind dielli, amvisa t'i shërbejë vaktin e mëngjesit. Teksa gjeli vëzhgon se kjo sjellje përsëritet e përsëritet nga java në javë e nga muaj në muaj, – njësoj siç ndodh me seritë kohore në modelet e regresionit - ai bëhet edhe më konfident se kjo sjellje do të vazhdojë pafundësisht. Por jo. Fatkeqësisht, pikërisht atëherë kur ai është më i sigurt se kurrë, në ditën e 365-të, ai do të përfundojë në tavolinën e festës. E njëjta gjë ndodh me modelet tona të shkencave sociale. Sa më shumë besime të tilla false të krijohen, aq më serioze bëhen pasojat e ngjarjeve të papritura me të cilat kemi filluar të ndeshemi veçanërisht gjatë dekadave të fundit: 11 Shtatori; Recesioni i Madh i vitit 2008 dhe së fundmi pandemia e COVID-19; ngjarje që kishin probabilitet zero të ndodhnin, por që në fakt e kanë transformuar shumë jetën tonë sot dhe në të ardhmen.

104 Nassim Nicholas Taleb, 2014, The Black Swan: The Impact of the Highly Improbable, Botim në shqip nga Dita 2000

Ndërsa shkenca dhe industrinë kanë synuar rritjen e sigurisë së njerëzimit ndaj pasigurive, askund tjetër sesa në teorinë e tregjeve financiare nuk është më i dukshëm dështimi që ofrojnë modelet e sigurisë ndaj rreziqeve të investimeve. Kurset e lëndës së financave në shkollat e biznesit deri në fund të viteve '50 nuk ishin tjetër veçse një narracion, përshkruese të operacioneve bankare dhe financiare, duke qenë kryesisht një disiplinë teknike. Diku nga vitet 1970, Wall Street-i u armatos me modele të sofistikuar të menaxhimit të rrezikut në ndërtimin e një portofoli investimesh. Një lëndë e thjeshtë e teknikës së financimit u shndërrua në një teori të komplikuar të menaxhimit të rrezikut të investimit; një profesion i thjeshtë i financierit të firmës dhe mbajtjes së shërbimeve të arkës u transformua në një detyrë të komplikuar të menaxhimit të pritshmërive dhe përdorimit të modelimeve matematikore të sofistikuar në operacionet e tregtimit. Rruga drejt këtij komplikimi ka qenë relativisht e gjatë, që prej viteve '50, dhe që vazhdon ende.

Fillimisht, parashikimet e ndryshimeve që ndodhnin në treg bazoheshin tek ajo që njihet si analiza e fundamenteve. Domethënë, parashikimi nëse çmimi i një letre me vlerë apo një monedhe do të rritej apo do të binte, bazohej tek shkaqet që ndikojnë në ndryshimin e çmimit: p.sh. të dhënat mbi fitimet e pritshme, inflacionin e pritshëm, investimet e pritshme të një korporate, të dhënat e borxhit publik apo renditjes së vendit për rrezikun e kredisë etj. Problemi i kësaj metode është se shkaqet vijnë shumë të paqarta. I njëjti shkak shpeshherë mund të përdoret

për të justifikuar lëvizjet krejt të kundërta të çmimeve të letrave me vlerë apo kursit të këmbimit. Mekanizmi shkak-pasojë është i mistershëm dhe nuk na shfaqet dukshëm dhe bindshëm. Nassim Talebi, profesori i shkencës së pasigurisë dhe një prej kritikëve më të fortë të teorisë financiare ortodokse, thotë se kur Sadam Hussein-i u kap dhe u ekzekutua nga ushtria amerikane, rritja e menjëhershme e çmimit të naftës u lexua në lajmet e biznesit (titrat e kanalit televiziv) se shkak u ishte pasi *“kapja e Sadamit rrit pasiguritë në rajon”*. Kur një orë më vonë çmimi u ul, e njëjta media raportonte se shkak u ishte pasi *“kapja e Sadamit kishte ulur tensionet dhe i jepte fund konfliktit në rajon”*. Pra, e njëjta ngjarje përdoret për të justifikuar dy ndryshime krejt të kundërta të lëvizjes së çmimit. Në reformimin e arkitekturës së tregjeve financiare, me qëllim rritjen e sigurisë dhe stabilitetit të sistemit bankar, instrumenti kryesor që është përdorur ka qenë krijimi i agjencive të garantimit të depozitave. Nëse depozitat janë të siguruara, nuk ka arsye pse njerëzit të nxitojnë të tërheqin depozitat, prandaj dhe krizat bankare mund të mbahen nën kontroll. Por këto institucione mund të bëhen edhe shkaktare të krizave, pasi garantimi i depozitave mund t'i shtyjë bankierët drejt riskmarrjes ekseseve në kërkim të normave më të larta të fitimeve. Cila prej këtyre alternativave do të ishte e vërtetë? Si mund të parashikohet atëherë ndikimi i një ngjarjeje në tregun financiar kur pasojat mund të jenë kaq të ndryshme? Analiza fondamentaliste *ex post* mund të jetë e shkëlqyer dhe solide, por *ex ante* është e pamundur që të na ndriçojë shumë. Menaxhimi i

rrezikut bazuar sipas kësaj analize duket shumë i pasigurt.

Prej këtej, teoria e tregjeve financiare zhvilloi një alternativë të dytë të vendimmarrjes në menaxhimin e riskut të investimeve, analizën teknike. Thelbi i kësaj metode është aftësia për të dalluar modele (*patterns*) dhe struktura të ngjashme të indikatorëve të tregjeve, të cilat përdoren në marrjen e vendimeve për të blerë apo shitur monedha apo letra me vlerë. Terminologjia e ‘*chartistëve*’ është e pasuruar me një zhargon që ngjason me një penel piktori: “*head and shoulders*”, “*support points*”, etj. Tregtarët e *forex*it (monedhave) të viteve ‘90 punuan mbi këto modele dhe shpeshherë ato funksionuan. Por, të investosh miliarda bazuar në këtë astrologji financiare – tek e fundit, leximi i një grafiku i ngjan leximit të shenjave të një filxhani – ngjan krejtësisht e pasigurt. Investitorët kanë nevojë të binden me modele më të sofistikuara sesa thjesht leximi i një grafiku.

Kështu, mbi këtë nevojë për t’i bërë parashikimet e tregjeve më të besueshme, lindi një teori “moderne” e financave, bazuar mbi përdorimin e modeleve të matematikës së probabilitetit. Thelbi i teorisë është se edhe pse çmimet janë të paparashikueshme, luhatjet, lëvizjet e tyre janë të parashikueshme sipas teorisë së probabilitetit. Nëse është e mundur që të parashikohet drejtimi i lëvizjes së çmimeve, atëherë edhe risku i investimeve është i parashikueshëm.

Zbatimi i teorisë së probabilitetit kishte filluar shekuj më parë. Një shembull klasik është ai i John Law-t, në shekullin XVIII, një mjeshtër i kësaj teorie,

të cilën e zbatoi me shumë sukses në lojërat e fatit, në kazino. Historia e Law-t është ajo e një personazhi të jashtëzakonshëm në historinë e krizave në tregjet financiare, por edhe e inovacionit financiar që, nëse do të ishte zbatuar me më shumë kujdes, ndoshta do të kishte ndryshuar vetë historinë e kontinentit tonë.

Ndërsa Law e përdori teorinë e probabilitetit thjesht për interesat e tij në lojërat e fatit, ishte merita e një matematikani francez, Luis Bachelier, i cili që në vitet 1900 kishte studiuar luhatjet e çmimeve të letrave me vlerë të qeverisë franceze. Thelbi i teorisë së Bachelier-it ishte se çmimi një letre me vlerë ndryshon sipas një probabiliteti të barabartë, njësoj si hedhja e monedhës: 50% bie kokë - 50% bie pilë. Në tregjet financiare kjo quhet "*random walk*" – ecja rastësore. Bazuar në shpërndarjen normale gaussiane – sipas matematikanit të shquar gjerman Karl Friedrich Gauss, - 68% e ndryshimeve të çmimeve bien brenda një devijimi standard, pra një ndryshimi në raport me mesataren; 95% bien brenda dy devijimeve standarde dhe 98% brenda tri devijimeve standarde. Nëse vendosen vëzhgimet mbi një kurbë, atëherë forma e kurbës do të ishte ajo e një kambane, prandaj dhe quhet kurba kambanë. Ndryshimet ekstreme janë kështu vetëm në 2% të rasteve; pra ato janë ngjarje shumë të rralla.

Studimi i Bachelier-it kishte rënë në harresë derisa një doktorant i Universitetit të Çikagos, Eugen Fama, do të mbronte tezën e tij doktorale me "Hipotezën e tregjeve eficiente". Hipoteza thotë se

në një treg ideal i gjithë informacioni i disponueshëm është i përfshirë në çmimin e sotëm të një letre me vlerë. Domethënë, çmimi i djeshëm nuk e ndikon të sotmin dhe çmimi i sotëm nuk e ndikon çmimin e nesërm; çdo çmim është “i pavarur” nga i fundit. Bazuar në këtë teori, u zhvilluan koeficientet “beta”, “variancat” e instrumenteve financiare të ndryshme dhe bazuar në to, investitorët mund të ndërtonin një portofol me një normë të caktuar kthimi dhe risk të përcaktuar dhe të dëshiruar. Një aplikim i alkimisë në tregjet financiare. Kjo teori është përdorur gjerësisht në ndërtimin e portofolit financiar dhe në atë të teknikave të shpërblimit të drejtuesve ekzekutivë dhe personelit të kompanive, dhe sipas matematikanit Benoit Mandelbrot¹⁰⁵, “fluska e internetit, e nxitur pjesërisht dhe nga shpërblimet ekstravagante të drejtuesve ekzekutivë me kontrata mundësie, mund të mos kishte ndodhur po të mos njihesh Bachelier dhe pasuesit e tij.” (*Misbehavior of Markets*).

Dy janë premiset fundamentale të kësaj teorie: çmimet janë të pavarura nga njëra-tjetra – pra, probabilitetet e luhatjes së çmimit janë të pakushtëzuara – dhe se shpërndarja e luhatjes së çmimeve i përgjigjet formës së shpërndarjes normale, gausiane. Përgjatë viteve 1970 e në vijim, e gjithë ngrehina e teorisë financiare u lidh si një trup – **me kushtin** që Bachelier dhe dishepujt e tij të viteve më të vona, të kishin të drejtë. Varianca dhe devijimi standard janë përafres

105 Benoit Mandelbrot and Richard L. Hudson, 2006, *The Misbehavior of Markets: A Fractal View of Financial Turbulence*, Random House

të mirë të riskut, siç pohonte Markowitz-i – me kushtin që kurba kambanë të përshkruante në mënyrë të saktë lëvizjen e çmimeve. Koeficientet *beta* të William Sharpe dhe vlerësimet e kostos së kapitalit kishin kuptim – me kushtin që Markowitz-i të kishte të drejtë, dhe më tej, që Bachelier të kishte të drejtë. Dhe Black dhe Scholes (teoricienët e modelit të vlerësimit të çmimit të aksioneve) kishin të drejtë - sërish, me kushtin që kurba kambanë të ishte e përshtatshme dhe se çmimet luhaten në mënyrë të vazhdueshme. *“Të marra së bashku”, - thotë Mandelbrot, - “kjo ngrehinë intelektuale është një testament i jashtëzakonshëm i gjenisë njerëzore. Por e tëra nuk është më e fortë se anëtarja më e dobët”.*

Çfarë thonë vëzhgimet e tregjeve reale mbi këto dy kushte thelbësore të teorisë: probabilitetet e pakushtëzuarat e luhatjes së çmimeve dhe shpërndarjen normale të tyre? Lidhur me hipotezën e pavarësisë së luhatjes së çmimeve, është provuar se, në fakt, çmimet kanë “memorie”. Nëse çmimet gjatë një jave, të themi, kanë qenë në rritje, atëherë gjasat më të mëdha janë se dhe javës tjetër çmimet do të vijjnë në rritje. Nëse luani në ruletën e kazinosë dhe shikoni se numri 13 bie më shumë se çdo numër tjetër, sigurisht që numrit 13 nuk do t’i jepnit të njëjtin probabilitet të ngjarjes, si dhe numrave të tjerë në fushën e lojës. Këtë gabim - thotë Nassim Taleb-i mund ta bëjnë vetëm profesorët e statistikës, por jo lojtarët e tregut. Studimit të këtij fenomeni ky autoritet i padiskutueshëm i shkencës së riskut i ka kushtuar një libër bestseller, *“Fooled by randomness”* (Të marrosur pas rastësisë). Ky fenomen, i vëzhguar tashmë nga studiuesit dhe që thekson se

luhatja e çmimeve është e paparashikueshme, bie ndesh me modelin e ecjes rastësore (*random walk*).

Premisa e dytë, ajo e shpërndarjes normale të luhatjes së çmimeve, gjithashtu nuk provohet të jetë e saktë. Sipas Mandelbrot-it, *“Nga viti 1916 deri në vitin 2003, lëvizjet ditore të indeksit ditor Dow Jones Industrial Average, nuk shfaqen në grafik se ngjajnë me një kurbë kambanë. Në ekstreme të dhënat shtohen shumë: shumë vëzhgime me ndryshime të forta. Teoria sugjeron se përgjatë kësaj kohe, duhet të jenë 58 ditë kur Dow luhatet me më shumë se 3.4%; në fakt ishin 1 001 ditë. Teoria parashikon gjashtë ditë kur indeksi luhatet përtej kufirit të 4.5%; në fakt ishin 366 ditë. Ndërsa luhatjet e indeksit më shumë se 7% do të ndodhnin në çdo 300 000 vite; në fakt në shekullin XXI kjo luhatje u regjistrua në 48 ditë”*. Ngjarjet si krizat aq të shpeshta financiare të viteve 2000, veçanërisht ajo e vitit 2008, kishin një probabilitet teorik të ndodhjes në disa miliarda vite dritë të jetës së planetit tonë. Por në fakt planeti po vizitohet nga kriza financiare gjithnjë e më të ashpra dhe më të kushtueshme. Duket se modelet e krijuara përgjatë rreth pesë dekadave të fundit dhe që na krijojnë më shumë besim në investimet në tregjet financiare, në fakt kanë dështuar. Bota reale e tregjeve financiare është ajo e një rastësie shumë më të egër, e dhunshme dhe me pasoja serioze për tregjet dhe investitorët.

Ky dështim i teorisë ortodokse, i cili fatkeqësisht ende vazhdon të jetë pjesë qendrore e kurrikulimit në programet universitare në mbarë botën, bën thirrje për një teori të re, sikurse e gjithë ngrehina e ekonomiksit është duke i rikonsideruar premisat

e saj dhe po revizionohet rrënjësisht. Keynes-i, i cili i dha përgjigje të qëndrueshme një krize të tillë të teorisë ekonomike klasike, përmes botimit në vitin 1936 të *“Teorisë së përgjithshme”*, thoshte se: *“Teoricienët klasikë ngjajnë si gjeometrat euklidianë në një botë joeuklidiane të cilët, pasi zbulojnë nga eksperiencia se vijat e drejta paralele shpesh bashkohen, qortojnë vijat që nuk vazhdojnë të drejta – si e vetmja kurë për konfliktin me të cilin po ndeshen. Megjithatë, në të vërtetë, nuk ka kurë tjetër veçse të hidhet poshtë aksioma e vijave paralele dhe të përpunojmë një gjeometri joeuklidiane. Diçka e ngjashme kërkohet sot në ekonomiks”*. Keynes-i e realizoi atë revolucion në mendimin ekonomik në atë periudhë; ndërsa matematikani francez (me origjinë polake) Beniot Mandelbrot po e realizon sot këtë revolucion në tregjet financiare përmes aplikimit të një metode të re të gjeometrisë dhe matematikës fraktale në studimin e parregullsive, vrazhdësisë, dhëmbëzimeve që vihen re në luhatjen e çmimeve përkundrejt vijave të drejta lineare të gjeometrisë euklidiane. Ai arrin të dallojë të rregulltën brenda parregullsive, të ndërtojë një lloj të veçantë të variancës dhe simetrisë, që lidh në një të vetme tërësinë e pjesëve të zhvillimeve të një tregu; të tërën e zbërthen në pjesëza të vogla, ku secila pjesëz është imitim i së tërës. Mandelbrot-i shikon përtej sipërfaqeve të lëmuara për të dalluar ashpërinë; përtej vijave të drejta për të dalluar dhëmbëzimet; përtej formave të rregullta gjeometrike për të dalluar asimetrinë në natyrë dhe në fenomenet ekonomike. Ai shpenzoi njëzet vjet për të studiuar sjelljen e çmimit të pambukut dhe ndërtoi një model kompjuterik sipas

gjeometrisë fraktale që imiton në mënyrë të plotë sjelljen e çmimit në jetën reale. Dikush që vëzhgon grafikët e luhatjes së çmimeve reale dhe çmimeve të stimuluar sipas modelit fraktal, e ka të pamundur të dallojë se cili është i vërteti dhe cili është stimulimi kompjuterik.

E panjohura mbetet motivuesi më i madh për njeriun dhe shoqërinë, për të eksploruar kufij të panjohur të dijes dhe shkencës. *“Natyrës i pëlqen të fshihet”*, – thoshte Herakliti. – *“Një lidhje e fshehtë është më e fortë se e dukshmja.”* Në biznes njeriu eksperimenton me të panjohurën duke vënë baste rreth saj. Çfarëdo formule që pretendon të shmangë riskun e investimeve dhe maksimizon fitimet, formulat që u japin siguri investitorëve dhe i shtyjnë ata drejt rreziqeve të panjohura, nuk bëjnë gjë tjetër veçse shtojnë krizat financiare, të cilat rrënojnë miliona kursimtarë të vegjël, duke prodhuar zhgënjime të mëdha sociale dhe drama njerëzore. Tregjet janë shumë, shumë të rrezikshme, shumë më të rrezikshme nga sa pretendon teoria financiare ortodokse. Deri më sot janë prodhuar teori bazuar në modele të rritjes së sigurisë së investitorëve, dhe që kanë prodhuar katastrofa financiare; është koha për një teori të re që e pajis shoqërinë me më shumë rregulla kujdesi dhe që zbut në kohë krizat financiare të ardhshme.

Kapitulli 16

TAKSIMI, SHPENZIMI DHE PËRFAQËSIMI PUBLIK

Që prej themelimit të sistemit tatimor në vend, në vitin 1992, Shqipëria zbatoi një sistem tatimor progresiv. Në vitin 2007 u eksperimentua me një lloj tjetër sistemi, me sistemin e taksimit proporcional, ose siç njihet *taksa e sheshtë*. Që prej kësaj kohe, është prodhuar një debat i fortë publik, kryesisht me natyrë ideologjike dhe shumë pak i bazuar në prova dhe evidenca empirike dhe historike.

Le ta quajmë këtë një nga eksperimentet e rëndësishme të tranzicionit dhe ndoshta ia vlen të ndalemi në meritat apo dështimet e sistemeve tatimore, të shqyrtuara në këndvështrimin e ekonomisë politike ose të ekonomisë publik normative. Një analizë e tillë bëhet e rëndësishme edhe për faktin se në fushatat elektorale debati mbi sistemet tatimore shndërrohet në një nga temat qendrore të platformave elektorale. Që në nisje të këtij shkrimi, duhet të bëjmë një qartësim të terminologjisë. Ajo që quhet si *taksa e sheshtë*, në tekstet e financave publike quhet *taksë proporcionale* dhe si e tillë është progresive. Progresiviteti vjen nga fakti se me rritjen e nivelit të të ardhurave, norma mesatare e tatimit rritet. Dallimi me sistemin aktual, që njihet si sistemi progresiv, është përdorimi i disa shkallëve

tatimore sipas niveleve të të ardhurave. Pra, ajo që bën dallimin midis tyre është numri i shkallëve tatimore dhe se niveli i progresivitetit rritet sa më lart ngjitemi në nivelin e të ardhurave. Në thelb, të dyja sistemet janë sisteme tatimore progresive.

Qëllimi i politikave fiskale, pavarësisht sistemit tatimor që zbatohet, është i njëjtë: të realizojë një proces rishpërndarjeje të të ardhurave të krijuara në ekonomi duke përdorur si krahun e të ardhurave, dhe atë të shpenzimeve. Por, në një analizë të fundit, përfitimet e grupeve të ndryshme shoqërore duhen analizuar jo vetëm nga taksimi, por dhe nga përfitimet nga shpenzimet publike. Për shembull, një sistem buxhetor që vjel më shumë taksa nga të pasurit, por që shpenzon në projekte që përfitojnë po të pasurit, nuk do të ishte një sistem i mirë rishpërndarës. Procesi i rishpërndarjes së të ardhurave përmes financave publike përmbledhet në dokumentin kryesor të vendit që është buxheti i shtetit.

Buxheti është padyshim instrumenti themelor në realizimin e politikave të rishpërndarjes midis grupeve të popullsisë, rajoneve të vendit dhe sektorëve ekonomikë, dhe në historinë dhe filozofinë e tij, është mjeti që, me justifikimin e arritjes së objektivave kombëtarë/strategjikë, është përdorur për të fuqizuar vetë shtetin dhe burokracinë e tij, duke marrë përherë e më shumë nga liria e individit, të shprehur në mënyrën më tipike në formën e taksave konfiskuese mbi individët.

Motivimi kryesor për mbajtjen e niveleve të larta të shpenzimeve publike, në botën përpara shekullit

XXI, ka qenë nevoja e financimit të luftërave dhe ekspansionet territoriale. Ndërsa me *Keynes*-in nivelet e larta të shpenzimeve publike janë shndërruar në instrumente të ndërhyrjes aktive të shtetit në ekonomi qoftë për nevoja të stimulimit të rritjes ekonomike, apo si instrument i zbutjes së cikleve të biznesit, kur ekonomitë rrezikojnë të futen në recesione të rrezikshme.

Një thënie e historianit të shumëcitur të lashtësisë Herodotit, se *“Lufta është babi i të gjitha gjërave”*, gjen vend edhe në shpjegimin e historikut të financave publike. Luftërat kanë qenë motori i ndryshimeve financiare. A nuk ishte Lufta e Peloponezit ajo që e detyroi qeverinë e Athinës, për shkak të rritjes së shpenzimeve të financimit të kësaj lufte, të shkrinte statujën prej ari të perëndisë Athina dhe të prodhonte paratë që i duheshin për vazhdimin e luftës? Ndërsa Ciceroni shkruante se *“lëngu lubrifikues i luftës është paraja e pakufizuar”*. Në çdo botim të njerëzve të shquar dhe shkrimtarëve të mëdhenj si Rable, Robert de Balsac, Robert Burns (i cili i ka kushtuar një poemë “urrejtjes” së akcizës), Dostojevski, Kardinali Rishelje, etj., gjejmë një mori referencash që na bindin se historia e financave publike ka qenë një përpjekje e përhershme për të mbyllur boshllëkun midis parave të disponueshme dhe shpenzimeve të kushtueshme të luftërave. Pesha e shpenzimeve për luftërat zinte më shumë se 1/3 e shpenzimeve buxhetore në periudhën e luftërave të Perikliut; 45-58% në Perandorinë Romake rreth shekullit XIV AD dhe më shumë se 1/3

e totalit të shpenzimeve në kalifatin Abbasid¹⁰⁶ . Në ndeshjen e Habsburgëve me Perandorinë Otomane, lufta i kishte kushtuar Vjenës deri në 98% të totalit të buxhetit, ndërsa më vonë kishin rënë në 43% të totalit të shpenzimeve. Edhe sot, SHBA shpenzojnë rreth 730 miliardë dollarë në vit për forcat ushtarake, ose 15% të totalit të shpenzimeve federale.

Taksimi zë vend edhe në Testamentin e Ri: Maria dhe Jozefi udhëtuan për në Betlehem për t'i *“dhënë Çezarit atë që i takon Çezarit”*. Megjithëse pagimi i taksave mund të shmanget, taksimi është i paevitueshëm.

Pikërisht me motivimin e angazhimeve në luftëra në emër të interesave kombëtarë, janë motivuar edhe politikat taksuese mbi popullsinë. Edhe pse, siç e thotë Lloyd George, *“koha më e mirë për të taksuar njeriun është dita kur ai vdes”*, kjo nuk do të thotë se taksat e trashëgimisë kanë qenë burimi i vetëm i të ardhurave të buxhetit. Përkundrazi, të gjitha taksat që njohim sot kanë ekzistuar, në forma dhe përmasa të ndryshme, tek të gjithë popujt që prej botës së antikitetit, të ndryshuara herë pas here kryesisht si pasojë e presioneve të grupeve të ndryshme shoqërore.

Një sistem taksimi i mençur është ai që maksimizon të ardhurat e buxhetit duke vendosur minimumin e kufizimeve ndaj rritjes ekonomike. Sigurisht që taksimi jo i drejtpërdrejtë (domethënë, mbi konsumin dhe jo mbi të ardhurat) do të ishte i preferuar në këtë kuptim, por edhe për hir të lehtësisë në kontrollin dhe

106 Nail Ferguson, 2001, *The cash nexus: Money and power in the modern world 1700-2000*; pg. 42-3

monitorimin e vjeljes së tyre, por duke qenë regresiv nga natyra, ai mund të çojë në destabilitet social për shkak të rëndimit të grupeve shoqërore me të ardhura më të ulëta.

Vendosja e tarifave doganore dhe akcizave mbi importet ka qenë forma më e hershme e vjeljes së të ardhurave. Në periudhën e lashtësisë, Athina kishte vendosur një tarifë prej 1% mbi të gjitha importet. Po kështu edhe Roma vilte *portoria*, që zinte gati $\frac{1}{4}$ e të ardhurave. Precedenti i vendosjes së tarifës doganore *specifike*¹⁰⁷ u vendos nga Mbreti John në Anglinë mesjetare, i cili vendosi një tarifë 16 *pens* mbi një listë mallrash, importi dhe eksporti. Tarifat e larta mbi eksportin e leshit, një prodhim kryesor në Angli, por edhe në Ballkan, ishin një burim i rëndësishëm i të ardhurave, por nga ana tjetër, edhe një faktor i rëndësishëm për rënien e ngadaltë të këtij sektori, ashtu sikurse edhe një shkak kryesor i evazionit fiskal. Për rastin e ish-Perandorisë Otomane, ky është një konstatim i literaturës së historisë së ekonomisë, nga historianët e njohur të kësaj periudhe, si Pamuk, Inalçik etj.

Në tatimin mbi të ardhurat personale (që është tatimi kryesor direkt), forma më e vjetër dhe e thjeshtë e taksimit ka qenë taksa për frymë, e cila, duke qenë fikse për çdo banor, ishte thellësisht regressive. Në

107 Tarifat doganore vendosen kryesisht në përqindje mbi vlerën e mallit (*ad valorem*). Për disa kategori produktesh ato vendosen në njësi monetare mbi një njësi produkti, që njihen si tarifa specifike. Për shembull, tarifa doganore prej 5 lekësh për çdo paketë cigaresh quhet *tarifë specifike*.

Anglinë e viteve 1200-1300, kjo taksë ishte 1 shilingë për frymë për çdo banor mbi 15 vjeç, duke përjashtuar lypsarët. Kjo ishte një taksë thellësisht regresive dhe nuk mbante në konsideratë të ardhurat e individit. Për këtë arsye, taksa kryesore dhe burimi kryesor i të ardhurave në monarkitë e kësaj epoke ishte taksa mbi tokën, e cila sërish ishte përgjithësisht sa 1/10 e prodhimit, domethënë proporcionale në raport me pjellorinë e tokës dhe prodhimin. Kjo sigurisht që e bënte taksimin më të ndershëm dhe më të pranueshëm. Fakti që popullsia botërore ishte kryesisht rurale sigurisht që e bënte këtë formë taksimi burimin kryesor të të ardhurave dhe zinte nga 40-60% të totalit të të ardhurave. Këtë formë taksimi e ndeshim të zbatuar në Shqipëri që prej kohës së Perandorisë Otomane dhe deri në kohën e Mbretërisë, në vitet 20-30 të shekullit të kaluar.

Tokëvili nënvizon se taksat kanë qenë një ndër shkaqet kryesore të Revolucionit Francez. Në fakt, në “Deklaratën e të Drejtave të Njeriut dhe të Qytetarit”, revolucionarët francezë kishin shkruar se *“taksat duhet të merren në mënyrë të barabartë nga të gjithë qytetarët, sipas aftësisë së tyre për të paguar”*, që në fakt ishte një koncept që i referohej Mesjetës, ku taksa kishte qenë e barabartë me 1/10 e të ardhurave. Këtë praktikë e ndeshim tek kalifati Abasid i shekullit VIII, në Anglinë e shekullit XIV (që u shtua në 15% në kohën e Cromwell-it), *decima*-n veneciane, etj. Po t’i referohemi Anglisë, që ndoshta ka historinë më të pasur të reformave fiskale dhe taksimit, përpjekja e parë e modernizimit të këtij lloji tatimi daton në

vitin 1662, me një nivel 20% taksë mbi të gjitha llojet e të ardhurave. Ky sistem u modernizua tërësisht nga William Pitt, që e uli nivelin e saj vetëm në 10%. Kjo pra ka qenë epoka e taksës proporcionale, apo e taksës së sheshtë, siç e njohim sot të pagëzuar me këtë emër prej dy studiuesve të njohur të taksimit, Robert Hall dhe Alvin Rabushka të Institutit Hoover.

Shembulli më i hershëm ku ndeshim taksën progresive në kuptimin e sotëm, pra, me shkallë më të lartë tatimore që aplikohen mbi nivelet më të larta të të ardhurave, gjendet në Francë (për një kohë shumë të shkurtër) që ishte zbatuar në normën nga 3-9 franga për frymë, sipas madhësisë së të ardhurave. Ky sistem ishte formalizuar në shekullin XVIII, me shkallën nga 0-20%, sipas niveleve të të ardhurave. Jakobinët, veçanërisht Robespieri, e përkrahu fuqimisht këtë politikë taksimi, që më vonë kishte ngjallur një debat të fortë nga ish-kryeministri britanik, Gladstone, i cili e konsideronte këtë politikë si një *“tendencë të qartë drejt komunizmit”*; kjo formë taksimi ishte qartësisht konfiskuese. Sidoqoftë, këtë praktikë taksimi filloi ta zbatonte edhe Anglia. Viti 1909 (kur Lloyd George paraqiti buxhetin në parlament) ishte viti kur shënohet kalimi nga taksë e sheshtë në taksimin progresiv me tri nivele: 3.75%, 5% dhe 5.83%, në varësi të fashës së të ardhurave. Sa më shumë rriteshin shpenzimet për luftërat, aq më shumë rriteshin edhe normat marzhinale të bandës së sipërme (kufiri i sipërm), duke arritur - në fundin e viteve 1970 - deri në 49% dhe u ul në 40% me ardhjen në pushtet të Margaret Thacer-it. Rasti interesant që shënon eksperiencën

e reformës së Thacer-it ishte se me uljen e normës së taksës nga 49% në 40%, totali i taksave që kishin paguar 1% e taksapaguesve më të mëdhenj të vendit (pra, më të pasurit) ishte rritur nga 11% në 15%, një shembull i qartë se ulja e taksës mund të sigurojë më shumë të ardhura, e famshmja *kurba Lafer*. Duke bërë një parantezë për shpjegimin e kurbës Lafer, e cila zë një vend të rëndësishëm në debatin mbi normat optimale të taksimit: Logjika thotë se të ardhurat nga taksat do të jenë zero në rast se norma tatimore është zero; por të ardhurat tatimore do të jenë zero edhe në rast se norma tatimore do të jetë 100%. Kjo do të thotë se me rritjen e normës tatimore nga niveli 0%, të ardhurat fillojnë të rriten dhe përtej një pike të caktuar sa më shumë që norma tatimore i afrohet 100%, ato fillojnë të bien deri sa bëhen zero. Pra, forma e kurbës së të ardhurave përgjatë rritjes së taksave është një U e përmbysur. Sfida kryesore e punës kërkimore empirike është pikërisht përcaktimi i asaj “pikë” nga ku me rritjen e normës së tatimit, kurba e të ardhurave fillon të bjerë. Shumë kërkime sot vlerësojnë se kjo pikë i korrespondon një norme tatimore prej 25%. Domethënë, përtej normës tatimore 25%, të ardhurat fillojnë të bien.

Bota demokratike ka zbatuar sistemin e taksave progresive përgjatë gjithë shekullit XX dhe rikthimi drejt taksës së sheshtë i dedikohet fillimit të viteve 1990, i filluar së pari në Hong Kong dhe Estoni, në vitin 1994, që mori më pas një shtrirje të shpejtë në shumë vende të Europës Qendrore e Lindore, në vendet e rajonit tonë, por dhe në disa nga shtetet e Amerikës.

Milton Friedman dhe ekonomistët libertarianë në SHBA, përmes punimeve të tyre akademike, kishin bërë apel për disa dekada që të kalohej drejt takës së sheshtë, por i vetmi sukses që arritën ishte reduktimi i niveleve të larta tatimore.

Triumfi i kësaj politike tatimore në Lindje ishte një befasi, të paktën në termat ideologjikë. Por arsyet ishin më të thjeshta. Qëllimi ishte: një sistem tatimor i thjeshtë në zbatim, zbutja e evazionit fiskal dhe përmirësimi eficiencës ekonomike. Më së shumti ishin arsyet që lidheshin me administrimin e dobët fiskal dhe jo konsideratat ideologjike.

Pas gati tre dekadash, rezultatet nga njëri vend në tjetrin kanë qenë shumë të ndryshme. Për shembull, në Rusi zbatimi i sistemit të taksës së sheshtë u shoqërua me rritje të të ardhurave të buxhetit për shkak të shmangies së evazionit fiskal. Rezultatet fillestare pozitive që u ndeshën në Sllovakia (viti 2004), filluan të zbeheshin me kalimin e viteve për shkak të administrimit të dobët fiskal dhe rritjes së fortë të normës së kontributeve të sigurimeve sociale (Remeta et al, 2005). Në një nga studimet më të fundit (Filer et al. (2019)), nuk gjenden efekte të rëndësishme të zbatimit të taksës së sheshtë mbi nënraportimin e të ardhurave (pra, në zbutjen e evazionit fiskal). Studime mbi eksperiencat individuale nga vendet në tranzicion tregojnë se edhe në rastet kur janë krijuar përfitime të eficiencës nga tatimi i sheshtë, kjo ka ardhur në kurriz të thellimit të pabarazive sociale për shkak të natyrës “regressive” të këtij sistemi.

Megjithatë, duhet thënë se ka një diversitetet shumë të fortë të mënyrave se si është aplikuar reforma

e sistemit tatimor dhe për rrjedhojë është vështirë të përgjithësohet prej tyre. Për shembull taksa e sheshtë apo progresive zbatohet mbi të gjitha kategoritë e të ardhurave, madje dhe mbi tatimet e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta (pra, ka një normë të vetme tatimore, për shembull 16% mbi të gjitha kategoritë e të ardhurave, por edhe mbi tatimin mbi vlerën e shtuar), dhe për pasojë, ndikimi i sistemit të përzgjedhur në pabarazi është i ndryshëm nëse vendet e aplikojnë progresivitetin vetëm mbi të ardhurat nga puna dhe jo për të ardhurat nga kapitali, siç është rasti i Shqipërisë. Shqipëria po aplikon aktualisht tatimin progresiv vetëm mbi të ardhurat nga puna, por jo mbi fitimet kapitale dhe shpërndarjen e dividendit, që është forma kryesore e të ardhurave për të pasurit (investitorët në biznes).

Për të kompensuar efektet negative të taksës së sheshtë në vitin 2007, Shqipëria përdori dy përshtatje: vendosjen e një kufiri përjashtues të të ardhurave (20 mijë lekë) në aplikimin e taksës, që zbatohet nga të gjitha vendet që kanë përshtatur këtë sistem tatimor; dhe kompensim të plotë të pagës në masën e rritjes së taksës dhe me indeksimin e përvitshëm të pagave dhe pensioneve. Në planin teorik, kjo e bën këtë reformë *Pareto eficiente*, në kuptimin që shtresat me të ardhura më të ulëta mbrohen nga efekti negativ i taksës, ndërsa grupet e të ardhurave më të larta janë më mirë: të gjithë janë *better off*. Shoqëria në tërësi është më mirë me një nivel më të ulët takse.

Kështu, bazuar në të dyja faktet e mësipërme, është vështirë të nxirret një konkluzion i qartë nëse

tatimi progresiv dhe ai i sheshtë kanë patur një ndikim të qartë në thellimin e pabarazive. Argumenti i përzgjedhjes së sistemit tatimor bazuar vetëm nga konsiderata ideologjike e luftës ndaj pabarazisë, nuk mund të thuhet se ka një bazë empirike në rastin e Shqipërisë. *Koeficienti Gini*, që mat shkallën e pabarazisë, ka qenë 0.27 në vitin 1996 kur vendi aplikonte taksimin progresiv, u rrit në 0.3 në vitin 2008 kur u aplikua taksa e sheshtë, ra në 0.29 në vitin 2012 kur akoma zbatohet taksa e sheshtë dhe u rrit në 0.346 në vitin 2014 kur aplikohet sistemi tatimor progresiv. Kjo do të thotë se pabarazia lidhet me shkaqe më thelbësore sesa thjesht ato që lidhen me sistemin tatimor progresiv apo të sheshtë.

Pas zbatimit të taksës së sheshtë, të ardhurat buxhetore në raport me PBB-në u rritën në vitin 2008 në 26.8%, nga 26% që kishin qenë një vit më parë. Ndërkohë, me rikthimin e tatimit progresiv në vitin 2014, të ardhurat buxhetore në raport me PBB-në ishin 26%. Deri në vitin 2019, të ardhurat buxhetore ishin vetëm sa 27.3% e PBB-së. Këto statistika dëshmojnë se ndikimi thelbësor në performancën fiskale nuk ka qenë ndryshimi i sistemit, por gjendja e ciklit të biznesit dhe eficientia e administrimit fiskal.

Qëllimi politikave fiskale është që, duke grumbulluar më shumë të ardhura, të shpërndajë më shumë përmes shpenzimeve publike në favor të grupeve më vulnerabël. Në fakt, qeverisjet e djathta janë karakterizuar nga një nivel më i lartë i mbështetjes sociale. Që prej vitit 1996 vendi ynë ka shpenzuar në programet e mirëqenies sociale mesatarisht 8.4%

të PBB-së, ndërsa që prej vitit 2007 kjo kategori shpenzimesh ka ardhur në rritje, duke e çuar faturën sociale në 10.4% të PBB-së. Aktualisht ajo ka rënë nën nivelin 9% të PBB-së, me gjithë retorikat ideologjike të majta të qeverisjes në fuqi.

Që nga koha e zbatimit të kësaj reforme kanë ndodhur zhvillime të rëndësishme në ekonomi dhe në shoqëri. Sigurisht që ka nevojë të studiohen më hollësisht ndikimet që ka për buxhetin çdo skenar për përmirësimin e sistemit tatimor, por qëllimi final duhet të jetë ai që sistemi të prodhojë një nivel të ardhurash mbi 32-35% të PBB-së, në mënyrë që të mundësohet një veprimtari më efektive e qeverive në mbështetjen e zhvillimit ekonomik e social të vendit. Mendoj se zgjedhjet *apriori* të një norme tatimi, thjesht duke u bazuar në logjikën e konkurrencës mes fqinjëve (*race to the bottom*), janë kundërproduktive dhe në afat të gjatë mund të dëmtojnë shoqërinë në tërësi. Ndërsa rivendosja e taksës së sheshtë, shoqëruar me përshtatës të nevojshëm për të zbutur efektet negative për grupet me të ardhura të ulëta, do të ishte ndihmuese për të rikthyer disiplinën fiskale dhe për të minimizuar evazionin fiskal, përcaktimi i normës tatimore duhet të jetë subjekt i llogaritjeve më rigorozë lidhur me nevojat e sotme dhe të ardhme buxhetore të vendit.

II

Siç e përmendëm edhe më sipër, historia ka dëshmuar se shkak kryesor i rritjes së shpenzimeve, për rrjedhojë edhe i taksave, kanë qenë luftërat. Për këtë arsye ndeshim nivelet më të ulëta historike si të

shpenzimeve dhe të taksave në shekullin XIX, dhe nivelet më të larta të tyre në shekullin XX. Shpenzimet publike u dyfishuan në vitet e Luftës së Parë Botërore dhe u katër-pesëfishuan në vitet e Luftës së Dytë Botërore. Ato vazhduan të rriten dhe të mbeten në nivele të larta edhe në vitet e pasluftës. Edhe në SHBA, që mbetet vendi me ekonominë e zhvilluar me nivelin më të ulët të shpenzimeve publike, këto janë rritur nga 16% e PBB-së në fillimet e viteve 1950, deri në mesatarisht 32% që janë aktualisht. Ndërsa në vendet e Europës shpenzimet publike u rritën nga nën 10% e PBB-së në vitet e paraluftës (në Angli, për shembull, ishin vetëm 6.5%), në 45-50% të PBB-së që janë aktualisht në të gjithë vendet europiane dhe madje edhe mbi 60% në vendet nordike.

Pse ky nivel i lartë shpenzimesh publike në kohët e sotme? Argumenti është *“shteti i mirëqenies”*, një term ky që i referohet bishopit të Kishës Anglikane të Manchesterit, në vitin 1928, William Temple. Krijimi i një shteti social dhe reformat që e shoqëruan këtë filozofi të inicuar nga Bismarku dhe të përqafuara në të gjithë kontinentin, çuan në ndryshime të thella të rolit të shtetit në ekonomi. Zhvillimi dhe modernizimi i infrastrukturës, pensionet dhe sigurimet shëndetësore, zhvillimi i një sistemi modern arsimor, patën dhe vazhdojnë të kenë rolin primar dhe përcaktues në nivelin e shtetit në ekonomi. Por, edhe vetë roli i shtetit si rregullator i cikleve të biznesit, i frymëzuar nga teoritë kejnsoniane që vazhduan të mbizotërojnë mendimin akademik dhe politikbërës deri në fillimin e viteve '80 të shekullit të kaluar, i dhanë botës atë profil që shohim sot në tipologjinë e financave publike. Në

fakt, instrumentet e teorisë kejnësiane ishin përgjigjja kryesore politike e vendeve të botës dhe në adresimin e krizës financiare globale të vitit 2008 dhe aktualisht të pandemisë së COVID-19. Shkolla e zgjedhjes publike sigurisht që jep një përgjigje edhe teorike të kësaj gjendjeje të shtetit të madh dhe të kudogjendur në jetën ekonomike e sociale, e lidhur kjo si me stadin e arritur të reformave sociale dhe mirëqenies së krijuar, ashtu dhe me lobimin e grupeve të interesave. Zyrtarët publikë gjejnë tek buxhetet gjithnjë e më të larta, dhe një motiv të ekzistencës së tyre.

III

Nëse konkluzioni i dalë nga analiza e sistemit të taksimit që parashtruam më sipër është se zbatimi i taksës së sheshtë është *pareto-eficiente*, një pyetje e natyrshme do të ishte: Atëherë përse vetëm disa vende e zbatojnë këtë reformë, ndërsa shumica e vendeve, veçanërisht ato të zhvilluara, vazhdojnë të zbatojnë sistemin progresiv? Pikërisht këtu duhet t'i referohemi ekonomisë politike, modelit të përfaqësimit politik të qytetarit votues.

Bentham, Tocqueville dhe John Stuart Mill janë ndër mendimtarët e parë të mëdhenj që kishin folur për një konflikt interesi që krijohet midis një elektorati që zgjerohet vazhdimisht dhe elitës së taksapaguesve. Në demokracinë moderne, thoshte një lord anglez, në analizë të fundit politika do të kontrollohet dhe do të vihet në shërbim të mazhorancës së elektoratit që janë kryesisht nga klasat e varfra, ndërsa të ardhurat sigurohen kryesisht nga një grup i vogël njerëzish të pasur.

Shumica e shteteve në shekullin XIX e lidhnin pjesëmarrjen në votime me kontributin në pagimin e taksave. Në Francë, deri në vitin 1830 pjesëmarrja në votime kushtëzohej nga një nivel minimal pagimi të tatimeve dhe ata që paguanin më shumë taksa kishin të drejtë të zgjidhnin deri në 40% të përfaqësimit në parlament. Edhe në Itali, Gjermani dhe vende të tjera europiane ka patur një lidhje midis pagimit të taksave dhe pjesëmarrjes në demokraci, lidhje që u thye pas Luftës së Parë Botërore. Sigurisht që në shoqëritë moderne demokratike kjo situatë ka ndryshuar. Numri i pjesëmarrësve në votime është shumë më i lartë se i tatimpaguesve. Në SHBA ky raport shkon nga 1.6 deri në 1.8:1; ndërsa në Shqipëri ky raport shkon në 2.6:1, që do të thotë se në gati 3 votues, vetëm njëri paguan taksa.

Sjellja e votuesit udhëhiqet nga sjellja e përfaqësimit të tij dhe kjo e fundit ndikohet nga ajo e zgjedhësve – duke nënkuptuar se ndikohet nga ekstremet e skedulit të taksave, të cilët duhet të rishpërndajnë në favor të fashës së të ardhurave të mesme – pikërisht e kundërta e asaj që krijon taksa e sheshtë. Kjo do të çonte në më shumë pabarazi, dhe fakti që kjo reformë u zbatua në vendet në tranzicion, të cilat kishin kaluar nga një sistem barazitizmi (në varfëri) tek një rritje e ndjeshme e pabarazisë (në pasuri), dhe që për rrjedhojë sipas modelit të sjelljes së votuesit, duhet të kishte ushtruar presion në rritje dhe jo në ulje të niveleve të sipërme marxhinale të tatimit mbi të ardhurat, e bën edhe më intrigues këtë veprim politik.

Argumenti themelor në këto rrethana besoj se lidhet kryesisht me inefficiencat e larta të administratës

fiskale, paaftësinë e saj për të zbatuar vjeljen e taksave duke shmangur evazionin e lartë fiskal i cili ka si burim kryesor grupet me të ardhura të larta. Fakti që edhe pse me norma pothuaj të barabarta të tatimit mbi të ardhurat me vendet e OECD-së, ekonomitë e Lindjes siguronin një nivel të ardhurash nga tatimet mbi të ardhurat personale mesatarisht 4.1% e PBB-së ndërsa vendet e OECD deri në 6.4% të PBB-së, dëshmojnë për një shkallë evazioni fiskal në tatimet mbi të ardhurat prej 36%. Sigurisht, që kjo praktikë dëshmon se po ndërtohet jo vetëm një shoqëri e pabarabartë, por dhe me parime morale të sëmura, gjë që mund të justifikojë plotësisht këtë ndryshim politik. Një tjetër argument është padyshim edhe nevoja e këtyre ekonomive në tranzicion për të ndërtuar një ekonomi tregu moderne dhe konkurruese, dhe është fakt i njohur në historinë e ekonomisë që taksat kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë një rol të ndjeshëm në këtë garë globale. Irlanda, për shembull, mbahet akoma si shembull ku vendosja e taksës mbi fitimin në 10% për disa dekada, ka luajtur një rol thelbësor dhe e bëri atë një ndër vendet më të suksesshme në progresin ekonomik e social të këtij vendi. Sidoqoftë, kjo garë konkurruese ka limitet e saj dhe siç e përmenda më herët, “gara për të prekur fundin” varet nga hapësira fiskale e një vendi dhe sfidat e tjera të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm.

IV

Nuk do të mjaftonte as edhe një material shumë më i gjerë studimor për të argumentuar rolin e politikave fiskale, neutralitetin, nxitjet pozitive apo

negative që ajo krijon në ekonomi. Besimi im është se ne kemi nevojë të përsosim si skemën e politikës së taksimit, por veçanërisht atë të administrimit fiskal. Nëse e majta për hir të ideologjisë i mbetet taksimit progresiv, atëherë ajo duhet ta zbatojë atë ndaj të gjitha llojeve të të ardhurave dhe jo vetëm të ardhurave nga puna. Ndërsa e djathta e cila beson se rikthimi i taksës së sheshtë është e dobishme për vendin, tezë për të cilën unë dakortësohem, duhet të zgjedhë një normë tatimore jo thjesht mbi logjikën e lojës së konkurrencës midis vendeve (gara për të prekur fundin, siç e shqyrtoam dhe më herët në këtë material), por bazuar në hapësirat fiskale që zotëron ekonomia jonë, nevojat buxhetore për mbështetjen e zhvillimit ekonomik e social dhe madhësinë e shtetit që dëshiron shoqëria.

Ne mund të ndajmë më shumë nëse kemi një ekonomi që krijon më shumë mirëqenie, përndryshe, do ta fusnim vendin dhe ekonominë e vet në një lojë me shumë zero, madje edhe negative.

Epilog

IDENTITETI I EKONOMISË SHQIPTARE NË RRJEDHËN E HISTORISË

Sikur një shqiptar i shekullit XIX të rilindte sot, në shekullin XX, a do ta kuptonte se kishte rilindur sërish në Shqipëri? Çfarë do ta kishte befasuar këtë njeri “parahistorik” kur të zgjohej në zenitin e epokës së globalizmit? Me siguri, gjëja e parë që mund të vinte re do të ishte se fermeri i hipur mbi një gomar (që do të ngjasonte me kohën e tij), do t’i ngjante i huaj vetëm se, teksa tërheq nga kërpeshi gomarin e ngarkuar me drithin që sapo e ka bluar për bukën, që gatuan akoma në shtëpi me çerep (prapë si në kohët e tij!), do të dallonte një instrument të çuditshëm, me të cilin ai flet me njerëz të padukshëm. Dhe ky është celulari. Nëse do të vizitonte një fshat çfarëdo, prapë këmbët do t’i bëheshin gjithë baltë; në ara do të shikonte fermerë që punojnë akoma me parmendë tokën bujqësore – tamam si në epokën homerike. Por mund të bënte habi me asfaltin që mbulon rrugët, të cilat lidhin fshatrat apo qytetet dhe makinat që nxjerrin tym dhe i japin ajrit një dozë mallkimi për mushkëritë e njerëzimit. Fermerët vazhdojnë të bëjnë të njëjtat gjëra si dhe në epokën e këtij njeriu të rilindur, edhe

pse sot përdorin (deri diku!) tek-tuk teknologji më të panjohura. Shtëpitë e fshatit, kopshtet, blegtoria dhe bimët e arave shumë pak mund të kenë ndryshuar, me përjashtim të ndonjë fidani të ri apo bimësie të re, fryt i revolucionit të bioteknologjisë.

Edhe jeta në qytet do t'i dukej po aq e zhurmshme dhe e rrëmujshme, ndonëse në disa kryeqendra urbane kjo është marramendëse. Zejtarë që punojnë gjithë ditën në treg, tregtarë që blejnë dhe shesin, të pamundur që lypin rrugës për të nxjerrë jetesën e ditës. Por do të habitej nga rrokaqiejt që zaptojnë qendrën e kryeqytetit, nga hotelet e famshme, ku gjatë ditës do të shihte zyrtarë me kollare, që e shkojnë pjesën më të madhe të ditës duke konsumuar pije të çuditshme (whiskey and brandy) në gota kristali. Do të mahnitej kur të shikonte njerëzit që rrugës duket sikur flasin me vete. Por edhe më befasuese do të ishte kur të mësonte se ushqimet e gatuar si në kohën e tij, me enë prej bakri apo prej balte, dhe perime të kopshtit, sot do të konsideroheshin një mall luksi dhe do të kushtonin shumë më shtrenjtë se mënyra moderne e të gatuarit dhe të ngrënit. Veshjet prej cohe liri të kohës së tij sot kushtojnë shumëfish më shtrenjtë se veshjet e gjithfarëllojshme, që gjenden me bollëk nëpër vitrina dyqanesh; se sandalet prej lëkure lope janë po aq në modë sa dhe në epokën e tij.

Vizitori ynë do ta ndiente veten edhe pjesë të kohës së tij, por dhe me shumë gjëra të çuditshme të panjohura për të. Po të lexosh kujtimet e kronikanit të famshëm turk Evlia Çelebi për udhëtimet nëpër Shqipërinë e shekullit XVII, e ndien dhe sot veten

sikur e ke jetuar atë kohë: pamjet tipike të një fshati shqiptar apo të një qendre urbane, që të ngjasojnë me jetën e ditëve të sotme.

Të Shqipëria e sotme gjen si të shkuarën e largët, edhe modernitetin e botës së zhvilluar; varfërinë dhe pasurinë që kanë bashkëjetuar brenda një mëhalle (edhe pse sot ka filluar fenomeni i krijimit të zonave të ndara të banimit – lindja e Rolling Hills); kopshtet gjithë lule dhe parqet çlodhëse krah papastërtive dhe mbetjeve që dekompozohen rrugëve dhe të irritojnë shqisat e të nuhaturit, përveçse krijojnë shqetësime serioze shëndetësore. E shkuara dhe moderniteti nuk ngjanë të huaja për njëra-tjetrën.

Përtej kësaj paraqitjeje shumë shkurt me trajta letrare të rrugës së ekonomisë, pyetja se çfarë fizionomie karakterizon ekonominë e vendit tonë është interesante si një moment reflektimi. A kemi një identitet tonin, tipik shqiptar, sikurse besojmë se kemi dhe një ADN të veçantë, që na bën të dallueshëm edhe në raport me fqinjët tanë? Madje, shpeshherë, pëshpëritet se tek kjo ADN e veçantë duhet të gjejmë dhe shkakun e dështimeve tona ekonomike, sociale dhe politike. Le të shohim pak dhe në historinë tonë të afërt.

Sistemi që kemi arritur të ndërtojmë në këto 30 vitet e fundit karakterizohet nga këto tipare themelore: modernizimi (për aq sa mund të flasim) është mbështetur tek investimet e huaja; inovacioni në ekonomi është shumë i dobët; sistemi financiar është akoma i pazhvilluar (në kuptimin e ndërmjetësimit financiar me sektorin privat) dhe pothuajse tërësisht i

bazuar te bankat; ruajtja e konkurrencës mundësohet vetëm në sajë të pagave të ulëta; partneriteti social është i dobët; sindikatat e punëtorëve janë inekzistente dhe punëtorët janë të cenusur përballë punëdhënësve. Në të gjitha raportet e konkurrencës globale, Shqipëria merr gjithnjë një notë shumë të lartë për lirinë e tregut të punës – e cila buron nga mungesa e organizimit sindikal dhe partneriteti i dobët social; dhe notën më të ulët të treguesit që tipizojnë një ekonomi moderne, të dijes, siç është inovacioni, përdorimi i teknologjisë dhe sofistikimi i biznesit.

Dominimi i kapitalit të huaj në modernizimin e jetës ekonomike të vendit i atribuohet para së gjithash mungesës së kapitalit (+dija) dhe aftësive menaxheriale. Për këtë arsye, në industritë kryesore të vendit janë investitorët e huaj ata që po lënë gjurmë. Pra, ekonomia e tregut sot është ajo e një tregu të varur nga jashtë. Në një kuptim, edhe sistemi socialist ishte një sistem i një socializmi të mbajtur në këmbë nga ndihmat e huaja, që buronin nga aleancat e varësisë politike. Ideja e një sistemi ekonomik të tregut të varur (dependent market economy)¹⁰⁸ është një tezë e artikuluar sot nga studiues të ndryshëm të sistemeve politike.

Edhe pse ka disa përpjekje nga kapitalistë vendës për të krijuar struktura investimesh më të qëndrueshme, sjellja tipike e kapitalistëve të rinj është

108 Shif për një përmbledhje: CornelBan, 2013, FromCocktail-toDependence:RevisitingtheFoundationsof DependentMarketEconomies, GEGI Working papers, Boston University

orientimi drejt aktiviteteve të shfrytëzimit të pasurive natyrore (energji, miniera, valët e telekomunikacionit, agroindustri, ujëra) dhe pothuajse nuk ndesh asnjë rast të investimeve në industrinë që karakterizohen nga një shkallë e lartë inovacioni dhe sofistikimi të bizneseve. Dhe për ta rënduar akoma më shumë këtë sjellje, ekonomia po përqendrohet në një grup shumë të kufizuar individësh, të cilët prej kohësh po diktojnë edhe politikën. Nëse një sipërmarrës dikur ishte fokusuar në industrinë e naftës apo të tregtisë, apo të ndërtimit të themi, sot atë e gjen aktor të rëndësishëm dhe në infrastrukturë, hoteleri, financë, ndërtim, edukim etj. Individë të veçantë që kapin pozicione dominuese në një mori industrish, mund të përbëjnë një problem jo vetëm për gjendjen e konkurrencës në vend, por, mbi të gjitha, për rreziqet me të cilat mund të përballet ekonomia në raste dështimesh të individit. Nuk është rastësi që 30 sipërmarrës të mëdhenj, që kishin një ekspozim aq të lartë ndaj bankave vendëse me kreditë e marra për të blerë asete apo zgjeruar aktivitetet e tyre përtej racionale ekonomike, krijuan kosto të larta për ristrukturimin e sistemit bankar në vend kur kreditë e humbura arritën në mbi 25% të totalit të portofolit. Fenomeni “too big to fail”, që e ndeshëm në industrinë financiare në vendet e zhvilluara, në Shqipëri e ndeshim te bizneset që operojnë në sektorët realë, një fenomen që bota e zhvilluar i ka dhënë fund që në vitet 1900. Prezenca e monopoleve në Shqipëri është aq e dukshme në çdo sferë të veprimtarisë ekonomike, sa nuk do të ishte e nevojshme të kishim një autoritet antimonopol për ta

provuar këtë; e provojmë vetë çdo ditë që bëjmë blerje nëpër tregtores, kur të njëjtin mall e gjejmë me çmime më të larta sa në vendet perëndimore, prej nga vijnë këto mallra.

Krijimi i këtyre monopoleve po bëhet barrierë serioze edhe për investimet e huaja, duke e stopuar kështu modernizimin e mëtejshëm ekonomik. Prej vitesh, vendi nuk po tërheq më investitorë të rëndësishëm në industrinë e vlerës së lartë të shtuar, duke krijuar një shqetësim mjaft serioz për gjendjen e sotme të manifakturës në vend. Shqipëria, bashkë me vendin e vogël, Malin e Zi, janë dy vendet e rajonit ku manifaktura është inekzistente dhe ku eksportet dominohen nga produkte me një vlerë të shtuar në nivele shumë të ulëta. Statistikat e tregtisë së jashtme dëshmojnë se eksportet e produkteve të teknologjisë së mesme dhe të lartë nga Shqipëria zënë vetëm 4% të totalit të eksporteve, ndërsa Mali i Zi 11%; kurse në Maqedoni ato zënë 27% dhe Serbi 32%. Ky progres i Maqedonisë dhe Serbisë i dedikohet investimeve të huaja në industrinë automative dhe elektrike. Në kujtimet e tij, Eqerem bej Vlora sjell një episod të një investitori hungarez, që kishte mbërritur në fushat e Myzeqesë të ndërtonte një fermë moderne dhe, pasi kishte sjellë pajisjet më moderne të kohës, “paria” lokale e kishte përzënë. Historia duket sikur përsëritet. Edhe sot vendi ynë ka luksin të përzërë investitorë nga më seriozët – disa prej tyre, madje, duke i tërhequr zvarrë dhe gjymtuar rëndë.

Funksionimi i tregut të punës, mungesa e sindikatave dhe abuzimet e vazhdueshme me kushtet

e punës, përfshirë dhe nivelet shumë të ulëta të pagave, janë pasojë e një shoqërie civile të dobët, por dhe e mungesës së traditës në organizimin sindikal. Sot Shqipëria ka nivelet më të ulëta të pagave në rajon dhe fakti se gati 50% e të punësuarve nuk paguajnë tatim mbi të ardhurat personale, është dëshmi e punësimit varfërues të qytetarëve. Gati gjysma e popullsisë jeton me 5\$/ditë (sipas paritetit të fuqisë blerëse ose 2.5\$ në terma nominalë), që është niveli botëror i varfërisë. Kushtet e punës janë gjithashtu problematike jo vetëm në miniera, por edhe në industrinë e manufakturës. Helmime, ndotje ambientale, orare pune që shkojnë edhe deri në 50 orë në javë, janë një realitet në shumë sipërmarrje private. Mungesa e institucioneve funksionuese, e ndjekur nga një shoqëri civile mjaft e dobët, bëjnë që funksionimi i tregut të punës të jetë shqetësues. Adam Smithi kishte shkruar që para 250 vitesh se është në interesin e vetë kapitalistëve një ndarje e drejtë dhe e ndershme e të ardhurave të krijuara në ekonomi, midis fitimeve të pronarëve të kapitalit dhe pagës së punëtorëve. Kjo është një tezë e testuar në mënyrë empirike nga mjaft studime dhe nga të dhënat anekdotike të shumë sipërmarrjeve të dalluara dhe në Shqipëri.

Sistemi që kemi ndërtuar në këta tridhjetë vjet i atribuohet sa kushteve fillestare të tranzicionit, po aq dhe trashëgimisë më të hershme të vendit, traditës historike të tij. Pavarësisht natyrës së sistemit ekonomik dhe politik, varësia nga jashtë ka qenë tipar dominues dhe kusht themelor për mbijetesën ekonomike të vendit gjatë gjithë historisë. Akoma dhe

sot vendi nuk ka mundur të integrohet në zinxhirin global prodhues të vlerës së shtuar, prej ku do të përcaktohej dhe identiteti ekonomik i vendit.

Niveli i ulët i produktivitetit dhe vlerës së shtuar bën që vendi të investojë shumë pak në edukim, kërkim dhe zhvillim, shërbime sociale, gjë që do të na mbajë të mbërthyer fort në sistemin e varësisë nga kapitali i huaj edhe në të ardhmen. Investimet në kërkim-zhvillim janë inekzistente. Madje, në të gjithë Ballkanin vetëm Serbia dhe Maqedonia figurojnë në European Innovation Scoreboard dhe ku vetëm Serbia renditet si një vend me një nivel të moderuar inovacioni. Sa kohë që kapitali i huaj nuk po përmbush rolin e tij të efektit “spillover”, siç predikojnë studiuesit e ekonomisë – të konvergimit të ekonomisë dhe strukturave të brendshme të biznesit me ato të vendeve të zhvilluara – raporti i varësisë nga jashtë do të dominojë edhe në dekadat e ardhshme.

Struktura ekonomike e vendit tonë është atipike për një ekonomi të një vendi në zhvillim. Në raport me të gjithë vendet e Ballkanit, vendi ynë ka peshën më të lartë të bujqësisë në prodhimin kombëtar, me 22%; vendi i dytë vjen Kosova me 14.5% dhe Maqedonia me 11%. Këtë nivel kaq të lartë të prodhimit bujqësor në strukturën ekonomike e ndeshim në Angli, në fillimet e viteve 1800, kur sapo kishte nisur Revolucioni Industrial. Industria, që është një indikator i industrializimit me të cilin matet dhe moderniteti i një shoqërie, në Shqipëri zë vetëm 14% të prodhimit kombëtar, në Kosovë zë 20%, në Maqedoni 18% dhe në Serbi 27%.

Ndërtimi i një shteti demokratik funksional mbetet dështimi më i madh dhe arsyeja themelore edhe për dështimet ekonomike. Eficienca e qeverisjes, cilësia e ligjit dhe e rregullimit të jetës ekonomike dhe sociale, kontrolli i korrupsionit, dëgjimi i zërit të qytetarëve dhe llogaridhënia dëshmojnë se janë shumë larg edhe me standardet e vendeve tona përreth. Ndërsa mesatarja e indikatorit të qeverisjes (GGI) në vendet baltike është 70 - 80% dhe në vendet e Ballkanit është 60%, Shqipëria ka një indeks rreth 50%. Ecuria e qeverisjes sigurisht që është fort e korreluar me cilësinë e gjithë tranzicionit, pasi në analizë të fundit, qeverisje e mirë apo e dobët nënkupton nivelin e kapaciteteve për të administruar politika dhe reforma. Në një studim të fundit (2016) të Global Development Network Southeast Europe, një projekt i Institutit të Vjenës për Ekonomiksin Ndërkombëtar arritën në përfundimin se: “dështimet në proceset e ndërtimit të shtetit kanë qenë përgjegjëset kryesore për dështimet në rrugën e industrializimit”.

Shkurt, paaftësia e vendit për të ndërtuar një qeverisje eficiente, ku funksion shteti ligjor, llogaridhënia dhe dëgjimi i zërit të qytetarëve, kanë qenë barriera më serioze për të shënuar sukses në ndërtimin e një strukture ekonomike të qëndrueshme dhe të përngjashme me një vend që është në rrugën e modernizimit industrial. Tregjet mbeten shumë të kapura dhe konkurrenca e lirë – çelësi i krijimit të një ekonomie të shëndetshme – larg të qenit një realitet biznesor. Përtej ndërtimeve cilësore dhe hoteleve luksoze, që kanë transformuar urbanizimin e vendit,

EPILOG / IDENTITETI I EKONOMISË SHQIPTARE
NË RRJEDHËN E HISTORISË

jeta e vërtetë ekonomike ngjan akoma me atë të një vendi protoindustrial, që sapo ka hyrë në fazë dhe se suksesi në këtë sipërmarrje do të varet krejtësisht nga cilësia e qeverisjes që do të zgjedhim ne vetë.

LITERATURA

1. Douglass North, 1990, *Institutions, Institutional Change and Economic Performance*, Cambridge University Press.
2. Daniel Chirot, 1989, *"The origins of backwardness in Eastern Europe: Economics and Politics from the middle ages until the early twentieth century"*, Oxford University Press.
3. Gregory Clark, 2008, *A Farewell to Alms: A Brief Economic History of the World*; Princeton University Press
4. Cituar nga, Todd G Buchholz, 2007, *Ide të Gjalla të Ekonomistëve të Vdekur*", ISP&Dita 2000.
5. Gregory Clark, 2007, *"A Farewell to Alms: A Brief Economic History of the World"*, Princeton University Press.
6. Niall Ferguson, *"The Cash nexus: Money and Power in the Modern World 1700-2000"*, Penguin Books, 2001, fq.5
7. Paul Bairoch and Maurice Lévy-Leboyer, 1981, *Disparities in Economic Development Since the Industrial Revolution*, Palgrave: Macmillan, 1981.
8. David Landes, 1995, *"The wealth and poverty of nations Why Some are So Rich and Some So Poor"*, Little, Brown

LITERATURA

9. Douglass C. North, 1992, TRANSACTION COSTS, INSTITUTIONS, AND ECONOMIC PERFORMANCE, International Center for Economic Growth,
10. Sevket Pamuk, The Evolution of Factor Markets in the Ottoman Empire, 1500-1800; <https://www.lse.ac.uk/Economic-History/Assets/Documents/Research/GEHN/GEHNConferences/conf6/Conf6-SPamuk.pdf>
11. Rostow W.W, 1956, "The Take-Off into Self-Sustained Growth", Economic Journal 66.
12. Aleksandër Gerschenkron (1962), *Economic Backwardness in the Historical Perspective*
13. Nicholas Craft, 2013, Twentieth Century Growth; working paper; Warwick University;
14. Michael Trebilcock, "Let the Market Decide: The Case Against Mandatory Pick-and-Pay," (with Lawson Hunter and Edward Iacobucci) (September 25, 2014). C.D. Howe Institute e-Brief No. 184.
15. Dani Rodrik, 1996, Coordination failures and government policy: A model with applications to East Asia and Eastern Europe; Journal of International Economics, 1996, vol. 40, issue 1-2, 1-22
16. Alexander Gray, "The Development of Economic Doctrine: An Introduction Survey", Longmans, Green and Co Ltd., London, 1931.
17. Joseph A Schumpeter, 1954, *History of Economic Analysis*, Oxford University Press.

18. Antoine Murphy, 1997, *John Law: Economic Theorist and Policy-maker*; Clarendon Press
19. Jonathan Levy, 2021, *"Ages of American Capitalism: A history of the United States"*, Random House
20. Sevket Pamuk, *A Monetary History of the Ottoman Empire*, Cambridge University Press, 2000.
21. Fatih Ermiş, 2014, *A History of Ottoman Economic Thought: Developments before the nineteenth century*, Routledge
22. Mehmet Genç, 1989, "State and Economy in the Ottoman Empire"
23. Robert Brenner, 1989, "Economic Backwardness in Eastern Europe in light of development in the West", in "The Origins of Backwardness in Eastern Europe: Economics and Politics from the Middle Ages until the early twentieth century", edited by Daniel Chirot, University of California Press, 1989
24. O'Brien, Leandro Prados de la Escosura, 2008, *Agricultural Productivity and European Industrialization, 1890-1980*, *The Economic History Review* 45(3):514 - 536
25. PéterGunst, 1989, *Agrarian Systems of Central and Eastern Europe*, tekThe origins of backwardness of Eastern Europe, University of California Press.
26. Halil İnalçık, 1994, *An Economic and Social History of the Ottoman Empire, 1300–1914*; Cambridge University Press
27. FikretAdanir, 1989, "Tradition and rural change in South Eastern Europe during Ottoman Rule", in

LITERATURA

The Origins of Backwardness in Eastern Europe,
University of California Press

28. J.J Best, 1842, Excursions in Albania: comprising a description of the wild boar, deer, and woodcock shooting in that country: and a journey from thence to Thessalonica & Constantinople and up the Danube to Pest; London: Wm. H. Allen & Co.
29. Injaz Zamputi, Akademia e Shkencave, v. 1989, Dokumente të shekujve XVI-XVII për Historinë e Shqipërisë, në 3 vëllime
30. EvliaCelebi, "Shqipëria 350 vjet më parë", Horizonte 2000; botimi 1, Shkodra 1930.
31. Eugenio Barbarich, 1905, Albania (Monografia antropogeografica), Roma, Enrico Voghera Editore
32. Alexander Gershenkron, "Economic Backwardness in Historical Perspective", 1952
33. Rosario Romeo, "Risorgimento e capitalismo", 1959, Laterza
34. K. Mandelbaum, 1945, The industrialisation of backward areas; Oxford: Blackwell, 1945
35. Michael Palaret, 1997, The Balkan economies c. 1800-1914: Evolution without development, Cambridge University Press
36. IliazFishta, Veniamin Toci, Gjendjaekonomike e Shqipërisë në vitet 1912-1944,
37. Michael Palaret, University of Edinburgh, "The Balkan Economies c. 1800-1914. Evolution without development", Cambridge University Press, 1997.

RRITJE PA ZHVILLIM
SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

38. Iliaz Fishta, Sistemi monetar dhe i kreditit në Shqipëri, fq. 32
39. Craft, 2001, Historical perspectives on development,, Frontiers of Economic Development, the future in perspective, fq. 314.
40. Beqir Meta, Politikatatimore e shtetitshqiptar, 1925-1939.
41. Gino Borgatta, Moneta e Credito in Albania, shkrime të vitit 1910-1920
42. Haxhi Shkoza, Financat e Shqipërisë (1839-1934),
43. Ludwig von Mises, 1952, "Socialism: An economic and sociological analysis"
44. Friedrich von Hayek, 1944, "The Road to Serfdom"
45. Milovan Djilas, 1961, Conversations with Stalin", Harcourt Brace Company
46. Josef Schumpeter, Capitalism, Socialism and Democracy (1942)
47. Karl Mannheim, Man and Society in the Age of Reconstruction (1940)
48. Karl Polanyi, "The Great Transformation" (1942)
49. Thomas Piketty, 2014, "Capital in 21st century"
50. Mihail Gorbacov, 2015, "The new Russia in a changing world"
51. Ivan Szelenyi dhe Balasz Szelenyi (1994), "Why socialism failed: Toward a theory of system breakdown. Causes of disintegration of East European State Socialism", Theory and Society, April, 1994.

LITERATURA

52. Vonyó, Tamás; Klein, Alexander (2017): Why did socialist economies fail?, School of Economics Discussion Papers, No. 1708, University of Kent, School of Economics, Canterbury
53. Popov Vladimir V. (2010), "Life Cycle of the Centrally Planned Economy: Why Soviet Growth Rates Peaked in the 1950s", CEFIR and NES Working Paper n. 152, November <http://pages.nes.ru/vpopov/documents/Soviet%20Growth-Boston.pdf>
54. Victor Nee & Peng Lian (1994), "Sleeping with the enemy: A dynamic model of declining political commitment in state socialism", Theory and Society volume 23, pages 253–296 (1994)
55. Karl Marksi, 1848, Manifesti Komunist
56. Josif Stalin, 1952, Probleme Ekonomike të Socializmit në Bashkimin Sovjetik
57. Domenico Mario Nuti, 2018, The rise and fall of socialism, DOC Research Institute
58. Wlodzimierz Brus, 1961, "Probleme të Përgjithshme të Funksionimit të Ekonomisë Socialiste"
59. Rudolf Bahro, 1982, Socialism and Survival,
60. Leon Walras, 1899, Elements of Pure Economics, (përkthim I v.)1954.
61. Alfred Marshall, 1890, Principles of Economics, Cambridge University
62. Friedrich August von Hayek, "The Use of Knowledge in Society," American Economic Review, XXXV, No. 4; September, 1945, pp. 519–30.

63. Domenico Mario Nuti, (2018), The rise and fall of socialism, Special Report, DOC Research Institute.
64. Branko Milanovic, Peter H. Lindert, Jeffrey G. Williamson, 2007, MEASURING ANCIENT INEQUALITY, Working Paper 13550 <http://www.nber.org/papers/w13550>
65. Grier, Kevin B.; Grier, Robin M. (2020). "The Washington Consensus Works: Causal Effects of Reform, 1970-2015". *Journal of Comparative Economics*. 49: 59–72. doi:10.1016/j.jce.2020.09.001. ISSN 0147-5967.
66. Goldfajn, Ilan; Martínez, Lorenza; Valdés, Rodrigo O. (2021). "Washington Consensus in Latin America: From Raw Model to Straw Man". *Journal of Economic Perspectives*. 35 (3): 109–132. doi:10.1257/jep.35.3.109. ISSN 0895-3309
67. Archibong, Belinda; Coulibaly, Brahim; Okonjo-Iweala, Ngozi (2021). "Washington Consensus Reforms and Lessons for Economic Performance in Sub-Saharan Africa". *Journal of Economic Perspectives*. 35 (3): 133–156. doi: 10.1257/jep.35.3.133. ISSN 0895-3309.
68. Adam Smith, "Pasuria e Kombeve" Dita 2000
69. Rothbard Murray, 1995, An Austrian perspective on the history of economic thought, Ludwig von Mises Institute
70. G. Edward Griffin, 1994, "The Creature from Jekyll Island - a second look at the Federal Reserve"
71. Paul M Warburg, 1930, "The Federal Reserve System, Its Origin and Growth" in two volumes

LITERATURA

(The Macmillan Company)

72. Kenichi O'Hmae, 1998, Bota pa Kufij, Dita 2000
73. Hans-Peter Schwarz, 2017, Shënime për Adenauerin – një portret i Adenauerit, Botim i Fondacionit Konrad Adenauer, Tiranë.
74. The World Bank, 2002, "Transition: The first Ten Years - Analysis and Lessons for Eastern Europe and the Former Soviet Union"
75. Shqipëria: Ruajtja e Rritjes së Qëndrueshme edhe përtej Tranzicionit, Memorandum Ekonomik i Bankës Botërore për Shqipërinë, Raport Nr. 29257-AL, Dhjetor 2004
76. Gerald Mayer, 2001, The Old Generation of Development Economists and the New, in *Frontiers of Development Economics: The future in perspective*.
77. Djankov and Murrell's, 2000, *The Determinants of Enterprise Restructuring in Transition: An Assessment of the Evidence*. Washington, D.C.: World Bank.
78. GencRuli, Artan Hoxha, *Social Business and Social Exclusion in Transition Countries: The case of Albania*.
79. Daron Acemoglu and Simon Johnson, 2005, *Unbundling Institutions*, (*Journal of Political Economy*, 2005, vol. 113, no. 5)
80. Selami Xhepa, Adrian Civici, 2020, *Opinione dhe Qëndrime të Publikut mbi Funksonimin e Sistemit Ekonomik dhe Rolin e Shtetit në Shoqëri, financiar nga Fondacioni Friedrich Ebert, Tiranë*

RRITJE PA ZHVILLIM
SHKAQET E DËSHTIMEVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

81. Charles Mackay, 1841, *Memoirs of the Extraordinary Popular Delusions and the Madness of the Crowd*,
82. George Akerlof and Robert J. Shiller, 2015, *Phishing for Phools: The Economics of Manipulation and Deception*, Princeton University Press.
83. Nassim Nicholas Taleb, 2015, *Antifragile: Things That Gain from Disorder*, Random House Publishing Group
84. Daniel Kahneman, 2012, *Thinking, Fast and Slow*, Farrar, Straus and Giroux
85. Thorstein Veblen, 2007, *The theory of the leisure class*, Oxford University Press.
86. J. Bradford DeLong and Lawrence H. Summers, 2001, *The 'New Economy': Background, Historical Perspective, Questions, and Speculations*, Federal Reserve Bank of Kansas City's symposium, "Economic Policy for the Information Economy," at Jackson Hole, Wyoming
87. Nassim Nicholas Taleb, 2014, *The Black Swan: The Impact of the Highly Improbable*, Botim në shqip nga Dita 2000
88. Benoit Mandelbrot and Richard L. Hudson, 2006, *The Misbehavior of Markets: A Fractal View of Financial Turbulence*, Random House
89. Nail Ferguson, 2001, *The cash nexus: Money and power in the modern world 1700-2000*; pg. 42-3

ISBN